



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Nr. i Org. 12 - Jedinica Org. unit AMMK Nr. Prot. 3522/17
Broj. Prot. Prot. No. 12, 07, 17
Nr. i faqeve - 02 - Data Datum 12, 07, 17
Broj. stranae No. pages Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS **KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE** **KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY**

DATE/A:	07.07.2017				
REFERENC-Ë:	___/AMMK/2017				
PËR/ZA/TO:	Dr.sc. Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv - AMMK				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	Grupi Punues me Vendim Nr. Prot. 2167/16 datë 10.05.2016 për hartimin e Arsyeshmerisë profesionale për Kanionin e Drinit të Bardhë – Ura e Fshejtë				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim për përgatitjen e Arsyeshmerisë profesionale për Kanionin e Drinit të Bardhë – Ura e Fshejtë				
Nr. i zyrës:	1403	Lokacioni:	Prishtinë	Data:	07/07/2017
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOSI/FOR ACTION					☐
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☒
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☐
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					☐
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					☐
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					☐
SIPAS DISKUTIMIT/KAKO JE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					☐
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					☒
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☐
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					



Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit të, Adresa: Rr. L. Haradinaj, ish Rilindja kati XV, 10090 Prishtinë
Tel. 038 211 685, e-mail: KEPA@ks-gov.net, www.akmm-rks.net

I nderuari z. Kryeshef,

Grupi Punues me Vendimin Nr. Prot. 2167/16 datë 10.05.2016 ka përgatitur Arsyeshmërinë profesionale për Kanionin e Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë.

Duke u bazuar në ndryshimin e rrethanave në teren, gjendjen ekzistuese të kësaj zone të mbrojtur si dhe kërkesën nga komuna e Rahovecit (12 Nr. 130, datë 04.05.2016) për përgatitjen e një Vlerësimi profesional për këtë zone, është konstatuar nevoja për një rivlerësim të gjendjes në këtë zone dhe rikategorizimin e saj sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233).

Sipas këtij Ligji, neni 20, hartimi i arsyeshmërisë profesionale të vlerave të natyrës është përgjegjësi dhe detyrë e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Gjithashtu sipas nenit 8., paragrafi 1., kësaj zone të mbrojtur i përshtatet kategoria Monument Natyre.

Bazuar në Nenin 19, pika 3 të këtij Ligji dhe vlerave natyrore të kësaj zone, Grupi Punues, propozon që kjo zonë me kufijtë e ri (fillimisht vetëm për territorin e Komunës së Rahovecit e me krijimin e rrethanave të përshtatshme edhe për atë të Gjakovës) propozohet të mbetet në kategorinë e Monumentit Natyror dhe përsëri të nxirren vendime të reja nga ana e dy Komunave përkatëse për mbrojtjen e pjesëve të veta territoriale.

Të bashkangjitur e gjeni këtë Arsyeshmëri profesionale.

Me respekt,

Anëtarë e Grupi punues:

Qenan Maxhuni – kryesues

Nexhmije Kamberi – anëtare


Valmira Gashi – anëtare

Rizah Murseli – anëtar

Fatlije Buza – anëtare

Fehmi Hoxha – anëtar

Fatos Deva – anëtar





Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

**Propozim profesional
për rikategorizimin e Monumentit të Natyrës
“Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë”**

Prishtine, 2017

Propozimi profesional për rikategorizimin e Monumentit të Natyrës “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë” është hartuar nga Grupi Punues me Vendimin Nr. Prot. 2167/16 datë 10.05.2016.

Sipas këtij Vendimi anëtar të këtij Grupi punues kanë qenë:

Qenan Maxhuni, zyrtar për biodiversitet në IKMN – kryesues

Nexhmije Kamberi, zyrtare për florë në IKMN - anëtare

Valmira Gashi, zyrtare për shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore në DMM - anëtare

Rizah Murseli, hulumtues profesional në IPH – anëtar

Fatlije Buza, zyrtare për cilësinë e ujërave në DU – anëtare

Fehmi Hoxha, drejtor për Urbanizëm në K. e Rahovecit - anëtar

Fatos Deda, bashkëpunëtor profesional për mjedis në K. e Gjakovës - anëtar

PËRMBAJTJA:

• HYRJE	4
• BAZA LIGJORE	5
• OBJEKTIVAT	7
• KARAKTERISTIKAT FIZIKO - GJEOGRAFIKE	8
○ Pozita gjeografike dhe madhësia e territorit	8
○ Përbërja gjeologjike	11
• BIODIVERSITETI	13
○ Flora dhe vegjetacioni	13
○ Fauna	19
• TRASHEGIMIA KULTURORE DHE ASPEKTET REKREATIVO - SPORTIVE	23
• GJENDJA	26
• MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI ME ZONËN	28
• PERFUNDIM	29
• LITERATURA	30

HYRJE

Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë është monument natyre me karakter hidro-geomorfologjik. Shtrihet në pjesën qendrore të Dukagjinit, në rrjedhjen e mesme të Drinit të Bardhë dhe përfaqëson një vlerë posaçërisht të lartë natyrore, si për nga aspekti geomorfologjik, gjeologjik dhe hidrografik, ashtu edhe për nga veçoritë floristike, vegjetative dhe faunistike.

Për shkak të vlerave natyrore, ky monument natyre është vënë nën mbrojtje ligjore në vitin 1986. Meqenëse kjo zonë ndodhet në kufirin administrative ndërmjet territorit të komunës së Gjakovës dhe asaj të Rahovecit kuvendet e këtyre dy komunave asokohe janë marrë vesh që njëkohësisht të marrin vendim mbi shpalljen e territoreve të tyre veç e veç si monument natyre me qëllim që monumenti si tërësi të merr trajtimin e merituar.

Duke u bazuar në ndryshimin e rrethanave në teren, gjendjen ekzistuese të kësaj zone të mbrojtur si dhe kërkesën nga komuna e Rahovecit (12 Nr. 130, datë 04.05.2016) për përgatitjen e një Vlerësimi profesional për këtë zonë, është konstatuar nevoja për një rivlerësim të gjendjes në këtë zonë përmes hartimit të një Propozimi profesional për rikategorizimin e saj sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233). Sipas këtij Ligji (neni 20), hartimi i arsyeshmërisë profesionale të vlerave të natyrës është përgjegjësi dhe detyrë e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Të dhënat e prezantuara në këtë Propozim profesional janë mbledhur nga arkiva e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës dhe komunave përkatëse si dhe gjatë vizitave dhe ekspeditave hulumtuese në terren gjatë vitit 2016 - 2017 nga ana e Grupit Punues në bashkëpunim me ekspertë të fushave përkatëse.

BAZA LIGJORE

Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë gëzon status të mbrojtjes ligjore që nga viti 1986 në kategorinë e Monumentit të Natyrës (Vendimi i K.K. të Gjakovës 01 nr. 011-10 i datës 05.03.1986 dhe Vendimi i K. K. të Rahovecit 01 nr. 352-13 i datës 09.04.1986).

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233), *Monumenti i Natyrës është pjesë ose tërësi e pjesëve të pandryshuara të natyrës së gjallë ose të vdekur i cili ka vlerë ekologjike, shkencore, estetike ose kulturo-historike dhe/ose vlera turistike. Monumenti i natyrës mundet me qenë gjeologjik - paleontologjik, mineralogjik, hidrologjik, strukture gjeologjike, sediment, gjeomorfologjik - shpella, humnera, muret shkëmbore, hidrologjik - burime, ujë rrjedhë, ujëvarë, liqe, botanik - ekzemplarë të rrallë ose të rëndësishëm të botës bimore për një lokalitet, lokalitet i vogël botanik ose zoologjik i rëndësishëm për vlerat e tij shkencore. Në monumentin e natyrës dhe në afërsi të drejtpërdrejt të tij që është pjesë përbërëse e zonës së mbrojtur nuk lejohen veprimtaritë të cilat rrezikojnë karakteristikat dhe vlerat e tij.*

Shpalljen e vlerës së mbrojtur të natyrës Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë e bënë kuvendi i komunës në territorin e së cilës gjendet, pas marrjes paraprake të pëlqimit nga Ministria. Propozimi i aktit për shpallje mbështetet në propozimin profesional të hartuar nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, me të cilin përcaktohen vlerat e zonës e cila propozohet të mbrohet, mënyra e administrimit me atë zonë si dhe propozimi i organit i cili e nxjerr aktin për shpallje për sigurimin e mjeteve për administrim me zonën e mbrojtur.

Për propozimin e shpalljes së zonës së mbrojtur informohet publiku. Procedurën e qasjes publike për shpalljen e monumenteve të natyrës e organizon dhe e udhëheqë kuvendi komunal në territorin e së cilës gjendet zona dhe zgjatë më së paku tridhjetë (30) ditë.

Propozuesi i aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur ka detyrim që të deklarohet për propozimet që kanë dalë nga qasja e publikut, kurse vërejtjet e parashtruara nga debati bëhen pjesë përbërëse e dokumentacionit në të cilin bazohet propozimi për shpallje.

Lajmërimi për qasjen publike shpallet në mjetet e informimit publik dhe në ueb faqen e Komunës dhe përmban shënimet, dokumentacionin hartografik dhe dokumentacion tjetër lidhur me zonën e propozuar për vënie në mbrojtje, afatin kohor për shqyrtim, datën e përfundimit të pranimit të komenteve dhe referencat e organit i cili i pranon komentet.

Komunat në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Strategjinë, programin e mbrojtjes së natyrës dhe dokumentet e rregullimit hapësinor janë të detyruara që të:

- kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet;
- shpallin zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente;
- sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat janë kompetente;
- marrin pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi;
- marrin pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente;
- kujdesen për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe japin mbështetje dhe kujdesen për shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës;
- përcjellin gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe për atë Ministrisë dhe Institutit i paraqesin raport;
- mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës;
- informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë dhe për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë;
- ofrojnë ndihmë profesionale dhe ndihmë tjetër organeve të pushtetit lokal në mbrojtjen e natyrës në territorin e vetë;
- kryejnë dhe punë të tjera të përcaktuara me këtë Ligj dhe aktet nen ligjore të nxjerra prej tij.

OBJEKTIVAT

Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë që nga viti 1986 ka qenë i mbrojtur si monument natyre me karakter hidrogjeomorfologjik. Ky monument ka vlera shkencore, kulturore, edukativo-arsimore dhe turistike.

Qëllimet e synuara me rikategorizimin e këtij monumenti janë:

- Harmonizimi i Vendimeve për shpallje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233),
- Harmonizimi me Ligjin Nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore,
- Mbrojtja e ekosistemit dhe diversitetit biologjik, menaxhimi i qëndrueshëm si dhe marrja e masave për revitalizimin e ekosistemeve të dëmtuara,
- Shfrytëzimi racional i vlerave natyrore përmes mbikëqyrjes dhe kontrollit të zonës për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të sajë,
- Ndërmarrja e veprimtarive të përshtatshme të ruajtjes dhe menaxhimit, me qëllim të rivendosjes së kushteve ekologjike në ekosistemet dhe habitatet e degraduara.
- Mundësimi i punëve kërkimore-shkencore, arsimore, kulturore, edukative dhe punëve të tjera profesionale në pajtim me konceptet bashkëkohore në zhvillimin e kësaj zone me synim ruajtjen e natyrës,
- Realizimi i qëllimeve të përgjithshme të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik etj.

KARAKTERISTIKAT FIZIKO - GJEOGRAFIKE

- **Pozita gjeografike dhe madhësia e territorit**

Kanioni i Drinit të Bardhë është krijuar në mënyrë epigjenike, dukuri kjo shumë e rrallë ku rrjedha e lumit të Drinit të Bardhë epigjenikisht ka prerë shkëmbin gëlqeror të Gradishes në pikën më të lartë të lartësisë mbidetare (408 m) në gjatësi prej 5.6 km duke krijuar një fenomen të rrallë natyror dhe atraktiv me prerje të thella të gëlqerorit në të dy anët i cili bashkë me rrethin e ngushtë përfaqëson një vlerë të lartë natyrore tek ne. Prerjet arrijnë lartësinë deri në 25 m ndërsa thellësia e lumit në grykë arrin deri në 12 m.

Sipërfaqja e përgjithshme e zonës së mbrojtur është 198.83 ha ku 124.96,09 ha i takojnë komunës së Rahovecit ndërsa 73.86,47 ha asaj të Gjakovës.

Nga sipërfaqja e mbrojtur në komunën e Rahovecit, me rastin e nxjerrjes së Vendimit 84.27,70 ha kanë qenë në pronësi shoqërore, ndërsa 40.68,39 ha në pronësi private.

Nga sipërfaqja e mbrojtur në komunën e Gjakovës 19.70,81 ha kanë qenë në pronësi shoqërore ndërsa 54.15,66 ha në pronësi private.

Sipërfaqja e mbrojtur në vështrim të këtyre vendimeve ndahet në dy zona:

- Zona e ngushtë – rigoroze (K. e Rahovecit ka 54.86,86 ha, ndërsa K. e Gjakovës 6.04,52 ha) dhe
- Zona e gjerë - mbrojtëse (K. e Rahovecit ka 70.09,23 ha, ndërsa K. e Gjakovës 67.81,95).



Fig. 1. Harta e zonës së mbrojtur aktuale (sipas parcelave që gjenden në Vendimet e dy Komunave)

Duke marrë parasysh se Komuna e Gjakovës ende nuk është e gatshme të bëjë ridefinimin e kufirit ekzistues të pjesës së sajë për shkak të implikimeve të shumë komponenteve (hapësinore, mjedisore, kulturore, financiare dhe menaxhuese), pas përmbylljes së konsultimeve të brendshme me organet komunale të fushave relevante pritet marrja e vendimeve të duhura nga subjektet përgjegjëse lidhur me specifikën e zonës.

Meqenëse Komuna e Rahovecit është e gatshme të procedoj shumë shpejt nxjerrjen e vendimit të ri për rikategorizimin e zone së mbrojtur ekzistuese, atëherë mbetet që edhe organet kompetente komunale nga Komuna e Gjakovës ta përgatisin të njëjtën sa më shpejt që është e mundur.




Fig. 2. Harta e zonës së propozuar për mbrojtje – pjesa e Rahovecit

Zona e propozuar për mbrojtje e monumentit të natyrës në kuadër të Komunës së Rahovecit përfshinë një sipërfaqe të përgjithshme prej 53 ha.

- **Përbërja gjeologjike**

Kanioni i Drinit të Bardhë, është fenomen morfo-hidrik me vlerë epigjenike, vizuale dhe edukative. Kanioni është krijuar në periudhë postlakustrike të liqenit neogjen të Dukagjinit. Mirëpo, intensiteti i prerjes dhe thellimit kanionit të epigjenisë është kushtëzuar dhe nga proceset e lëvizjeve të mëvonshme diferencuese tektonike.

Gryka ka veçori tipike të kanionit dhe është zhvilluar në formacione karbonatike të kretakut të sipërm.



Foto 1. Pamje nga Kanioni i Drinit të bardhë te Ura e Fshejtë

BIODIVERSITETI

Biodiversiteti është një nocion shumë kompleks që nënkupton tërësinë e llojeve dhe ekosistemeve, ose shprehur ndryshe biodiversiteti paraqet llojlojshmërinë jetësore në tokë.

Zona e Mbrojtur - Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë ka pozitë të volitshme gjeografike, me veçori hidrogeologjike, pedologjike, me kushte të mira klimatike që e bëjnë këtë zonë interesante si në pikëpamje floristike dhe vegjetative ashtu edhe në atë faunistike dhe peizazhore.

Kjo llojlojshmëri është rezultat i ndërveprimit kompleks të faktorëve biotik dhe abiotik të cilët krijojnë kushte të favorshme për llojlojshmëri të bimëve dhe shtazëve brenda kësaj zone.

Ekspozimi ndaj dy llojeve të klimave, asaj kontinentale dhe mesdhetare ka kushtëzuar mbretërimin e tipit të butë të klimës kontinentale me elemente adriatiko-mesdhetare që janë mjaftë të rëndësishme në aspekt të pranisë së llojeve të rralla bimore dhe atyre shtazore.

Flora dhe vegjetacioni

Pozita gjeografike, ku në përmasë të madhe ndihet ndikimi i klimës mesdhetare nëpërmjet të luginës së Drinit të bardhë, ka kushtëzuar krijimin e një vegjetacioni me elemente të florës submesdhetare që është mjaftë karakteristik për këtë territor.

Konfiguracioni i terrenit ka kushtëzuar edhe dominimin e vegjetacionit të tipit shkurror që fatmirësisht nuk japin edhe mundësi për ndonjë ndryshim esencial në bazën e tyre. Shkëmbi gëlqeror për shkak të klimës e cila mbretëron dhe kushteve të tjera karakterizohet me një përbërje specifike floristike si dhe një vegjetacion interesant.

Nga vizitat hulumtuese të realizuara në këtë zonë veçojmë këto lloje të evidentuara:

Tabela 1. Llojet e bimëve të evidentuara ne teren

Nr.	Emri latinisht	Emri shqip
1	<i>Achillea millefolium</i>	Barpezmi mijëfletësh
2	<i>Acer campestre</i>	Kreka
3	<i>Acer monspessulanum</i>	Krekëza
4	<i>Acinos arvensis</i>	Mendërmira arash
5	<i>Acinos hungaricus</i>	Mendërmia e hungarisë
6	<i>Ajuga chamaepitys</i>	Ajugë si pishë e vogël
7	<i>Alnus glutinosa</i>	Verri i zi
8	<i>Alyssum sinuatum</i>	Alisoid gjirak
9	<i>Alyssum saxatile</i>	Sericë e shkëmbinjve
10	<i>Anchusa arvensis</i>	Gjuhëlopa e arave
11	<i>Anchusa azurea</i>	Gjuhëlopa blu
12	<i>Anchusa officianalis</i>	Gjuhëlopa mjekësore
13	<i>Aristolochia clematitis</i>	Petriku kulpër
14	<i>Artemisia absinthium</i>	Pelini
15	<i>Arum italicum</i>	Këlkaza e Italisë
16	<i>Artemisia vulgaris</i>	Perlini i rëndomtë
17	<i>Artemisia campestris</i>	Pelin i fushës
18	<i>Artemisia lobelii</i>	Pelini eriant
19	<i>Asparagus tenuifolius</i>	Ferrëmiu gjethehollë
20	<i>Bellis perennis</i>	Lule dhensh
21	<i>Berteroa incana</i>	Berterojë thinjoshe
22	<i>Diploxaxis muralis</i>	Diploxaks i mureve
23	<i>Cardus nutans</i>	Freshkulli
24	<i>Carpinus orientalis</i>	Shkoza e zezë
25	<i>Centaurea solstitialis</i>	Ferrëbardha
26	<i>Ceterach officinarum</i>	Bargjarpëri mjekësor

27	<i>Cichorium intybus</i>	Cikore
28	<i>Cirsium vulgare</i>	Gjembgomari
29	<i>Clematis vitalba</i>	Kulpëra e egër
30	<i>Cornus mas</i>	Thana
31	<i>Cornus sanguineus</i>	Thanukla
32	<i>Crataegus monogyna</i>	Murrizi një bërthamësh
33	<i>Colchium autumnale</i>	Xhërrokulli vjeshtor
34	<i>Convolvulus cantabricus</i>	Dredhja e Kantabrisë
35	<i>Cornilla emerus</i>	Milëza emerus
36	<i>Cyclamen hederifolium</i>	Bukëderr
37	<i>Convolvulus altheoides</i>	Dredhja mëllagëngjajshme
38	<i>Datura stramonium</i>	Tatulla
39	<i>Echinops sphaerocephalus</i>	Ehinopsi kokërruzullor
40	<i>Echium italicum</i>	Ushqerrëza e Italisë
41	<i>Echium vulgare</i>	Ushqerrëza e rëndomtë
42	<i>Erodium cicutarium</i>	Gjilpërëqyqja si kukutë
43	<i>Eryngium campestre</i>	Gjemëbardhi i fushës
44	<i>Erysimum sylvestris</i>	Erisimë
45	<i>Euphorbia helioscopia</i>	Rryelli diellpamës
46	<i>Euphorbia myrsinites</i>	Rryelli mërsinë
47	<i>Fragaria vesca</i>	Luleshtrydhe
48	<i>Fraxinus ornus</i>	Frashëri i bardhë
49	<i>Fumana procumbens</i>	Fumana e shtrirë
50	<i>Fumaria officinalis</i>	Fomi mjekësor
51	<i>Galium cruciata</i>	Bar Shëngjergji
52	<i>Galium lucidum</i>	Ngjitësja e shkëlqyeshme
53	<i>Geranium rotundifolium</i>	Kamaroshë gjetherrumbullaket
54	<i>Hedera helix</i>	Urthi

55	<i>Heliotropium europaeum</i>	Dielldrishësi i Evropës
56	<i>Helloborus odoratus</i>	Shpendra
57	<i>Hordeum murinum</i>	Elbi i egër
58	<i>Hypericum perforatum</i>	Lulebasani
59	<i>Inula oculus-christi</i>	Plenëra sykrishti
60	<i>Lactuca serriola</i>	Ogrishta
61	<i>Lamium purpureum</i>	Hithbuta e purpurt
62	<i>Lathyrus laxiflorus</i>	Vingjëra
63	<i>Lathyrus tuberosus</i>	Vingjëra me zhardhok
64	<i>Ligustrum vulgare</i>	Voshtra
65	<i>Linaria vulgaris</i>	Linaria e rëndomtë
66	<i>Gagea lutea</i>	Gage e verdhë
67	<i>Lunaria annua</i>	Lunaria një vjeqare
68	<i>Marrubium vulgare</i>	Marrube e rëndomtë, Kapinok
69	<i>Medicago prostrata</i>	Jonxha e shtrirë
70	<i>Micromeria albanica</i>	Bishtmiu shqiptar
71	<i>Muscari botryoides</i>	Pështriku vilengjashëm
72	<i>Nigella damascena</i>	Nigella e damaskut
73	<i>Ononis spinosa</i>	Kalmuthi gjembor
74	<i>Orinthogalum umbellatum</i>	Minukëla ombrellore
75	<i>Petrorhagia terebinthus</i>	Qelbes
76	<i>Sedum acre</i>	Rryshqyqe e athët
77	<i>Sedum dasphyllum</i>	Rrush i egër
78	<i>Sedum maximum</i>	Rrushqyqja e madhe
79	<i>Sedum atratum</i>	Rrushqyqe e zezë
80	<i>Prunus mahaleb</i>	Mezhdredhe
81	<i>Thlaspi perfoliatum</i>	Tlaspi
82	<i>Quercus cerris</i>	Qarri

83	<i>Quercus pubescens</i>	Bungëbuta
84	<i>Salvia aethiopis</i>	Sherbela etiopiane
85	<i>Rosa canina</i>	Trëndafili i egër
86	<i>Sideritis roeseri</i>	Çaj mali
87	<i>Prunus spinosa</i>	Kulumbria
88	<i>Centaurea stoebe</i>	Kokoçeli stebe
89	<i>Verbascum bosnense</i>	Netull
90	<i>Verbascum pulverulentum</i>	Bar peshku pluhurosor
91	<i>Verbascum blattaria</i>	Bar peshku moleje
92	<i>Linaria angustifolia</i>	Linarie gjethengushtë
93	<i>Sideritis montana</i>	Sideriti i malit
94	<i>Scilla autumnalis</i>	Boçka vjeshtore
95	<i>Teuricum chamaedrys</i>	Arrësi dushk i vogël
96	<i>Sambucus ebulus</i>	Qingla
97	<i>Ulmus campesteris</i>	Vidhi
98	<i>Xanthium italicum</i>	Rrodhja
99	<i>Tribulus terrestris</i>	Tribula tokësore
100	<i>Tamarix tetrandra</i>	Marina me katër thekë
101	<i>Tanacetum vulgare</i>	Karajpeli
102	<i>Teucrium polium</i>	Bari i majësillit
103	<i>Verbena officinalis</i>	Barshpretka
104	<i>Veronica persica</i>	Veronika persiane
105	<i>Vicia sativa</i>	Grashina e kultivuar
106	<i>Viola arvensis</i>	Manushaqe arash
107	<i>Viola elatior</i>	Manushaqe e lart
108	<i>Xeranthemum annuum</i>	Kserantema një vjeqare
109	<i>Xeranthemum cylindraceum</i>	Kserantema cilindrike



Foto 2. Bukëderr (*Cyclamen hederifolium*)



Foto 3. Xhërokulli vjeshtor (*Colchium autumnale* L.)



Foto 4. Qingla (*Sambucus ebulus*)



Foto 5. Barpezmi mijëfletësh (*Achillea millefolium*)



Foto 6. Lule dhensh (*Bellis perennis*)



Foto 7. Ushqerrëza e Italisë (*Echium italicum*)

Fauna

Fauna e Kosovës në përgjithësi është pak e studiuar. Në kuadër të kësaj hynë edhe ajo e Kanionit të Drinit të Bardhë i cili me biotopet e veçanta ofron kushte të mira për jetesën e llojeve të ndryshme shtazore.

Nëpër shkëmbinjtë gëlqeror ka mjaftë shpella/zgavra të vogla të cilat ofrojnë kushte për strehimin e një numri të madh të shpendëve, disa prej tyre lloje karakteristike. Kjo specifike edhe ka mundësuar që në këtë zonë të ketë një llojllojshmëri të theksuar faunistike

Gjatë vizitave hulumtuese në terren si dhe nga të dhënat që gjenden në arkivin e IKMN-së janë konstatuar disa lloje të shtazëve, e që më të shpeshta kanë qenë:

- Kërmilli (*Helix pomatia*),
- Breshka tokësore (*Testudo hermani*),
- Hardhuca e gjelbërt (*Lacerta viridis*),
- Iriqi (*Erinaceus concolor*),
- Dhelpira (*Vulpes vulpes*),
- Lepuri i fushës (*Lepus europaeus*) etj.

Nga llojet e njohura të shtazëve në këtë zonë veçohet kryesisht shpendët që përfaqësohen me këto lloje:

Tab.1. Lista e llojeve të shpendëve¹

Nr.	Emri latinisht	Emri shqip
1	<i>Acrocephalus arundinaceus</i>	Bilbilthi fushor i kallamave
2	<i>Anas platyrhynchos</i>	Kuqlla qafë gjelbër
3	<i>Anas querquedula</i>	Marsatorja
4	<i>Ardea cinerea</i>	Çapka e përhime

¹ Arkiva e IKMN-së

5	<i>Ardea purpurea</i>	Çapka e kuqërreme
6	<i>Aythya nyroca</i>	Rosa pikaloshe
7	<i>Buephala clangula</i>	Rosa me katër sy
8	<i>Buteo buteo</i>	Huta
9	<i>Carduelis carduelis</i>	Gardalina
10	<i>Carduelis cannabina</i>	Gardalina e kërpit
11	<i>Ciconia ciconia</i>	Lejleku i bardhe
12	<i>Columba oenas</i>	Pëllumbi i pyllit
13	<i>Columba livia</i>	Pëllumbi i shkëmbit
14	<i>Corvus corax</i>	Korbi
15	<i>Corvus frugilegus</i>	Korbi sqep bardhë
16	<i>Corvus monedula</i>	Gala
17	<i>Corvus corone</i>	Sorra
18	<i>Coturnix coturnix</i>	Shkurta
19	<i>Emberiza cia</i>	Cerla gushë gjelbër
20	<i>Falco tinunculus</i>	Skifteri kthetrazi
21	<i>Falco naumanni</i>	Skifteri kthetra verdhë
22	<i>Fulica atra</i>	Bajza
23	<i>Galerida cristata</i>	Dervishi
24	<i>Hirundo daurica</i>	Dallëndyshe
25	<i>Mergus merganster</i>	Zhytësi i mesëm
26	<i>Mergus albellus</i>	Zhytësi i vogël laraman
27	<i>Monticola saxatilis</i>	Tusha e zakonshme
28	<i>Oenanthe hispanica</i>	Bishtbardha e gurit
29	<i>Passer domesticus</i>	Harabeli
30	<i>Perdix perdix</i>	Thëllëza e fushës
31	<i>Phoenicurus ochruros</i>	Bishtkuqi zashkan
32	<i>Riparia riparia</i>	Dallëndyshja e lumit
33	<i>Turdus merula</i>	Mëllenja
34	<i>Vanellus vanellus</i>	Gicvilja



Foto 8. Kërmilli (*Helix pomatia*)



Foto 9. Hardhuca e gjelbërt (*Lacerta viridis*)



Foto 10. Skifteri kthetrazi (*Falco tinunculus*)



Foto 11. Bilbilthi fushor i kallamave
(*Acrocephalus arundinaceus*)



Foto 12. Çapka e përhimë (*Ardea cinerea*)



Foto 13. Çapka e kuqërreme (*Ardea purpurea*)

TRASHËGIMIA KULTURORE DHE ASPEKTET REKREATIVO - SPORTIVE

Ura e Fshejtë (Nr. rendor 624 dhe Nr. Unik në databazë 001057) është pjesë e Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme të miratuar nga Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Vendim Nr 68/2016 datë 10.10.2016.

Sipas Ligjit Nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore Neni 6 pika 6.4. *Monumentet arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit. Kjo zonë e mbrojtjes mund të zgjerohet ose ngushtohet dhe përcaktohet në planin e Institucionit kompetent dhe në planet hapësinore relevante në pajtueshmëri me nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor.*


Në këtë monument natyror organizohen gara vjetore sportive të hedhjes në ujë - kërcim së larti nga ura. Menaxhimi bëhet nga Kuvendi Komunal i Gjakovës dhe organizohen në sezonin veror Korrik - Gusht.

Kanioni i Drinit të Bardhë ka vlera shkencore, edukativo-arsimore dhe turistike. Qasja është e lehtë pasi ky monument gjendet në drejtim të rrugës Gjakovë - Prizren tek kilometri i nëntë. Kanioni mund të vizitohet nga lartë, duke ndjekur krahun e majtë apo të djathtë, por edhe nëpër kanion nëse përdoret barka. Ndër të tjera ura, apo më saktësisht rrethina e saj shërben edhe si pushimore verore ku ngrihen çadrat e qytetarëve nga anë të ndryshme të Kosovës. Po ashtu rreth saj ka shtëpiza që shërbejnë për kalimin e ditëve të verës.

Kanioni mund t'i prezantohet publikut, por ende nuk ka staza të definuara, brushura apo ndonjë material promovues për të shpjeguar më mirë historinë e këtij monumenti të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Ura e Fshejtë e shek. XVIII

Ura e Fshejtë është ndërtuar mbi kanionin dhe është e gjatë 70 m. Posedon një hark gjysmë rrethor dhe shtrihet mbi lumin e Drinit të Bardhë. Thellësia prej harkut deri te shtrati i ujit është 30 m. Ura është e gjatë 37 m., e gjërë 7 m. dhe e lartë 18,50 m. Kjo urë është e ndërtuar qysh në shekullin XVII, ndërsa gjatë Luftës së Parë Botërore ajo u shkatërrua tërësisht. Më vonë, me 1942 u rindërtua nga Simonseni i Italisë, ndërsa dëmet që pësoi gjatë luftës së vitit 1999 i evitoi KFOR-i italian.



(https://sq.wikipedia.org/wiki/Ura_e_Fshajt%C3%AB#/media/File:The_%27Fshejt%27_Bridge.jpg)

Foto 14. Pamje e vjetër e Urës



Foto 15. Aktivitete rekreative te Kanioni i Drinit të bardhë te Ura e Fshejtë




Foto 16. Pamje nga garat e kërcimeve nga Ura e Fshejtë

GJENDJA

Në zonën e mbrojtur të Kanionit të Drinit të Bardhë në të dy anët e sajë, si nga pjesa e Komunës së Gjakovës ashtu edhe nga ajo e Komunës së Rahovecit ka pasur ndërhyrje si në zonën e gjerë mbrojtëse ashtu edhe në atë të ngushtë – rigoroze.

Sa i përket pjesës që i takon Komunës së Gjakovës ndërhyrjet e evidentuara janë baseni që shfrytëzohet për larje-rekreacion edhe atë mu në zonën rigoroze të mbrojtur, mandej pompa për karburant si dhe objekte tjera komerciale që gjenden në zënën e gjerë mbrojtëse pranë magjistrales Prizren – Gjakovë.

Meqenëse në pjesën që i takon Komunës së Rahovecit gati gjysma e sipërfaqes gjendet nën zonën e ngushtë – rigoroze të mbrojtjes (rreth 55 ha) atëherë edhe ndërhyrjet e mëdha janë bërë mu në këtë zonë. Kompanitë që merren me tregtimin e rërës kanë dëmtuar një pjesë të madhe të shtratit të lumit Drini i Bardhë poshtë urës, pastaj problem më i madh është edhe dëmtimi i digës e cila gati për 20 vite ka mbajtur këtë pjesë në kushte më të mira. Ekzistojnë gjithashtu dy lokale kryesore në afërsi, njëra është sipër urës kurse tjetra në pjesën e poshtme të saj. Gjithashtu në zonën rigoroze është në përfundim e sipër Kompleksi Memorial me obeliskun, projekt i Komunës së Rahovecit.

Meqenëse pronësia në masë të madhe ka kaluar nga ajo shoqërore në atë private atëherë edhe janë ndërtuar disa objekte banimi si dhe objekte tjera komerciale, fatkeqësisht pa marrjen e pëlqimit paraprak nga organi përgjegjës.




Foto 17. Pamje nga gjendja në zonë

MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI ME ZONËN

Punët profesionale në monitorimin dhe hulumtimin e vlerave natyrore në zonat e mbrojtura të natyrës i kryen Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) si organ kryesorë qendror për mbrojtjen e natyrës, ndërsa përcjelljen e gjendjes së veçorive të rëndësishme dhe karakteristike e bëjnë komunat në bashkëpunim me IKMNn dhe personat tjerë juridik të autorizuar.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L- 233, do të përcjellë punën dhe zbatimin e masave të mbrojtjes së zonës duke dhënë mendime profesionale në planet e zhvillimit dhe në të gjitha vendimet të cilat janë të lidhura me këtë objekt të mbrojtur të natyrës.

Meqenëse komunat përkatëse do të nxjerrin vendimet për mbrojtjen e kësaj zone atëherë ato edhe do të jenë përgjegjëse në aspektet e menaxhimit dhe administrimit me këtë zonë.

Propozimi i aktit për shpallje – Vendimi, mbështetet në këtë propozim profesional në të cilën janë përcaktuar vlerat e zonës si dhe propozohet organi i cili nxjerr aktin për shpallje për sigurimin e mjeteve për administrim me zonën e mbrojtur.

PËRFUNDIM

Duke u mbështetur në vlerat e elementeve karakteristike të zonës së mbrojtur Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë si dhe vlerat tjera të llojllojshme me të cilat disponon kjo zonë (klime, biodiversiteti etj.), kjo zonë me kufijtë e ri (fillimisht vetëm për territorin e Komunës së Rahovecit e me krijimin e rrethanave të përshtatshme edhe për atë të Gjakovës) propozohet të mbetet në kategorinë e Monumentit Natyror dhe përsëri të nxirren vendime të reja nga ana e dy Komunave përkatëse, asaj të Rahovecit dhe Gjakovës për mbrojtjen e pjesëve të veta territoriale.

Me qëllim të realizimit të ndryshimeve të propozuara, duhet të shfuqizohen të gjitha vendimet paraprake në fushën e planifikimit hapësinor të kësaj zone të mbrojtur më parë.

Për Monumentin e Natyrës përcaktohet regjimi mbrojtës i shkallës së III-të në të cilën përcaktohen masat dhe kushtet me të cilat lejohen dhe ndalohen aktivitete dhe veprimtari të caktuara, për zbatimin e të cilave kujdesen Komunitat përkatëse.

Ndër masat që duhet të ndërmerren janë:

- mos ndërtimi i objekteve të pa planifikuara,
- shënjimi i kufijve të zonës së mbrojtur,
- vazhdimi i hulumtimeve të mëtejme të vlerave natyrore,
- mbrojtja adekuate e llojeve të rrezikuara,
- ndalimi i hedhjes së mbeturinave etj.

Masat tjera duhet të përcakton në vendimin për vënien nën mbrojtje të kësaj zone nga ana e të dy komunave përkatëse.

LITERATURA

- Arkiva e IKMN-së
- AMMK (2010): Raporti Gjendja e Natyrës në Kosovë 2008-2009
- Çavolli, R. (1997): Gjeografia Regjionale e Kosovës, faqe 22, 145, 149
- Dhora, Dh. (2008): Fjalor i emrave të kafshëve të Shqipërisë, Botimet “Camaj-Pipa”, 288 fq. Shkodër, SHQIPËRI
- LIGJI PËR MBROTJEN E NATYRES (Nr. 03/L-233), Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti V / Nr. 85 / 9 Nëntor 2010
- Konventa mbi Diversitetin Biologjik (CBD), Rio de Janiero 1992
- “Kopja e Planit dhe Certifikata e Pronësisë”. Komuna e Rahovecit - Zyra Kadastrale Komunale 2016.
- “Kopja e Planit dhe Certifikata e Pronësisë”. Komuna e Gjakovës - Zyra Kadastrale Komunale 2016.
- Pllana R. et al. (2006) Monumentet hidrike dhe mbrojtja e tyre në Kosovë, Bolwois, Ohër, Maqedoni.
- <http://gjakovaportal.com/en/kultura/ArtMID/542/ArticleID/1231327/Ura>



PLANI LOKAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE TË NGURTA

KOMUNA RAHOVEC



Përgatitur nga:

Green Art Center - Prishtina "GAC"

2020

TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie nga Kryetari i Komunës	4
Shkurtesat.....	5
Përkuftizimet e Mbeturinave	6
1. HYRJE DHE KONTEKSTI NACIONAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE	9
1.1 Qëllimi i planit	9
1.2 Historiku kombëtar i menaxhimit të mbeturinave.....	9
1.3 Politikat, strategjia dhe korniza ligjore kombëtare	10
1.4 Rolet dhe përgjegjësitë	Error! Bookmark not defined. 1
2. KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS.....	2
2.1 Konteksti lokal i menaxhimit të mbeturinave	2
3. HARTIMI I PLANIT PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË MBETURINAVE TË NGURTA.....	4
3.1 Fushëveprimi i planit.....	4
3.2 Planifikimi strategjik (vizioni dhe objektivat)	4
3.3 Objektivat.....	5
3.4 Hartimi i planit.....	6
3.5 Identifikimi i lokacionit.....	7
3.6 Hartimi i planit për deponinë e mbeturinave inerte në Komunën e Rahovecit.....	8
4 ANALIZA E SITUATËS AKTUALE	9
4.1 Gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave inerte	20
5 PLANI PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE TË NGURTA	25
5.1 Koncepti i deponimit të sigurtë të mbeturinave inerte.....	25
5.2 Modalitetet e operimit.....	25
5.3 Përcaktimi i materialeve	26
5.4 Skenarët e funksionalizimit të lokacionit të grumbullimit të mbeturinave inerte	28
6 KRITERET PËR PROJEKTIMIN DHE FUNKSIONALIZIMIN E LOKACIONIT PËR DEPONIM TË MBETURINAVE NGURTA.....	29
6.1 Specifikimet teknike për ndërtimin e DMINP	29
6.2 Specifikimi i kostove të pajisjeve për funksionalizimin e deponisë së mbetjeve inerte	29
6.3 Operimi dhe Mirëmbajtja.....	32
6.4 Kushtet teknike dhe operacionale	33
7 PLANI I VEPRIMEVE.....	34

LISTA E FIGURAVE

Fig. 1: Vendndodhja e Komunës së Rahovecit në Kosovë	12
Fig. 2: Pamja e lokacionit me Google My Maps që tregon pamje nga vendi i propozuar për deponinë inerte, Rahovec;	17
Fig. 3: Distanca për deponinë inerte nga Qendra, Rahovec	18
Fig. 4: Harta e Pozitës gjeografike të komunës së Rahovecit sipas Ndarjeve administrative	19
Fig. 5: Harta e krahasuese e vendodhjes së deponive ilegale, Komuna e Rahovecit (verifikimi 2020)	22
Fig. 6: Harta e llojeve dhe përbërjes së mbeturinave sipas prezencës së deponive ilegale, Komuna e Rahovecit (verifikimi 2020)	23
Fig. 7: Llojet e mbetjeve inerte dhe ripërdorimi i tyre	27
Fig. 8: Foto ilustruese e makinerisë gurëthyese	31

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Statistika mbi numrin e popullsisë për Komunën e Rahovecit	20
Tabela 2. Numri i deponive sipas raportit të fundit i AMMK 2020 për vlerësimin e vitit kalendarik 2019	22
Tabela 3: Zërat e kostove për ndërtimin e lokacionit të deponisë	30
Tabela 4. Vlerësimi i kostove e pajisjeve për deponinë inerte	31
Tabela 5. Vlerësimi i kostove për operimin dhe mirëmbajtjen	32
Tabela 6. Planifikimi i zbatimit të planit, komuna Rahovec	35

Parathënie nga Kryetari i Komunës

Të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit,

Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave të ngurta është i një rëndësie të veçantë për Komunën e Rahovecit. Ky plan do të synojë në aspiratën tonë për mjedis të pastër e të shëndetshëm, duke kontribuar në zbatimin e politikës të BE së dhe arritjes së objektivave kombëtare të Republikës së Kosovës për mbeturinat, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve.

Nëpërmjet menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave sipas llojeve të tyre, do të adresojmë sfidat që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave inerte dhe krijimin e kushteve për deponimin dhe trajtimin e tyre në formë të organizuar në Komunën e Rahovecit.

Krijimi i kushteve për funksionalizimin e lokacionit brënda komunës për trajtimin e duhur të mbeturinave inerte prej ndërtimeve do të inkurajë mbështetje të vazhdueshme politike, financiare, fuqizim të kapaciteteve organizative dhe njerëzore të komunës dhe ne jemi të gatshëm të ofrojmë mbështetjen e plotë të këtij drejtimi. Ne inkurajojmë qeverinë, donatorët dhe shoqërinë civile të na mbështesin në arritjen e objektivave sipas planit dhe realizimin e misionit të komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarë.

Ndërkohë, si komunë do të punojmë në vazhdimësi për të ofruar shërbime më të mira për qytetarë dhe duke mbështetur programe të rëndësishme në ruajtjen e mjedisit dhe që zhvillojnë iniciativa reduktuese dhe ricikluese.

Për realizimin e këtij plani, dua të falënderoj organizatën joqeveritare Green Art Center –Prishtina (GAC) për mbështetje dhe përkrahjen e vazhdueshme profesionale për përmirësim të gjendjes mjedisore në komunën e Rahovecit dhe hartimin e planeve konkrete në menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave me rëndësi të veçantë për komunën tonë.

Kryetari i Komunës

Smajl Latifaj

Shkurtesat

AKMM	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjensia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DSHP	Drejtoria e Shërbimeve Publike
GAC	Green Art Center Prishtina
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave
PMMI	Plani lokall i Menaxhimit të Mbeturinave Inerte
SRKMM	Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave

Përkufizimet e Mbeturinave

Përkufizimet që janë përdorur në këtë document janë ato që janë përdorur në Ligjin Nr.2012/04-L-060 për Mbeturinat.

Bio-mbeturinë – mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat engjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit.

Deponi – vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

Deponim përfundimtar i mbeturinave – operimet të cilat ofrojnë zgjidhje përfundimtare për mbeturinat të cilat nuk mund të ripërdoren apo përpunohen, duke mos rrezikuar mjedisin apo shëndetin e njeriut.

Deponim – çdo operim i cili nuk është përpunim, as në rastet kur operimi ka për pasojë sekondare rikuperimin e substancës apo energjisë.

Kompostim – trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit, i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushte të kontrolluara.

Konsumator – personi icili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas Ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", Republika e Kosovës.

Kullim – çdo lëng që rrjedh ose i shpërlarë nga mbeturinat e deponuara dhe që shkarkohet nga deponia ose gjendet brenda deponisë.

Liçenca për menaxhimin e mbeturinave – leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", Republika e Kosovës.

Mbeturinë – substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë.

Mbeturina industriale – mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari të tjera prodhuese.

Mbeturina inerte – mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

i. mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiete tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

ii. i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Mbeturina komerciale – mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industrial.

Mbeturina komunale – mbeturina nga amvisëritë dhe mbeturina nga aktivitetet e tjera të cilat, për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

Mbeturina medicinale – mbeturina të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale.

Mbeturina të parrezikshme – mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.

Mbeturina të rrezikshme – mbeturinat që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme.

Mbeturina të veçanta – mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta.

Mbeturina të vëllimshme – mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

Mbledhje – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.

Mbledhje e ndarë – nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuara sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.

Menaxhim i mbeturinave – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.

Parandalim – masat e ndërmarra para se substanca, materiali apo produkti të bëhet mbeturinë, për të redukuar:

i. sasinë e mbeturinës, përfshirë ri-shfrytëzimin e produkteve ose zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve;

ii. efektet negative të mbeturinave për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

iii. përmbajtjen e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

Përdorimi i mbeturinave – çdo operim, veprimtari që kryhet për qëllime riciklimi ose ripërdorimi të mbeturinave, pjesërisht ose në tërësi, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të specifikuar.

Përpunim i mbeturinave – operim, rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet e tjera të cilat përndryshe do të duhej të përdreshin për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo në ekonominë e gjerë.

Person – person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

Prodhuksi mbeturinë – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime të tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.

Riciklim – çdo operim i përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substance, qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshin rikthimin e materialeve organike, por nuk përfshin përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave.

Ri-përdorim – çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent, i cili nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar.

Stabilizim i mbeturinës – çdo trajtim i mbeturinës me metodën e caktuar me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Zotëruesi mbeturinë – prodhuksi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinë.

1. HYRJE DHE KONTEKSTI NACIONAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

1.1 Qëllimi i planit

Plani lokal për Menaxhimin e Mbeturinave Inerte (PMMI) i komunës së Rahovecit është dokument planifikimi që e mundëson zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal, duke i kontribuar zbatimit të politikave dhe përmbushjes së objektivave kombëtare. Ai po ashtu synon:

- i) Mbledhjen e të dhënave për mbeturinat komunale, duke e ofruar një përshkrim të rrjedhave të mbeturinave dhe përgjegjësi, karakteristikave dhe vëllimeve të mbeturinave që duhet të menaxhohen dhe një përkufizim të shtrirjes gjeografike të planit;
- ii) Një vlerësim të skemave aktuale të mbledhjes së mbeturinave, duke e përkufizuar bazën e shërbimeve dhe aktiviteteve aktuale për menaxhimin e mbeturinave;
- iii) Opsionet e menaxhimit të mbeturinave të ngurta inerte prej ndërtimit dhe prishjeve që do ta mundësonin mbledhjen dhe përpunimin e kësaj rryme të mbeturinave sipas objektivave kombëtare dhe kontekstit lokal;
- iv) Shërbimin cilësor, duke i përcaktuar mënyrat dhe instrumentet që e garantojnë një cilësi të tillë;
- v) Kornizën institucionale, organizative dhe rregullatore, duke i rekomanduar masat dhe instrumentet për përmirësimin e komponentëve organizativë, kontributet publike dhe private dhe përgjegjësitë për mbledhjen, transportimin, riciklimin dhe trajtimin e mbeturinave sipas llojeve;
- vi) Nevojat financiare dhe investimet, duke i përkufizuar ato që janë të nevojshme për realizimin dhe ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave inerte komunale, dhe
- vii) Burimet financiare për investime dhe një strategji për Komunën e Rahovecit që i mbulon shpenzimet, duke e krijuar një mjedis të favorshëm për ta siguruar financimin nga qeveria dhe nga burimet e jashtme përmes donatorëve.

1.2 Historiku kombëtar i menaxhimit të mbeturinave

Sipas Ligjit Nr. 04/I-060 për Mbeturinat dhe Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbeturinave, komunat e Kosovës janë përgjegjëse për hartimin e planeve komunale të tyre për menaxhimin e mbeturinave, të cilat do të duhet të trajtojnë:

- sasinë dhe llojet e mbeturinave që pritet të krijohen dhe origjinën e mbeturinave të cilat do të shfrytëzohen, ose deponohen sipas planit, në vendin e caktuar,
- programin për mbledhjen e mbeturinave komunale nga amvisëritë, mbeturinat komerciale dhe mbeturinat industriale,
- programin për mbledhjen, grumbullimin dhe ndarjen e mbeturinave të rrezikshme nga mbetjet e tjera, ose ndarjen e llojeve të mbeturinave,

- propozimet për teknikat e mundshme për ripërdorimin dhe riciklimin e komponentëve të ndryshme nga mbeturinat komunale,
- programin për vetëdijesimin publik dhe edukimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave,
- përshkrimin e lokacioneve për pajisjet dhe objektet për trajtimin dhe largimin e mbeturinave, përfshirë kushtet teknike të nevojshme për dizajnimin e objekteve të reja,
- parallogaritjen e shpenzimeve të menaxhimit të mbeturinave dhe burimet e financimit për realizimin e projekteve të planifikuara, dhe
- Mundësitë për bashkëpunimin ndërmjet dy apo më shumë komunave.

Komunat në tërë Kosovën përballen me një sfidë të madhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e tyre. Përpos detyrave të tjera në spektrin e politikave socio ekonomike në nivel lokal, mbetet gjithashtu kompetencë e komunave që të përmirësojnë infrastrukturën dhe t'i furnizojnë banorët e tyre me ujë, rrymë, shërbime shëndetësore, mbrojtje të mjedisit dhe transport.

Standardet e përmirësuara për mbledhje të ndarë, trajtim dhe largim të mbeturinave nënkuptojnë se do të çojnë në rritje të shpenzimeve për ofrimin e këtyre shërbimeve përmes investimeve që do të kërkojnë për zbatimin e tyre. Prandaj, sfidë është që të krijohen zgjidhje që i përmirësojnë standardet e shërbimit dhe që i minimizojnë ndikimet negative dhe ekonomike për qytetarë, dhe që, në të njëjtën kohë, mbështeten nga popullata dhe mund të realizohen në kuadër të strukturave dhe kushteve aktuale.

1.3 Politikat, strategjia dhe korniza ligjore kombëtare

Qeveria e Kosovës është e angazhuar në procesin e anëtarësimit në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislationit të shtetit të Kosovës në përputhje me instrumentet legjislative të BE-së.

Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është pjesërisht e harmonizuar me Acquis të Bashkimit Europian (BE) për sektorin e mbeturinave. Aktualisht, Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit (MEA) është duke bërë përpjekje për harmonizim të plotë, ku qëllimi kryesor i kornizës aktuale ligjore për menaxhimin e mbeturinave është reduktimi i gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i elementeve të ripërdorshme të mbeturinave, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut; si dhe deponimi i mbeturinave në mënyrë miqësore ndaj mjedisit.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit (MEA) posedon Planin Kombëtar dhe Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbeturinave si dhe është në proces të finalizimit të Strategjisë së Re Kombëtare për Menaxhim të Mbeturinave. Në vijueshmëri, Sipas Ligjit 04-L-060(neni 9), kjo strategji përmban:

- Një përshkrim dhe vlerësim të gjendjes aktuale të menaxhimit të mbeturinave;
- Caqet dhe masat themelore për menaxhimin e mbeturinave;
- Masat që duhet të merren për menaxhimin e mbeturinave komunale të ngurta dhe mbeturinat e parrezikshme;
- Masat që duhet të merren për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzimet për përpunimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit;
- Udhëzimet për ruajtjen e sigurt apo largimin e mbeturinave;

- Udhëzimet për masat e sigurisë dhe prodhimin dhe standardet administrative teknike për t'i arritur qëllimet për menaxhimin e mbeturinave;
- Nevojat afatgjata të Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të të gjitha llojeve të mbeturinave sipas këtij ligji.

Plani strategjik përpilohet nga MEA-a në bashkëpunim me ministritë dhe autoritetet e tjera kompetente, aprovohet nga qeveria për një periudhë dhjetëvjeçare dhe rishikohet çdo pesë vjet.

Ligji kryesor që rregullon sektorin e mbeturinave në Kosovë është Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat ("Ligji për mbeturinat"). Ky ligj është veçanërisht i rëndësishëm kur shpjegohet rregullimi i sektorit të mbeturinave në Kosovë në raport me ligjet e tjera, veçanërisht ato që adresojnë krijimin, menaxhimin dhe udhëheqjen e ndërmarrjeve publike (p.sh.harmonizimi me: Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare). Ligji 04-L-060 për mbeturinat ("Ligji për mbeturinat") ndër të tjerash ka për qëllim:

- i) Evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave,
- ii) Ripërdorimin e komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat,
- iii) Zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore,
- IV) Parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, dhe
- v) Deponimin përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Ligje të tjera që ndikojnë në rregullimin e sektorit të mbeturinave përfshijnë:

1. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Ligji për Vetëqeverisjen Lokale");
2. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar nga ligjet që ndryshojnë Ligjin për Ndërmarrjet Publike Ligji nr. 05/L-009 dhe Nr. 04/L-111 ("Ligji për NP");
3. Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-006 ("LSHT");
4. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet që ndryshojnë dhe plotësojnë Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-237 i vitit 2014, 05/L-068 i vitit 2016 dhe nr. 05/L-092 i vitit 2016 ("Ligji për PP");
5. Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat ("Ligji për PPP");
6. Ligji Nr. 04/L-024 për Ndhimën Shtetërore ("Ligji për Ndhimën Shtetërore");
7. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit ("Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit");
8. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinorë ("Ligji për Planifikim Hapësinorë");
9. Ligjet tjera që kanë ndikim të kufizuar në rregulloren e menaxhimit të mbeturinave, të cilat përfshijnë:

Ligji për Ndërtim, Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për Ujëra, Ligji për Kimikatet, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Ndotjes, Ligji për Produktet Biocide, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji për Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimeve dhe Mbeturinave. Komponentët kryesorë sipas llojeve të mbeturinave, të cilat janë: guri, betoni, tulla, komponentë hekuri, komponentë plumbi, komponentë elektrik, etj.

10. Udhëzime administrative nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë:

Draft/2015, Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi i ndërtesave (qershor2015)
 15/2012, Menaxhimi i deponive të mbeturinave (dhjetor 2012)
 13/2013, Katalogu shtetëror i mbeturinave (qershor 2013)

16/2013, Vlerat kufitare të koncentrimave për komponentët e rrezikshme në mbeturina (qershor 2012)

07/2014, Kompetencat e mbajtësve, prodhuesve dhe importuesve të mbeturinave (prill 2014)

09/2014, Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave (nëntor 2014)

1.4 Rolet dhe përgjegjësitë

Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit është organi kombëtar që e udhëheq hartimin e politikave, zbatimin e ligjit dhe mbikqyrjen e aktiviteteve për mbrojtje të mjedisit, përfshirë menaxhimin e mbeturinave, burimeve të ujit, ajrit, dheut dhe biodiversitetit. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, raportimi për mjedisin është detyrë dhe përgjegjësi e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, AKMM-së.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre brenda juridiksionit të tyre për t'i arritur disa qëllime dhe për të ofruar shërbime për qytetarët e tyre. Mirëmbajtja dhe ofrimi i shërbimeve publike dhe komunale, përfshirë menaxhimin e mbeturinave janë pjesë e kompetencave vetanake të komunave. Në Komunën e Rahovecit, Drejtoria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave, shërbime këto që ofrohen nga Kompania Regjionale e mbeturinave "Ekoregjioni" SH.A me njësinë e saj "Ambjenti" në territorin e Rahovecit dhe kompania privat e "Ekodrinia".




Figura 1. Vendndodhja e Komunës së Rahovecit në Kosovë

Operatorët e autorizuar nga komuna e Rahovecit janë kompania Regjionale e mbeturinave “Ekoregjioni” SH.A me njësinë e saj publike “Ambjenti”, ku komuna e Rahovecit është aksionere me 8% të akcioneve në kompaninë regjionale dhe e cila shërben në **Zonën I** në **6589 klientë**, si edhe kompania private “Ekodrinia”, e cila shërben në **Zonën II** në rreth **4110 klientë**. Të dhënat e raportuara janë të dhëna të ofruara prej komunës së Rahovecit për vitin referent 2020. Krahas tjerash, të dyja këto kompani i dërgojnë mbeturinat komunale të grumbulluara në Deponinë Regjionale në Landovicë në distancë rreth 27 km, deponi kjo që menaxhohet prej Kompanisë për Menaxhim të Deponive në Kosovë.

2. KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS

2.1 Konteksti lokal i menaxhimit të mbeturinave

Sipas Ligjit për Mbeturinat, përgjegjësitë dhe detyrat e komunave për sa i përket menaxhimit të mbeturinave përfshijnë:

- Krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave, sipas nenit 10 të këtij ligji dhe krijimin e kushteve për zbatimin e tij,
- Hartimin e një raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave,
- Rregullimin e përgjegjësiave dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimin e tyre dhe organizimin e menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre,
- Mirëmbajtjen dhe mbajtjen e një sistemi të informimit publik dhe raportimin për punët e kryera siç është paraparë me këtë ligj dhe me aktet ligjore të tjera për menaxhimin e mbeturinave,
- Zbatimin e procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e personave të licencuar për mbledhjen, depozitimin dhe transportimin e mbeturinave të ngurta komunale në territorin e saj,
- Evidentimin e vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimin e projekteve për sanimin e tyre me shënimet për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, llojin e ndotjes, sasinë e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënimet e tjera me rëndësi për realizimin e projekteve, dhe
- Mbikëqyrjen dhe kontrollimin e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre përmes inspektorëve komunal të mjedisit.

Neni 10 i këtij ligji i përcakton komponentët e planit komunal, duke përfshirë, mes tjerash, informatat për sasi dhe llojet e mbeturinave, qëllimet dhe caqet e reduktimit të mbeturinave, programet për mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave të amvisërisë, mbeturinave komerciale, industriale dhe të rrezikshme, ndarjen, riciklimin dhe kompostimin të mbeturinave, vetëdijësimin publik, masat dhe shpenzimet e tyre për menaxhimin e mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhim të mbeturinave për komunën e Rahovecit janë të ndara sipas kompetencave të paraqitura si më poshtë:

- Komuna kontraktin operatorët (publik apo privat) për aktivitetet e Menaxhimit të Mbeturinave, duke u bazuar në ligjin përkatës.

- Drejtoria për Shërbime Publike a) Menaxhon projektet komunale të parapara me buxhet nga lëmi i infrastrukturës të ujit, kanalizimit dhe hapësirës publike;
- b) Është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike komunale, përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizim, mirëmbajtjen e rrugëve, transportin lokal, ngrohjen lokale, tregjet, varrezat, hapësirat publike, parket, mirëmbajtjen e pastërtisë dhe rregullimit të qytetit dhe vendbanimeve tjera, ndërmarrjen e masave për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore dhe kryen punët tjera të përcaktuara me ligj
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa planifikon, përcakton obligimet në bazë të rregulloreve komunale të subjekteve të caktuara në Komunë, shkallën e ngarkesës (tarifën) nga lëmi i tatimit në pronë, taksave dhe gjobave komunale.
- Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje e Mjedisit a) Përpunon kërkesat për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcakton kushteturbanistike për zbatimin e planit hapësinor, planin urbanistik, planin e rregullimit, planin të parcelimit, vijës së rregullimit dhe ndërtimit,
- b) Lëshon lejet e ndërtimit, lejet e përdorimit dhe shfrytëzimit, cakton komisione përmbikëqyrjen të objekteve, jep pëlqimet e rregullimit të infrastrukturës,
- c) Menaxhon projektet komunale të parapara me buxhet nga lëmi i urbanizmit.
- Drejtoria e Inspeksionit a) Në kuadër të Drejtorisë për inspeksion e që janë në përgjegjësi të Komunës sipas dispozitave ligjore kryhen punët e inspektimit të tregut, sanitar, trafikut, ndërtimtarisë, bujqësisë, veterinarisë, shërbimet komunale, hidroekonomisë dhe inspektimet tjera komunale të përcaktuara me ligj.
- b) Ndërmerr procedurat ligjore, në kuadër të inspektimit nga sferat e inspektimit komunal në procedurë administrative dhe gjyqësore.
- c) Kryen edhe punët tjera të përcaktuara me Ligjin.
- Operatorët e autorizuar nga komuna e Rahovecit janë Ndermarrja Regjionale e mbeturinave "Ekoregjioni" me njësinë e saj "Ambienti" mbulon territorin e Rahovecit sipas zonimit në Zonën I dhe kompania private "Ekodrinia" e cila shërben në Zonën II.

3. HARTIMI I PLANIT PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË MBETURINAVE TË NGURTA

3.1 Fushëveprimi i planit

Komuna e Rahovecit ka si synim që të përmirësojë procesin e menaxhimit të mbeturinave komunale në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Referuar kompetencave, Komuna e Rahovecit planifikon zbatimin e reformave në sektorin e menaxhimit të mbeturinave me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve financiare duke marrë në konsideratë planifikimet konkrete që adresojnë menaxhimin e rrymave të ndryshme të mbeturinave dhe inkurajojnë ndarjen e tyre në burim dhe mbledhjen e diferencuar për të nxitur Riciklimin, Ripërdorimin dhe për rrjedhojë Reduktimin e mbeturinave që depozitohen në venddepozitim (lokacionin/deponinë) e trajtimit të përkohshëm/përfundimtar, krahas sigurimit të një shërbimi më cilësor për qytetarët. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në hartimin e planeve, Green Art Center-Prishtina ka për qëllim që të mbështesë Komunën e Rahovecit që të identifikojë dhe të hartojë një koncept të financueshëm për menaxhimin e mbeturinave inerte prej ndërtimit dhe operimin e qëndrueshëm të

Deponisë për Mbeturinat Inerte nga ndërtimi dhe demolimi, si dhe të planifikojë një plan operimi, pasi të ketë identifikuar dhe të ketë siguruar pajisjet e nevojshme me qëllim organizimin e duhur të fraksionit të mbeturinave inerte; duke synuar krijimin e kushteve për trajtim të sigurtë të mbetjeve që derivojnë prej ndërtimeve dhe prishjeve, eliminimin e deponive ilegale prezente të këtij lloji në territorin e komunës optimizimin e kostove, si dhe nxitjen e procesit të reduktimit dhe riciklimit në kuadër të planeve të Komunës për të filluar me grumbullimin e diferencuar të mbeturinave.

3.2 Planifikimi strategjik

Hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave inerte është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbeturinave në nivel lokal, përmes ofrimit të zgjidhjve për ndërtimin dhe operimin e lokacionit të përcaktuar për mbeturinat inerte nga ndërtimi dhe prishjet në Komunën e Rahovecit.

Ky plan mundëson planifikimin strategjik për të ardhmen për këtë fraksion të mbeturinave si edhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis akterëve të ndryshëm për menaxhimin e mbeturinave në nivel lokal. Plan i lokal për menaxhimin e mbeturinave inerte (PMML) do të jetë i orientuar gjatë hartimit të saj, në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e trajtimit të mbeturinave inerte që vijnë nga ndërtimet dhe prishjet në nivel territorial komunal përmes ofrimit të zgjidhjeve për funksionalizimin e lokacionit/deponisë që do të trajtojë këtë fraksion të mbeturinave.

Qëllimi i planit është parashtrimi i qartë i politikave të menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal, duke harmonizuar interesat e të gjithë akterëve dhe publikut, të cilit ky shërbim i ofrohet për të siguruar një menaxhim më efikas dhe të qëndrueshëm, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme, duke përfshirë teknologjinë e përshtatshme për trajtimin final të mbeturinave inerte.

Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SR KMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare. Plan i identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe trajtimin final të mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi;
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standartet e menaxhimit të tyre;
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave inerte;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve e qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Ky plan do të referohet legjislacionit kombëtar, respektivisht LIGJI NR. 04 / L-060 për Mbeturina, ku grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve e lokale, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre (Ligji nr. 03/I-040 “Për vetqeverisjen lokale”, 2008, i cili përbën bazën ligjore që rregullon aktivitetin dhe përgjegjësitë e komunave në këtë fushë. Në mënyrë të veçantë ky ligj (neni 15, pika 1.8) ngarkon Komunitet me detyrën dhe i bën ato fuqiplotë për planifikimin për menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre si dhe planifikimin dhe ndërtimin e infrastrukturës e cila do të ndihmojë në reduktimin e mbeturinave dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

3.3 Objektivat

Komuna është duke u fokusuar drejt një bashkëpunimi të ngushtë me qytetarët dhe bizneset, vecanërisht ata që operojnë në fushën e ndërtimit, për të adresuar dhe përshtatur një zgjidhje efektive për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi sikundër dhe lloje të tjera të kësaj natyre me qëllim që të përmirësojë shërbimin e largimit të mbeturinave të këtij fraksioni, të eliminojë krijimin e deponive ilegale si problematikë në këtë komunë, të zvogëlojë shpenzimet e derivuara nga operimi dhe pastrimi i deponive që krijohen në nivel territorial, të gjenerojë të ardhura të vetëqëndrueshme nga përpunimi adekuat i këtij fraksioni, të mbrojë shëndetin e banorëve dhe të nxisë qëndrueshmërinë e zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Komunës.

Nën këtë objektiv të përgjithshëm, komuna ka për qëllim ngritjen e një sistemi me strukturë operative për grumbullimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi si një qendër (deponi për mbeturina inerte) që do të shërbejë qytetarëve të Rahovecit, për të destinuar dhe trajtuar mbeturinat inerte nga ndërtimi dhe demolimi.

Komuna ka planifikuar dhe përcaktuar një hapësirë të përshtatshme për dërgimin e këtij fraksioni të mbeturinave, si edhe tenton të marrë parasysh edhe lokacione tjera eventuale. Referuar adresimit të lokacionit të përshtatshëm i cili përmbush detyrimet ligjore të vendosura sipas kriterëve prej organeve qendrore, në planin e saj komuna synon që mbeturinat inerte nga ndërtimi dhe demolimi të selektohen, trajtohen dhe aty ku mundet, të ripërdoren si materiale dytësore ndërtimore.

3.4 Hartimi i planit

Në fazën e parë u themelua grupi i punës me përfaqësues nga zyrtarë të komunës, përfaqësues të Green Art Center dhe ekspertizë të angazhuar. Ata ishin pjesë e zhvillimit të planit duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që i përshtaten më shumë politikave të Komunës si dhe duke përfshirë prioritetet e komunës, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore. Konkretisht të shprehura në mënyrë të listuar hapat bazë të ndjekura për procesin e planifikimit të menaxhimit të mbeturinave sipas fraksionit të planit, janë si mëposhtë:

Hapi 1. Krijimi i strukturave organizative

Hapi 2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe alternativave përkatëse

Hapi 3. Planifikimi operacional i menaxhimit të mbeturinave inerte prej ndërtimit dhe demolimit

Hapi 4. Planifikimi financiar i menaxhimit të mbeturinave inerte prej ndërtimit dhe demolimit

Hapi 5. Konsultimet dhe zbatimi i planit.

Sipas procesit të konsultimit, duke parashtruar nevojat në sektorin e menaxhimit të mbeturinave që i nevojiten komunës, u ofruan mundësi për komente apo diskutime të ndryshme referuar qëllimit të planit. Përfaqësuesit e Komunës së Rahovecit, kanë asistuar gjatë vizitave në terren dhe kanë dhënë

asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e lokacioneve potenciale për përcaktimin e deponisë inerte si dhe përmes ofrimit të të dhënave për analizim të detajuar të situatës dhe sektorit të menaxhimit të mbeturinave gjatë përgatitjes së planit.

3.5 Identifikimi i lokacionit

Komuna e Rahovecit, respektivisht Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP) kanë identifikuar paraprakisht një lokacion cili i mund të shërbejë për depozitimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi.

Duke u mbështetur në arsyetime konkrete që lidhen me ndikimin në mjedis, si dhe çështjet administrative dhe pronësore, Komuna e Rahovecit duhet të arrijë në përfundim së vendi i cili do të propozohet, duhet të plotësojë në mënyrë optimale kërkesat ligjore dhe ato të Komunës për të ndërtuar dhe operuar me deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi. Referuar asaj, lokacioni i propozuar ofron kushtet për funksionalizim të saj por duhet të planifikohen përgatitjet e dokumenteve përcjellëse ligjore si Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis për të synuar operimin e tij. Vendi i propozuar parasheh një sipërfaqe në formë të një zbrazëtie (kanali në formë hinke), i cili synohet ndër vite të mbushet dhe rehabilitohet sipas normativave të caktuara. Sipas zyrtarëve të Komunës, vendi i propozuar planifikohet të përdoret për deponimin e mbeturinave inerte dhe është pronë komunale. Ky lokacion është në distancë 2.23 km prej qytetit si dhe ofron akses mjaft të mirë me rrugët kryesore.



Fig. 2: Pamja e lokacionit me Google My Maps që tregon pamje nga vendi i propozuar për deponinë inerte, Rahovec;



Fig. 3: Distanca për deponinë inerte nga Qendra, Rahovec;

3.6 Hartimi i planit për deponinë e mbeturinave inerte në Komunën e Rahovecit

Paraprakisht duhet të merret në konsideratë se zbatimi i një plani të komunës për administrimin e qëndrueshëm të mbetjeve inerte prej ndërtimit dhe demolimit do të kërkojë një vlerësim në lidhje me ndikimin mjedisor dhe sigurinë për vendin apo vendet e zgjedhura për deponimin dhe trajtimin e tyre në të ardhmen.

Duke marrë parasysh se është reflektuar mbi alternativat e mundshme, koncepti i hartimit të planit lokal për menaxhimin e mbeturinave inerte do të reflektojë mbi ngritjen e një qendre të përkohshme /lokacion të përkohshëm vetëm për mbeturinat e ndërtimit, në të cilën do të planifikohen aktivitetet për përpunimin e kësaj kategorie të mbeturinave. Për ta realizuar këtë qëllim, është hartuar një dokument i cili përmban:

- Një përshkrim të kriterëve teknike dhe operacionale të një vend-depozitimi për mbeturinat inerte si dhe kostot respektive për ndërtimin dhe operimin e saj;
- Të zhvillojë një plan organizativ dhe operacional për funksionalizimin e lokacionit për pranimin e mbetjeve të ndërtimit dhe prishjeve;
- Të përcaktojë llojin dhe kostot e pajisjeve dhe mjeteve që kërkohen për operim të rregullt në lokacion të deponisë për inerte;
- Të rekomandojë rregulla të përgjithshme dhe të veçanta për realizimin e shërbimit të grumbullimit, transportit, trajtimit të mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi.

Ky plan do të ndihmojë komunën për të hartuar Termat e Referencës për projektimin e detajuar, ndërtimin dhe pajisjen me mjete të trajtimit për mbeturinat inerte në të ardhmen në bashkëpunim me donatorë apo Qeverinë e Kosovës.

4 ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

Profili i Komunës së Rahovecit

Rahoveci është qytet dhe komunë në pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Në veri kufizohet me Klinën, në lindje me Suharekën, në pjesën jugore gjendet komuna e Prizrenit, ndërsa në tërë pjesën perëndimore kufizohet me komunën e Gjakovës. Përafërsisht ka diku 276 km² dhe është vendbanim i 56,208 banorëve.

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore.

Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione e këto janë: rrafshirë-luginore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës shtrihet në hemisferën veriore të Ekuadorit me shkallë 42° 30' dhe 42° 50' të gjërsisë veriore gjeografike dhe ndërmjet 20° 21' dhe 20° 55' të gjatësisë lindore gjeografike. Vendbanimet në komunën e Rahovecit janë të koncentruara në lartësitë mbidetare prej 310 m. (Krusha e Madhe pjesa e re e vendbanimit pjesa lindore të bregut të lumit Drini i Bardhë) deri në 920 m. lartësi mbidetare që është i koncentruar vendbanimi i Zatriqit.

Për nga lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshirë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në luginë ose rrafshirë janë këto : (310 – 350 m.) Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Drinasi, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë : Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshirave).




Fig. 4: Harta e Pozitës gjeografike të komunës së Rahovecit sipas Ndarjeve administrative

Tabela 1.Statistika mbi numrin e popullsisë për Komunën e Rahovecit

NJA	Nr. Popullsisë	Nr. Populls. Urbane	Nr. Populls. Rurale	Nr. Ek.familjare totale	Nr. Bisneseve	Nr. Institucione
Total	56,208	15,892	40,316	9,927	3000	73

* Në të gjitha të dhënat e marra dhe elaboruara në kuadër të planit do të përdoret numri i popullsisë i llogaritur nga Agjensia e Statistikave të Kosovës.

Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ dhe minerale si krom, azbest, nik el, kobalt, bakër dhe gypyr guri (thëngjilli). Gurët dekorative: gjendet në afërsi të fshatit Drenovc, në një largësi prej 5, 5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat për këtë material ndërtimor dekorativ mendohet të jenë rreth 207.386 m³. Shtresat e lezolilit dekorativ janë sipërfaqësore të mbuluara me një shtresë humusi prej 0,5 m. Gurët gëlqerorë : gjenden në Hudhrat e Danit, një vend në veri-perëndim të qytetit të Rahovecit 8 km larg tij. Ato shtrihen në formë blloqesh me trashësi që varion nga 0,3 në 2 metra, dhe janë 1,5 metra poshtë sipërfaqes së tokës. Gurët gëlqerore paraqiten në ato të kuq dhe të murrëm. Gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerore mendohet të ketë një volum prej 382.913 m³. Azbesti : Shtresat e lezolilit të azbestit janë të përqendruara në afërsi të fshatit Rudin/Pastasel ne perëndim të Rahovecit, në një largësi prej 8 km. Sipas hulumtimeve është përcaktuar sipërfaqja e shtresës prej 100.000 m² dhe mendohet që rezerva të kapë shifrën prej 10.000.000 Ton. Kjo e dhënë është e përafërt dhe kërkon hulumtime të hollësis hme gjeologjike. Kobalti, Nikeli dhe Bakri - Ne rrethinën e Gurit te Kuq janë konstatuar shtresa e xeh eroreve te Nikel-Kobaltit. Përbërja mesatare e këtij xeherori sipas hulumtimeve të bëra vite më parë për mineralin në formë të ngurtë është (Nikeli 0,18 %, Kobalti 0,13 % dhe Bakri 2,73 %). Sasia e rezerveve të këtij xeherori nuk dihet. Kromi: mendohet që ky mineral të gjindet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradisht, lugina e prroit Rimnik, Delja, Shipi në Zadriq, Sharnica mbi Qëndresë, Drenovci, Guri i kuq, Kanzniku, etj. Thëngjilli: gjëndet në lokalitetet e Hoçës së Madhe, Krushës, prroit të Nagavcit, Drinasi, etj. Për të përcaktuar sasinë e rezervave dhe cilësitë kalorifike të thëngjillit duhen bërë hulumtime të thella gjeologjike.

Se fundi, sipas Komunës ekziston mundësia që të gjinden shtresa naftë mbajtëse ne territorin e Komunës së Rahovecit. Vendodhja e tyre mendohet të jetë në fshatin Kramovik dhe përgjatë rrjedhjes së Drinit të Bardhë deri në Krushën e Madhe.

4.1 Gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave komunale

Shërbimi i grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbeturinave realizohet nga Ndermarrja Publike “Ekoregjioni” me njësinë e saj “Ambienti” dhe kompania private “Ekodrinia”.

Komuna raporton se në territorin e saj gjenerohen rreth 4,766.00 ton mbeturina në vit (2019) ose një mesatare prej rreth 91.65ton/javë që vjen si rezultat i llogaritjes nga prodhimi i gjenerimit mesatar (referuar të dhënave të ofruara nga komuna, DSHP). Shtrirja zonale e amvisërive dhe bizneseve, institucioneve (klientët), të cilët janë të përfshirë në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave sipas kompanisë “Ekoregjioni” dhe “Ekodrinia” janë:

- Zona Urbane: e cila i takon vetëm Rahovecit si qytezë – 3072 klient
- Zona Rurale: zonat e mbetura të rrethinës – 6064 klient.

Sipas të dhënave, niveli i ofrimit të shërbimit konsiston në 85% të territorit ku kompania publike ofron shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në 53.43 % të numrit të klientëve dhe ajo private në pjesën e mbetur.

Kapaciteti i gjenerimit sipas koeficientit të gjenerimit të mbeturinave për kokë banori, referuar të dhënave në planin komunal për menaxhim të mbeturinave do të nënkuptojnë si vijon:

- Urbane dhe suburbane 0.62 kg/ditë banorë
- Rurale 0.5 kg/ditë banorë
- Rurale e thellë 0.4 kg/ditë banorë

Referuar tabelës së mësipërme sipas shpërndarjes së popullsisë, kapaciteti i gjenerimit të mbeturinave për Komunën e Rahovecit do të nënkuptojë që në nivel të zonës urbane gjenerohen rreth 3 596 ton mbeturinë në vit dhe në zonë rurale rreth 6 622 tonë mbeturinë në vit; total ky, i cili do të përkojë me kapacitetin e gjenerimit të mbeturinave për Komunën e Rahovecit në 10 218 tonë/ mbeturinë në vit.

Referuar situatës së mëhershme mjedisore në komunë në disa zona periferike të qytetit dhe zona rurale ekzistojnë deponi ilegale të reja apo të vjetra. Por, edhe përkundër përpjekjeve të komunës në disa zona periferike të qytetit dhe zona rurale ekzistojnë deponi ilegale ku sipas vlerësimeve (raporti i fundit i AMMK 2020 për vlerësimin e vitit kalendarik 2019) rreth 20 deponi të ndara në 11 deponi të vogla, 6 të mesme dhe 3 të mëdha gjenden në territorin e komunës.

Referuar shërbimit të grumbullimit, në komunën e Rahovecit prezencë e deponive ilegale prej së kaluarës si dhe depozitimi i tyre në brigje të lumenjve, prrockave, paraqet rrezik duke ndikuar në ndotjen e tyre e tokës dhe ujrave, po ashtu shfaqjen e dukurive si, erozioni dhe vërshimet në tokat bujqësore, që shtrihen përgjatë këtyre lumenjve.




Fig.5: Harta e krahasuese e vendodhjes së deponive ilegale, Komuna e Rahovecit (verifikimi 2020)

Përkundër aktiviteteve të komunës, prezenca e deponivë ilegale me përbërje të llojeve të mbeturinave kryesisht të ndërtimit dhe demolimit, apo të përziera si dhe atyre të amvisërisë duhet të adresohet për zgjidhje prej komunës së Rahovecit në planifikimin dhe përcaktimin e hapësirave për trajtimin e këtyre llojeve të deponive apo në rritjen e mbulueshmërisë së shërbimit.

Sipas raportimit prej komunës, vlerësohet së rreth 85% e territorit të komunës (qytetarëve) është e mbuluar me shërbim të grumbullimit të mbeturinave të amvisërisë. Kjo do të verifikohet dhe në prezencë të llojit të deponisë ilegale me mbeturina të amvisërisë (6 deponi sipas tabelës mëposhtë). Deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin rrezik permanent për banorët e Komunës, ku përmes përmes zbërthimit të materieve emetojnë lëndë toksike të dëmshme për shëndetin e njeriut duke u shpërndarë edhe në ujërat nëntoksorë si pasojë e përzierjes me rreshjet e shiut (prezencë e materialit asbest tek mbetjet që derivojnë prej prishjeve të ndërtimit).

Tabela 2. Numri i deponive sipas raportit të fundit i AMMK 2020 për vlerësimin e vitit kalendarik 2019

Madhësia – Sasia e deponisë		Deponitë ilegale	
		Sasia #	Përqindja
E vogël	1-5 200l qese mbeturinash / karroca dore,	11	55%
E mesme	5-20 200l qese mbeturinash / karroca dore,	6	30%
E madhe	> 20 karroca dore, dmth kamion i nevojshëm.	3	15%
Totali		20	100%
Karakteristikat e deponive		Sasia në numër	Sasia në përqindje

Mbeturina të amvisërisë (A)	6	30%
Mbeturina inerte / ndërtimore (N)	4	20%
Mbeturina industriale dhe të rrezikshme (R)	-	-
Mbeturina të vëllimshme (V)	-	-
Mbeturina të përziera (A, N, R, V)	10	50%
Totali:	20	100.00 %

Referuar karakteristikave të deponive ilegale sipas llojit të mbeturinave që gjenden në to, sipas rapo rteve prej kësaj komune vlerësohen se:

- 6 janë deponi me Mbeturina të amvisërisë (A)
- 4 janë deponi me Mbeturina inerte / ndërtimore (N)
- 10 me përbërje të Mbeturinave të përziera (A, N, R, V).




Fig 6: Harta e llojeve dhe përbërjes së mbeturinave sipas prezencës së deponive ilegale, Komuna e Rahovecit (verifikimi 2020)

Bazuar në këto karakteristika shihet që synimet strategjike të komunës së Rahovecit konkretizohen në plotësimin e shërbimit në nivel territorial të komunës (100% mbulueshmëri) dhe gjetjen e alternativave për funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave të veçanta (përfshirë mbeturina inerte, të vëllimshme etj) ku krahas rritjes së plotësimit të shërbimit (rreth 15% e qytetarëve nuk

janë në shërbim) njëherësh duhet të gjenden mundësi për gjetjen e zgjidhjeve për krijimin e sistemeve për organizimin e mbeturinave inerte dhe ato të vëllimshme.

Sipas analizës dhe vlerësimeve bazuar në studimet në shkallë vendi, vlerësohet se mbeturinat inertë nga ndërtimi dhe demolimi (prishjet) përbëjnë rreth 10 % të mbeturinave urbane. Kjo nënkupton se potencialisht në nivelin total të mbeturinave të gjeneruara të cilat përkrijnë me 10 218 ton në vit, rreth 1002 ton mbeturinë inertë në vit gjenerohen në komunën e Rahovecit. Në vlerësim ditor rreth 2.75 ton/ditë e mbeturinave është mbeturinë inerte. Megjithatë mungesa e mbulueshmërisë së shërbimit, depozitimet ilegale aktuale të shkarkuara në formë të deponive ilegale në territorin e komunës, e vështirësojnë llogaritjen e saktë të këtij fraksioni të mbeturinave.

Vlera referente financiare që do të konsiderohet në përlllogaritje të planeve të komunës për eliminimin e përhershëm të tyre rekomandohet të marrë parasysh një analizë të saktë të perimetrit të depozitimit, llojit të përbërjes dhe koeficientin e ngarkesës ku do të përlllogaritet në 1 kamion lili bart 8 – 13 m/kub ngarkesë 1 m/kub inerte peshon rreth 1.5 ton.

Problemet aktuale me të cilat komuna përballet ndër të tjerash do të përfshijnë:

1. Sasinë e madhe të mbeturinave të amvisërisë (6 deponi, kryesisht në formën e deponive ilegale të madhësive të ndryshme), ku duhet të ndërmirren masa të ofrimit të shërbimit apo monitorimit në zbatim të grumbullimit;
2. Sasinë e madhe të mbeturinave inerte nga ndërtim/demolimi dhe ato voluminoze (kryesisht në formën e deponive ilegale të madhësisë së mesme dhe të madhe);
3. Hedhja e pakontrolluar dhe krijimin e deponive të egra;
4. Mungesa e një vendi adekuat për grumbullim dhe trajtimin e mbeturinave;
5. Mungesa e një destinacionit final – ripërdorimi i produkteve që gjenerohen nga trajtimi i tyre.
6. Organizimi i shërbimit për grumbullimin, transportin dhe deponimin e tyre.

Komuna ka një rregullore komunale për mbeturinat, e cila përcakton rregullat dhe detyrimet e qytetarëve dhe bizneseve në lidhje me grumbullimin, transportin dhe depozitimin e mbeturinave duke konsideruar edhe mbeturinat jot të amvisërisë, por ka mangësi në zbatimin e saj dhe monitorimin e veprimeve të gjeneruesëve të këtij lloji të mbeturinave.

Komuna nuk ka një shërbim të organizuar për grumbullimin dhe largimin e mbeturinave të vëllimshme dhe atyre të ndërtimit dhe prishjeve duke mënjeluar faktin e kampanjave simbolike për eliminimin e tyre, apo pastrimet e kohëpaskohëshme gjatë aplikimit të shtrirjes së shërbimit.

Në Komunë konfirmojnë se lejet e ndërtimit përmbajnë gjithmonë kushtin që ndërtuesi është përgjegjës për largimin e mbeturinave të ndërtimit, por nuk ka siguri në monitorimin e zbatimit të këtij kriteri. Në raste të veçanta, Komuna ose vetë ndërtuesit apo individë angazhojnë përkohësisht kontenerë të mëdhenj 7m³ për grumbullimin e mbeturinave inerte në objektet ku ndërtohet dhe deri më tani zbrazja e tyre ka funksionuar në sistem të pakontrolluar.

5. PLANI PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE TË NGURTA

5.1 Koncepti i deponimit të sigurtë të mbeturinave inerte

Plani për ndërtimin dhe operimin në një lokacioni të përcaktuar për depozitimin dhe trajtimin e mbeturinave inerte i referohet nevojës së komunës për adresimin e dukurisë së eliminimit të deponive ilegale që formohen në qytet si dhe trajtimin e këtij fraksioni në periudhë afatgjatë, me qëllim organizimin e shërbimit efikas të menaxhimit të mbeturinave, trajtimit të tyre sipas llojeve dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që deponohen. Në një përmbledhje të këtyre programeve strategjike, do të paraqiten alternativat e mundshme për menaxhimin e rrymes së mbetjeve inerte, si vijon:

- a. Përdorimin dhe funksionalizimin e një lokacioni si një vend-depozitim për këtë fraksion të rrymës së mbeturinave duke u integruar përpunim i pjeshëm i këtyre llojeve të mbeturinave që derivojnë prej ndërtimit dhe prishjeve, dhe
- b. Përdorimi i hapësirave të tjera të përkohshme, të cilat mund të krijohen për nevojë të punimeve të ndërtimit si për mbushje për gropa, rrugë, sheshe etj. Kryesisht për ndërtuesit e mëdhenj të interësuar dhe në bashkëpunim me institucionet relevante komunale dhe me sigurinë se mbeturinat që do të dërgohen nuk do të jenë të përziera me lloje tjera mbeturinash;

Plani është hartuar duke ju referuar se “mbeturinat inerte nga ndërtimi dhe demolimi janë përgjegjësi e gjeneruesit”, si dhe mbi bazën e përkufizimit siç është pranuar në ligjin “Për mbeturinat” në Republikën e Kosovës:

“Mbeturina inerte janë mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biolo-gjik në vendet ku janë deponuar si:

- a. Mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërrthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
- b. I tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet toksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore”.

5.2 Modalitetet e operimit

Modalitetet e planifikuara do të ndihmojnë komunën e Rahovecit për të ngritur një sistem të qëndrueshëm dhe efikas të shërbimit për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave inerte. Funksionalizimi i lokacionit së propozuar dhe objektit të trajtimit të mbeturinave që derivojnë prej ndërtimit dhe demolimit (prishjeve) do të mund të zhvillohen sipas skenarëve të ndryshëm të paraqitura si më poshtë:

1. Dërgimi i mbeturinave inerte në lokacionin për mbeturina nga ndërtimi dhe demolimi.

Ky model do të zbatohet nga gjeneruesit e mbeturinave inerte (qytetarët, bizneset dhe institucionet) të cilët do të dërgojnë vetëm mbeturina nga ndërtimi dhe demolimi në lokacionin e destinuar prej anës së komunës. Ky lokacion me karakterin e një qendre shërbimi, do të pranojë dhe shërbejë për gjeneruesit e këtij fraksioni të mbeturinave përgjatë tërë javës (pesë-gjashtë ditë në javë) sipas

orareve të përcaktuara prej institucionit komunal. Klientët mund të dërgojnë mbeturinat e tyre në objektin e grumbullimit (deponi) brënda orarit, sipas ditëve të punës, gjatë të cilave deponia do të jetë e hapur. Rekomandohet që pranimi dhe depozitimi i mbeturinave inerte në deponi të jetë pa tarifë për klientët që i sjellin vetë ato. Në këtë mënyrë klientet do të inkurajohen që ti dërgojnë në mënyrë të vullnetshme mbeturinat e tyre në deponi duke marrë përsipër kostot e dërgimit të mbetjeve inerte.

2. Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi bëhet sipas kërkesës së klientëve.

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave inerte mund të organizohet në bazë të kërkesave të klientëve (qytetarët apo bizneseve) sipas kontratave për shërbim të veçantë. Ky skenar është i përshtatshëm veçanërisht për bizneset e mëdha të ndërtimit, por mund të funksionojë edhe për qytetarët, veçanërisht në rastet e rikonstruksioneve dhe riparimeve të shtëpive apo të bizneseve të tyre. Klientët do të drejtohen operatorit të grumbullimit, në këtë rast kompanisë kompanisë/operatorit të përcaktuar nga komuna, ku mund të jetë Ndërmarrja Publike "Ekoregjioni" që duhet të ofrojë kapacitete për grumbullimin dhe transportimin e këtij lloji të mbeturinave. Klientët do të adresojnë një kërkesë/kontratë të shkruar nëpërmjet të cilës do të kërkojnë që t'i ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbeturinave inerte që do të gjenerohen nga veprimtaria e tyre. Për këtë qëllim komuna/kompania do të vërë në dispozicion të klientëve një numër telefoni dhe një adresë email-i si dhe do të caktojë dhe do të bëjë publike një tarifë të veçantë në varësi të sasisë dhe distancës së transportit për këtë shërbim të veçantë.

3. Kontrata me palë të treta (kompani private).

Komuna mund të lidhë kontratë me një kompani private, të cilës i jepet leje e posaçme operimi dhe grumbullimi vetëm për këtë fraksion të mbeturinave apo edhe të tjera. Në këtë rast propozohet që kompania private me kontratë të veçanta të organizojë skemën e grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave inerte duke vendosur kontenierë të mëdhenj (5-7 m³) në pika të veçanta në territorin e komunës ose të bëjë grumbullimin derë më derë me kërkesë të klientëve për largimin e këtyre mbeturinave, duke ju përmbajtur një orari të caktuar dhe tarife të veçantë shërbimi. Kjo alternativë mund të jetë e përshtatshme të zbatohet edhe duke u alternuar në kuadër të skenarit të dytë.

Institucioni komunal mundet të përzgjedhë opsionet e mësipërme duke i kombinuar ato, si edhe duke deleguar përgjegjësitë tek operatori, i cili mund të jetë kompani publike apo kompani private. Në të gjitha rastet komuna duhet të monitorojë performancën e kryerjes së këtij shërbimi. Në këtë drejtim, institucioni komunal duhet të punojë në drejtim të zbatimit të rregullave të vendosura për organizimin e këtij shërbimi si dhe të bashkëpunojë ngushtë me inspektorët e mjedisit.

5.3 Përcaktimi i materialeve

Lokacioni për mbeturina inerte i paracaktuar prej Komunës së Rahovecit do të përdoret si vendgrumbullim vetëm për mbeturina inerte nga ndërtimi dhe demolimi gjatë prishjeve/renovimeve shtëpiake apo mbeturina të ngjashme të prodhuara nga bizneset dhe institucionet, duke përfshirë:

- Beton,
- Tulla, tjegulla dhe qeramikë;
- Metale,
- Plastike dhe xham (opsionale sipas konfirmimit të komunës, referuar planeve komunale për këtë kategori mbeturine);
- Mbetje bitumi, asfalti

- Dhera dhe gurë;
- Materiale izoluese;
- Materiale me bazë knaufi, argjile;

Pjesa më e madhe, zakonisht në sasi sa rreth 70 % e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi përbëhet nga dhera dhe gurë, rreth 25 % përbëhen nga betoni, tulla, qeramikë, ndërsa pjesa 5% që mbetet përbëhet nga materiale të tjera.

Për menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave inerte ka teknika të ndryshme dhe treg të ndryshëm të shitjes së tyre. Disa materiale si tullat apo materiale qeramike të padëmtuara mund të rikuperohen nga prishjet dhe ripërdoren direkt në procesin e ndërtimit. Materialet e betonit mund të grimcohen dhe përdoren gjatë shtrimit të rrugëve, rrafshimit të terreneve etj. Mbetjet nga materialet izoluese sërish mund të trajtohen për tu përdorur në ndërtim në formate tjera (fibra për izolim etj).



Fig 7: Llojet e mbetjeve inerte dhe ripërdorimi i tyre

Kryesisht këto materiale i nënshtrohen minimalisht procesit të selektimit dhe trajtimit fizik të tyre duke përfshirë:

- Selektimin (përmes përdorimit të sitës) për të ndarë gurët nga dherat dhe materiale të tjera;
- Copëzimi i gurëve/betoneve në përmasa të ndryshme dhe përdorimin për prodhim betoni, apo shtresa për mbushje në rrugë, sheshe etj.
- Ndarja e mbetjeve të riciklueshme si plastikë, dru, xham apo metale, si dhe materialet me përbërje knaufi;
- Depozitimi final i materialeve që nuk rikuperohen apo që nuk përdoren (apo që bëjnë pjesë në rrymën e mbeturinave që kërkojnë trajtim të veçantë sipas politikave nacionale), mbeturina të rrezikshme si azbesti etj.

Të gjitha këto procese trajtimi, janë plotësisht të mundshme që të realizohen sipas një plani kohor, në lokacionin/deponinë që do të funksionalizohet në Rahovec për trajtimin e mbeturinave inerte nga ndërtimet dhe demolimi duke u kthyer në zinxhirin e tregut të tregtisë dhe ekonomisë.

Pjesa e mbetjeve inerte, përmes një sistemi të operimit të sigurtë rekomandohet të akumulohet për mbushjen e gropës në kanalin natyror, i cili në një fazë përfundimtare duhet të trajtohet dhe të mbyllet sipas kushteve teknike të pranimit dhe të rehabilitohet sipas standarteve.

5.4 Skenarët e funksionalizimit të lokacionit për deponimin dhe trajtimin e mbeturinave inerte

Komuna e Rahovecit pas përcaktimit të mënyrës së grumbullimit, kriteret e depozitimit dhe funksionimit të lokacionit/deponisë së mbeturinave inerte duhet të marrë parasysh planifikimet afatgjata për funksionalizimin e lokacionit për trajtimin parafinal të mbetjeve prej ndërtimit dhe demolimit që do të pranohen në këtë lokacion.

Rekomandohet që kjo hapësirë të funksionojë si një vendpozicionim/ objekt i hapur për pritjen dhe trajtimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe deponimi, referuar dhe karakteristikave të këtij fraksioni në përmasa të mëdha dhe peshë.

Paraprakisht, të gjitha masat që komuna planifikon të ndërmarrë duhet t'i plotësojë në rregulloren e komunale për menaxhimin e mbeturinave të komunës si dhe ti prezentojë dhe informojë të gjithë akterët për ndryshimet dhe përgjegjësitë e prodhuesve të këtij fraksioni të mbeturinave.

Ndër të tjerash duhet të ceket dhe të shtohet në rregulloren komunale për mbeturina, si vijon:

- Amvisërive, bizneseve dhe institucioneve (me një fjalë "klientët") do t'i ndalohet hedhja e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi në Pikat e Grumbullimit të Mbeturinave të sistemit me kontenierë publik të komunës, jashtë kushteve të vendosura paraprakisht nga Komuna dhe Kompania;
- Komuna ka vënë në funksion të "klientëve" lokacionin sipas kriterëve teknikisht të pranuar për depozitimin e Mbeturinave Inerte në adresën e caktuar rreth 2.3 km nga qendra e Rahovecit dhe sipas skicës së bashkangjitur.
- Kompania do të bëjë publike orarin e pritjes për dërgimin e mbetjeve, kushtet dhe llojet e mbeturinave që do të depozitohen në lokacion/deponi, si dhe kushtet dhe tarifën për rastet kur kompania do të bëjë vetë grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave me kërkesë të veçantë të klientëve.
- Klientët që do të sjellin me mjetet e tyre mbeturinat nga ndërtimi dhe demolimi dhe do të lirohen nga pagesa;
- Klientët që do t'i kërkojnë kompanisë marrjen dhe transportin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi për depozitim në Deponi do të paguajnë tarifave shtesë të aplikuar;

Çdo ngarkesë e cila do të sillet në Deponi nga klientët apo nga kompania, do të peshohet paraprakisht në vendin e depozitimit. Administratori i objektit do të shënojë çdo ngarkesë që depozitohet në Deponi:

- Sasinë në ton,
- Llojin e mbeturinave dhe sasinë respektive.
- Gjeneruesin dhe transportuesin e mbeturinës.

Administratori i Deponisë do të hartojë një raport mujor lidhur me sasinë dhe llojin e mbeturinave që grumbullohen në lokacion, si dhe sasinë e mbeturinave që ndahen për ripërdorim dhe ato që përdoren për depozitim përfundimtar në kanal inatyror me destinim për tu mbushur.

Ndarja dhe selektimi i mbeturinave të riciklueshme dhe/ose të ripërdorshme do të bëhet në kontenierë për mbeturina të veçanta me kapacitet 7m³ në hapësirën e pranimit të mbeturinës. Kjo rekomandohet për të siguruar mos depozitimin në hapësirën natyrore për mbushje të mbeturinave që nuk i përkasin fraksionit të mbetjeve inerte. Për sa kohë nuk do të ketë kontenierë të mëdhenj, mbeturinat e selektuara mund të ruhen në vende të hapura të ndara sipas llojit;

Lokacioni mund të jetë i përbërë me seksione të veçanta për lloje të ndryshme mbeturinash, të cilat do të tregohen me sinjalistikë të vendosur, gjë që do të lehtësojë dhe orientojë klientët dhe punëtorët në këtë hapësirë për shkarkimin e mbeturinave në vendin e duhur.

Për çështje sigurie, klientët do të asistohen nga punëtorët e deponisë. Politikat e tarifës për klientët që i sjellin vetë mbeturinat inerte do të mbeten në kompetencë të komunës për tu aplikuar sipas kalkolimit të kostot së nevojshme të operimit dhe investimit në kohë.

Administratori i deponisë në bashkëpunim me drejtuesit e kompanisë do të vendosin modalitetet e përdorimit, ripërdorimit dhe destinacionin final të mbeturinave të riciklueshme – të ripërdorshme që do të rezultojnë nga procesi i selektimit të mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi. Gjithashtu, administratori i deponisë do të sigurojë që në këtë lokacion deponimi nuk do të dërgohen apo priten dhe nuk do të trajtohen mbeturina të rrezikshme dhe të ndryshme nga ato të cilat do të lejohen të pranohen në lokacionin e propozuar.

6 KRITERET PËR PROJEKTIMIN DHE FUNKSIONALIZIMIN E LOKACIONIT PËR DEPONIM TË MBETURINAVE TË NGURTA

6.1 Specifikimet teknike

Plani për ndërtimin dhe operimin e deponisë për mbeturinat inerte nga ndërtimi dhe demolimi do të respektojë detyrimet që lindin nga Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2012 "Për menaxhimin e deponive të mbeturinave", në të cilin theksohet se:

"Në deponitë e mbeturinave inerte pranohen, trajtohen dhe deponohen vetëm mbeturinat për të cilat është konstatuar se janë inerte dhe se kullimi nuk i tejkalon vlerat e parametrave të paraqitur në Shtojcën 1 të këtij Udhëzimi Administrativ." (neni 9, pika 4)

Gjatë planifikimeve duhet të merren parasysh dhe referuar literaturës ndërkombëtare:

1m³ volum mbeturina inerte përlogaritet në peshë mesatarisht në 1.5 ton, dhe ku faktori i ngjeshjes është shumë i ulët maksimumi deri në 10%.

Gjithashtu plani duhet të marrë parasysh plotësimin e disa kriterëve teknike dhe mjedisore të njohura përgjithësisht për ndërtimin dhe operimin e një deponie/lokacioni për mbeturinat inerte, të tilla si:

- Një deponi për mbeturinat nga inerte nuk duhet të vendoset pranë një parku apo rezervati natyror, vende të cilat janë habitate të specieve të veçanta apo ku ka një jetë të egër të zhvilluar dhe mjedis krejt të pastër dhe në një ose pranë një zone të mbrojtur me rezerva ujore;
- Vendi i zgjedhur duhet të jetë në përputhje me zonimin funksional (planin hapësinor) të komunës;
- Vendi i zgjedhur duhet të jetë lehtë i aksesueshëm (rrugë e shtruar);
- Deponia/lokacioni nuk duhet të vendoset në vende të cilat paraqesin rrezik nga përmytjet;
- Gjithashtu, Komuna dhe Kompania duhet të mobilizojnë pajisje trajtimi dhe instalime apo paisje të tjera të lëvizshme, në mënyrë që sipas nevojave kur lokacioni duhet të zhvendoset/mbyllet cikli, të mund ti zhvendosë lehtësisht ato nga një vend në një tjetër.

6.2 Specifikimi i kostove të pajisjeve për funksionalizimin e deponisë së mbetjeve inerte

6.2.1 Investimet fillestare për lokacionin e deponisë inerte

Investimet në infrastrukturën e funksionalizimit bazik të deponisë janë ekonomike për sa i përket investimit bazik elementar dhe bazohen kryesisht në punime të ndërtimit minimal, të cilat përfshijnë:

- Gërmim, mbushje dhe sheshim i platosë;
- Rrethim i lokacionit me rrjetë teli;
- Vendosja e një porte të lëvizshme në hyrje;
- Ndriçim i jashtëm periferik;
- Vendosja e ujëmbledhësve për ujrë të shiut/atmosferikë;
- Vendosja e një kabine në hyrje të deponisë si ambient zyre për administratorin/punëtorët dhe vendosja e kabinës për tualet;
- Vendosja eventuale e kamerave të sigurisë

Vlerësimi i kostove të investimit fillestar rekomandohet të bëhet prej ekipës së projektimit pas definimit të lokacionit ku do të vendoset deponia për grumbullimin e mbeturinave të ndërtim demolimit. Zërat e punimeve, volumet dhe kosto e saktë e tyre mund të ndryshojnë respektivisht nga projekti i detajuar për ndërtimin e objektit.

Tabela 3. Zërat e kostove për ndërtimin e lokacionit të deponisë

Zërat e kostove	Njësia	Sasia	Çmimi njesi (Euro)	Shuma Euro
Punime : Gërmim, mbushje dhe largim dhe në zonën e hyrjes në lokacion	m/kub	1000	2	2000
Punime shtrim i platosë (10 cm)	m/katror	250	11	2750
Rrethim i lokacionit me rrjetë teli solid /llamarine; zona e pranimit	meter	450	25	11 250
Porte të lëvizshme	Copë	1	2000	2000
Ndriçim i jashtëm dhe elektricitet	Njesi		5000	5000
Vendosja e sistemi të ujëmbledhësve për ujë atmosferikë	Njesi		3000	3000
Punime për furnizimin me ujë të pijshëm dhe ujë për shërbime të tjera	Njesi	1	5000	5000
Kabine për zyrë dhe tualet kabinë	Copë	2	4500	9000
Vendosja e kamerave të sigurisë	Copë	3	200	600
Shuma sipas zërave më lart				40 600
TOTAL				40 600 Euro

Është me rëndësi që deponia të ketë qasje të mirë rrugore për mjete ngarkuese dhe të jetë e shtruar. Sipas zërave të kostove të përmbledhura, funksionalizimi bazik i këtij lokacioni do të kushtojë komunës së Rahovecit rreth **40 600** euro, i cili do të përfshijë kostot për punimet për hapësirën në lokacion në vlerë 29 350 euro dhe punime shtesë si rrethimi i tij në vlerë 11 250 euro.

Komuna mund të realizojë punët për ndërtim të lokacionit në faza ku paraprakisht duhet të planifikojë buxhetin sipas punëve për realizim. Ndërtimi i lokacionit planifikohet të nisë për vitin 2021 sipas planeve komunale për menaxhim të integruar të mbeturinave komunale.

6.2.2 Specifikimi i pajisjeve për funksionalizimin e deponisë së mbetjeve inerte prej ndërtimit dhe demolimit

Lokacioni i caktuar/deponia do të bëhet funksionale në tërësi pas sigurimit të pajisjeve bazike që ndihmojnë mbarëvajtjen e punës dhe përdoren për trajtimin e mbeturinave që do të pranohen në deponi. Në mënyrë të veçantë, deponia e mbeturinave inerte prej ndërtim demolimi, duhet të pajiset me

Mjet ngarkimi me kapacitet ngritës nga përpara (1m^3)/fadromë;

- Makinë e lëvizshme gurëthyes – seleksionues;
- Vegla dhe pajisje të ndryshme pune për përpunim të mbeturinave;

Në Deponi mund të vendosen 5 deri në 7 kontenierë 7 m^3 të cilë do të përdoren për ndarjen dhe depozitimin e përkohshëm të mbeturinave të riciklueshme që mund të gjenerohen nga procesi i selektimit të tyre (opsionale sipas konfirmimit të komunës, referuar planeve komunale për këtë kategori mbeturine).



Figura 8: Foto ilustruese e makinerisë gurëthyesë

Megjithatë kryesisht lloji i materialit që sillet në deponi është material ndërtimor prej betoni apo dhe me gurë, pajisja kryesore në këtë deponi do të jetë një makinë e lëvizshme gurëthyesë dhe seleksionuese, që do të kryej njëkohësisht dhe funksionin e sitës për materiale me përmasa të ndryshme.

Kosto e vlerësuar e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për funksionimin e saj është paraqitur në tabelën që vijon.

Tabela 4. Vlerësimi i kostove të pajisjeve për deponinë inerte

Makineri dhe pajisje	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Shuma Euro
Kontenierë 7m^3	Copë	5	1500	7 500
Mjet ngarkimi (fadrome)	Copë	1	35 000	35 000
Makinë e lëvizshme gurëthyesë	Copë	1	250 000	250 000
Pajisje pune	Njesi	10	50	500
Shuma Pajisje				293 000 Euro

Nga ky vlerësim rezulton se kostoja e pajisjeve kryesore për funksionalizimin e kësaj deponie është rreth **293 000 Euro**.

Duhet theksuar se mjetet dhe paisjet për qendrën janë vlerësuar të reja, por sipas nevojës dhe mundësive të institucioneve përkatëse ato mund të jenë edhe të përdorura sipas specifikimeve teknike të përcaktuara prej ekspertëve të komunës.

Sipas alternativave të mundshme, komuna mundet të lidhë kontratë me palë të treta të interesuara sipas kriterëve të përcaktuara duke definuar pjesën investive të operimit brënda lokacionit dhe bartjen e kostove infrastrukturore (pajisjet).

6.3 Operimi dhe Mirëmbajtja

Përveç ndërtimit, furnizimit dhe instalimit të paisjeve, në deponi do të jetë e nevojshme të parashihet aspekti operacional dhe organizativ që do të sigurojë funksionimin e këtij Objekti/qendre për pranimin e mbeturinave të ndërtimit dhe prishjeve.

Deponia do të jetë pronë e Komunës së Rahovecit, e cila do të vihet në dispozicion për përdorim të Kompanisë "Ndërmarrja Publike "Ekoregjioni" apo të shqyrtohet dhënia në shfrytëzim tek palë të dyta apo të parashihen skenarë të kompanive private të interesuara për zhvillimin e këtij aktiviteti të cilët bartin përsipër kostot investive dhe ato operative.

Në të gjitha opsionet e zgjedhura nga komuna, kompanitë që do të operojnë në lokacionin për mbeturina inerte prej ndërtimit dhe demolimit, këto të fundit do të sigurojnë personelin e nevojshëm punëtor dhe drejtues, si dhe do të mbulojnë të gjitha kostot për operimin përfshirë pagat dhe sigurimet shoqërore për punëtorët, pagesat për energjinë, dhe furnizimin me ujë, kostot e amortizimit të paisjeve (përlogaritur rreth 2% e vlerës së investimit sipas zërave) si dhe mirëmbajtjen e funksionimin e tyre.

Kostot për funksionimin dhe mirëmbajtjen e deponisë do të paraqiten si vijon:

Tabela 5. Vlerësimi i kostove për operimin dhe mirëmbajtjen

Kosto direkte staff	Njerëz	Numri punëtorëve	Paga mujore (përfshirë sigurimet)	Paga vjetore (Euro)
Administrator		1	400	4800
Shofer/mekanik		1	380	4560
Shofer		1	330	3960
Puntore		3	280	3360
Kosto staff		6		16 680
Mirëmbajtje				
Kosto mirembajtje	njësia		Sasia	Shuma vjetore (Euro)
Energji elektrike	Kë/orë		8 h/ditë	750
Karburant & Lubrifikant për mjet Fadrom	litër		Vit/fikse	10 000
Karburant & Lubrifikant për mjet gurëthyese	Litër		Vit/fikse	15 000
Mirëmbajtje 2%			fikse	586
Kosto				26 336
Total kosto				43 016 euro/vit

Në deponi do të punësohen të paktën 6 punëtorë detyrat e së cilëve caktohen prej organit mbikqyrës, në këtë rast kompania publike apo komuna ose palë të treta. Sipas vlerësimeve kostoja për operimin dhe mirëmbajtjen e deponisë do të jetë rreth 43 016 euro në vit duke u ndarës në kosto direkte të stafit operativ në vlerë vjetore 16 680 euro/paga dhe kosto shtesë operimi dhe mirëmbajtje në vlerë rreth 26 336 euro/vit.

6.4 Kushtet teknike dhe operacionale

Ndërtimi dhe operimi i Deponisë/lolacionit për mbeturinat inerte duke përfshirë depozitimin dhe trajtimin e tyre do të kërkojë plotësimin e disa kushteve teknike dhe operacionale, ndër të cilat më të rëndësishme janë:

- Të operohet nga një operator i certifikuar (i licensuar sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës);
- Të sigurojë ndarjen/selektimin e mbeturinave të ripërdorshme dhe / ose të riciklueshme (si ç'mund të jenë tullat, druri, hekuri / alumini, plastika etj. Gjithmonë duke u bazuar në planet komunale për trajtimin e llojeve të mbeturinave);
- Të sigurojë që në deponi të evitohet hyrja e mbeturinave të biodegradueshme, të rrezikshme të ngurta ose të lëngshme të llojeve të ndryshme të tilla si goma, bateri etj;
- Të sigurojë kontrollin e ujrave (lëngjeve) të ndotura, krahas kontrollit të ujrave të shiut;
- Të evitohet prania e mbledhësve informalë dhe hyrja e pakontrolluar e kafshëve apo njërvësh të paautorizuar;
- Të jetë e pajisur me një zyrë, mjetet minimale të punës dhe sigurisë;
- Të jetë e pajisur me mjete / pajisje për shpërndarjen dhe ngjeshjen e mbeturinave sipas një standardi të caktuar;
- Të evitohet grumbullimi dhe depozitimi për një afat të gjatë dhe në atë sasi që do të rrezikojë operimin në vazhdimësi të deponisë;
- Duke qënë se pjesa më e madhe e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi pritet të përbëhet nga gurë, dhera dhe materiale ndërtimore, të sigurojë që materiali i deponuar apo përpunuar të përdoret për mbushjet e rrugëve të aksesit dhe vendeve tjera.
- Të planifikojë dhe zbatojë një plan për mbylljen e deponisë paralelisht me depozitimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi.
- Organizimi i procesit të grumbullimit në tërësi dhe i atij të trajtimit të mbeturinave inerte nga ndërtimet dhe prishjet do të kërkojë vendosjen dhe zbatimin me rigorozitet të disa rregullave të përgjithshme operacionale:

- Hartimin e rregullores sipas rregullave të detyrueshme dhe të zbatueshme nga gjeneruesit e këtyre mbeturinave të cilat do të aplikohen dhe do të monitorohen në kuadër të menaxhimit të grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbeturinave në përgjithësi, si psh:

- Vendosja e rregullave dhe masave shtrënguese që ndalojnë gjeneruesit e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi që ti hedhin/depozitojnë ato në vende të paautorizuara;
- Detyrimin e ndërtuesve për të vendosur kontenerë me kapacitet të madh për grumbullimin mbeturinave inerte që gjenerohen gjatë ndërtimeve;
- Detyrimin e amvisërive që të largojnë me shpenzimet e tyre të gjitha mbeturinat që nuk i përkasin mbetjeve të amvisërisë,
- Të ndalohet përzierja e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi me mbeturina të biodegradueshme dhe të tjera të rezikshme dhe depozitimi i tyre i përbashkët.
- Të sigurojë një mekanizëm inspektimi efektiv.

7. PLANI I VEPRIMEVE

Ndërtimi, blerja, furnizimi dhe instalimi i paisjeve për ta bërë plotësisht funksionale lokacionin për deponimin dhe trajtimin e mbeturinave inerte në Rahovec është një projekt i kushtueshëm për tu përballuar vetëm nga buxheti i kufizuar i Komunës. Për rrjedhojë do të ishte e natyrshme që të planifikohet një zbatim i ndarë në disa faza të këtij plani. Gjithsesi do të kërkohej angazhimi i drejtpërdrejtë prej anës së udhëheqësisë së komunës për të gjetur burime financimi nga Qeveria e Kosovës apo dhe në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm që operojnë në fushën e mbeturinave në Kosovë.

Për të përmbushur zhvillimin e planit për ndërtimin e deponisë për mbeturina inerte në komunën e Rahovecit rekomandohet që të ndahet në dy deri në tre faza:

Faza e I-rë (2020-2021): Hartimi i projektit të detajuar të zbatimit dhe hartimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për lokacionin e propozuar. **Kosto për Fazën e I-rë vlerësohet rreth xxx Euro** (përfshi dhe kontratën e mbikqyrjes së punimeve të zbatimit) sipas zërave të mëposhtëm të punëve:

- Integrimi i projektimit të lokacionit për deponimin e mbetjeve inerte në planin e prokurimit dhe buxhetin e komunës;
- Hartimi i projektit të zbatimit
- Hartimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
- Rishikimi i rregullores për menaxhimin e mbeturinave
- Përcaktimi i rregullave të funksionimit të qendrës për deponimin dhe trajtimin e mbeturinave inerte dhe publikimi

Faza e II-të (2021) Prokurimi dhe kryerja e punimeve të infrastrukturës. Këto punime në këtë fazë do të përfshijnë: **Kosto për Fazën e II-të vlerësohet rreth 40 600 Euro** (përfshi dhe rrethimin e hapësirës së punës në lokacion) sipas zërave të mëposhtëm të punëve:

- Gërmim, mbushje dhe sheshim i platosë;
- Rrethim i lokacionit me rrjetë teli;
- Vendosja e një porte të lëvizshme në hyrje;
- Ndriçim i jashtëm periferik;
- Vendosja e Ujëmbledhësve për ujrat e shiut/atmosferikë;
- Vendosja e një kabine në hyrje të deponisë si ambient zyre për administratorin/punëtorët dhe vendosja e kabinës për tualet;
- Vendosja eventuale e kamerave të sigurisë
- Hartimi i strategjisë së komunikimit dhe fushatës së ndërgjegjësimit të qytetarëve

Sipas vitit kalendarik 2021-2022 rekomandohet komuna e Rahovecit që të bëjë eliminimin e deponive ilegale prezente në territorin e komunës, duke i stacionuar ato në lokacionin e caktuar brënda lokacionit për deponi inerte, në mënyrë të tillë që të mos interferojë punimet Brenda kësaj deponie.

Gjithashtu rekomandohet që të ndahet/caktohet një zonë provizore brënda lokacionit për zbrazje të materialit inert prej biznesëve dhe qytetarëve. Ky pozicion i cili do të shërbejë për mbushje duhet të jetë e mirëshënuar hapësira ku lejohet zbrazja dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të lejohet që të interferohen punimet në zone apo zbrazje e pakontrolluar në hapësirën përreth .

Faza e tretë: Furnizimi me pajisje dhe Funkcionalizimi operativ i qendrës sipas marreveshjeve me operatorë publike apo privatë. **Kosto për Fazën e III-të vlerësohet rreth 336 016 Euro** (përfshi dhe kostot operative dhe të mirëmbajtjes) sipas zërave të mëposhtëm të punëve

- Përgatitja e specifikimeve teknike dhe prokurimi i paisjeve për funksionimin e QGMI.
- Prokurimi dhe instalimi i paisjeve për QGMI
- Funkcionalizimi, operimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në qendër

Faza e katërt : Rehabilitimi i lokacionit në një fazë kalimtare.

Periudha e mbushjes së hapësirës së dedikuar për deponimin e mbetjeve inerte do të kërkojë një periudhë të konsiderueshme kalimtare për mbushjen e saj. Përmes sistemit të monitorimit dhe raportimit të rregullt të sasisë së mbetjeve të deponuara, pasi ky lokacion nuk posedon kapacitet pranues, komuna duhet të parashohë planin e mbylljes dhe rehabilitimit të sigurtë të kësaj hapësirë. Kjo fazë do të përkohet me mbushje me dhe dhe pyllëzim të kësaj hapësire dhe kthimin e saj në hapësirë me kushte teknike të përmbushura.

Në tabelën në vijim janë ofruar të dhëna të detajuara mbi investimet kapitale përgjatë periudhës 2019-2025.

Tabela 6. Planifikimi i zbatimit të planit, komuna Rahovec

FAZA I – viti 2020 Faza përgatitore

Veprimtaria	Kostoja totale (EU)	Afatet kohore	Përgjegjësia
Integrimi i projektimit në planin e prokurimit dhe buxhetin e komunës		Nëntor 2020	Kryetari komunës, zyra financave
Hartimi i projektit të zbatimit			DSHP, Drejtoria për Urbanizëm, Drejtoria financave
Hartimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis		Dhjetor 2020	DSHP, Drejtoria për Urbanizëm
Rishikimi i rregullores për menaxhimin e mbeturinave		Dhjetor 2020	DSHP, Drejtoria për Punë Inspektuese
Hartimi dhe rishikimi i rregullave të funksionimit të qendrës		Shkurt 2021	DSHP, Drejtoria për Punë Inspektuese
Totale kosto faza I	xxx		
Kosto shtesë viti 2020-2021 Pastrimi i deponive ilegale prezente në komunën e Rahovecit	xxxx	Dhjetor 2020- Maj 2021	Kryetari komunës , SHP, Drejtoria financave
FAZA II– Viti 2021 Ndërtimi dhe vendosja në funksion i lokacionit/deponisë për inerte			
Zbatimi i punimeve të ndërtimit dhe të infrastrukturës për vënien në funksionim të lokacionit		Prill – korrik 2021	Kryetari komunës, DSHP, Drejtoria për Punë Inspektuese
Hartimi i strategjisë së komunikimit dhe fushatës së ndërgjegjësimi të qytetarëve		Prill 2021	Kryetari komunës, DSHP
Fillimi i operimit për pranim të mbeturinave inerte (provizor)		2020	Komuna,
Totale kosto faza II	46 000		
FAZA III – Viti 2022-2023 Ndërtimi dhe vendosja në funksion i deponisë për inerte			
Përgatitja e specifikimeve teknike dhe prokurimi i paisjeve për funksionimin e deponisë së mbetjeve inerte		Shtator 2021 – mars 2022	Kryetari komunës ,DSHP, Drejtoria financave
Operimi i plotë i qendrës të mbeturinave inerte		Maj 2022	DSHP, Drejtoria për Punë Inspektuese
Totale kosto faza III	336 016		

Planifikimet financiare supozojnë së një pjesë e shpenzimeve për ndërtimin dhe funksionalizimin e deponisë/qendrës do të sigurohen nga donacione prej organizatave ndërkombëtare, ndërsa një kosto e pjesshme kryesisht e investimit bazik dhe ato operative do të mbulohet nga buxheti i vetë Komunës dhe i Ndermarrja Publike “Ekoregjioni” apo kompani palë të treta në marrëdhënie të kontraktimit apo bashkëpunimit.

Hartimi i projektit të zbatimit dhe i VNM do ti ofrojë Komunës një projekt të zbatueshëm dhe të financueshëm me të cilin do të përfaqësohet denjësisht përpara organizatave donatore, të cilat mund të financojnë këtë plan.

Si konkluzion, mund të themi se zbatimi i masave të para të Planit për ngritjen e sistemit eficient për grumbullimin e mbeturinave inerte deri në realizimin e Qendrës për deponimin dhe trajtimin e mbeturinave inerte prej ndërtim demolimit sipas planit për komunën e Rahovecit për menaxhimin e mbeturinave inerte, mund të fillojë prej vitit 2021. Përpjekjet e para të aktiviteteve që komuna planifikon të ndërmarrë rekomandohen që në situatë kalimtare pasi posedon të caktuar lokacionin e përkohshëm ku mund të dërgohen mbeturinat inerte, do të fokusohen në aplikim të rregullores, informim dhe monitorim.

Praktikat e vetëdijësimit publik për hedhjen e diferencuar të mbeturinave inerte përmes aktiviteteve të grumbullimit të veçantë të tyre/apo dërgimit vullnetar në lokacionin e paracaktuar, duhet të shoqërohen me informim publik sipas një kalendari të caktuar. Gradualisht, institucioni komunal përmes donatorëve potencialë duhet të gjejë zgjidhje për ndërtimin e kësaj deponie dhe funksionalizimin e saj sipas fazave të përshkruara.

Plani rekomandohet të rishikohet çdo 6 muaj nga Grupi Punues i Komunës për të bërë përditësimin e afateve dhe rregullimet e nevojshme në kuadër të ndryshimeve që mund të shfaqen gjatë zbatimit të tij.



Komuna Rahovec

2020



PLANI LOKAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE TË VËLLIMSHME

KOMUNA RAHOVEC



TABELA E PËRMBAJTJES

Parathënie nga Kryetari i Komunës	4
Shkurtesat.....	5
Përkufizimet e Mbeturinave	6
1. HYRJE DHE KONTEKSTI NACIONAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE	8
1.1 Qëllimi i planit	8
1.2 Historiku kombëtar i menaxhimit të mbeturinave.....	8
1.3 Politikat, strategjia dhe korniza ligjore kombëtare	9
1.4 Rolet dhe përgjegjësitë në nivel rajonal dhe lokal	10
2. KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS.....	11
2.1 Konteksti lokal i menaxhimit të mbeturinave	11
3. HARTIMI I PLANIT PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË MBETJEVE TË VËLLIMSHME	13
3.1 Fushëveprimi i planit.....	13
3.2 Planifikimi strategjik (vizioni dhe objektivat)	13
3.3 Objektivat.....	14
3.4 Hartimi i planit.....	14
3.5 Identifikimi i lokacionit.....	15
3.6 Hartimi i planit për qendren e grumbullimit në Komunën e Rahovecit	16
4 ANALIZA E SITUATËS AKTUALE	17
4.1 Gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave të vëllimshme.....	18
5 PLANI MBI NDËRTIMIN DHE ORGANIZIMIN E QENDRES PËR MBETURINA TË VËLLIMSHME	22
5.1 Koncepti i qendrave të grumbullimit	22
5.2 Modalitet e operimit.....	23
5.3 Përcaktimi i materialeve	24
5.4 Skenarët e funksionalizimit të QGMV	25
6 KRITERET PËR PROJEKTIMIN DHE NDËRTIMIN E QGMV	26
6.1 Metodat e depozitimit të mbeturinave	26
6.2 Specifikimi i kostove të pajisjeve për funksionalizimin e QGMV.....	28
6.3 Operimi dhe Mirëmbajtja.....	31
6.4 Kushtet teknike dhe operationale	32
7 PLANI I VEPRIMEVE.....	34

LISTA E FIGURAVE

Figura1: Vendndodhja e Komunës së Rahovecit në Kosovë	11
Fig. 2: Pamja e lokacionit me Google My Maps për QGMV, Rahovec;	15
Fig. 3: Lokacioni për QGMV, Rahovec;	16
Fig. 4: Harta e Pozitës gjeografike të komunës së Rahovecit sipas Ndarjeve administrative	17
Fig.5: Harta e krahasuese e vendodhjes së deponive ilegale, Komuna e Rahovecit (verifikimi 2020)	19
Fig 6: Harta e llojeve dhe përbërjes së mbeturinave sipas prezencës së deponive ilegale, Komuna e Rahovecit (verifikimi 2020)	21
Fig 7: Llojet e mbetjeve të vëllimshme	25
Figura 8: Foto ilustruese e QGMV	29
Figura 9: Foto ilustruese e makinerisë së përdorur	31

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Statistika mbi numrin e popullsisë për Komunën e Rahovecit	17
Tabela 2. Numri i deponive sipas raportit të fundit i AMMK 2020 për vlerësimin e vitit kalendarik 2019	20
Tabela 3: Zërat e kostove për ndërtimin e lokacionit të qendres	30
Tabela 4: Zërat e kostove për ndërtimin e hapësirës së shkarkimit të mbeturinave të vëllimshme/riciklueshme	31
Tabela 5. Vlerësimi i kostove për operimin dhe mirëmbajtjen e QGMV	32
Tabela 6. Planifikimi i zbatimit të planit, komuna Rahovec	35

Parathënie nga Kryetari i Komunës

Të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit,

Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme përmes ndërtimit dhe funksionimit të qendrës për grumbullimin, trajtimin dhe magazinimin e mbeturinave të kësaj kategorie është i një rëndësie të veçantë për Komunën e Rahovecit.

Komuna është e angazhuar që nëpërmjet këtij plani t'i kontribuojë zbatimit të politikës të BE së dhe arritjes së objektivave kombëtare të Republikës së Kosovës për mbeturinat, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve. Nëpërmjet një menaxhimi të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të mbeturinave sipas llojeve të tyre, do të adresojmë sfidat që ndërlidhen me menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme dhe krijimin e kushteve për grumbullimin e veçantë, trajtimin dhe riciklimin e tyre.

Jemi të vetëdijshëm se zbatimi i këtij plani ambicioz do të ofrojë zgjidhje për komunën e Rahovecit lidhur me menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme duke ofruar kushte për qytetarë që ti deponojnë në formë të organizuar ato si dhe duke mbrojtur vlerat e mjedisit të pastër në komunën tonë.

Ne inkurajojmë qeverinë, donatorët dhe shoqërinë civile që të mbështesin Komunën tonë në arritjen e objektivave sipas planit dhe realizimin e misionit të komunës për ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarë.

Ndërkohë, si komunë do të punojmë në vazhdimësi për të krijuar kushte për të rritur kulturën e ruajtjes së mjedisit dhe mbështetjen ndaj iniciativave reduktuese dhe ricikluese.

Për realizimin e këtij plani, dua të falënderoj organizatën joqeveritare Green Art Center –Prishtina (GAC) për mbështetje dhe përkrahjen e vazhdueshme profesionale për përmirësim të gjendjes mjedisore në komunën e Rahovecit dhe hartimin e planeve konkrete në menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave me rëndësi të veçantë për komunën tonë.

Kryetari i Komunës

Smajl Latifaj

Shkurtesat

AKMM	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjensia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DSHP	Drejtorja e Shërbimeve Publike
GAC	Green Art Center-Prishtina
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
MEA	Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit
QGMV	Qendra për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave
PMMI	Plani lokal i Menaxhimit të Mbeturinave Inerte
SRKMM	Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave

Përkufizimet e Mbeturinave

Përkufizimet që janë përdorur në këtë document janë ato që janë përdorur në Ligjin Nr.2012/04-L-060 për Mbeturinat.

Bio-mbeturinë – mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat engjashme nga implantet për përpunimin e ushqimit.

Deponi – vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

Deponim përfundimtar i mbeturinave – operimet të cilat ofrojnë zgjidhje përfundimtare për mbeturinat të cilat nuk mund të ripërdoren apo përpunohen, duke mos rrezikuar mjedisin apo shëndetin e njeriut.

Deponim – çdo operim i cili nuk është përpunim, as në rastet kur operimi ka për pasojë sekondare rikuperimin e substancës apo energjisë.

Kompostim – trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit, i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushte të kontrolluara.

Konsumator – personi icili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas Ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", Republika e Kosovës.

Kullim – çdo lëng që rrjedh ose i shpërlarë nga mbeturinat e deponuara dhe që shkarkohet nga deponia ose gjendet brenda deponisë.

Liçenca për menaxhimin e mbeturinave – leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", Republika e Kosovës.

Mbeturinë – substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë.

Mbeturina industriale – mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari të tjera prodhuese.

Mbeturina inerte – mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

i. Mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materietë tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

ii. I tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Mbeturina komerciale – mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industrial.

Mbeturina komunale – mbeturina nga amvisëritë dhe mbeturina nga aktivitetet e tjera të cilat, për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

Mbeturina medicinale – mbeturina të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale.

Mbeturina të parrezikshme – mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.

Mbeturina të rrezikshme – mbeturinat që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme.

Mbeturina të veçanta – mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta.

Mbeturina të vëllimshme – *mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.*

Mbledhje – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.

Mbledhje e ndarë – nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.

Menaxhim i mbeturinave – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.

Parandalim – masat e ndërmarra para se substanca, materiali apo produkti të bëhet mbeturinë, për të redukuar:

i. sasinë e mbeturinës, përfshirë ri-shfrytëzimin e produkteve ose zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve;

ii. efektet negative të mbeturinave për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

iii. përmbajtjen e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

Përdorimi i mbeturinave – çdo operim, veprimtari që kryhet për qëllime riciklimi ose ripërdorimi të mbeturinave, pjesërisht ose në tërësi, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të specifikuar.

Përpunim i mbeturinave – operim, rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet e tjera të cilat përndryshe do të duhej të përdreshin për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo në ekonominë e gjerë.

Person – person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

Prodhuksi mbeturinës – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime të tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.

Riciklim – çdo operim i përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substance, qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshin rikthimin e materialeve organike, por nuk përfshin përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave.

Ri-përdorim – çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent, i cili nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar.

Stabilizim i mbeturinës – çdo trajtim i mbeturinës me metodën e caktuar me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Zotëruesi mbeturinës – prodhuksi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinë.

1. HYRJE DHE KONTEKSTI NACIONAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

1.1 Qëllimi i planit

Plani për trajtimin e mbeturinave të vëllimshme i komunës së Rahovecit është dokument planifikimi që e mundëson zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Planin e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave në nivel lokal, duke i kontribuar zbatimit të politikave dhe përmbushjes së objektivave kombëtare. Ai po ashtu synon:

- i) Mbledhjen e të dhënave për mbeturinat komunale, duke e ofruar një përshkrim të rrjedhave të mbeturinave dhe përgjegjësi, karakteristikave dhe vëllimeve të mbeturinave që duhet të menaxhohen dhe një përkufizim të shtrirjes gjeografike të planit,
- ii) Një vlerësim të skemave aktuale të mbledhjes së mbeturinave, duke e përkufizuar bazën e shërbimeve dhe aktivitetëve aktuale për menaxhimin e mbeturinave,
- iii) Opsionet e menaxhimit të mbeturinave të vëllimshme që do ta mundësonin mbledhjen dhe përpunimin e kësaj rryme të mbeturinave sipas objektivave kombëtare dhe kontekstit lokal,
- iv) Shërbimin cilësor, duke i përcaktuar mënyrat dhe instrumentet që e garantojnë një cilësi të tillë,
- v) Kornizën institucionale, organizative dhe rregullatore, duke i rekomanduar masat dhe instrumentet për përmirësimin e komponentëve organizativë, kontributet publike dhe private dhe përgjegjësitë për mbledhjen, transportimin, riciklimin dhe trajtimin e mbeturinave,
- vi) Nevojat financiare dhe investimet, duke i përkufizuar ato që janë të nevojshme për realizimin dhe ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave të vëllimshme komunale, dhe
- vii) Burimet financiare për investime dhe një strategji për Komunën e Rahovecit që i mbulon shpenzimet, duke e krijuar një mjedis të favorshëm për ta siguruar financimin nga qeveria dhe nga burimet e jashtme.

1.2 Historiku kombëtar i menaxhimit të mbeturinave

Sipas Ligjit Nr. 04/I-060 për Mbeturinat dhe Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbeturinave, komunat e Kosovës janë përgjegjëse për hartimin e planeve komunale të tyre për menaxhimin e mbeturinave, të cilat do të duhet të trajtojnë:

- sasinë dhe llojet e mbeturinave që pritet të krijohen dhe origjinën e mbeturinave të cilat do të shfrytëzohen, ose deponohen sipas planit, në vendin e caktuar,
- programin për mbledhjen e mbeturinave komunale nga amvisëritë, mbeturinat komerciale dhe mbeturinat industriale,
- programin për mbledhjen, grumbullimin dhe ndarjen e mbeturinave të rrezikshme nga mbetjet e tjera, ose ndarjen e llojeve të mbeturinave,

- propozimet për teknikat e mundshme për ripërdorimin dhe riciklimin e komponentëve të ndryshme nga mbeturinat komunale,
- programin për vetëdijesimin publik dhe edukimin në lidhje me menaxhimin e mbeturinave,
- përkrahimin e lokacioneve për pajisjet dhe objektet për trajtimin dhe largimin e mbeturinave, përfshirë kushtet teknike të nevojshme për dizajnimin e objekteve të reja,
- paralogaritjen e shpenzimeve të menaxhimit të mbeturinave dhe burimet e financimit për realizimin e projekteve të planifikuara, dhe
- mundësitë për bashkëpunimin midis dy apo më shumë komunave.

Komunat në tërë Kosovën përballen me një sfidë të madhe në ofrimin e shërbimeve për qytetarët e tyre. Përpos detyrave të tjera në spektrin e politikave socio ekonomike në nivel lokal, mbetet kompetencë e komunave që të përmirësojnë infrastrukturën dhe t'i furnizojnë banorët e tyre me ujë, rrymë, shërbime shëndetësore, mbrojtje të mjedisit dhe transport.

Standardet e përmirësuara për mbledhje të ndarë, trajtim dhe largim të mbeturinave nënkuptojnë se do të çojnë në rritje të shpenzimeve për ofrimin e këtyre shërbimeve. Prandaj, sfidë është që të krijohen zgjidhje që i përmirësojnë standardet e shërbimit dhe që i minimizojnë ndikimet negative dhe ekonomike për qytetarë, dhe që, në të njëjtën kohë, mbështeten nga popullata dhe mund të realizohen në kuadër të strukturave dhe kushteve aktuale.

1.3 Politikat, strategjia dhe korniza ligjore kombëtare

Qeveria e Kosovës është e angazhuar në procesin e anëtarësimit në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit (MEA) është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit të shtetit të Kosovës në përputhje me instrumentet legjislative të BE-së.

Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është pjesërisht e harmonizuar me Acquis të Bashkimit Europian (BE) për sektorin e mbeturinave. Aktualisht, Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit është duke bërë përpjekje për harmonizim të plotë, ku qëllimi kryesor i kornizës aktuale ligjore për menaxhimin e mbeturinave është reduktimi i gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i elementeve të ripërdorshme të mbeturinave, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut; si dhe deponimi i mbeturinave në mënyrë miqësore ndaj mjedisit.

Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit posedon Planin Kombëtar dhe Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Mbeturinave si dhe është në proces të finalizimit të Strategjisë së Re Kombëtare për Menaxhim të Mbeturinave. Në vijueshmëri, Sipas Ligjit 04-L-060(neni 9), kjo strategji përmban:

- Një përshkrim dhe vlerësim të gjendjes aktuale të menaxhimit të mbeturinave;
- Caqet dhe masat themelore për menaxhimin e mbeturinave;
- Masat që duhet të merren për menaxhimin e mbeturinave komunale të ngurta dhe mbeturinat e parrezikshme;
- Masat që duhet të merren për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Udhëzimet për përpunimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit;
- Udhëzimet për ruajtjen e sigurt apo largimin e mbeturinave;
- Udhëzimet për masat e sigurisë dhe prodhimin dhe standardet administrative teknike për t'i arritur qëllimet për menaxhimin e mbeturinave;
- Nevojat afatgjata të Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të të gjitha llojeve të mbeturinave sipas këtij ligji.

Plani strategjik përpilohet nga MEA-a në bashkëpunim me ministritë dhe autoritetet e tjera kompetente, aprovohet nga qeveria për një periudhë dhjetëvjeçare dhe rishikohet çdo pesë vjet.

Ligji kryesor që rregullon sektorin e mbeturinave në Kosovë është Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat ("Ligji për mbeturinat"). Ky ligj është veçanërisht i rëndësishëm kur shpjegohet rregullimi i sektorit të mbeturinave në Kosovë në raport me ligjet e tjera, veçanërisht ato që adresojnë krijimin, menaxhimin dhe udhëheqjen e ndërmarrjeve publike (p.sh.harmonizimi me: Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare). Ligji 04-L-060 për mbeturinat ("Ligji për mbeturinat") ndër të tjerash ka për qëllim:

- i) Evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave,
- ii) Ripërdorimin e komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat,
- iii) Zhvillimin e qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore,
- iv) Parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, dhe
- v) Deponimin përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Ligje të tjera që në një farë mënyre ndikojnë në rregullimin e sektorit të mbeturinave përfshijnë:

1. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Ligji për Vetëqeverisjen Lokale");
2. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar nga ligjet që ndryshojnë Ligjin për Ndërmarrjet Publike Ligji nr. 05/L-009 dhe Nr. 04/L-111 ("Ligji për NP");
3. Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-006 ("LSHT");
4. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet që ndryshojnë dhe plotësojnë Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-237 i vitit 2014, 05/L-068 i vitit 2016 dhe nr. 05/L-092 i vitit 2016 ("Ligji për PP");
5. Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat ("Ligji për PPP");
6. Ligji Nr. 04/L-024 për Ndhimën Shtetërore ("Ligji për Ndhimën Shtetërore");
7. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit ("Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit");
8. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinorë ("Ligji për Planifikim Hapësinorë");

9. Ligjet tjera që kanë ndikim të kufizuar në rregulloren e menaxhimit të mbeturinave përfshijnë:

Ligji për Ndërtim, Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për Ujëra, Ligji për Kimikatet, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Ndotjes, Ligji për Produktet Biocide, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji për Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimeve dhe Mbeturinave. Komponentët kryesorë të këtyre mbeturinave janë: guri, betoni, tulla, komponentë hekuri, komponentë plumbi, komponentë elektrik, etj.

10. Udhëzime administrative nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë:

- Draft/2015, Menaxhimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi i ndërtesave (qershor 2015)
- 15/2012, Menaxhimi i deponive të mbeturinave (dhjetor 2012)
- 19/2012, Menaxhimi i automjeteve mbeturinë dhe komponentëve të tyre (gusht 2012)
- 20/2012, Eksportimi, importimi dhe transiti i mbeturinave (gusht 2012)
- 23/2012, Menaxhimi i gomave të përdorura dhe mbeturinë (dhjetor 2012)
- 05/2013, Menaxhimi i vajrave të përdorura dhe mbeturinë (nëntor 2014).
- 13/2013, Katalogu shtetëror i mbeturinave (qershor 2013)

16/2013, Vlerat kufitare të koncentrimave për komponentët e rrezikshme në mbeturina (qershor 2012)

22/2013, Menaxhimi i mbeturinave mjekësore dhe të veterinarisë (nëntor 2014)

07/2014, Kompetencat e mbajtësve, prodhuesve dhe importuesve të mbeturinave (prill 2014)

09/2014, Licenca për Menaxhimin e Mbeturinave (nëntor 2014)

1.4 Rolet dhe përgjegjësitë në nivel rajonal dhe lokal

Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit është organi kombëtar që e udhëheq hartimin e politikave, zbatimin e ligjit dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve për mbrojtje të mjedisit, përfshirë menaxhimin e mbeturinave, burimeve të ujit, ajrit, dheut dhe biodiversitetit. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, raporti mi për mjedisin është detyrë dhe përgjegjësi e Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, AK MM-së.

Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, komunat i ushtrojnë kompetencat e tyre brënda juridiksionit të tyre për t'i arritur disa qëllime dhe për të ofruar shërbime për qytetarët e tyre. Mirëmbajtja dhe ofrimi i shërbimeve publike dhe komunale, përfshirë menaxhimin e mbeturinave janë pjesë e kompetencave vetanake të komunave. Në Komunën e Rahovecit, Drejtoria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave, shërbime këto që ofrohen nga Ndermarrja Publike "Ekoregjioni"¹ me njësinë e saj "Ambienti" mbulon territorin e Rahovecit dhe kompania private "Ekodrinia".



Figura 1. Vendndodhja e Komunës së Rahovecit në Kosovë

Operatorët e autorizuar nga komuna e Rahovecit janë kompania Regjionale e mbeturinave "Ekoregjioni" SH.A me njësinë e saj publike "Ambjenti", ku komuna e Rahovecit është aksionere me 8% të aksioneve në kompaninë regjionale dhe e cila shërben në **Zonën I** në **6589 klientë**, si edhe kompania p

private "Ekodrinia", e cila shërben në **Zonën II** në rreth **4110 klientë**. Të dhënat e raportuara janë të dhëna të ofruara prej komunës së Rahovecit për vitin referent 2020. Krahas tjerash, të dyja këto kompani i dërgojnë mbeturinat komunale të grumbulluara në Deponinë Regjionale në Landovicë në distancë rreth 27 km, deponi kjo që menaxhohet prej Kompanisë për Menaxhim të Deponive në Kosovë.

2. KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS

2.1 Konteksti lokal i menaxhimit të mbeturinave

Sipas Ligjit për Mbeturinat, përgjegjësitë dhe detyrat e komunave për sa i përket menaxhimit të mbeturinave përfshijnë:

- Krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave - ve për territorin e tyre, hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave, sipas nenit 10 të këtij ligji dhe krijimin e kushteve për zbatimin e tij,
- Hartimin e një raporti vjetor për menaxhimin e mbeturinave,
- Rregullimin e përgjegjësive dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimin e tyre dhe organizimin e menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre,
- Mirëmbajtjen dhe mbajtjen e një sistemi të informimit publik dhe raportimin për punët e kryera siç është paraparë me këtë ligj dhe me aktet ligjore të tjera për menaxhimin e mbeturinave,
- Zbatimin e procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e personave të licencuar për mbledhjen, depozitimin dhe transportimin e mbeturinave të ngurta komunale në territorin e saj,
- Evidentimin e vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimin e projekteve për sanimin e tyre me shënimet për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, llojin e ndotjes, sasinë e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënimet e tjera me rëndësi për realizimin e projekteve, dhe
- Mbikëqyrjen dhe kontrollimin e aktiviteteve të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre përmes inspektorëve komunal të mjedisit.

Neni 10 i këtij ligji i përcakton komponentët e planit komunal, duke përfshirë, mes tjerash, informatat për sasinë dhe llojet e mbeturinave, qëllimet dhe caqet e reduktimit të mbeturinave, programet për mbledhjen dhe depozitimin e mbeturinave të amvisërisë, mbeturinave komerciale, industriale dhe të rrezikshme, ndarjen, riciklimin dhe kompostimin të mbeturinave, vetëdijësimin publik, masat dhe shpenzimet e tyre për menaxhimin e mbeturinave.

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhim të mbeturinave për komunën e Rahovecit janë të ndara sipas kompetencave të paraqitura si më poshtë:

- Komuna kontraktin operatorët (publik apo privat) për aktivitetet e Menaxhimit të Mbeturinave, duke u bazuar në ligjin përkatës.

Drejtoria për Shërbime Publike a) Menaxhon projektet komunale të parapara me buxhet nga lëmi i infrastrukturës të ujit, kanalizimit dhe hapësirës publike .

b) Është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike komunale, përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizim, mirëmbajtjen e rrugëve, transportin lokal, ngrohjen lokale, tregjet, varrezat, hapësirat publike, p arqet, mirëmbajtjen e pastërtisë dhe rregullimit të qytetit dhe vendbanimeve tjera, ndërmarrjen e m asave për mbrojtjen nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore dhe kryen punët tjera të përcaktuara me ligj

Drejtoria për Buxhet dhe Financa planifikon, përcakton obligimet në bazë të rregulloreve komunale të subjekteve të caktuara në Komunë, shkallën e ngarkesës (tarifën) nga lëmi i tatimit në pronë, tak save dhe gjobave komunale.

Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje e Mjedisit a) Përpunon kërkesat për lëshimin e leje ve ndërtimore dhe përcakton kushteturbanistike për zbatimin e planit hapësinor, planin urbanistik, planet e rregullimit, planit të parcelimit, vijës së rregullimit dhe ndërtimit,

b) Lëshon lejet e ndërtimit, lejet e përdorimit dhe shfrytëzimit, cakton komisione përmbikëqyrjen të objekteve, jep pëlqimet e rregullimit të infrastrukturës,

c) Menaxhon projektet komunale të paraparë me buxhet nga lëmi i urbanizmit.

Drejtoria e Inspeksionit a) Në kuadër të Drejtorisë për inspekcion e që janë në përgjegjësi të Komun ës sipas dispozitave ligjore kryhen punët e inspektimit të tregut, sanitar, trafikut, ndërtimtarisë, bujq ësisë, veterinisë, shërbimet komunale, hidroekonomisë dhe inspektimet tjera komunale të përcaktu ara me ligj.

b) Ndërmerr procedurat ligjore, në kuadër të inspektimit nga sferat e inspektimit komunal në proce durë administrative dhe gjyqësore.

c) Kryen edhe punët tjera të përcaktuara me Ligjin.

Operatorët e autorizuar nga komuna e Rahovecit janë Ndermarrja Publike “Ekoregjioni”¹ me njësinë e saj “Ambienti” mbulon territorin e Rahovecit dhe kompania private “Ekodrinia”.

3. HARTIMI I PLANIT PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË MBETJEVE TË VËLLIMSHME

3.1 Fushëveprimi i planit

Komuna e Rahovecit ka si synim që të përmirësojë procesin e menaxhimit të mbeturinave komunale në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Referuar kompetencave, Komuna e Rahovecit planifikon zbatimin e reformave në sektorin e menaxhimit të mbeturinave me qëllim rritjen e efikasitetit të përdorimit të burimeve financiare duke marrë në konsideratë planifikimet konkrete që adresojnë menaxhimin e rrymave të ndryshme të mbeturinave dhe inkurajojnë ndarjen e tyre në burim dhe mbledhjen e diferencuar për të nxitur Riciklimin, Ripërdorimin dhe për rrjedhojë Reduktimin e mbeturinave që depozitohen në venddepozitimin (deponinë) e trajtimit përfundimtar, krahas sigurimit të një shërbimi më cilësor për qytetarët.

Në kuadër të bashkëpunimit, Green Art Center-Prishtina ka për qëllim që të mbështesë Komunën e Rahovecit që të identifikojë dhe të hartojë një plan për organizimin e menaxhimit të mbeturinave të vëllimshme përmes një koncepti të financueshëm, si dhe të planifikojë një plan operimi, pasi të ketë identifikuar dhe të ketë siguruar pajisjet e nevojshme për ta bërë qendren e trajtimit të këtij fraksioni të mbeturinave një objekt funksional me qëllim organizimin e duhur të fraksionit të mbeturinave të vëllimshme që derivojnë sipas rrymës së mbeturinave që gjenerohen në komunë, duke synuar eliminimin e deponive ilegale në komunën e Rahovecit, optimizimin e kostove të transportit të

mbeturinave që grumbullohen në këtë komunë për në deponinë rajonale, si dhe nxitjen e procesit të reduktimit dhe riciklimit të materialeve të depozituara në kuadër të planeve të Komunës për të filluar me grumbullimin e diferencuar të mbeturinave.

Ky plan do të përqendrohet vetëm në trajtimin e mbeturinave të vëllimshme që derivohen prej aktiviteteve të gjeneruesve të mbeturinave në komunën e Rahovecit.

3.2 Planifikimi strategjik

Hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme përmes ndërtimit të qendrave të grumbullimit është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbeturinave në nivel lokal, përmes ofrimit të zgjidhjeve për trajtimin e këtij fraksioni të mbeturinave duke stimuluar grumbullimin e organizuar dhe rekuperimin e materialeve që derivojnë nga ky lloj i mbetjeve në Komunën e Rahovecit.

Ky dokument mundëson planifikimin e veprimeve për të ardhmen për këtë fraksion të mbeturinave, si edhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis akterëve të ndryshëm për menaxhimin e mbeturinave në nivel lokal.

Koncepti për ndërtimin e qendres së grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme (QGMV) do të jetë i orientuar në veprime konkrete dhe të detajuara në lidhje me sistemin e trajtimit të mbeturinave të vëllimshme ofrimit të zgjidhjeve për funksionalizimin e qendres që do të trajtojë këtë fraksion të mbeturinave.

Qëllimi i planit është parashtrimi i qartë i politikave të menaxhimit të mbeturinave në nivel lokal, duk e harmonizuar interesat e të gjithë akterëve dhe publikut, të cilit ky shërbim i ofrohet për të siguruar një menaxhim më efikas dhe të qëndrueshëm, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme, duke përfshirë aktivitetet që synojnë rekuperimin dhe riciklimit e materialeve që vijnë nga kjo kategori e mbetjeve.

Më konkretisht, plani ka si qëllim të mundësojë dhe sigurojë si më poshtë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SR KMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave kombëtare dhe arritjen e objektivave kombëtare në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare. Planit identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe trajtimin final të mbeturinave të vëllimshme;
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standartet e menaxhimit të tyre;
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave të vëllimshme;

- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve e qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Përgatitja e planit për organizimin e shërbimit dhe menaxhimin e mbeturinave të vëllimshme do të referohet legjislacionit kombëtar, respektivisht LIGJI NR. 04 / L-060 për Mbeturina, ku grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale, duket e i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre (Ligji nr. 03/l-040 "Për vetqeverisjen lokale", 2008, i cili përbën bazën ligjore që rregullon aktivitetin dhe përgjegjësitë e komunave në këtë fushë. Në mënyrë të veçantë ky ligj (neni 15, pika 1.8) ngarkon Komunitet me detyrën dhe i bën ato fuqiplotë për planifikimin për menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre si dhe planifikimin dhe ndërtimin e infrastrukturës e cila do të ndihmojë në reduktimin e mbeturinave që dërgohen në deponi dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

3.3 Objektivat

Komuna është duke u fokusuar drejt një bashkëpunimi të ngushtë me qytetarët e komunës së Rahovecit për të adresuar dhe përshtatur zgjidhje efektive për grumbullimin, transportin dhe trajtimin e mbeturinave në kontest të gjerë të fushëveprimit, me qëllim që të përmirësojë shërbimin e largimit të mbeturinave sipas fraksioneve dhe llojeve të caktuara, të eliminojë krijimin e deponive ilegale si problem në këtë komunë referuar mungesës së destinacioneve ku qytetarët mund të dërgojnë mbeturinat sipas llojit, të zvogëlojë shpenzimet e derivuara nga operimi dhe kostot për eliminim të deponive ilegale, të gjenerojë të ardhura nga përpunimi adekuat i mbeturinave sipas fraksioneve, të mbrojë shëndetin e banorëve dhe të nxisë qëndrueshmërinë e zhvillimit ekonomik në të gjithë territorin e Komunës.

Nën këtë objektiv të përgjithshëm, komuna ka për qëllim ngritjen e një sistemi me strukturë operative për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme në një qendër (Qendra e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme) që do të shërbejë qytetarëve të Rahovecit përmes Ndermarrjes Publike "Ekoregjioni"1 me njësinë e saj "Ambienti" dhe kompanive private në marrëdhënie kontraktuale me komunën, për të destinuar dhe trajtuar mbeturinat e kësaj kategorie.

Komuna do të planifikojë dhe përcaktojë një hapësirë të përshtatshme për grumbullim të këtij fraksioni të mbeturinave duke synuar që të ofrojë zgjidhje të përshtatshme për qytetarë. Referuar adresimit të lokacionit të përshtatshëm i cili përmbush detyrimet ligjore të vendosura sipas kriterëve prej organeve qendrore, në planin e saj komuna synon që mbeturinat e vëllimshme të selektohen, trajtohen dhe të ripërdoren si materiale dytësore në tregun e riciklimit apo për nevojat e qytetarëve të komunës.

3.4 Hartimi i planit

Në fazën e parë u themelua grupi i punës me përfaqësues nga zyrtarë të komunës, përfaqësues të Green Art Center dhe ekspertizë të angazhuar. Ata ishin pjesë e zhvillimit të planit duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që i përshtaten më shumë politikave të Komunës si dhe duke përfshirë prioritetet e komunës, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore. Konkretisht të shprehura në mënyrë të listuar hapat bazë të ndjekura për procesin e planifikimit të menaxhimit të mbeturinave sipas fraksionit të planit, janë si mëposhtë:

Hapi 1. Krijimi i strukturave organizative

Hapi 2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese dhe alternativave përkatëse

Hapi 3. Planifikimi operacional i menaxhimit të mbeturinave të vëllimshme

Hapi 4. Planifikimi financiar i menaxhimit të mbeturinave të vëllimshme

Hapi 5. Konsultimet dhe zbatimi i planit.

Duke parashtruar nevojat në sektorin e menaxhimit të mbeturinave që i nevojiten komunës, janë ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme referuar qëllimit të planit. Përfaqësuesit e Komunës së Rahovecit kanë dhënë asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e lokacionit potencial për ndërtimin e qendres, mundësive të operimit si dhe përmes ofrimit të të dhënave për analizim të detajuar të situatës dhe sektorit të menaxhimit të mbeturinave gjatë përgatitjes së planit.

3.5 Identifikimi i lokacionit

Komuna e Rahovecit, respektivisht Drejtoria e Shërbimeve Publike (DSHP) kanë identifikuar paraprakisht një lokacion cili i mund të shërbejë për depozitimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi.

Duke u mbështetur në arsyetime konkrete që lidhen me ndikimin në mjedis, si dhe çështjet administrative dhe pronësore, Komuna e Rahovecit duhet të parashohë ndërtimin e një qendre të grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme sipas dy alternativave:

1. Pranë hapësirës komunale që komuna ka ndarë për zhvillimin e veprimtarisë së trajtimit të mbetjeve inerte,
2. Të shqyrtojë alternativa të tjera sipas marrëshjeve kontraktuale me kompani private të angazhuara në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Në të gjitha situacionet, vendi i përcaktuar duhet të plotësojë në mënyrë optimale kërkesat ligjore dhe ato të Komunës për të ndërtuar dhe operuar një qendër të grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme dhe atyre të riciklueshme. Referuar asaj, lokacioni i propozuar për destinimin e mbeturinave inerte ofron kushtet për funksionalizim edhe të një qendre që do të shërbejë për grumbullimin dhe magazinimin e mbeturinave të vëllimshme, por paraprakisht duhet të planifikohen përgatitjet e veprimeve përcjellëse për të synuar operimin e tij. Referuar asaj, lokacioni i propozuar ofron kushtet për funksionalizim të saj por duhet të planifikohen përgatitjet e dokumenteve përcjellëse ligjore si Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis për të synuar operimin e tij.

Vendi i propozuar parasheh një sipërfaqe në formë të një zbrazëtie në formë hinke, i cili përmban një hapësirë të gjerë në hyrje dhe sipas konfiguracionit natyror vijon me një kanal natyror i përcaktuar prej organeve komunale për tu mbushur dhe rehabilituar në të ardhmen sipas normativave të caktuara. Sipas zyrtarëve të Komunës, vendi i propozuar planifikohet të përdoret njëkohësisht edhe për deponimin e mbeturinave inerte dhe është pronë komunale. Ky lokacion është në distancë 2.23 km prej qytetit si dhe ofron akses mjaft të mirë me rrugët kryesore (Alternativa 1).



Fig. 2: Pamja e lokacionit me Google My Maps për QGMV, Rahovec;




Fig. 3: Lokacioni për QGMV, Rahovec;

3.6 Hartimi i planit për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme

Paraprakisht duhet të merret në konsideratë se zbatimi i një plani për organizimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme dhe ndërtimin dhe operimin e një qendre për grumbullimin e tyre do të kërkojë një vlerësim në lidhje me sigurinë për vendin e zgjedhur dhe ndikimet në mjedis varësisht llojit të mbeturinave që do të grumbullohen dhe trajtohen në qendër.

Në terma të përgjithshme, sipas përkufizimit dhe aplikimit të standarteve të ligjeve të EU, Qendra e grumbullimit të mbeturinave komunale është një qendër e autorizuar dhe e specializuar, për grumbullimin e përkohshëm të mbeturinave që siguron:

- Mundësi për të kontrolluar mbeturinat para dërgimit të tyre për trajtim përfundimtar në deponi;
- Fleksibilitet në zgjedhjen e opsioneve të depozitimit të mbeturinave;
- Një sistem shërbimi për përdorim prej anës së qytetarëve;
- Zvogëlimin e kostove të transportit për në deponi përmes ndarjes së mbetjeve për riciklim;
- Kompostimin e mbeturinave të biodegradueshme;
- Grumbullimin i mbeturinave të vëllimshme;
- Ose secila prej këtyre veprimtarive në vete dhe / ose disa prej tyre ose të gjitha së bashku.

Duke marrë parasysh reflektimet mbi alternativat e mundshme, koncepti i hartimit të planit për organizimin e sistemit të grumbullimit të mbetjeve të vëllimshme do të konsistojë mbi ngritjen e një qendre të përhershme për llojet e mbetjeve të riciklueshme përfshirë dhe të vëllimshme, në të cilën do të planifikohen aktivitetet për përpunimin e kësaj kategorie të mbeturinave. Për ta realizuar këtë qëllim, është hartuar një dokument i cili përmban:

- Një përshkrim të kriterëve teknike dhe operacionale të një qendre të grumbullimit për mbeturina të vëllimshme dhe riciklueshme si dhe kostot respektive për ndërtimin dhe operimin e saj;
- Të zhvillojë një plan organizativ dhe operacional për funksionalizimin e qendrës;
- Të përcaktojë llojin dhe kostot e pajisjeve dhe mjeteve që kërkohen për operim të rregullt në QGMV;
- Të rekomandojë rregulla të përgjithshme dhe të vecanta për realizimin e shërbimit të grumbullimit, transportit, trajtimit të mbeturinave të vëllimshme.

Ky plan do të ndihmojë komunën për të hartuar Termat e Referencës për projektimin e detajuar, ndërtimin dhe pajisjen e QGMV në të ardhmen në bashkëpunim me donatorë apo Qeverinë e Kosovës.

4. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

Profili I Komunës së Rahovecit

Rahoveci është qytet e pozicionuar në pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Në veri kufizohet me Klinën, në lindje me Suharekën, në pjesën jugore gjendet komuna e Prizrenit, ndërsa në tërë pjesën perëndimore kufizohet me komunën e Gjakovës. Përafërsisht sipërfaqja është rreth 276 km² dhe numri i banorëve në komunë është rreth 56,208 banorë.

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore.

Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësia ose mikro regjione e këto janë: rrafshirë-luginore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës shtrihet në hemisferën veriore të Ekuadorit me shkallë 42° 30' dhe 42° 50' të gjërësisë veriore gjeografike dhe ndërmjet 20° 21' dhe 20° 55' të gjatësisë lindore gjeografike. Vendbanimet në komunën e Rahovecit janë të koncentruara në lartësitë mbidetare prej 310 m. (Krusha e Madhe pjesa e rreth e vendbanimit pjesa lindore të bregut të lumit Drini i Bardhë) deri në 920 m. lartësi mbidetare që është i koncentruar vendbanimi i Zatriqit.

Referuar lartësisë mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshirë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në luginë ose rrafshirë janë këto : (310 – 350 m.) Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Drinasi, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë : Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshirave).




Fig. 4: Harta e Pozitës gjeografike të komunës së Rahovecit sipas Ndarjeve administrative

Tabela 1. Statistika mbi numrin e popullsisë për Komunën e Rahovecit

NJA	Nr. Popullsisë	Nr. Populls. Urbane	Nr. Populls. Rurale	Nr. Ek.familjare totale	Nr. B	Nr. Inst
Total	56,208	15,892	40,316	9,927	3000	73

* Në të gjitha të dhënat e marra dhe elaboruara në kuadër të planit do të përdoret numri i popullsisë i llogaritur nga Agjensia e Statistikave të Kosovës.

Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ dhe minerale si krom, azbest, nik el, kobalt, bakër dhe gypyr guri (thëngjilli). Gurët dekorative: gjendet në afërsi të fshatit Drenovc, në një largësi prej 5, 5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat për këtë material ndërtimor dekorativ mendohet të jenë rreth 207.386 m³. Shtresat e lezolitit dekorativ janë sipërfaqësore të mbuluara me një shtresë humusi prej 0,5 m. Gurët gëlqerorë : gjenden në Hudhrat e Danit, një vend në veri-perëndim të qytetit të Rahovecit 8 km larg tij. Ato shtrihen në formë blloqesh me trashësi që varion nga 0,3 në 2 metra, dhe janë 1,5 metra poshtë sipërfaqes së tokës. Gurët gëlqerore paraqiten në ato të kuq dhe të murrëm. Gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerore mendohet të ketë një volum prej 382.913 m³. Azbesti : Shtresat e lezolitit të azbestit janë të përqendruara në afërsi të fshatit Rudin/Pastasel ne perëndim të Rahovecit, në një largësi prej 8 km. Sipas hulumtimeve është përcaktuar sipërfaqja e shtresës prej 100.000 m² dhe mendohet që rezerva të kapë shifrën prej 10.000.000 Ton. Kjo e dhënë është e përafërt dhe kërkon hulumtime të hollësis hme gjeologjike. Kobalti, Nikeli dhe Bakri - Ne rrethinën e Gurit te Kuq janë konstatuar shtresa e xeh eroreve te Nikel-Kobaltit. Përbërja mesatare e këtij xeheriori sipas hulumtimeve të bëra vite më parë për mineralin në formë të ngurtë është (Nikeli 0,18 %, Kobalti 0,13 % dhe Bakri 2,73 %). Sasia e reze rvave të këtij xeheriori nuk dihet. Kromi: mendohet që ky mineral të gjindet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradisht, lugina e prroit Rimnik, Delja, Shipi në Zadriq, Sharnica mbi Qëndresë, Drenovci, Guri i kuq, Kanzniku, etj. Thë ngjilli: gjendet në lokalitetet e Hoçës së Madhe, Krushës, prroit të Nagavcit, Drinasi, etj. Për të përca ktuar sasinë e rezervave dhe cilësitë kalorifike të thëngjillit duhen bërë hulumtime të thella gjeologji ke.

Se fundi, sipas Komunës ekziston mundësia që të gjinden shtresa naftëmbajtëse ne territorin e Ko munës së Rahovecit. Vendodhja e tyre mendohet të jetë në fshatin Kramovik dhe përgjatë rrjedhjes së Drinit të Bardhë deri në Krushën e Madhe.

4.1 Gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave komunale

Shërbimi i grumbullimit, transportit dhe trajtimit të mbeturinave realizohet nga Ndermarrja Publike “ Ekoregjioni” me njësinë e saj “Ambienti” dhe kompania private “Ekodrinia”.

Komuna raporton se në territorin e saj gjenerohen rreth 4,766.00 ton mbeturina në vit (2019) ose një mesatare prej rreth 91.65ton/javë që vjen si rezultat i llogaritjes nga prodhimi i gjenerimit mesatar (referuar të dhënave të ofruara nga komuna, DSHP). Shtrirja zonale e amvisërive dhe bizneseve, institucioneve (klientët), të cilët janë të përfshirë në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave sipas kompanisë “Ekoregjioni” dhe “Ekodrinia” janë:

- Zona Urbane: e cila i takon vetëm Rahovecit si qytezë – 3072 klient
- Zona Rurale: zonat e mbetura të rrethinës – 6064 klient.

Sipas të dhënave, niveli i ofrimit të shërbimit konsiston në 85% të territorit ku kompania publike ofron shërbim të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në 53.43 % të numrit të klientëve dhe ajo private në pjesën e mbetur.

Kapaciteti i gjenerimit sipas koeficientit të gjenerimit të mbeturinave për kokë banori, referuar të dhënave në planin komunal për menaxhim të mbeturinave do të nënkuptojnë si vijon:

- Urbane dhe suburbane 0.62 kg/ditë banorë
- Rurale 0.5 kg/ditë banorë
- Rurale e thellë 0.4 kg/ditë banorë

Referuar tabelës së mësipërme sipas shpërndarjes së popullsisë, kapaciteti i gjenerimit të mbeturinave për Komunën e Rahovecit do të nënkuptojë që në nivel të zonës urbane gjenerohen rreth 3 596 ton mbeturinë në vit dhe në zonë rurale rreth 6 622 tonë mbeturinë në vit; total ky, i cili do të përkojë me kapacitetin e gjenerimit të mbeturinave për Komunën e Rahovecit në 10 218 tonë/ mbeturinë në vit.

Referuar situatës së mëhershme mjedisore në komunë në disa zona periferike të qytetit dhe zona rurale ekzistojnë deponi ilegale të reja apo të vjetra. Por, edhe përkundër përpjekjeve të komunës në disa zona periferike të qytetit dhe zona rurale ekzistojnë deponi ilegale ku sipas vlerësimeve (raporti i fundit i AMMK 2020 për vlerësimin e vitit kalendarik 2019) rreth 20 deponi të ndara në 11 deponi të vogla, 6 të mesme dhe 3 të mëdha gjenden në territorin e komunës.




Fig.5: Harta e krahasuese e vendodhjes së deponive ilegale, Komuna e Rahovecit (verifikimi 2020)

Referuar shërbimit të grumbullimit, në komunën e Rahovecit prezenca e deponive ilegale prej së kaluarës si dhe depozitimi i tyre në brigje të lumenjve, prrockave, paraqet rrezik duke ndikuar në ndotjen e tyre e tokës dhe ujrave, po ashtu shfaqjen e dukurive si, erozioni dhe vërshimet në tokat bujqësore, që shtrihen përgjatë këtyre lumenjve.

Përkundër aktiviteteve të komunës, verifikohen prezencë të deponivë ilegale me përbërje të llojeve të mbeturinave kryesisht të ndërtimit dhe demolimit, apo të përziera, problematikë kjo që duhet të adresohet për zgjidhje prej komunës së Rahovecit në planifikimin dhe përcaktimin e hapësirave për trajtimin e këtyre llojeve të deponive. Deponitë ilegale të mbeturinave paraqesin rrezik permanent për banorët e Komunës, ku përmes përmes zbërthimit të materieve emetojnë lëndë toksike të dëmshme për shëndetin e njeriut duke u shpërndarë edhe në ujërat nëntoksorë si pasojë e përzierjes me rreshjet e shiut (prezencë e materialit asbest tek mbetjet që derivojnë prej prishjeve të ndërtimit).

Tabela 2. Numri i deponive sipas raportit të fundit i AMMK 2020 për vlerësimin e vitit kalendarik 2019

Madhësia – Sasia e deponisë		Deponitë ilegale	
		Sasia #	Përqindja
E vogël	1-5 200l qese mbeturinash / karroca dore,	11	55%
E mesme	5-20 200l qese mbeturinash / karroca dore,	6	30%
E madhe	> 20 karroca dore, dmth kamion i nevojshëm.	3	15%
Totali		20	100%
Karakteristikat e deponive		Sasia në numër	Sasia në përqindje

Mbeturina të amvisërisë (A)	6	30%
Mbeturina inerte / ndërtimore (N)	4	20%
Mbeturina industriale dhe të rrezikshme (R)	-	-
Mbeturina të vëllimshme (V)	-	-
Mbeturina të përziera (A, N, R, V)	10	50%
Totali:	20	100.00 %

Referuar karakteristikave të deponive ilegale sipas llojit të mbeturinave që gjenden në to, sipas rapo rteve prej kësaj komune vlerësohen se:

- 6 janë deponi me Mbeturina të amvisërisë (A)
- 4 janë deponi me Mbeturina inerte / ndërtimore (N)
- 10 me përbërje të Mbeturinave të përziera (A, N, R, V).




Fig 6: Harta e llojeve dhe përbërjes së mbeturinave sipas prezencës së deponive ilegale, Komuna e Rahovecit (verifikimi 2020)

Bazuar në këto karakteristika shihet që synimet strategjike të komunës së Rahovecit konkretizohen në gjetjen e alternativave për funksionalizimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave të veçanta (përfshirë mbeturina inerte, të vëllimshme etj) ku krahas rritjes së plotësimit të shërbimit njëherësh duhet të gjenden mundësi për gjetjen e zgjidhjeve për krijimin e sistemeve për organizimin e mbeturinave të vëllimshme dhe ato inerte.

Aktualisht, Komuna nuk zhvillon aktivitet për trajtimin dhe depozitimin e sigurtë të këtij fraksioni. Një ëherësh, Ndermarrja Publike "Ekoregjioni"1 me njësinë e saj "Ambienti" dhe kompania private "Ekodrinia" nuk posedojnë të dhëna lidhur me sasinë e mbeturinave të vëllimshme të krijuara si dhe ato të fraksioneve tjera të mbeturinave. Rastet e hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave të vëllimshme duke përfshirë kryesisht mbeturinat prej mobiljeve shtëpiake, si: karrige, tavolina, dyshekë, qilima, divanë, kolltukë etj, për eliminimin e të cilave sipas aksioneve jo të rregullta, kompania i pastron hapësirat pranë pikave të grumbullimit apo lokacione tjera ku hidhen në formë të pakontrolluar.

Problemet aktuale me të cilat komuna përballet ndër të tjerash do të përfshijnë:

1. Hedhja e pakontrolluar dhe krijimin e deponive ilegale;
2. Mungesa e një vendi adekuat për grumbullim dhe trajtimin e tyre sipas përbërjes të fraksionit;
3. Mungesa e një destinacionit final – ripërdorimi i produkteve që gjenerohen nga trajtimi i tyre.
4. Organizmi i shërbimit për grumbullimin, transportin dhe deponimin e tyre në formën e organizuar.

Komuna ka një rregullore komunale për mbeturina, e cila përcakton rregullat dhe detyrimet e qytetarëve dhe bizneseve në lidhje me grumbullimin, transportin dhe depozitimin e këtyre mbeturinave, por ka mangësi në zbatimin e saj dhe monitorimin e veprimeve të gjeneruesëve të këtij lloji të mbeturinave.

Komuna nuk ka një shërbim të organizuar për grumbullimin dhe largimin e këtyre llojeve të mbeturinave duke mënjanuar faktin e kampanjave simbolike për eliminimin e tyre, apo pastrimet e kohë pas kohë të shërbimit.

5. PLANI MBI NDËRTIMIN DHE ORGANIZIMIN E QENDRËS PËR MBETURINA TË VËLLIMSHME

5.1 Koncepti i Qendrës

Plani për ndërtimin e qendrës për mbeturina të vëllimshme që do të shërbejë për deponimin e përkohshëm dhe trajtimin e mbeturinave të këtij fraksioni sipas llojit të tyre i referohet nevojës së komunës për adresimin e dukurisë së eliminimit të deponive ilegale që formohen në qytet si dhe trajtimin e këtij fraksioni në periudhë aftagjatë. Kjo politikë ka për qëllim organizimin e shërbimit efikas të menaxhimit të mbeturinave dhe trajtimit të tyre sipas llojeve dhe reduktimin e sasisë së mbetjeve që deponohen në deponi.

Qendrat e grumbullimit të mbeturinave komunale paraqesin vendet apo objektet të cilat plotësojnë kushtet e caktuara paraprake për shkarkimin e mbeturinave, në mënyrë që ato të përgatiten për transport deri në impiantet dhe instalimet për magazinim, procesim, trajtim dhe deponim përfundimtar të mbeturinave.

Funksionimi i këtyre sistemeve bazohet në Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060 (neni 34 paragrafi 7), ku Komunitatet me akt të veçantë, rregullojnë sistemin dhe kushtet për mënyrën e mbledhjes, ndarjes, përpunimit, riciklimit dhe mënyrat për transportim të mbeturinave komunale.

Gjithashtu sipas ligjit të amenduar, Ligjin për Mbeturina Nr. 04/L-060 (neni 34 paragrafi 8), menaxhimi i mbeturinave komunale nga komunitatet duhet të bëhet përmes kontratave të veçanta me një ose më shumë operator publik ose privat të licensuar për administrimin e mbeturinave.

Menaxhimi i qendrës së grumbullimit të mbeturinave komunale mund të kryhet drejtpërdrejt nga Komunitati me personelin e saj, ose mund ti jepet në shfrytëzim të kompanive publike ose private të regjistruara sipas ligjit. (Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 neni 22 paragrafi 4).

Krijimi i sistemit të qëndrueshëm për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme dhe funksionalizimi i një qendre për Grumbullimin e Mbeturinave të Vëllimshme do të ndihmojnë në rritjen e sasisë së ndarë/rikthueshme të mbeturinave përmes rekuperimit të materialeve të riciklueshme si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që depozitohen në deponinë e Landovicës në Prizren.

Funksionalizimi i lokacionit për depozitim provizor të mbeturinave të vëllimshme ka për qëllim të sigurojë destinacionin për grumbullimin e rregullt të këtij fraksioni të mbeturinave si dhe aktivitetet përcjellëse si ajo e selektimit, ripërdorimit të llojeve të përcaktuara sipas ligjit përkatës.

Specifikimet e llojeve të mbeturinave të vëllimshme do të përkufizohen duke marrë në konsideratë përkufizimin për mbeturinat e vëllimshme sipas ligjit Nr. 04/L-060 "Për Mbeturinat", specifikisht në neni 4, pika 1.44:

"Mbeturinë e vëllimshme quhen mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë".

Në këtë fraksion të mbeturinave, si mbeturinë e vëllimshme do të përkufizohen mbeturinat si:

- Mobilje prej druri dhe të materialeve të tjera, dyshekë, qilima dhe veshje;

- Paisje elektroshtëpiake si frigoriferë, soba dhe furra elektrike, makina larëse për veshje dhe enët e kuzhinës etj.(Mbeturina të bardha);
- Pajisje elektronike të tilla si kompjutera, monitorë, lodra, televizorë etj.

Mbeturinat e vëllimshme do të grumbullohen sipas një shërbimi të veçantë dhe do të depozitohen përkohësisht në qendrën që rekomandohet të funksionalizohet. Njëkohësisht, kjo qendër rekomandohet të jetë sipas sistemit të hapur ku qytetarët vetë do të mund të dërgojnë materialet e recuperueshme në to. Modaliteti për Operimin e QGMV mbetet në kompetencë të komunës për ta përcaktuar. Bazuar në format e operimit, komuna i lejon administrimin e qendrës kompanisë publike ose sipas kriterëve të përcaktuara parasheh formë tjetër të administrimit të saj përmes partneritetit me sektorin privat. Kjo qendër do të shërbejë për të bërë paratrazimin e mbeturinave para destinacionit final përmes aktiviteteve të recuperimit të materialeve me vlerë tregu, ndërkohë që pjesa e mbeturinave që do të mbetet do të dërgohet për depozitim përfundimtar në deponinë rajonale në Prizren.

Referuar llojeve që do të klasifikohen në këtë qendër, produktet e ripërdorshme të mbeturinave do të jenë të ndryshme si pasojë e llojeve të mbeturinave të vëllimshme, për rrjedhojë edhe destinacionet e tyre të përdorimit apo shitje do të jenë të ndryshme. Disa prej llojeve të materialeve do të mund të përdoren për qëllime të kompanisë që i administron, në këtë rast p.sh mbeturinat e drurit që shfrytëzohen për nxehje, produktet tekstile për përdorim etj, përderisa llojet e tjera përmes aktiviteteve të zbrërimit fizik sipas llojit dhe përbërjes së mbeturinës destinohen në tregun e riciklimit përmes një çmimi të shitjes sipas tregut dhe procedurave të ankandit public (nëse administrator do të jetë kompani publike) apo përmes marrëveshjeve që komuna apo kompania parashohin për subjekte të treat (subjekte private).

Hartimi i këtij plani me rekomandimet përkatëse do të sjellë një përshkrim të detajuar të formës operacionale për zhvillimin e kësaj veprimtarie dhe kostot e përafërta për funksionalizimin bazik të saj. Në formë të strukturuar do të rekomandohen zgjidhjet sipas standarteve për mënyrën e grumbullimit dhe ofrimit të shërbimit për këtë fraksion të mbeturinave dhe format e trajtimit në qendrën e ndarjes.

5.2 Modalitet e operimit

Modalitetet e planifikuara do të ndihmojnë komunën e Rahovecit për të ngritur një sistem të qëndrueshëm dhe efikas të shërbimit për grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave të vëllimshme dhe të riciklueshme.

Funksionalizimi i qendrës së grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme do të mund të zhvillohen sipas skenarëve të ndryshëm të paraqitura si më poshtë:

1. Dërgimi i mbeturinave të vëllimshme në qendër prej anës së qytetarëve.

Ky model do të zbatohet nga gjeneruesit e mbeturinave të vëllimshme (qytetarët, bizneset dhe institucionet) të cilët do të dërgojnë vetëm mbeturina të përcaktuara nga komuna në QGMV. Qendra e Grumbullimit të Mbeturinave të Vëllimshme (QGMV) do të qëndrojë e hapur për qytetarë sipas orareve të caktuara përgjatë 5-6 ditë punë në javë. Oraret mund të jenë të ndryshëm gjatë stinëve të ndryshme të vitit. Klientët mund të dërgojnë mbeturinat e tyre të vëllimshme në objektin e grumbullimit brënda orarit sipas ditëve të punës gjatë të cilave objekti do të jetë i hapur.

Rekomandohet që pranimi dhe depozitimi i mbeturinave të vëllimshme në QGMV të jetë pa tarifë për klientët që i sjellin ato vetë, me qëllim që të nxiten qytetarët ti dërgojnë vullnetarisht mbeturinat në qendër.

2. Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave të vëllimshme bëhet sipas kërkesës së klientëve prej operatorit të përzgjedhur për grumbullimin dhe largimin e këtij lloji të mbeturinave

Mbledhja e mbeturinave të vëllimshme mund të organizohet në bazë të kërkesave nga klientët (qytetarët, bizneset apo institucionet) nëpërmjet komunikimit me kërkesë me shkrim, me email ose përmes telefonit të vënë në dispozicion prej Kompanisë kërkojnë të largojnë kundrejt pagesës mbeturinat e vëllimshme nga banesa apo biznesi. Për këtë qëllim kompania dhe komuna do të vërë në dispozicion të klientëve një numër telefoni dhe një adresë email-i si dhe do të caktojë dhe do të bëjë publike një tarifë të veçantë për këtë shërbim. Në këtë drejtim rekomandohet që kompania/komuna të ketë të azhuruar faqen zyrtare ku klienti mundet të qaset për informata shtesë.

3. Grumbullimi i mbeturinave të vëllimshme do të ofrohet falas nga Ndërmarrja Publike “Ekoregjioni”1 me njësinë e saj “Ambienti” sipas një kalendari dhe orari të rregullt publik

Në varësi të sasisë, kalendari për grumbullim të organizuar për mbeturinat e vëllimshme mund të ndryshojë nga 1 herë në muaj (kryesisht në periudhën e pranverës dhe vjeshtës), 1 herë në tre-muaj apo edhe 1 herë në cdo gjashtë muaj, sipas metodës Aksioni pranveror për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme dhe aksioni vjeshtor.

Institucioni komunal mundet të përzgjedhë opsionet e mësipërme duke i kombinuar ato. Rekomandohet që në secilën formë të aplikuar, komuna dhe kompania publike të bëjë informim të vazhdueshëm qytetar me qëllim nxitjen e tyre për zbatimin e këtyre reformave që komuna synon të ndërmarrë në funksion të përmirësimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme. Në këtë drejtim, institucioni komunal duhet të punojë në drejtim të zbatimit të rregullave të vendosura për organizimin e këtij shërbimi si dhe të bashkëpunojë ngushtë me inspektorët e mjedisit dhe operatorin publik.

5.3 Përcaktimi i materialeve

Qendra e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme e paracaktuar prej Komunës së Rahovecit do të përdoret për grumbullimin e veçantë të mbeturinave duke zgjedhur ekskluzivisht nga këto lloje si vijojnë:

- Mbetje letër / karton
- Mbetje plastike
- Mbetje druri
- Mbetje metalike
- Mbetje qelqi
- Mbetje tekstili
- Fraksion organik
- Mbeturinat nga pajisjet elektrike dhe elektronike;
- Mbeturinat nga ambalazhet dhe paketimet tjera;
- Mbeturinat që përmbajnë puliuretan, dysheke;

- Vajrat e përdorura dhe mbeturinat me vajra (referuar politikave të nivelit qendror të pajiset me Leje nga Ministria);
- Bateritë dhe akumulatorët e shpenzuar (referuar politikave të nivelit qendror të pajiset me Leje nga Ministria);
- Gomat e vjetra dhe të shpenzuara (referuar politikave të nivelit qendror të pajiset me Leje nga Ministria);
- Gypa plastike (më përmbajtje mercuri duhet të pajiset me Leje nga Ministria);
- Mbeturinat medicinale dhe veterinare (referuar politikave të nivelit qendror të pajiset me Leje nga Ministria);
- Ngjyra, bojëra, ngjitëse dhe rrëshirë (referuar politikave të nivelit qendror të pajiset me Leje nga Ministria);

Megjithatë komuna duhet të përcaktojë cilat lloje të këtyre mbetjeve do të grumbullojë paraprakisht në qendër duke marrë në konsideratë edhe politikat e nivelit qendror kryesisht në trajtimin e mbetjeve të medicinale, të rrezikshme etj. ku respektivisht sipas akteve nënligjore nevojitet leja prej MEA për magazinimin e llojeve të mbetjeve të rrezikshme.

Projektimi, implementimi dhe administrimi i qendrës së grumbullimit të mbeturinave komunale, është kompetencë e komunës në territorin e së cilës planifikohet të ndërtohen.

Megjithatë lokacioni i zgjedhur për ndërtimin e qendrës së grumbullimit të mbeturinave komunale është plotësisht në dispozicion nga autoriteti komunal duhet të hartohet vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe lëshimi i lejes mjedisore (me kompetencë komunale, VNM për komunë), e njëjta vlen edhe me rastin e çdo ndryshimi të mëvonshëm që planifikon Komuna.

Madhësia fizike e qendrës së grumbullimit zakonisht përcaktohet bazuar në sasinë e mbeturinave të krijuara brenda zonës së shërbimit, duke përfshirë ndryshimet e parashikuara siç janë frekuenca e rritjes së popullsisë dhe programet e riciklimit të mbeturinave sipas planeve tjera komunale për menaxhim të integruar të mbeturinave.

Qendra e grumbullimit e planifikuar duhet të ndërtohet në zonë që shërbehen nga rrjeti rrugor urban për të lehtësuar aksesin e përdoruesit. Zona e përzgjedhur duhet të posedojë një rrjet adekuat rrugor për të lejuar qasje të makinave ose automjeteve të vogla të përdoruesve, si dhe për automjetet e rënda. Qendra e grumbullimit të mbeturinave komunale duhet të projektohet në përputhje me të gjitha rregulloret aktuale që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit, si dhe sigurinë në punë. Operacionet e kryera në qendrën e grumbullimit nuk duhet të krijojnë rreziqe për ujë, ajër, tokën, bimët dhe shtazët, ose ndotje akustike nga zhurma dhe ndotje nga aromat e lëshuara, dhe as të dëmtojnë peisazhin dhe vendet me interes të veçantë.

Qendra e grumbullimit duhet të ndërtohet dhe menaxhohet sipas rregullave të përcaktuara nga autoritetet komunale.

Qëllimi i këtij plani është që të ndihmojë Komunën për të ngritur një sistem të organizuar përmes një qendre shërbimi për qytetarët për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme duke ofruar modalitetet mbi strukturën, organizimin dhe funksionimin e QGMV, si një objekt që mund të punojë me një apo disa funksione të kombinuara si më poshtë:

Pjesa më e madhe e mbeturinave të vëllimshme kryesisht janë mbetje si mobilje, mjete druri, qilima, pajisje elektroshtëpiake, kjo do të nënkuptojë që për menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave të vëllimshme ka teknika të ndryshme dhe treg të ndryshëm të shitjes së tyre. Disa materiale përbërëse mund të ripërdoren për qëllime të ndryshme apo të klasifikohen sipas llojit të materialit dhe të destinohen sipas tregut të shitjes. Kompania në këtë drejtim mundet të analizojë tregun potencial të shitjes dhe të lidhë kontrata me operatorë privatë të interesuar për materiale të caktuara.

Mbeturinat që aktualisht nuk mund të ripërdoren apo shiten mund të dërgohen në deponi në formë të organizuar apo të grumbullohen për trajtim të veçantë në të ardhmen.



Fig 7: Llojet e mbeturinave të vëllimshme

Kryesisht këto materiale i nënshtrohen minimalisht procesit të selektimit dhe trajtimit fizik të tyre duke përfshirë:

- Selektimin manual;
- Copëtimi i tyre në përmasa të ndryshme dhe përdorimin sipas materialit: psh druri për nxehje, tekstili për ripërdorim etj.
- Ndarja e mbetjeve të riciklueshme si plastikë, dru, xham apo metale, elektroshtëpiake dhe destinimi për treg të riciklimit;
- Depozitimi final i organizuar i materialeve që nuk kanë ripërdorim apo treg të shitjes (apo që bëjnë pjesë në rrymën e mbeturinave që kërkojnë trajtim të veçantë sipas politikave nacionale), mbetura të rrezikshme etj.

Të gjitha këto procese trajtimi, janë plotësisht të mundshme që të realizohen sipas një plani kohor, në QGMV duke u kthyer në zinxhirin e tregut të tregtisë dhe ekonomisë.

5.4 Skenarët e funksionalizimit të QGMV

Komuna e Rahovecit paraprakisht do të përcaktojë kriteret rreth mënyrës së grumbullimit sipas fraksionit të mbetjeve, llojet e mbeturinave që do të pranohen në qendër dhe formën e funksionimit të QGMV.

Rekomandohet që kjo hapësirë të funksionojë si një objekt në system të hapur për pritjen e këtyre llojeve të mbeturinave ku qytetarët do të mund të kenë qasje për ti dërguar vetë ato në qendër.

Krahas saj një hapësirë e destinuar si qendër e magazinimit do ti shërbejë operatorit/kompanisë për zhvillimin e aktivitetit të klasifikimit të materialit të riciklueshëm sipas llojit apo aktivitete të presimit dhe ballimit të materialit të riciklueshëm.

Sinjalistika informuese në këtë qendër duhet të jetë e mirëshënjestuar me qëllim që qytetarët të informohen lidhur me vendin (kontenierin e caktuar) ku munden të hedhin mbeturinat sipas llojeve.

Paraprakisht, të gjitha masat që komuna planifikon të ndërmarë duhet t'i plotësojë në rregulloren e komunale për menaxhimin e mbeturinave të komunës si dhe ti prezentojë dhe informojë të gjithë akterët për ndryshimet dhe përgjegjësitë e prodhuesve të këtij fraksioni të mbeturinave.

Ndër të tjerash duhet të ceket dhe të shtohet në rregulloren komunale për mbetura, si vijon:

- Amvisërive, bizneseve dhe institucioneve (me një fjalë "klientët") do t'i ndalohet hedhja e mbeturinave të vëllimshme në Pikat e Grumbullimit të Mbeturinave të sistemit me kontenierë publik të komunës, apo edhe në cdo lokacion tjetër;

- Komuna ka vënë në funksion të "klientëve" lokacionin e caktuar për dërgimin e kësaj kategorie të mbeturinave apo përmes shërbimit të veçantë me pagesë.
- Kompania do të bëjë publike orarin e pritjes për dërgimin e mbetjeve, kushtet dhe llojet e mbeturinave që do të pranohen në qendër, si dhe kushtet dhe tarifën për rastet kur kompania do të bëjë vetë grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave me kërkesë të veçantë të klientëve.
- Klientët që do të sjellin me mjetet e tyre mbeturinat e vëllimshme dhe do të lirohen nga pagesa;
- Klientët që do t'i kërkojnë nga Ndërmarrja Publike "Ekoregjioni"¹ me njësinë e saj "Ambienti" apo kompani private të angazhuara për marrjen dhe transportin e mbeturinave të vëllimshme për depozitim në qendër do të paguajnë tarifave shtesë të aplikuar;

Klientët (qytetarët) do të inkurajohen që ti shkarkojnë vetë mbeturinat e vëllimshme në kontenierët apo ndarjet e veçanta brënda qendrës.

Lokacioni duhet të jetë i përbërë me seksione të veçanta për lloje të ndryshme mbeturinash, të cilat do të tregohen me sinjalistikë të vendosur, gjë që do të lehtësojë dhe orientojë klientët për shkarkimin e mbeturinave në vendin e duhur.

Për çështje sigurie, klientët do të asistohen nga punëtorët e qendrës. Punëtorët e kompanisë që do të operojnë në qendër do të bëjnë zbrëthimin, selektimin dhe magazinimin e mbeturinave që janë depozituar në qendër sipas llojit të materialit të pranuar.

Ndarja dhe selektimi i mbeturinave të riciklueshme dhe/ose të ripërdorshme do të bëhet në kontenierë për me kapacitet 5-7m³ apo në hapësirë të ndarë me dhoma të veçanta sipas llojit.

Rekomandohet që pranimi dhe depozitimi i mbeturinave të vëllimshme në Qendër të jetë pa tarifë për klientët që i sjellin ato vetë me qëllim që të nxiten qytetarët ti dërgojnë vullnetarisht mbeturinat në qendër.

6. KRITERET PËR PROJEKTIMIN E QENDRËS

6.1 Metodatat e depozitimit të mbeturinave

Plani për ndërtimin dhe operimin e QGMV do të respektojë detyrimet që lindin nga LIGJI NR. 02/L-30 për mbeturina Neni 11 "Plani për objektet dhe pajisjet e administrimit të mbeturinave", plotësuar prej shtojcës sipas ligjit LIGJI NR. 04/L-060 Neni 23 Objektet dhe impiantet për menaxhimin e mbeturinave dhe LIGJI NR. 04/L-060 për mbeturina , Neni 32 Magazinimi i mbeturinave sipas së cilit :

1. Mbeturinat magazinohen në vende teknikisht të përgatitura për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave.
2. Mbeturinat që ruhen përkohësisht, klasifikohen sipas llojeve dhe veçorive të tyre.
3. Mbeturinat e rrezikshme ruhen në magazina të veçanta për mbeturina të rrezikshme.
4. Afati për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave nuk mund të jetë më i gjatë se tre (3) vite.

Gjatë planifikimeve duhet të merren parasysh dhe referuar literaturës ndërkombëtare (data OECD)*:

Rreth 7% e mbetjeve vjetore i referohet kategorisë së mbetjeve të vëllimshme. Kjo nënkupton se potencialisht në nivelin total të mbeturinave të gjeneruara të cilat përkrijnë me 10 218 ton në vit dhe Referuar kësaj matjeje në komunën e Rahovecit rreth 715.26 ton mbeturinë e vëllimshme (+/-10%) në

vit konsiderohet që bën pjesë në këtë kategori të mbeturinave (nuk kategorizohen mbeturinat e fraksionit të riciklueshëm që përfshijnë lëtar/karton/qelq/plastike/metal).

*<https://stats.oecd.org/Index.aspx?DataSetCode=MUN> Slovenia calculation

Në vlerësim ditor rreth 1.96 ton/ditë e sasisë së gjeneruar të mbeturinave është mbeturinë e vëllimshme.

Insitucioni komunal duhet të sigurohet për metodat e depozitimit të mbeturinave në qendrën grumbulluese, të cilat përcaktohen nga Komuna dhe duhet të përfshihen edhe në marrëveshjen e miratuar për rregullimin dhe operimin e qendrës (Udhëzim Administrativ NR.08/2017 PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE TË MBETURINAVE perkufizimi 1.5.2.2) dhe ligji NR. 04/L-060 Neni 32 Magazinimi i mbeturinave.

Gjatë depozitimit të mbeturinave komunale, komuna duhet të ofrojë kushte dhe senjalistikë të duhur për qytetarë lidhur me vendin e shkarkimit të mbetjeve sipas llojeve. Ndër të tjerash duhet të sigurohet që:

- Kontejnerët dhe vendi i destinuar për grumbullimin e mbeturinave duhet të etiketohen me shenjë të qartë dhe adekuate që tregon për rrezikshmërinë e mbeturinave;
- Ruajtja e akumulatorëve me Pb, kryhet në kontejnerë specialë të papërshkueshëm nga uji të pajisur me sisteme për mbledhjen e çdo lëngu që mund të rrjedhë prej tyre (në përputhje me dispozitat e legjislacionit aktual);
- Mbeturinat prej letre dhe kartoni të duhet të jenë të mbrojtura nga agjentët atmosferikë;
- Fraksioni organik i lagësht hidhet në kontejnerë të papërshkueshëm nga uji, të pajisur me një sistem mbylljeje (komuna përcakton pranimin apo jo të këtij fraksioni në qendër);
- Kontejnerët, e fiksuar ose të lëvizshëm, të përdorur brënda qendrës së grumbullimit dhe që nuk synohen të ripërdoren për të njëjtat lloje të mbeturinave, i nënshtrohen trajtimeve të përshtatshme për të lejuar përdorime të reja.
- Mbeturinat e ndezshme depozitohen në përputhje me dispozitat e legjislacionit aktual (komuna përcakton pranimin apo jo të këtij fraksioni);
- Të respektohen rregullat që rregullojnë ruajtjen e substancave të rrezikshme (në përputhje me dispozitat e legjislacionit aktual, komuna përcakton pranimin apo Jo të këtij fraksioni referuar politikave të përcaktuara prej nivelit qendror);
- Mbeturinat e lëngshme depozitohen në kontejnerë të lëvizshëm (si p.sh, bateritë ose rezervuarët e vegjël) të pajisur me pajisje të duhura të kontrollit dhe të pozicionuara në vend të mbuluar (në përputhje me dispozitat e legjislacionit aktual);
- Sistemet për ngarkimin dhe shkarkimin e lëngjeve nga rezervuarët duhet të mbahen efikas për të shmangur shpërndarjen në mjedis (në përputhje me dispozitat e legjislacionit aktual);
- Mbeturinat e rrezikshme nuk duhet të mbahen më shumë se 30 ditë në qendrën grumbulluese dhe ato duhet të dërgohen në vendin për magazinim (në rast të aplikimit, bazuar në Udhëzimin Administrativ për Menaxhimin e Mbeturinave të Rrezikshme-neni 19 paragrafi 4.

Kohëzgjatja e depozitimit të secilit lloj mbeturinash dërguar qendrës së grumbullimit për mbeturinat e rrezikshme nuk duhet të kalojë tre muaj, andaj ato duhet të transferohen në impiantin e trajtimit pasues të paktën një herë në çdo 3 muaj (itinerari mundet të variojë sipas llojit të fraksionit të ndarjes që prahen në qendër).

Referuar llojeve të mbeturinave që do të përcaktohen për tu magazinuar në qendër, në të gjitha variantet politikat komunale do të harmonizohen me ligjet në fuqi.

Referuar kompetencave dhe politikave të nivelit lokal, llojet e mbetjeve që do të pranohen në qendër, rekomandohen të jenë si vijon:

Mobilje, si:

- Tavolina, Komodina dhe rafte, Karrige, divanë dhe të ngjashme me to, Krevat dhe dyshekë,
- Shporet për ngrohje prej hekuri,

Materiale prej druri të tilla si:

- Dyer dhe dritare (pa xhama),
- Materiale të ngjashme prej plastike:
- Mobilje të ndryshme,
- Dyer dhe dritare (pa xhama),
- Mbeturina të bardha, të tilla si: lavatriçe, Televizorë, Frigoriferë, furrë etj,
- Tuba/vaska banjo,

Veshje dhe mbetje tekstili të tjera si qilima etj.

Megjithatë, lloji i mbeturinave që do të pranohen në QGMV, mund të zgjerohet më tej, me lloje të tjera, në bazë të asaj që është më shumë e nevojshme në Komunën e Rahovecit.

6.2 Specifikimi i kostove të pajisjeve për funksionalizimin e qendres së grumbullimit dhe magazinimit

Investimet bazike

Qendra e Grumbullimit të Mbeturinave të Vëllimshme do të ndërtohet në zonën e përcaktuar prej komunës së Rahovecit, varësisht në hapësirën ku planifikohet të zhvillohet aktiviteti për deponimin e mbetjeve inerte (në hyrje të lokacionit, në një zonë të qasshme dhe organizuar), hapësirë kjo në distancë 2.3 km prej qendrës së qytetit dhe e cila konsiston si pronë e komunës ku synohet të bëjë trajtimin e materialeve mbeturinë prej ndërtimit dhe demolimit.

Varësisht prej sipërfaqes në dispozicion rekomandohet që hapësira për këtë qendër të rrethohet me rrjetë metalike apo pjesë metalike për të shmangur shikimin nga jashtë objektit si edhe të mos pengojë funksionimin e aktiviteteve tjera Brenda saj dhe operimin e punëtorëve të kompanisë.

QGMV do të pajiset me infrastrukturë për shkarkimin e ujërave atmosferikë dhe ujrave të zeza, furnizim me ujë të pijshëm, lidhje me rrymë elektrike, një gjenerator rryme mbështetës dhe një depozitë uji (nëse nuk ka furnizim të vazhdueshëm). Platforma e shkarkimit të mbetjeve dhe seksioni (ndërtesa) e magazinimit do të mbulohet pjesërisht (mbulojë e lehtë me kapriatë metalike të ngjashme si në fotot më poshtë).

Përpos hapësirës së shkarkimi, QGMV do të organizohet në disa kabina/ndarje ose seksione (kabina të hapura) depozitimi të cilat do të jenë të mbuluara. Numri i kabinave/ndarjeve varet nga kategoritë e nënndarjes së mbeturinave të vëllimshme që do të pranohen. Përmasat/kapaciteti magazinues i

kabinave/ndarjeve apo seksioneve do të llogariten mbi bazën e sasisë së mbetjeve të vëllimshme dhe kohës së mbajtjes së tyre në objekt.

Rekomandohet që QGMV të ketë të paktën 5 seksione /kabina depozitimi dhe magazinimi të mbuluara, një për secilën kategori mbeturinash (dru, hekur, duro-alumin, plastike, mbeturina të bardha, metale jo- herroze etj) ku do të mund të magazinohen mbetjet sipas llojit.

Koha maksimale e magazinimit nuk do të jetë më shumë se 6 muaj.

QGMV do të ketë një zyrë, vend të përshtatshëm për veshjen e puntorëve dhe një tualet.

QGMV do të pajiset me mjetet e nevojshme të cilat do të lehtësojnë operacionet e grumbullimit, përpunimit, transportit dhe magazinimit të mbeturinave.

Në hapësirën e pranimit për qytetarë, QGMV do të pajiset gjithashtu me kontejnerë të madhësisë 5 dhe/ose 7m³, dhe kontejnerë për zbrazje të materialeve sipas llojeve.

Në të gjithë kontenerët e zbrazjes do të vendoset shënjëzimi për llojin e mbeturinës që do të hidhet/pranohet në të. Një pjesë e territorit të qendrës rekomandohet të caktohet si parkim për makina për qytetarë dhe kontejnerët për shkarkim.

Objekti duhet të pajiset gjithashtu me mjete ngarkimi, shkarkimi si dhe mjete pune të vogla të cilat përdoren për shpërbërjen/shkatërrimin e mbeturinave të vëllimshme.

Investimet në infrastrukturën e funksionalizimit bazik të qendres janë ekonomike dhe në parim do të bazohen në:

1. Punime gjurmimi ku do të përfshihen mbushje/ngjeshje dhe transport dheu;
2. Punime për kanalizimet e ujrave atmosferikë dhe ujrave të zeza;
3. Punime për furnizimin me ujë të pijshëm dhe ujë për shërbime të tjera dhe rrymë elektrike;
4. Rrethimi i hapësirës me rrjetë teli ose panele llmarine të valëzuar dhe një portë me rrëshqitje;
5. Furnizimi dhe vendosja e një peshore min 1 ton;
6. Asfaltim i platformës;
7. Furnizimi dhe vendosja e dy kontejnerëve për zyra, akomodimin e punëtorëve dhe tualet,
8. Ndriçim i jashtëm, ndriçim i platformës së grumbullimit dhe objektit të magazinimit të mbeturinave;
9. Ndërtimi i seksionit/platformës së grumbullimit (shkarkimit) të mbeturinave me mbulesë kapriatë metalike me h= 6 m (tipologjia Figura 6);
10. Ndërtimi i një magazine/ndërtese (i mbyllur nga 3 anët) për magazinimin e përkohshëm të mbeturinave. Ndërtesa do të mbulohet me kapriatë metalike dhe mbyllet nga tre anë me llamarinë (fletë metalike) të valëzuar.

QGMV do të ndërtohet në të paktën një sipërfaqe prej rreth 1065 m² (ndër të cilat pjesa e hapur me mbulojë rreth 600 m dhe 196 m² pjesa e magazinimit të mbetjeve) referuar kapacitetit maksimal të gjenerimit dhe llojit të mbetjeve që do të pranojë. Ndërtesa e magazinës rekomandohet të përbëhet nga 7ndarje ose kabina me gjatësi 4m secila, gjerësi 7m dhe lartësi (h) 6 m. Dimensionet e objektit të magazinimit do të kërkojnë një hapësirë me gjatësi rreth 28 m, gjerësi 7 metra dhe lartësi 6 metra. Sipas ndarjeve do të magazinohen mbeturinat pasi të jenë veçuar sipas llojit të tyre. Objekti rekomandohet të jetë i mbyllur nga tre anët me llamarinë të valëzuar dhe çdo kabinë do të jetë e ndarë nga njëra - tjetra me llamarinë të valëzuar deri në lartësinë (h) 3m.

Megjënese komuna parasheh që të zhvillojë në të ardhmen aktivitete të selektimit dhe ballimit të mbetjeve të riciklueshme duke u referuar në planifikimet sipas Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave, përmes vendosjes së një prese horizontale me kapacitet mesatar atëherë pjesa e magazinimit ofron mundësi për instalimin e pajisjeve për presim. Në raste të zgjerimit të

kapaciteteve për riciklim duhet të merret në konsideratë zgjerim i hapësirave për zhvillimin e aktiviteteve të riciklimit në lokacion.

Platforma e shkarkimit dhe grumbullimit të mbetjeve të vëllimshme rekomandohet të jetë sipas sistemit të hapur vetëm me mbulojë në metalike në formë L rezistente ndaj zjarrit në një bazament betoni arme të padepërtueshëm prej ujrave. Sipërfaqja e hapësirës totale për shfrytëzim për dërgimin e mbeturinave të vëllimshme do të jetë në total në 600 m² sipas dimensioneve 40 m gjatësi dhe 15 m gjërësi. Ndërkohë që zona e mbuluar ku do të pozicionohen kontenerët sipas shenjësimeve për llojin e materialeve që do të pranohen në to do të jetë 32 m gjatësi me 6 metër gjërësi dhe lartësi (l) 6 m; ku kontenerët sipas llojit do të vendosen në formë të rreshtuar dhe qasja për lëvizje brenda në hapësirë për shkarkim të mbetjeve do të jetë e lire dhe shkarkimi do të bëhet prej një ane.



Figura 8: Foto ilustruese e QGMV: pritja dhe zona e magazinimit

Punimet të cilat vlerësohen të ndërmerren do të jenë:

Vlerësimi i kostove të investimit fillestar rekomandohet të bëhet prej ekipës së projektimit pas definimit të hapësirës brenda lokacionit ku do të vendoset infrastruktura për dërgimin dhe grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme. Zërat e punimeve, volumet dhe kosto e saktë e tyre mund të ndryshojnë respektivisht nga projekti i detajuar për ndërtimin e objektit dhe objekteve tjera përcjellëse.

Tabela 3. Zërat e kostove për ndërtimin e hapësirës së shkarkimit të mbeturinave të vëllimshme/riciklueshme

Zërat e kostove	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Shuma Euro
Punime gërmim - mbushje ngjeshje dhe transport dheu	m/kub	600	2	1 200
Punime shtrim i platosë (deri 10 cm)	m/katror	600	11	6 600
Rrethimi i sheshit me rrjetë teli ose panele llamarine të valëzuar	Metër	600	3	1 800
Porte me rrëshqitje	Copë	1	2000	2 000
Ndriçim i jashtëm dhe elektricitet	Njësi		5000	5 000
Vendosja e sistemi të ujëmbledhës t për ujra atmosferikë	Njësi		3000	3 000
Punime për furnizimin me ujë të pijshëm dhe ujë për shërbime të tjera	Njësi	1	5000	5 000
Kabine për zyre dhe tualet kabinë	Copë	1	4500	4 500
Vendosja e kamerave të sigurisë	Copë	4	180	720
Ndërtim mbulese kapriate metalike bashkë me murin beton i armuar (h = 6)	Metër katror	192	140	26 880
Ndërtim magazine/object me mbulësë kapriate metalike komplet	Metër katror	200	200	40 000
Vendosja e shënjestimit (tabela informuese)	Fikse			1500
Shuma sipas zërave më lart				98 200
TOTAL				98 200 Euro

Është me rëndësi që qendra të ketë qasje të mirë rrugore për mjete transportuese dhe të jetë e shtruar sipas standarteve.

Sipas zërave të kostove të përmbledhura, funksionalizimi bazik i QGMV do të kushtojë komunës së Rahovecit rreth 98 200 euro, i cili do të përfshijë kostot për punimet për hapësirën në qendër në vlerë 29 820 euro dhe punime të konstruksionit metalik dhe shënjestimi në vlerë 68 380 euro.

Komuna mund të realizojë punët për ndërtim të lokacionit në faza ku paraprakisht duhet të planifikojë buxhetin sipas punëve për realizim. Ndërtimi i lokacionit planifikohet sipas planit të nisë për vitin 2021-2022 dhe rekomandohet të bëhet në faza.

Specifikimi i pajisjeve për funksionalizimin e QGMV

Lokacioni i caktuar si qendër për grumbullim të mbetjeve të vëllimshme do të bëhet funksionale në tërësi pas sigurimit të pajisjeve bazike që ndihmojnë mbarëvajtjen e punës dhe përdoren për ngarkim dhe trajtimin e mbeturinave që do të pranohen në qendër. Në mënyrë të veçantë, QGMV, duhet të pajiset me:

- Mjet ngarkimi me kapacitet 0.5 - 1 m³,
- Vinc pirun;
- Mjet ngarkimi i vogël;
- Presë (baler) vertikale për presimin e mbeturinave të riciklueshme; (automatic or semi-automatic vertical baler press)

- Vegla dhe paisje të ndryshme pune;

Në qendër mund të vendosen 5 deri në 7 kontenierë 5-7 m³ të cilë do të përdoren për ndarjen dhe depozitimin e përkohshëm të mbetjeve sipas llojit që mund të gjenerohen nga procesi i selektimit të tyre (opsionale sipas konfirmimit të komunës, referuar planeve komunale sipas kategorive të mbeturinave).



Figura 9: Foto ilustruese e makinerisë gurëthyese

Kosto e vlerësuar e mjeteve dhe paisjeve të nevojshme për funksionimin e saj është paraqitur në tabelën që vijon.

Tabela 4. Vlerësimi i kostove të pajisjeve

Makineri dhe pajisje	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Shuma Euro
Kontenierë 7m ³	Copë	5	1500	7 500
Mjet ngarkimi	Copë	1	80 000	80 000
Vinc pirun	Copë	1	70 000	70 000
Mjet ngarkimi i vogël	Copë	1	50.000	50.000
Presë	Copë	1	12000	12 000
Pajisje pune	Njësi	6	50	300
Shuma Pajisje				219 800Euro

Nga ky vlerësim rezulton se kostoja e pajisjeve kryesore për funksionalizimin e kësaj deponie është rreth 219 800 Euro.

Duhet theksuar se mjetet dhe paisjet për qendrën janë vlerësuar të reja, por sipas nevojës dhe mundësive të institucioneve përkatëse ato mund të jenë edhe të përdorura sipas specifikimeve teknike të përcaktuara prej ekspertëve të komunës. Në rast të furnizimit me mjete të përdorura kostoja e pajisjeve teknike përgjysmohet.

6.3 Operimi dhe Mirëmbajtja

Përveç ndërtimit, furnizimit dhe instalimit të paisjeve, në qendër do të jetë e nevojshme të parashihet aspekti operacional dhe organizativ që do të sigurojë funksionimin e kësaj qendre për pranimin e mbeturinave të vëllimshme dhe riciklueshme.

QGMV do të jetë pronë e Komunës së Rahovecit, e cila do të vihet në dispozicion për përdorim për kompaninë publike "Ekohigjiena" apo kooperimi në marrëdhënie kontraktuale me operatorë privatë sipas kushteve të përcaktuara prej komunës. Kompania do të duhet të sigurojë personelin e nevojshëm punëtor dhe drejtues, si dhe do të mbulojë të gjitha kostot për operimin përfshirë pagat dhe sigurimet shoqërore për punëtorët, pagesat për energjinë, dhe furnizimin me ujë, kostot e amortizimit të paisjeve (përlllogaritur rreth 2% e vlerës së investimit sipas zërave) si dhe mirëmbajtjen e funksionimin e tyre. Kostot për funksionimin dhe mirëmbajtjen e qendres do të paraqiten si vijon:

Tabela 5. Vlerësimi i kostove për operimin dhe mirëmbajtjen e QGMV

Kosto direkte staff	Njerëz	Numri punëtorëve	Paga mujore (përfshirë sigurimet)	Paga vjetore (Euro)
Administrator		1	400	4800
Shofer/mekanik		1	380	4560
Puntore		2	280	6720
Kosto staff		4		16 080
Total personel				
Kosto tjera shtesë				2000
Kosto energji elektrike				10.000
Karburant & Lubrifikant				2.000
Kosto mirembajtjeje pajisje (2%)				
Total o/vit				30 800 eur

Në QGMV do të punësohen të paktën 4 punëtorë detyrat e së cilëve caktohen prej organit mbikqyrës, në këtë rast Ndermarrja Publike "Ekoregjioni"1 me njësinë e saj "Ambienti". Sipas vlerësimeve kostoja për operimin dhe mirëmbajtjen e qendrës do të jetë rreth 30 800 euro në vit duke u ndarë në kosto direkte të stafit operativ në vlerë vjetore 16 080 euro/paga dhe kosto shtesë operimi dhe mirëmbajtje në vlerë rreth 14 720 euro/vit. Meqenëse QGMV do të ndërtohet pranë hapësirës të destinuar edhe për pranimin dhe trajtimin e mbetjeve inerte, kostot administrative dhe disa kosto të investimit fillestar për funksionalizimin e lokacionit do të mund të jenë të përbashkëta (zëra të kostove për investime bazike kosto shofer dhe kosto për punëtorë)

6.4 Kushtet teknike dhe operationale

Operimi i QGMV duke përfshirë mënyrën e grumbullimit, pranimit dhe trajtimin të mbetjeve që do të dërgohen në të do të kërkonte plotësimin e disa kushteve teknike dhe operacionale paraprase.

Paraprakisht, në rregulloren e tanishme për menaxhimin e mbeturinave të komunës së Rahovecit d o të shtohet se:

- Amvisërive, bizneseve dhe institucioneve (me një fjalë “klientët”) do ti ndalohet nxjerrja e mbeturinave të vëllimshme në Pikat e Grumbullimit të Mbeturina ve të sistemit me kontejnerë publik të komunës,apo në sistemin derë më derë, jashtë kushteve të vendosura paraprakisht nga Komuna dhe Kompania (Operatori publik/privat);
- Komuna ka vënë në funksion të “klientëve”, Qendrën për Grumbullimin e Mbeturina ve të Vëllimshme” në adresën e përcaktuar dhe sipas skicës bashkëlidhur.
- Aplikimi I tarifave do të bëhet sipas formës së shërbimit (komuna do të përcaktojë tarifën e shërbimit për grumbullimin e fraksionit të vëllimshme).
- Llojet e mbeturinave që do të dërgohen në qendër prej qytetarëve të komunë së Rahovecit dhe format e shkarkimit të tyre.

Referuar rregullave të operimit në QGMV, ato duhet të konsiderojnë si vijon:

- Operatori do të bëjë publike orarin e pranimit, kushtet dhe llojet e mbeturinave që do të depozitohen në QGMV, si dhe kushtet dhe tarifën e shërbimit për rastet kur operatori do ta bëjë vetë grumbullimin dhe transportin e këtyre mbeturinave me kërkesë të vecantë të klientëve.
- Klientët do të sjellin me mjetet e tyre ose do ti kërkojnë Operatorit marrjen dhe transportin e mbeturinave të vëllimshme për depozitim në QGMV;
- Mbeturinat që do të pranohen në QGMV do të peshohen në peshoren e objektit paraprakisht t depozitimit të tyre. Administratori i qendrës do të shënojë çdo ngarkesë që depozitohet në objekt:
 - o Sasinë në ton,
 - o Llojin e mbeturinave dhe sasinë respektive,
 - o Subjektin që i ka sjellë mbeturinat.
- Administratori i QGMV do të hartojë një raport mujor për sasinë dhe llojin e mbeturinave që grumbullohen në QGMV si dhe sasinë e mbeturinave që ndahen për ripërdorim dhe ato që dërgohen për depozitim përfundimtar në deponinë e Landovicës.
- Depozitimi paraprak dhe i përkohshëm i mbeturinave do të bëhet në kontejnerë për mbeturina të vëllimshme me kapacitet 5- 7m3, ose në vende – kabina të hapura të organizuara në hapësirë n e destinuar;
- Qendra do të ketë seksione (kabina të hapura) të veçanta për lloje të ndryshme mbeturinas h, të cilat do të tregohen me sinjalistikë, gjë që do të lehtësojë dhe orientojë klientët për shka rkimin e mbeturinave në vendin e duhur.

- Klientët do të inkurajohen që ti shkarkojnë vetë mbeturinat në seksionet apo kontejnerët për katës. Ndërkohë që për çështje sigurie, klientët do të asistohen nga punëtorët e qendrës;
- Kompania nuk do të ngarkojë tarifë për klientët të cilët i sjellin vetë mbeturinat e vëllimshme (politikat e komunës mund të ndryshojnë këtë pikë);
- Punëtorët e qendrës do të bëjnë zbërthimin, selektimin dhe magazinimin e mbeturinave që j anë depozituar në qendër. Ndërkohë që administratori i qendrës në bashkëpunim me drejtuesit e kompanisë do të vendosin modalitetet e përdorimit, ripërdorimit dhe destinacionin final të mbeturinave të riciklueshme apo të ripërdorshme që do të rezultojnë nga procesi i selektimit të mbeturinave të vëllimshme që do të depozitohen në qendër.
- Të sigurohet një mekanizëm inspektimi efektiv lidhur me standartet mjedisore të zbatuara në QGMV.

7. PLANI I VEPRIMEVE

Ndërtimi, blerja, furnizimi dhe instalimi i paisjeve për ta bërë plotësisht funksionale qendrën për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme në Komunën e Rahovecit është një projekt mesatarisht i kushtueshëm për tu përballuar vetëm nga buxheti i kufizuar i Komunës. Për rrjedhojë do të ishte e natyrshme që të planifikohej një zbatim i planit I ndarë në disa faza. Gjithsesi do të kërkohej angazhimi i drejtpërdrejtë prej anës së udhëheqësisë së komunës për të gjetur burime financimi nga Qeveria e Kosovës apo dhe në bashkëpunim me donatorë të ndryshëm që operojnë në fushën e mbeturinave në Kosovë.

Për të përmbushur zhvillimin e planit për ndërtimin e QGMV në komunën e Rahovecit rekomandohet që të ndahet në dy deri në tre faza:

Faza e I-rë (2021):

Hartimi i projektit të detajuar të zbatimit dhe pajisja me leje të caktuara prej komunës kundrejt kompanisë apo prej MEA. **Kosto për Fazën e I-rë vlerësohet rreth xx Euro** sipas zërave të mëposhtëm të punëve:

- Integrimi i projektit të QGMV në planin e prokurimit dhe buxhetin e komunës;
- Hartimi i projektit të zbatimit
- Pajisja me lejeve mjedisore sipas legjislacionit në fuqi
- Rishikimi i rregullores për menaxhimin e mbeturinave
- Përcaktimi i rregullave të funksionimit të QGMV dhe publikimi

Faza e II-të (2021 - 2022):

Prokurimi dhe kryerja e punimeve të infrastrukturës. Këto punime në këtë fazë do të përfshijnë: **Kosto për Fazën e II-të vlerësohet rreth 98 200 Euro** (përfshi dhe rrethimin e hapësirës) sipas zërave të mëposhtëm të punëve:

- Gërmim, mbushje dhe sheshim i platosë;
- Rrethim i lokacionit me rrjetë teli;

- Vendosija e një porte të lëvizshme në hyrje;
- Ndriçim i jashtëm periferik;
- Vendosija e Ujëmbledhësve për ujrat e shiut/atmosferikë;
- Vendosija e një kabine në hyrje të qendrës si ambient zyre për administratorin/punëtorët dhe vendosja e kabinës për tualet;
- Vendosija eventuale e kamerave të sigurisë
- Ndërtim i mbulesës së platosë me mbulesë kapriate metalike
- Vendosija e kontenerëve
- Shënjëzimi i qendrës
- Hartimi i strategjisë së komunikimit dhe fushatës së ndërgjegjësimit të qytetarëve

Sipas vitit kalendarik 2021-2022 synohet që komuna e Rahovecit të ketë bërë eliminimin e deponive ilegale prezente në territorin e komunës dhe të ketë funksionalizuar lokacionin e përkohshëm për deponimin e mbeturinave inerte.

Faza e tretë (2022 - 2023):

Ndërtimi i qendrës së magazinimit, Furnizimi me pajisje dhe Funksionalizimi operativ i qendrës dhe përgatitja e marrëveshjeve me operatorë privatë në sektorin e riciklimit. **Kosto për totale për Fazën e III-të vlerësohet rreth 307 300 Euro** (duke paraparë pasqisje të reja dhe kostot operative dhe të mirëmbajtjes) sipas zërave të mëposhtëm të punëve:

- Përgatitja e specifikimeve teknike dhe prokurimi i punëve dhe paisjeve për funksionimin e QGMV.
- Ndërtim magazine mbulesë kapriate metalike komplet
- Prokurimi dhe instalimi i paisjeve për QGMI
- Funksionalizimi, operimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në qendër

Në tabelën në vijim janë ofruar të dhëna të detajuara mbi investimet kapitale në periudhë kalimtare:

Tabela 6. Planifikimi i zbatimit të planit, komuna Rahovec

FAZA I – viti 2021 Faza përgatitore			
Veprimtaria	Kostoja totale (EU)	Afatet kohore	Përgjegjësia
Integrimi i projektimit të QGMV në planin e prokurimit dhe buxhetin e komunës		Shkurt 2021	Kryetari komunës, zyra financave
Hartimi i projektit të zbatimit			DSHP, Drejtoria për Urbanizëm, Drejtoria financave
Marrja e lejeve sipas legjislacionit në fuqi		Prill 2021	Komuna, Drejtoria për Urbanizëm
Rishikimi i rregullores për menaxhimin e mbeturinave		Qershor 2021	DSHP, Drejtoria për Punë Inspektuese

Hartimi dhe rishikimi i rregullave të funksionimit të qendrës		Tetor 2021	DSHP, Drejtoria për Punë Inspektuese
Totale kosto faza I			
FAZA II– Viti 2022 Ndërtimi dhe vendosja në funksion e QGMV			
Zbatimi i punimeve të ndërtimit dhe të infrastrukturës për vënien në funksionim të lokacionit		Dhjetor 2021 – mars 2022	Kryetari komunës, DSHP, Drejtoria për Punë Inspektuese
Hartimi i strategjisë së komunikimit dhe fushatës së ndërgjegjësimit të qytetarëve	10 000	Tetor 2021	Kryetari komunës, DSHP
Fillimi i operimit për pranim të mbeturinave të vëllimshme		Mars 2022	Komuna, Ndermarrja Publike , palë të treta private
Totale kosto faza II	68 200		
FAZA III – Viti 2022- 2023 Ndërtimi dhe vendosja në funksion të plotë të QGMV			
Përgatitja e specifikimeve teknike dhe prokurimi i paisjeve për funksionimin e deponisë së mbetjeve inerte		Shtator 2022	Kryetari komunës ,DSHP, Drejtoria financave
Ndërtimi i qendres për magazinim	40 000	Dhjetor 2023	Kryetari komunës ,DSHP, Drejtoria financave
Operimi i plotë i qendrës të për grumbullim dhe magazinim të mbeturinave të vëllimshme		Qershor 2023	Ndermarrja Publike “Ekoregjioni”1/operatorë të tjerë privatë, Drejtoria për Punë Inspektuese
Totale kosto faza III	307 300		

Planifikimet financiare supozojnë së një pjesë e shpenzimeve për ndërtimin dhe funksionalizimin e QGMV do të sigurohen nga donacione prej organizatave ndërkombëtare, ndërsa një kosto e pjesshme kryesisht e investimit bazik dhe ato operative do të mbulohet nga buxheti i vetë Komunës dhe Ndermarrja Publike “Ekoregjioni”1 me njësinë e saj “Ambienti” dhe kompania private “Ekodrinia”. Hartimi i projektit të zbatimit do ti ofrojë Komunës një projekt të zbatueshëm dhe të financueshëm me të cilin do të përfaqësohet denjësisht përpara organizatave donatore të cilat mund të financojnë këtë plan.

Si konkluzion, mund të themi se zbatimi i masave të para të Planit për ngritjen e sistemit eficient për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme deri në realizimin e Qendres për grumbullimin dhe trajtimin e tyre sipas planit për komunën e Rahovecit për menaxhimin e mbeturinave inerte, mund të fillojë prej vitit 2022. Përpjekjet e para të aktiviteteve që komuna planifikon të ndërmarrë rekomandohen që në situatë kalimtare pasi të ketë përcaktuar lokacionin e ku qytetarët do të mund të dërgojnë mbeturinat e vëllimshme, do të fokusohen në aplikim të rregullores, informim dhe monitorim.

Praktikat e vetëdijësimit publik për hedhjen e diferencuar të mbeturinave të vëllimshme përmes aktiviteteve të grumbullimit të veçantë të tyre/apo dërgimit vullnetar në lokacionin e paracaktuar, duhet të shoqërohen me informim publik sipas një kalendari të caktuar dhe sipas formave të

pagesave të aplikuara sipas rregullores komunale për mbeturina. Gradualisht, institucioni komunal përmes donatorëve potencialë duhet të gjejë zgjidhje për ndërtimin e kësaj deponie dhe funksionalizimin e saj sipas fazave të përshkruara.

Plani rekomandohet të rishikohet çdo 6 muaj nga Grupi Punues i Komunës për të bërë përditësimin e afateve dhe rregullimet e nevojshme në kuadër të ndryshimeve që mund të shfaqen gjatë zbatimit të tij.

Përgatitur nga:
Green Art Center-Prishtina
"GAC"

INFORMATË PËR ZONËN E MBROJTUR

“Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë”

Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë është monument natyre me karakter hidro-gjeomorfologjik. Për shkak të vlerave natyrore, ky monument natyre është vënë nën mbrojtje ligjore në vitin 1986.

Meqenëse, kjo zonë ndodhet në kufirin administrativ ndërmjet territorit të komunës së Rahovecit dhe asaj të Gjakovës, kuvendet e këtyre dy komunave aso kohe janë marr vesh që njëkohësisht të marrin vendim mbi shpalljen e territoreve të tyre veç e veç si monument natyre me qëllim që monumenti si tërësi të merr trajtimin e merituar.

Sipërfaqja e përgjithshme e mbrojtur në territorin e komunës Rahovec është 124.96.09 ha, prej saj në pronësi shoqërore 84.27.70 ha dhe në pronësi private 40.68.39 ha, sipas regjistrimit të mbrojtjes territori ndahet në dy zona : **a) Zona e ngushtë** (rigoroze) dhe **b) Zona e gjerë** (mbrojtëse).

Me datë 10.05.2016 është formuar grupi punues për hartimin e Arsyeshmërisë Profesionale për Kanionin e Drinit të Bardhë - Ura e Fshejtë për ri-kategorizimin e kësaj zone, me kryesues: Qenan Maxhuni nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, si dhe anëtarët: Nexhmije Kamberi, Valmira Gashi, Rihzah Murseli, Fatlije Buza, Fehmi Hoxha si përfaqësues nga Komuna e Rahovecit gjithashtu dhe Fatos Deda nga komuna e Gjakovës. Në raportin përfundimtar të propozimit vetëm anëtari nga komuna e Gjakovës nuk e ka nënshkruar.

Grupi punues ka propozuar që kjo zonë me kufijtë e ri (fillimisht vetëm për territorin e Komunës së Rahovecit e me krijimin e rrethanave të përshtatshme edhe për atë të Gjakovës) të mbetet në kategorinë e Monumentit Natyror dhe përsëri të nxirren vendime të reja nga ana e dy komunave përkatëse për mbrojtjen e pjesëve të veta territoriale.

Të bashkangjitur gjeni dokumentet të cilat i përmendëm më lartë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.10.2020**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm! Gjithsesi kolegë të nderuar, dua të ju informoj që salla e kuvendit sikur në çdo mbledhje dezinfektohet një ditë përpara mbledhjes, që shfrytëzoj rastin me falënderua edhe drejtorin e Shëndetësisë por edhe Drejtoreshën e Administratës për kujdesin e vazhdueshëm në sallën ku ne i mbajmë punimet e kuvendit. Gjithashtu dua të ju informoj se deri me tani, transmetimet kanë qenë nga webfaqja e komunës tonë të mbledhjeve online por nga sot kemi mediumin Kosova Press për transmetimet online.

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën kohore Janar – Shtator 2020,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për transfere dhe rialokim të mjeteve,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Celinë, P-71513083-00231-0
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Nagavc, P-71510055-00809-0
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Krushë të Madhe, P-71513005-00258-0,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Krushë të Madhe, P-71513005-00257-0,
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Krushë të Madhe, P-71513005-00256-0,
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje me interes të përgjithshëm P-71510057-01817-0 – Rahovec,

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shpallje me interes të përgjithshëm P – 71510037-01015-96 – Xërxë,
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik – Rahovec,
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për lirim nga qiraja të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme komunale,
14. Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.

Pika shtesë

1. Marrja e vendimit për shfuqizim të Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2020;
2. Marrja e vendimit për shfuqizim të Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2020;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 1988 i datës 28.06.2018 për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në fshatin Gexhë.

Kryesuesi - Të nderuar kolegë kuvendarë, për këtë mbledhje ju informojë që do të kemi edhe tre(3) pika shtesë, e para ka të bëjë me kthimin e vendimit nga Ministria e Pushtetit Lokal (MAPL) të vendimit të mbledhjes se kaluar për shfuqizimin e vendimit të rregullores të tatimit në pronë për vitin 2021. Ka qenë arsyeshmëria nga MAPL-ja për shfuqizim dhe pas shqyrtimit nga ana e Ministrisë ky vendim nuk duhet të aprovohet në tërësi për shkak të transparencës në të kemi aprovuar si rregullore komplet dhe na është kërkuar që të merret vendim vetëm për caktimin e normave tarifore si dhe pikë tjetër shtesë, komisioni ad-hoc i cili është formuar nga kuvendi për plotësimin dhe ndryshimin e anëtarit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe është mbledhur dhe e ka krye punën e vet dhe sot duhet të merret vendim si dhe pika tjetër shtesë është për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale në periudhë afatgjatë, me kërkesë të banorëve të fshatit Gexhë. Të nderuar kolegë kuvendarë, a jeni për këtë rend dite. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës me pikat shtesë. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për kryesuesin, kuvendaret dhe gjithë të pranishmit në sallë. Unë kam vërejtje tek procesverbali i kaluar, pasi që në diskutimet që kemi bërë lidhur me çështjen e konkursit, fjalimi i kryetarit pas Avni Morinës që ka qenë në foltore nuk është cekur dhe kërkoj nga kryesuesi dhe sekretariati i kuvendit që ky procesverbal të bëhet plotësim ndryshimi nëse është e mundur në një kohë optimale dhe dërgesën do ta bëj edhe nëpërmjet formës zyrtare nëpërmes emailit apo protokollit sipas ligjeve që është e paraparë dhe kërkoj nga sekretariati i kuvendit dhe kryesuesi që këtë kërkesë timen me marr parasysh pasi në të kundërtën nëse jo atëherë kërkoj nga të gjithë kolegët asamblistë që këtë procesverbal të mos e votojnë.

Kryesuesi – Sigurisht që sekretariati do ta ketë parasysh këtë pasi që edhe gjatë incizimeve kur po bëhen nuk po n dëgjohet mirë dhe sigurisht që do të përmirësohet ajo pjesë. Atëherë e qesim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatoj se me 3 abstenime aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Fehmi Hoxha – Përshëndetje kryesues, kryetarin, nënkryetarin, anëtarë kolegë kuvendarë, media dhe gjithë të pranishmit. Pyetja ime është për kryetarin, kur është miratuar korniza afatmesme buxhetore për vitin 2021-2024 para miratimit, ne si grup i PDK-së i kemi parashtruar 3 kërkesa dhe një nder ato kërkesa është edhe rregullimi i kanalizimit fekale dhe atmosferik në rrugën Fahredin Hoxha. Kryetari është zotuar se menjëherë do të fillohet me procedurën mirëpo kanë kaluar një muaj dhe ende nuk ka dalë ne terrene asnjë ekip për me bo matje dhe të paraqesë dhe përgatitë paramasën dhe para llogarinë duke ditur se komuna e Rahovecit ka kontratë me dy kompani për furnizim dhe rregullimin e kanalizimit. Kështu që e lusë edhe njëherë kryetarin pasi është zotuar që sa me shpejtë të rregullohet pasi vërtet është një pjesë shume e keqe aty kanalizimi i lagjes se epërme me gupe të diametrit 315Ø kyqet ne kanalizimin e lagjes tonë që e kemi ndërtuar vet me kontributin tonë me gypë 200Ø dhe sa herë një shi i vogël bjen e tërë lagjja kundërmon dhe del kanalizimi jashtë. Kështu që kryetar ju kisha lutur që ti përmbaheni zotimit. Po ashtu kërkesa tjetër është se duke e ditur që të gjitha afatet kanë kaluar për miratimin e planit zhvillimor komunal dhe hartën zonale, pasi plani zhvillimor komunal është i përgatitur ne tërësi dhe ka mbetur një raport dhe të kërkohet pëlqimi paraprak pranë Ministrisë se Mjedisit dhe planifikimit hapësinor respektivisht pranë institutit për mbrojtjen e monumenteve natyrore. Problemi është se e kemi një dokument i cili është shqyrtuar dhe punuar 18 muaj në te kaluarën, pra është çështja e zonës se mbrojtur të k anionit të Drinit të bardhë. Ai dokument në fakt është një propozim profesional i cili është dhënë nga organet kompetente të institutit për mbrojtjen e monumenteve natyrore dhe ai dokument dy here ka qenë në seancë dhe është tërhequr. Pra duhet të rregullohet çështja e zonës se mbrojtur, pasi ekziston propozimi profesional i organeve kompetente dhe kërkoj për seancën e radhës që ky dokument faktikisht propozimi profesional i institutit për mbrojtjen e monumenteve natyrore të silltet ne kuvend të shqyrtohet dhe me pas të miratohet. Këtë po e kërkoj pasi sinqerisht kanë kërkuar afatet dhe është peng ky dokument për marrjen e pëlqimit paraprak pranë Ministrisë se mjedisit dhe planifikimit hapësinor, e që është e lidhur edhe harta zonale si dokument i dytë kështu që ju kisha lutë ta sillni në kuvend që ta rregullojmë dhe me pas të bëhet një raport dhe kërkohet nga Ministria marrja e pëlqimit paraprak për me sjellë planin zhvillimor komunal që me votue këtu, pasi është një dokument shume i rëndësishëm që kërkohet nga të gjitha instancat me te larta që komuna duhet ta ketë. Kemi filluar nder të parët mirëpo po vonohemi edhe po kërkoj që ta përfundojmë edhe atë.

Masar Popaj – Pyetja ime ka të bëjë për drejtorinë e bujqësisë, se pari deshta të urojë për punët që janë bërë në shtrimin e rrugëve fushore por duke parë disa ngecje që bujqit kanë në lidhje me rrugët fushore pasi ka ankesa dhe vërejtje se zhavorri është i përzier me baltë dhe nëse mundemi me marrë një përgjigje nga ju se a është bërë kontrollimi i atyre rrugëve nga organet kompetente pra a është bërë kontrollimi teknik. Gjithashtu vërejtje tjetër nga bujqit është sepse ka mbetur një rrugë fushore në fshatin Fortesë e papërfunduar kryesisht ne rrugën tek vëllezërit Destan, Shefqet dhe Bedri Berisha në gjatësi prej 80 metra.

Vjosa Isma – Përshëndetje për të gjithë. Pyetja ime është për drejtorin e drejtorisë se arsimit në komunën e Rahovecit. Pyetja e parë është se a mundeni të na thuani se si ka mundësi gati dy vite në shkollën Selajdin Mullaabazi-Mici nuk ka ende drejtor, si e shpjegoni këtë që pa drejtor që dy vite dhe ju nuk keni ndërmarr asnjë veprim për të hapur konkurs për me përzgjedh drejtorin e shkollës Selajdin Mullaabazi – Mici ndërsa për me largua një aktivist të vetëvendosjes edhe pse kishte kualifikime juve jeni kujdes me shume zell. A mund të na thuani që edhe ne listën e pagave figurojnë emra të mësimdhënësve të cilët ka muaj e ne raste edhe me vite që janë jashtë shtetit dhe ne disa raste edhe marrin pagë edhe ju nuk jeni kujtue të shpalleni konkurs për ato vende. A mund të na thuani se si ka mundësi që disa mësimdhënës në sholla të ndryshme mbajnë me shume se 20 ore dhe ka raste që deri ne 40 orë i mbajnë edhe nuk paguhen për orët shtesë ndërsa mësimdhënësit që janë jashtë vendit marrin pagë. A mund të na thuani se si ka mundësi që ju keni marrë mësimdhënës si zëvendësues dhe keni pagua vetëm për 2 ose 3 muaj kurse për muajt tjerë jo dhe jeni arsyetua me faktin se nuk

mundeni me i vendos menjëherë në listën e pagave, pra 3 muaj paguhen kurse 3 muaj nuk paguhen, vërtet kjo është turp nëse një mësimdhënës nuk merr pagë për 3 muaj.

Ali Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, drejtorë të drejtorive komunale, kolegë asamblistë, përfaqësues të mediave. Unë deshta me i ngritë dy çështje, e para nuk ndërlihet direkt me juve por po synojmë që përmes juve të i adresojmë problemet në institucionet përkatëse qendrore. Edhe vitin e kaluar e kam ngritë çështjen e shenjzimit të rrugëve magjistrale dhe rajonale që janë në menaxhimin e Ministrisë të Infrastrukturës, pasi vërtet sidomos shoferet e autobusëve dhe kamionëve që ju bien me i frekuentua shpesh këto rrugë nuk e kanë sinjalistikën e duhur dhe kur e dimë që tash jemi në sezonin vjeshtorë dhe dimërore, pasi kohëve të fundit kemi pasur edhe kohë me mjegull dhe mos sinjalizimi i duhur ka shkaktuar telashe. Çështja tjetër që deshta me bërë si formë komenti për përzgjedhjen e fermerëve për mekanizma bujqësore, vërtet është bërë një punë e mirë që ju përgëzoj kryetar dhe drejtorinë e Bujqësisë, ku janë përzgjedh një numër i madhe i fermerëve që kanë përfitua dhe në bashkëbisedim e sipër me fermerë të caktuar janë ndarë shume të kënaqur.

Munib Durguti – Përshëndetje i nderuar kryesues, kryetar, të nderuar asamblistë, përfaqësues të mediave. Unë deshta të ripotencoj çështjen e ngritur para disa muajve rreth masave të zbatimit nga ana e kafiterive për distancat në lokalet e tyre, duke ditur që jemi në fazën e dytë të pandemisë dhe është mirë që të kemi një aktivitet me të ngjeshur të drejtorisë së inspekcionit pra inspektorët të jenë në terrene dhe të kujdesen për zbatimin e masave në mënyrë me strikte siç e parasheh ligji anticovid. Po ashtu e kam ngritë një çështje në fillim të pandemisë për shkeljen e masave nga ana e furrtarëve, pra bëhet fjalë se ata ende e shesin bukën me dorë përveç disave që bartin maskë asnjëri prej tyre nuk bartin dorëza për shitjen e bukës dhe kjo është shume e pahijshme dhe sjellim një shembull që e ka bërë kryetari i Prizrenit Mytaher Haskuka në fillim të pandemisë ku ka pasur një takim në sallën e kuvendit komunal me gjithë furrtarët dhe i ka kërcënuar me tërheqjen e lejes sanitare në rast se shkelën masat e higjienës. Pra bizneset e dimë se ato regjistrohen në qendrat regjionale mirëpo komuna është ajo që e lëshon lejen sanitare që nënkupton kushtet higjienike. Do të ishte mirë që kryetari të ndajë një kohë dhe ti kujtojë këta të nderuar që shëndeti i qytetarëve është mbi të gjitha dhe në rast se ata vazhdojnë me avazin e vjetër që ti ndëshkojmë me tërheqjen e lejes sanitare.

Fehmi Cena – Unë deshta me ngritë një çështje që ka të bëjë me degradimin e tokës bujqësore të punueshme konkretisht është fjala për ndërtimin e disa shtëpive në një zonë të thellë bujqësore jashtë qytetit të Rahovecit tek vendi i quajtur Dea, përgjatë rrugës Rahovec- Potoqan i ulët përtej lumit Rimmik dhe ajo është diçka që bie në sy e sigurisht që ka edhe raste të tjera dhe unë mendoj që ne kemi diskutuar edhe me përpara që toka bujqësore për komunën e Rahovecit duhet të mbrohet dhe ju jeni zotuar në atë sepse ne njihemi si komunë bujqësore dhe shumica e ekonomive të komunës tonë janë ekonomi bujqësore po ashtu njihemi edhe si prodhues me të mirë edhe si kryeqytet bujqësor dhe po ashtu jeni zotuar se do të mbronit tokën bujqësore të punueshme dhe ky është një rast tipik që shihet se nuk keni punuar në këtë drejtim dhe nuk jeni përmbajtur zotimit. Mendoj se duhet të keni kujdes që të mos lejohet dhe pyetja është e thjeshtë se pse është lejuar një gjë e tillë, pasi tashe tutje mendoj se edhe të tjerët nuk mundeni me i ndalues sepse edhe të tjerët kanë të drejtë me ndërtua shtëpi apo objekte të forta edhe në zona të thella bujqësore të ngjashme dhe atëherë do të kemi një uzurpim dhe degradim të pakontrolluar.

Shqipe Kryeziu – Pyetja ime ka të bëjë me drejtorinë komunale të arsimit dhe i drejtohem Drejtorit se procesi mësimor ka filluar me 14 Shtator dhe sa jam e informuar unë objektet shkollore nuk janë dezinfektuar por edhe maska nuk ka për nxënësit. Kur mendoni që ti dezinfektoni këto objekte shkollore dhe të pajisen nxënësit me mjete mbrojtëse. Pra kjo thjeshtë është vetëm kur mendoni se kur do të veproni ju e dini vetë. Pyetja tjetër i drejtohem kryetarit, pasi në disa komuna mësimdhënësve ju kanë plotësuar kërkesat për shujta dhe rrogat jubilarë por në komunën tonë çka do të bëhet, se a do të pritët që të ju plotësohen këto kërkesa mësimdhënësve.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, anëtarët e kuvendit komunal, përfaqësuesit e OSBE-së, LMT-së, mediave dhe të gjithë të pranishmit në sallë. Është viti i tretë që po e ngrisë një çështje rreth rrugës Fortesë- Krushe e Madhe dhe me të vërtetë ajo rrugë është dëmtuar në disa segmente shumë saqë është e mërzitshme me kalua aty, kështu që gjithmonë kemi pasur premtime që do të bëhet por kjo nuk po realizohet ende. Është mirë kryetar që ne kemi kode për rregullimin e rrugëve të komunës pra kemi kodë të veçantë dhe do të ishte mirë që me urgjencë ta merrni seriozisht dhe disa segmente janë aty që ndoshta nuk kanë kosto shumë të madhe dhe të kryhet kjo punë pasi është një qarkullim mjaft i madhe i njerëzve dhe është një prioritet i madhe dhe besoj që këtë do ta rregulloni dhe të merrni masa që sa më shpejt të rregullohet sepse me të vërtetë që 3 vite po e përsërisim të njëjtën kërkesë dhe do të ishte mirë që me qenë me i vëmendshëm në kërkesat e anëtarëve të kuvendit që i bëjnë.

Rukije Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin dhe gjithë të pranishmit në sallë. Kam një pyetje për drejtorin e drejtorisë së QKMF-së, ku paraqes shqetësimin e e pacientëve të cilët marrin insulinë që përgjegjësitë nga QKMF-ja të delegohen edhe në QMF-të dhe të ju ofrojnë ndihmë pacientëve të cilët kanë marrë insulinën dhe është me të vërtetë jetike kjo insulinë sepse është në pyetje jeta e qytetarit. Edhe kam zhvillua bisedë me mjeke familjarë dhe me kanë thënë që përgjegjësitë nuk po i delegon QKMF-ja në QMF, kështu që është mirë që të delegohen këto përgjegjësi dhe të shkon insulina sepse nuk mundet një pacientë nga Kramoviku apo Çifllaku dimër dhe verë varësisht nga kushtet që i kanë, të ju ofrojmë kushte që sa më afër qytetarit. Këtë shqetësim e kam shprehur edhe mandatin e kaluar dhe mendoj që do të hasim në mirëkuptim.

Sali Sallteku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për kryetarin dhe gjithë juve të pranishëm në sallë. Unë kam një vërejtje të madhe rreth rrugës kryesore në Fortesë që punimet që po bëhen të ngadalta e kanë bërë të mërzitshme kalimin nëpër atë rrugë dhe e pakalueshme. Unë kisha kërkuar nga ju si autoritet që keni të merrni masat e duhura se vërtetë është bërë e pakalueshme dhe po krijon vështirësi me kalua neper atë rrugë. Po ashtu një pyetje tjetër që kam është se shtëpinë e kulturës që kemi nisur në fshatin tonë, kam kërkuar disa herë pasi deri me tani ka kushtuar gati 50,000 euro dhe kam kërkuar vazhdimisht nga komuna që të paktën 20% me na ndihmua pasi vërtetë është bërë një investim i mirë në qendër të fshatit dhe është hera e tretë që po kërkoje këtë ndihmë nga komuna. Po ashtu edhe Drejtorisë së Arsimit i kisha kërkuar që me shpesh me boe vizita neper shkollë sepse ka me Korona virus arsimtar dhe do të ishte mirë me qenë me të kujdesshëm sepse shumë lehtë mundet me u përhap edhe te na, kështu që disa arsimtar që janë me gjendje jo të mirë shëndetësore dhe afër pensionit duhet të largohen sepse vërtetë nuk janë efektiv dhe ju sjellin dëme edhe nxënësve aty. Besoj që do ta keni parasysh kërkesën time.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë kam një pyetje për drejtorin e arsimit, fjala është për projektin e oborrit të shkollës në fshatin Malësi e Vogël pasi ka qenë projekt që ka qenë i planifikuar këtë vit mirëpo nuk ka asnjë lëvizje në këtë drejtim edhe po dua me ditë se deri ku ka arritë kjo procedurë.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, drejtorë të drejtorive, të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Rahovecit, përfaqësues të mediave, pastaj përfaqësues që janë prezentë dhe që e mbikëqyrin këtë mbledhje të rregullt të KK.Rahovec. Faleminderit shumë për kontributin tuaj, për shqetësimet, pyetjet dhe komentet e juaja që i keni bërë. Anëtar i kuvendit të Komunës z. Dervish Çadraku ka pyetur për oborrin e Shkollës Skender Kastrati në Malësi të Vogël, pasi është pjesë e kontratës dhe kontrata është fituar dhe nënshkruar dhe operatori është duke zhvilluar punime dhe tash ka disa shkollë dhe në kuadër të kësaj është edhe oborri i shkollës në Malësi të Vogël dhe nëse koha merr mirë atëherë shumë shpejt do të fillojnë punimet edhe në Malësi të Vogël, ku aktualisht janë nyjat sanitare në fokus d.m.th. nyjat sanitare neper shkollë. Kështu që ky projekt është pjesë e kontratës dhe mund ta konfirmoni edhe në DKA që mund ta shihni kontratën dhe mund të i informoni ata që s'janë të informuar pasi ky projekt veçse është pjesë e kontratës. Pastaj pyetja për rrugën katër korsi nga z. Sali Sallteku, që edhe unë jam dakord për këtë, ne jemi duke pasur telashe me operatorin që zhvillon punime në rrugën katër korsi në lotin e parë, që përfshin prej Bërmjakes e deri në Xërxë.

E vërteta është se në atë pjesë ka edhe ujëra nëntokësor e po ashtu edhe probleme me kompani rajonale siç është sistemi i ujitjes, pastaj sistemi i ujësjellësit KRU.Gjakova, pastaj Telekomi i Kosovës, Posta e Kosovës e megjithatë edhe operatori që është nënkontraktor i një operatori tjetër fatkeqësisht ka pasur telashe dhe ne po shpresojmë që brenda këtyre ditëve me u shtrua ajo pjesë me asfalt. Kështu që po synojmë me u bo maksimalisht mirë ajo punë edhe ne jemi në presion të vazhdueshëm edhe prej qytetareve dhe po i bëjmë trysni që sa më shpejt me u shtrua ajo pjesë me asfalt pasi po krijon shumë vështirësi në qarkullim të automjeteve. Pastaj të shtëpia Oda në Malësi të Vogël, unë i falënderoj donatorët dhe bashkëqytetarët e Malësisë së Vogël që kanë kontribuu shumë në ndërtimin e atij objekti të bukur dhe besoj që ka me qenë funksional edhe e arsyeton qëllimin investiv. Ne mund të bëjmë diçka në rregullimin e oborrit të atij objekti për shkak se nuk aplikua asnjëherë asnjë praktik sepse ka shtëpi apo oda që janë ndërtua edhe neper fshatra tjera edhe nuk ju kemi ndihmua p.sh. në këtë rast Senocit i kemi ndihmua në rregullimin e oborrit, mjedisit rreth objektit pastaj e kemi rregullua një parqe dhe e kemi shtrua me kubëza. Kështu që ndoshta diçka të ngjashme mund të bëjmë edhe në Malësi të Vogël apo edhe në objekte të tilla publike të cilat janë vepër e komunitetit apo vepër e solidaritetit nga ana e komunitetit. Pra kam folur edhe me kryetarin e fshatit dhe do të përpiqem që edhe unë me bo një kontribut bashkë me juve që edhe ajo pjesë që ndoshta varet prej ndikimit tim si autoritet që me ndihmën edhe të bashkë mërgimtareve besojmë që do të përmbillet me sukses. Pastaj tek mësimdhënësit me Covid-19, e vërteta është se gjithkush që mundet të ketë shenja klinike ka për detyrë me u drejtua në qendrën kryesore të mjekësisë familjare ose në objektin me të afërt shëndetësorë dhe mund të kërkojë testim pra marrjen e mostrës për testim. Si e dini janë dy mundësi, edhe instituti i shëndetësisë publike laborator i mikrobiologjisë molekulare dhe po ashtu edhe laboratorët privatë të licencuar. Nëse ka raste të tilla, unë i kisha lutur që kush i njeh që të paraqiten sepse detyra jonë është me i orientua edhe me i aplikua ato masa që rekomandimet të cilat parashihen sipas rregullave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe masave që kërkon me i respektua IKSHPK-ja. Mund të kemi ndonjë rast pasi nuk përjashtohet mundësia edhe pajtohem që vizitat neper shkolla duhet me pas edhe me shpesh edhe me hulumtua që në këtë aspekt me kontribuu që mos ka raste me Covid dhe ne nuk e dimë por edhe ata që kanë është mirë me u lajmërua. Pastaj pyetja e parashtruar nga Rukije Krasniqi, unë besoj që këtë përgjigje duhet me dhanë drejtori i Shëndetësisë sepse ndoshta mund të mos jem shumë i saktë, pasi këta ndoshta e kanë një udhëzim administrative që e përcakton pak me ndryshe. Pastaj pyetja e parashtruar nga z. Rasim Fazliu, ndërtimi i rrugës Fortesë- Celinë, është e vërtetë se kjo rrugë ka probleme dhe këtu para kuvendit jemi zotuar edhe unë edhe drejtori i shërbimeve publike, e po ashtu është një e vërtetë e madhe se operatori i cili merret me riparimin e rrugëve është ankuar në mungesë të mjeteve financiare dhe tash me ridestinimin që kemi bërë ai ka pranuar me ardhë dhe me prioritet janë disa gropa në qytete e sigurisht edhe ajo rrugë besoj që ka me ndodhë riparimi i asaj rruge dhe besoj që sivjet duhet me ndodhë riparimi i rrugës Fortesë-Celinë. Pastaj Shqipe Kryeziu ka pyetur pajisje me maska mbrojtëse ose me mjete mbrojtëse anticovid. Unë jam i bindur që ne kemi lidhur një kontratë apo me një operatorë që bënë furnizimin me materiale mbrojtëse kundër covid-19, ne të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit qofshin filllore apo të mesme kanë materiale e tyre dhe unë besoj që kemi mjaft materiale sipas specifikacionit që kanë bërë vetë Ministria e Arsimit në bashkëpunim me qendrën operative kombëtare emergjente dhe si administrohen ato por shpërndarja e materiale nuk ka arsye asnjë ankesë kurrkush me pas sepse ka mjaft materiale edhe maska, dezinfektues, dorëza neper shkolla. Pra shpërndarja ka ndodhur dhe nëse drejtoret e shkollave nuk ju kanë njoftuar atëherë duhet të i pyeteni drejtoret e shkollave sepse unë e di saktë sepse ka ndodhur edhe depozitimi i materialeve edhe ka filluar shpërndarja edhe të gjitha shkollat i kanë marrë edhe për këtë mund ta konfirmoj edhe drejtori i Arsimit. Pastaj të shujtat dhe pagat jubilarë, unë mendoj se nuk është mirë me bo krahasime midis komunave p.sh komuna e Fushëkosovës asnjë problem nuk e ka me shujta edhe paga jubilarë sepse e ka buxhetin 3 here me të madhe se komuna jonë, jo në kuptimin për paga dhe mëditje siç e kemi na por buxhetin në tërësi e ka me të madhe për shkak se leje ndërtimi dhe plotë mundësi për me realizua shumë të hyra. Në komunën tonë ky proces ka filluar me u stabilizue, me pagat jubilarë ne jemi

duke stabilizuar atë që quhet realizim i se drejtës se mësimdhënësit për me përfitua pagën jubilarë kur del në pension. Ndersa sa i takon shujtave kemi pak probleme por mos të harrojmë se avokatet i kanë bërë ankesat e tyre dhe ne jemi duke punuar edhe sindikatën e arsimit por edhe individualisht me mësimdhënësit që mos të na dërgojnë në gjykatë që natyrisht ata i fitojnë të drejtat e tyre dhe dëmtohen projektet për shkak se ne nuk kemi mundësi me krye me automatizëm këtë punë por e kemi stabilizua si proces, pra procesi është duke shkuar mirë. Besoj që në këtë pikë mundet me korrigjua drejtori i Financave pasi ne jemi në konsultime të vazhdueshme pasi ata me te drejt kërkojnë realizimin e të drejtës se vet mirëpo ne me të drejt ju themi juve se nuk është se i kemi të gjitha mundësitë me i krye me automatizëm, por tash ka fillua me u stabilizua procesi dhe jam i bindur që ne këtë drejtim nuk do të kemi nevojë me zbatua vendime gjyqësore ose vendime që vine edhe të i marrin parat nga thesari ose nga përmbaruesi. Pra tash e tutje nuk do të kemi nevojë sepse edhe sivjet janë krye disa punë sa i takon pagave jubilarë por edhe vazhdojnë të kryhen disa punë sipas mundësive buxhetore dhe kemi një dakordim me ata që ju takon me realizua këtë të drejtë. Te pyetja e parashtruar nga z. Fehmi Cena, është e vërtetë që duhet të punojnë të gjithë se bashku edhe me krejt organet përkatëse që të ndalet dhe të minimizohet ndërtimi o objekteve që ne fakt dëmtojnë apo degradojnë token bujqësore. Ne kemi inspektorat edhe pse kemi me mungesë, që realisht jam në dijeni për cilën rast jeni duke folur aty është e ndaluar edhe ai në pronë të vet e ka ndërtua por realisht është e ndaluar dhe do të përpiqemi me ndërpre aktivitetin e kundërligjshëm edhe që i dëmton apo i degradon tokat bujqësore e ne këtë rast tokat vreshtarë. Këto janë tani për tani fuqitë tona por nuk do të thotë me i ndalua por sigurisht që edhe ju duhet me na ndihmua si anëtarë të kuvendit që rastet e tilla sepse vërtet nuk po është e lehtë pasi lëndët po shkojnë neper gjykata dhe neper pushtetet që nuk varen prej neve dhe ata pastaj po i paguajnë disa gjoba por po vazhdojnë ndërtimet, pra nuk është që ne s'po veprojmë por jo që gjithë aktiviteti jonë është vendimtar d.m.th. nuk është komuna ajo që mundet me i ndalë. Pra këtë frymë të diskutimit tonë duhet me pas edhe organet tjera që neve nuk na përgjigjen, e këtë rast gjykatat që neve nuk na përgjigjen, e këtë rast gjykatat që sfidohemi prej tyre edhe ata i dënojnë ka 2-3 mijë euro edhe ata se kanë problem edhe e paguajnë atë gjobë edhe e kryen dënimin edhe vazhdon ndërtimin. Pra kemi shume këso raste ku po sfidohemi si udhëheqje ose si organe komunale. Te pyetja e parashtruar nga Munib Durguti, unë jam dakord rreth kësaj pasi e dini se ne fillet e pandemisë ka pasur me shume përkushtime edhe të kuvendit edhe të udhëheqjes komunale të inspektoreve edhe të policisë edhe të gjitha organeve. Tash ka fillua me u kthye njëfarë rutine, pasi furrat e bukës dhe lokalet të cilat operojnë kafiteritëe tjera nuk do të thotë që jemi të kënaqur me zbatimin e masave anticovid. Por po ashtu është shume e vërtet se ka dënime nga policia qofte edhe mospërdorim të maskës dhe mos mbajtjes se distancës dhe unë i kam raportet çdo 24 ore dhe fatkeqësisht kemi 20-30 gjoba për shkeljen e masave anticovid që i bëjnë subjekte fizike, juridike individë, kafiteri etj. Te furrat e bukës pajtohem se mundemi me i mbledhë edhe njëherë ju kemi dërguar disa letra edhe ata janë dakordue por edhe ata tash nuk është se po i përgjigjen edhe aq shume dhe nuk është ne rregull se nuk po i aplikojnë. Ndoshta qyteti i Prizrenit është me ndryshe sepse janë me te përgjegjshëm edhe me ma me traditë edhe me esnafë janë edhe furrtarët. Pra duhet me i kontrollua edhe me i vizitua edhe njëherë drejtorin e inspektoratit që inspektorin e sanitarisë me obligua që me shkua me pae se si po funksionojnë këto furra dhe a janë ato mbështjellëset dhe apo sigurohemi ne si klientë që buka që jepet është mbështjellur me masën që mbron shëndetin e qytetareve që frekuentojnë apo që janë klientë aty. Te pyetja e parashtruar nga Ali Morina, shenjëzimi rrugëve rajonale dhe magjistrale është jo i mirë dhe jemi totalisht të pakënaqur dhe ne kemi kërkuar që të kemi shenjëzim edhe vertikal edhe horizontal ne te gjitha rrugët rajonale që janë në përgjegjësi të Ministrisë kurse ata arsyetohen se i kanë disa kontrata dhe ndoshta edhe i bëjnë tash por ne do ta ri aktualizojmë edhe njëherë edhe do të kërkojmë pasi edhe rruga Rahovec – Xerxë është pa shenjëzim e sidomos horizontal e mos të flasim për rrugë tjera, pra është rrugë shume e frekuentuar dhe nuk ka ndodhur shenjëzimi me shume se 2 vjet. Te pyetja e parashtruar nga Ali Morina për përzgjedhjen e fermerëve, unë besoj që përpjekja e komunës për ti mbështetur fermerët e komunës se Rahovecit duhet të vazhdoj edhe me tutje dhe është mirë që po konsolidohet një sistem i cili përkundër që

mundet me pas ndonjë të metë apo ndonjë defekt, e rëndësishme është që një program po vazhdon edhe fermerët janë përfitues të kësaj, edhe sigurisht që edhe vitet e ardhshme duhet me vazhdua zbatimi i masave mbështetëse për fermerët dhe bujqit e komunës së Rahovecit sepse edhe vet kemi thënë se është kryeqytet i bujqësisë, sigurisht që ka të meta por jam shumë i sigurtë që duke falënderua edhe anëtarët e kuvendit të komunës për miratimin e buxhetit që e kanë bërë, po na jepet mundësia që mbështetja e fermerëve që e kanë bërë të vjen nga viti në vite duke u rritur edhe kjo është mirë, ndoshta edhe me pajisje tjera që mundën me na tregua fermerët se çka janë me të nevojshëm tash e tutje. Deri me tash ne e kemi bërë një përzgjedhje edhe të pajisjeve edhe në konsultim me ta e ndoshta do të ketë nevojë edhe pajisje tjera të cilat ju duhen për me vazhdua punën e tyre në bujqësi. Pastaj pyetja e parashtruar nga Vjosa Isma, se pse nuk ka drejtor në shkollën e mesme profesionale Selajdin Mullabazi Mici. Mendoj se aty ka një ushtrues detyre siç mund të ketë edhe ne disa shkolla tjera ushtrues detyre të drejtorit. Pastaj dikush mundet edhe me pyet se pse ushtrues detyre, sepse ende nuk ka dalë udhëzimi administrativ për shpalljen e konkurseve për drejtorë të shkollave. Pra ligji i ri për zyrtarë publikë nuk është kompletua ende infrastruktura me udhëzime administrative dhe me rregullore për me procedua hapjen e konkurseve për drejtor të shkollave dhe kjo është një e vërtetë e madhe që po e godet komunën e Rahovecit dhe çdo komunë të republikës së Kosovës. Pra nëse ju ka skedua mandati atëherë keni të drejtë vetëm ushtrues detyre por nuk keni të drejtë me hap konkurse, por ne po kërkojmë me hap konkurse dhe po presim me i hap konkurset pasi janë edhe disa shkolla tjera që janë me ushtrues detyre. Nëse nxjerrët udhëzimi administrativ dhe neve na jepet drita jeshile atëherë ne vazhdojmë edhe për shkollën Selajdin Mullaaabzi Mici por edhe për disa shkolla tjera që ju ka skedua kontrata drejtoreve aktual e që tash janë me një vendim vetëm ushtrues detyre. Këtë problem e kemi edhe në administratën publike pra ende nuk kemi dritë të gjelbër për me fillua hapjen e konkurseve sipas ligjit të ri për zyrtarë publik që ka hie në fuqi me datën 30 Qershor të këtij viti e që e ka konfirmua edhe gjykata kushtetuese. Po ashtu Vjosa ka pyet se pse marrin paga mësimdhënësit që janë jashtë vendit dhe unë po ju përmendi një rastë që nuk është turp me përmend, pra është Refki Kryeziu i cili ka marrë pushim mjekësor dhe ka pasur operacion dhe ju e dini se është asamblist në Kuvendin e Komunës dhe ne jemi në komunikim me atë, pra ky rast është dhe nëse ju keni ndonjë rast që është jashtë vendit e që merr pagën pa qenë në vendin e punës, e q e ju ndoshta se dini se ligji anticovid edhe strategjia e Ministrisë së Arsimit na ka mundësuar neve që në kushte të pandemisë që 30 vende apo qytetarë të komunës së Rahovecit të profileve të nevojshme e që janë me gjendje jo të mirë shëndetësore e që kanë moshën e caktuar, ata mund të mos dalin në vendin e punës dhe marrin rrogën e plotë dhe angazhohen stafi i mësimdhënësve mbështetës, i korirëve apo shërbëtorëve pasi që janë edhe 4 punëtor teknik që parashihen. Pra kjo është kuota që ka fitua komuna jonë si çdo komunë tjetër, që ndoshta Prishtina i ka 70 vende, prandaj nuk është e çuditshme që Smajl Latifi mësimdhënësi në moshën 60 vjeçare apo edhe në moshën 50 vjeçare që mundet me qenë keq me shëndet dhe rekomandimi nga qendra operative kombëtare emergjente që Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit e kanë mundësuar këtë dhe me stafe mbështetës nga 250 euro me kontratë 4 mujore. Pra besoj që e keni kuptua dhe nëse shihni edhe rastë tjera pasi unë po tregohem shumë i drejtpërdrejt dhe korrekt dhe i saktë në këto që po i them, pasi e kemi edhe kemi fletë lëshimin për Refki Kryeziu për pushim mjekësor dhe për këtë është në dijeni edhe Kuvendi dhe DKA-ja. Pastaj pyetja e parashtruar nga Masar Popaj për rrugët fushore a janë kualitative. Unë jam shumë korrekt pasi çdo kryesi apo këshillë i fshatit apo i lagjes, nëse i ka kërkuar dhe ju ka dhënë prioritete 2 km atëherë edhe 1.5 km janë shtuar secilit vendbanim. Mirëpo varet se kush ka punuar, pasi unë kam disa vërejtje dhe drejtorja e bujqësisë ka disa vërejtje në operatorin që ka zhvillua punime në pjesën e Hoçes vogël, Nagavc, Krushes Madhe kurse në pjesën ku ka operua një operator tjetër si Mendi-P asnjë vërejtje nga fermerët deri me tani nuk e kemi marrë, pasi vërtet janë bërë punët shumë mirë. Kështu që operatori Mendi-P ka punuar në pjesën e juaj dhe kontrata ka me vazhdua dhe sigurisht se ka me u lidhë edhe kontratë e re për rrugë fushore sepse është prioritet i drejtorisë së bujqësisë dhe kryetarit të Komunës dhe unë besoj që edhe ato 80 metra do të shohim edhe do të kryhen. Pastaj pyetja interesante e parashtruar nga Fehmi Hoxha. Faleminderit për pyetjen dhe zotimin publik që e kemi

dhënë, ne do të përpiqemi me ta dëshmuar se e mbajmë dhe është e vërtetë se kemi kontratë me dy operatore për çështjen e trajtimit apo kanalizimit të ujërave të zeza dhe jam në dijeni edhe te atij problemi dhe kam biseduar edhe me drejtorin. Kompania aktualisht është duke punuar në Hoçë të Vogel dhe ka me zbritje në qytete pasi janë dy kompani dhe jam i bindur se ky problem ka me u zgjidhë brenda një afati të arsyeshëm e që konsideroj që nëse merr koha e mirë atëherë brenda këtij viti dhe këtë premtim ne do ta mbajmë. Plani zhvillimor komunal me datën 3 Nëntor ditë e Martë, drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor bashkë me operatorin që ka kontratë me ne në komunën e Rahovecit do të bëjë prezantimin PZHK-së sipas procedurave atje dhe kërkesën për pëlqim nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit e kemi dërguar me kohë dhe është bërë një punë e madhe në bashkëpunim me kuvendin e Komunës dhe qytetaret e Rahovecit dhe ekspert e kësaj fushe dhe shpresoj që do të jetë se shpejti edhe ne mbledhjen e kuvendit në një seancë të rregullt për miratim. Tash të zona e mbrojtur tek ura e fshejtë, ka pasur dy apo tre herë tentativa edhe ne mandatin e kaluar kur unë nuk isha kryetar dhe unë ju kam sugjeruar grupin politik të këshilltareve që me kanë konsultua edhe mua sigurisht që ka qenë edhe ky, pasi në parim nuk jam kundër zgjerimit të zonës së mbrojtur por sikurse që jam në parim që edhe me u mbrojte maksimalisht zona e mbrojtur dhe kërkohet një kujdes. Pra edhe mu zgjeroi me shume kujdes por edhe sigurisht me u mbrojte sepse është zonë e mbrojtur me ligje Kanioni i urës së Fshejtë që mund të këtë edhe ndonjë zonë tjetër. Pra jam për me aktualizua këtë temë dhe nuk jam kundër që me sjellë në seancën e radhës si propozim por mos harroni sepse ne megjithatë jemi të obliguar që ta mbrojmë apo ta specifikojmë se çfarë lloje ndërtimesh dhe aktiviteteve lejohen në zonën e mbrojtur në Kanionin e Urës së Fshejtë. Përkundër faktit se kanë ndodhur disa ndërtime dhe ju e dini që janë legalizue por ne duhet të jemi shume të kujdesshëm dhe une e kuptoj se ju keni qenë drejtor i Urbanizmit dhe jeni marrë me këtë punë por nuk duhet m u ngutë shume për shkak se ne i kuptojmë edhe interesat e investitorëve potencial që dojnë me zhvillue aktivitete në atë zonë sikurse duhet ta kuptojmë që kemi një ligje që mbronë decidivisht zonat që janë të shpallura si zona mbrojtëse. Pra jam që në hartat zonale me u specifikua deri në detaje se çka duhet me ndodhë në fakte në atë pjesë, pasi kemi situatën ku ka edhe prona private ku ka tjetërsim të pronës publike pasi që 20 vite aty kanë marrë pronë edhe e kanë bërë të veten, kështu unë jam mundua me ndalua këtë. Pra le ti mbetet edhe me tutje një sqarimi me profesional dhe argumentues në përputhje me ligjin edhe eksperteve të caktuar dhe nëse është nevoja po i thërrasim edhe në kuvendin e komunës që me na ndihmone rreth kësaj. Pra në parim jam dakord por me shkua me kujdes të shtuar pasi dy herë është sjellë në kuvend dhe nuk është votuar pasi e dini mirë se është çështje e ndjeshme si situatë kurse në parim jam për me zgjerue por me kujdes të shtuar por edhe me mbrojte maksimalisht atë zonë dhe zonat tjera të mbrojtura.

Vjosa Isma – Po kthehem prapë te drejtori i shkollës pasi kryetari tha që ky ligje u hie në fuqi tash qershor por rasti i këtij si ushtrues detyre është gati 2 vite prej kohës kur nuk është Vjollca Vuçiterna, ai e merr pagën e mësimdhënësit kurse është ushtrues detyre i drejtorit gati 2 vite d.m.th. nëse tash në Qershor është ky ligje atëherë pse me herët nuk e keni shpallë vendin e punës për drejtor shkolle, pasi vërtet ai person nuk ka as autoritet ndaj mësimdhënëseve. T e kjo pjesa e Refki Kryeziut atij i takon pushimi mjekësor nëse nuk ndjehet mirë me shëndet edhe i takon me marr pagesë mirëpo zëvendësim të tij është deshtë me bo me ndonjë mësimdhënës tjetër e jo nxënësit me humb orë e me u zëvendësua nga punëtori ndihmës por nga secili mësimdhënës me u zëvendësua sa formalisht dhe ka pasur raste që në kohë pandemie janë bashkuar dy klasë për me zëvendësua një kolegë i tij duke rrezikuar seriozisht shëndetin e nxënësve duke i bashkuar dy klasë, kështu që edhe pse i takon pushimi mjekësor me pagesë por ai duhet me u zëvendësua nga mësimdhënësi tjetër. Rasti tjetër është i Valon Kabashi që nuk merr pagesë mirëpo ai që dy vite qëndron në listën e pagave por merr pushim pa pagesë dhe unë me sa e di vetëm për shkaqe shëndetësore apo avansim profesional mundet me i takua dikujt pushim pa pagesë me marr vazhdimisht kështu që edhe kur u pranua, është pranuar në kundërshtim të ligjit pasi e ka lëndën në gjykatë por ai ka prioritet japin që me marr pushim pa pagesë që 2 apo 3 vite e qëndron në listën e pagave.

Kryetari – E para është se ai është ushtrues detyre dhe merr pagën e një mësimdhënësi siç thuani edhe ju tani, mirëpo në momentin që vjen koha për me u shpallë konkursi për drejtor atëherë mund të flasim ndryshe pasi ende nuk kemi të drejtë, edhe ky ligji për zyrtaret publik nuk është tash pasi njëherë u shkua në gjykatën kushtetuese, pra ka qenë i suspenduar aktiviteti i konkurseve që ka me shume se një vite dhe nuk është tash, por vetëm me 30 qershor e ka konfirmue gjykata kushtetuese që është në fuqi dhe ende nuk kemi një proces të ri të zbatimit të ligjit të ri të zyrtareve publik. Pra ky ligje me siguri është votuar ne 2019 mirëpo menjëherë dikush e ka dergue në gjykatën kushtetuese dhe ka pritë 60 ditë në gjykatën kushtetuese dhe ju ka vazhdua për shkak të pandemisë edhe 3 muaj tjera. Pra janë dy ligje, ligji i pagave dhe i zyrtareve publikë që janë vonua ne procese, pra është një periudhë e gjatë ku janë vonuar nga pandemia edhe gjykata kushtetuese për shkak se nuk janë mbledhë dhe ne fund të qershorit ka dhënë përgjigje, kështu ë ligjin e pagave e ka rrëzuar kurse ligjin e zyrtareve publik e ka konfirmua si të drejtë dhe tash edhe pse është konfirmuar ende nuk kemi udhëzim administrativ. Tek pushimet mjekësore, mësimdhënësi ka të drejtë me marr pushim mjekësore me pagesë, me arsyetime të bazuara nga mjekët dhe po ashtu pushim pa pagesë është e drejtë e tij. Pra është e drejtë e patjetërsueshme e mësimdhënësve me marr pushim pa pagesë për një vite. Pra ligji i punës e lejon me marr pa pagesë për një vite por vetëm duhet të potencohet arsyetimi.

Fehmi Hoxha – Faleminderit shume kryesues, unë nuk dua të replikoj me ju kryetar por vetëm po dua të bëj disa sqarime, e para unë besoj që do të përfundoni atë rrugë ne atë lagje pasi jeni zotuar sivjet pasi veç jemi në prag të dimrit dhe duhet ta shpejtoni këtë dhe besoj që do kryhet ky zotim i juaji. E dyta rreth kanionit me ligje është e rregulluar se duhet të bëhet ri kategorizimi i zonave të mbrojtura dhe ne jemi vonua se duhet me krye dhe është e vërtet se dy herë ka qenë ne kuvend pasi ishte fushata zgjedhore dhe është tërhequr pasi janë bërë kalkulime. Dhe po ashtu është shume e vërtet se ju e keni këshillua këshilltaret tuaj që ta mbështesin atëherë se isha drejtor i urbanizmit, propozimin profesional të institutit për mbrojtjen e monumenteve natyrore. Instituti është përgjegjës për dhënien e propozimit profesional dhe të gjitha procedurat kanë përfunduar dhe janë zhvilluar debatet publike dhe shqyrtimet publike pastaj vërejtjet, kërkesat e ndryshme dhe nuk është votuar në kuvend dhe nuk po e them unë që me u zgjerua e as me u ngushtua por dokumenti duhet me kalua përmes kuvendit komunal për me mujt me marrë certifikimin paraprak të planit zhvillimor komunal. Ne e kemi të papërfunduar dhe nuk mundemi me marr pëlqimin paraprak prej Ministrisë pasi është e rregulluar me ligje. Tash kuvendarët duhet të diskutojnë pasi një propozim është dhe duhet të del para kuvendareve dhe ta diskutojmë të gjithë se bashku dhe dokumenti duhet të përfundojë. Për atë e thash se kryetar jam shume ne dijeni dhe jam marrë shume me këtë çështje dhe pa e rregullua këtë pjesë nuk mundemi me marr pëlqimin paraprak dhe mos ndrysho kufij dhe mos ndrysho asgjë nëse nuk pajtohemi askush por dokumenti duhet ta ketë preambulën e ligjit të ri për ri kategorizimin e zonave të mbrojtura. Pra dokumenti duhet të kaloj përmes kuvendit dhe si do të votohet është krejtësisht diçka tjetër mirëpo dokumenti do të përfundoj.

Kryetari – E thash prezantimin e kanë të PZHK-së me datën 3 Nëntor në Ministri pasi e ka ftua vetë ministria pasi është çështje e procedurës për me shkua drejt pëlqimit të PZHK-së edhe shpresojmë që ne hartën zonale do të kemi aktivitete sa me shpejt që është e mundur dhe gjithashtu shpresojmë që këto dy dokumente strategjike do të i miratoj kuvendi i komunës, kuptohet pas debatit ekspertizës dhe analizës.

Shqipe Kryeziu – Kryetar sipas juve shkollat qenkan të pajisura me dezinfektues, por unë punoj në dy shkolla në Ukshin Hoti në Krushe të Madhe dhe Selajdin Mullaabazi- Mici në Rahovec por edhe neper shkollat tjera i kam pyetur se nuk kanë pajisje e sidomos Ukshin Hoti nuk ka pajisje dezinfektuese por ndoshta shkon drejtori edhe ju thotë atyre drejtoreshave tjerë që të ju japin nxënësve maska gjithashtu le ti pastrojnë objektin shkollor dhe nuk e di a ka punëtor teknik dhe orari është i shkurtuar pasi unë çdo ditë aty.

Kryetari – Unë besoj që nuk janë tema këto për kuvendin e komunës pasi ne ato dy shkolla funksionojnë organet drejtuese të shkollave dhe sigurisht që janë edhe drejtorët e shkollave dhe është mirë me këqyr se a po e pastrojnë apo jo dhe të gjitha vërejtjet e juaja duhet ti dërgoni ne DKA dhe ju siguroj që ka me marr masa administrativë ndaj secilit që bën shkelje dhe gjithashtu jam i bindur dhe po e përsëris faktin se shpërndarja e

një kontingjenti të madhe me materiale mbrojtëse në funksion të zbatimit të respektimit të masave anticovid i keni neper të gjitha shkollat duke përfshijë edhe shkollën në Krushe të Madhe por edhe ndonjë shkolle tjetër. Por mënyrën se si e administrojnë organet e shkollës nuk e di por materiale ka mjaftueshëm dhe shpresoj se do të kemi edhe me tutje mjaftueshëm për tu mbrojtur nga Covid-19 edhe për ta mbrojtur shëndetin edhe të mësimitdhënësve edhe të nxënësve por edhe të prindërve që e frekuentojnë atë shkollë.

Kryesuesi – Të nderuar kolegë kuvendarë, tani kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Raportit Financiar për periudhën kohore Janar – Shtator 2020.

Afrim Limani – I nderuar kryesues, nënkryetar, të nderuar kuvendarë dhe gjithë të pranishëm në sallë. Kam kënaqësinë që para juve të lexoj raportin 9-mujor financiar të komunës Rahovecit për periudhën Janar – Shtator 2020. Paraprakisht para se me hie ne raport, deshta të ju them se ky raport është i harmonizuar plotësisht me Ministrinë e Financave e konkretisht me departamentin e buxhetit. Ky raport përbëhet nga dy pjesë kryesore, nga pjesa e realizimit të buxhetit dhe nga pjesa e te hyrave që çdo ngjarje dhe aktivitet është i involvuar në kuadër të këtij raporti. Para se me hie ne leximin e raportit, deshta të ju them edhe një informatë me rëndësi sepse deri ne këtë periudhë kur jam duke raportuar inkasimi i të hyrave është relativisht shume i mirë edhe shpresoj që deri ne fund të periudhës pra përmbylljes se vitit fiskal të kemi edhe tejkalim të hyrave. Këtë e thash se përkundër asaj që këtë vit fiskal na kanë përcjellë disa ngjarje të cilat kanë shkaktuar ngecje të hyrave e konkretisht është fjala për covid-19. Gjithashtu edhe shpenzimi i buxhetit është ne masë jashtëzakonisht të mirë dhe deri ne kete periudhë kur jam duke raportuar realizimi i buxhetit është në përqindjen afërsisht 74%. Fillimisht me lejoni që të ju përshkruaj raportin në pika të shkurta ne pjesën me te rëndësishme, në mënyrë që të ju lë hapësirë që edhe ju të bëni pyetje edhe të diskutojmë rreth raportit. Në faqe 3, kemi të prezantuar të hyrat e rregullta vetanake ku deri ne fund të muajit shtator ne total të hyrat janë 802,141 euro dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njëjte të vitit të kaluar që janë 850,390 euro atëherë kemi një ndryshim negativ me vlerë prej 48,667 euro. Planifikimi total i të hyrave është 1,156,841 euro. Në faqe numër 4, kemi të paraqitur edhe realizimin e të hyrave bashke me gjobat e gjykatave dhe trafikut si dhe të hyrat nga pyjet, kështu që ne total të hyrat janë me vlerë prej 944,257 euro kur e krahasojmë me periudhën e njëjte të vitit e kaluar kemi një ndryshim negativ prej 50,627 euro. Në faqe numër 5 kemi të prezantuar të hyrat sipas kategorive ekonomike ndërsa ne faqe numër 6, kemi të hyrat nga tatimi ku janë të specifikuara te paraqitura të gjitha të hyrat sipas muajve që kemi 306,668 euro dhe kur i krahasojmë me periudhën e njëjte të vitit të kaluar atëherë kemi një ndryshim negativ ne vlera përafërsisht 90,000 euro. Në faqe numër 7, kemi të prezantuar vetëm shpenzimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike ne kuadër të programeve, ku ne total shpenzimi i buxhetit është ne vlerë prej 10,499,526 euro. Në faqe numër 8, janë të paraqitura shpenzimi i buxhetit të shprehura ne përqindje ne raport me planifikimin e buxhetit që ne kuadër të kategorive ekonomike që ne total deri ne këtë periudhë pra ne shtator, përqindja e realizimit të buxhetit është 67,99%. Në faqe numër 10,11 dhe 12 janë të paraqitura shpenzimi i buxhetit në kuadër të mallrave dhe shërbimeve sipas kategorive ekonomike dhe në faqe numër 13 kemi një rekapitullim të gjithë këtyre shpenzimeve të cilat kanë ndodhur ne kuadër të programeve dhe do të ju jap një informatë me rëndësi që deri ne kete periudhë kemi arrite që gjitha obligimet ne kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë të paguara dhe ne fund të vitit nuk do të kemi një raport të obligimeve në kuadër të kësaj kategorie. Sa për informimin e juaj deshta të ju them edhe një informatë që mos me ju lanë hapësirë të bëni pyetje, në kodin 13720 naftë për ngrohje qendrore që ka një dallim të madhe me periudhën e vitit të njëjte të vitit të kaluar, pra i kemi 66,207 euro kurse ne vitin e kaluar periudha e njëjte ka qenë 38,145. Ky dallim i madhe është se ne kemi arrit që gjate muajit Mars e kemi shfrytëzuar mundësinë dhe hapësirën e mirë për çmimin e ulët të naftës pra ne atë periudhë jemi furnizua me naftë dhe kuptohet që kemi bërë edhe pagesën e faturës dhe tash e tutje deri ne fund të vitit fiskal do të figuron kjo vlerë e shpenzimit.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin për paraqitjen e raportit financiar për periudhën Janar – Shtator 2020. Edhe ne si anëtarë të kuvendit komunal jemi të vetëdijshëm se sivjet jemi me një vit pak

a shume të jashtëzakonshëm për shkak të Covid-19 që ka pasur vështirësi sigurisht ne shume gjëra e këto janë shfaqur edhe ne komunën tonë. Por ne jemi të thirrur këtu që ti themi disa gjëra për ato që i kemi parë në raportin financiar për periudhën Janar – Shtator. Deshta fillimisht të ndalem tek të hyrat vetanake, nëse e krahasojmë se sa ka qenë planifikimi dhe sa janë realizua mund të themi se për këtë periudhë kemi zvogëlim të hyrave vetanake në vitin 2020 dhe po them ne krahasim me vitin 2019 siç e përmenda se ka qenë situatë e jashtëzakonshme por evidente është se të hyrat vetanake për vitin 2020 krahasuar me periudhën 2019 është dukshëm me e vogël. Nëse ndalemi në gjërat ne trafik shohim se këtu ka ngritje apo rritje ne krahasim me vitin 2019 ndërsa te gjërat e gjykatave ka rënie të madhe pasi nuk ka realizim të tyre. Do të ndalem te planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë për vitin 2020, edhe këtu duhet të bëjmë krahasime pasi realizimi i tatimit në pronë për vitin 2020 është 99,212 euro me pak krahasuar me planifikimin që është bërë për vitin 2020 ndërsa nëse e krahasojmë realizimin e tatimit në pronë kemi 61,501 euro me pak se ne vitin 2019 d.m.th. këto janë shifra që janë ne kete raport që na keni ofrua ju. Sa i përket shpenzimeve sipas kategorive ekonomike, në bazë të dokumenteve që na keni ofruar shohim se shpenzimi i buxhetit neper disa kategori është i pamjaftueshëm për këtë periudhë në bazë të shifrave që kemi ne raport sepse shohim që ne disa kategori ekonomike ka pasur mjete të alokuara mirëpo nuk është shpenzuar buxheti e sigurisht që ju e dini më mirë se pse ka ndodhur kjo. Pastaj tek lista e mallrave dhe shërbimeve që kemi sipas programeve, këto çështje i kemi ngritur edhe në komitetin për politike dhe financa mirëpo për hire të opinionit pasi është edhe mbledhje e kuvendit duhet disa gjëra prape të përsëriten siç kemi kodin 13440 shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, pasi në kuvendin komunal është paraqitur shifra 6797 euro e sigurisht që drejtori ju shpjegon kuvendareve se pse ka ndodhur kjo pasi neve ne komitet na ka shpjeguar. Pastaj kemi kodin 13480 shpenzime për anëtarësim, edhe këtu për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 janë 23,431 euro d.m.th. ka shpenzime me shume kurse ne vitin 2019 kanë qenë 5620 euro kurse tash janë 23,431 euro, sigurisht edhe për këtu na jep sqarime drejtori. Pastaj kodi 14490 shpenzime të vendimeve të gjykatave në vitin 2019 i kemi pasur 8700 euro kurse për vitin 2020 janë 20,199 euro.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, edhe unë falënderoj drejtorin e Financave për përgatitjen dhe prezantimin e raportit buxhetor për këtë periudhë 9-mujore Janar – Shtator 2020. Mendoj se për ne është një raport mjaft i qartë dhe i ka të dhënat e qarta, krahasimi me vitet paraprake sidomos me vitin 2019. Por ajo çka me brengos si delegat është natyrisht se të hyrat për këtë periudhë kohore ne raport me planifikimin vjetor janë me te ultë dhe nëse shkon me këtë kuotë atëherë deri ne fund të vitit gjithashtu ka mundësi me qenë të ulëta dhe të mos përmbushet planifikimi. Pra ne raport me planifikimin vjetor të hyrat janë realizua 69,34% dhe gjithashtu ne raport me periudhën e njëjte të vitit të kaluar përsëri kemi me pak të hyrat edhe ne raport me planifikimin me periudhën e njëjtë të vitit 2020 nëse shikojmë të hyrat e rregullta është 92,05% pra se paku është deshtë bëhet deri në 100%. Sa i përket të hyrave totale pra të hyrat e rregullta bashkë me gjërat gjithashtu ne raport me vitin e kaluar kemi deri në 51,000 me pak. Ajo që bie ne sy është se të hyrat sidomos për muajin Prill dhe Maj kanë qenë jashtëzakonisht të ulëta dhe e kuptoj arsyeshmërinë sepse ishte kohë e vështirë e pandemisë ku ne ishim në karantinë të izoluar dhe atëherë ka pasur edhe lëvizje me pak por si duket pastaj kemi këta muajt tjerë të të hyrave shume me te mira dhe ka luajt rol pasi edhe ne mbledhje kemi kërkuar një angazhim me te madhe të administratës dhe të ekzekutivit që të punojnë edhe përkundër asaj që është pandemi dhe të hyrat duhet të realizohen sepse ato janë shume të rëndësishme për buxhete edhe projekte të ndryshme dhe interesin e qytetareve. Tek tabela 1.5 krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2020-2019 tek tatimi në pronë kjo natyrisht bie në sy sepse të hyrat janë goxha të ultë në krahasim me planifikimin, pasi ne krahasim me planifikimin vjetor me përqindje është 56,67% ndërkaq ne krahasim me periudhën e njëjtë 9-mujore është 75,5% dhe po ashtu po dua të përmend që të hyrat në tatimin në pronë që vlerësohen dhe që janë me stabile duhet të kemi kujdes pasi kemi pritur me u realizua me shume për arsye se për këtë vite është edhe ajo pjesa e tatimit pasi tatimi këtë vite është me i shtrenjtë pasi është shtuar edhe taksa për pllacë dhe oborre të shpisë. Tek kodi 50013 taksa për certifikata të lindjes, kisha kërkuar nga ju drejtor një

sqarim, se planifikimi ishte mbi 72,000 ndërsa të hyrat janë vetëm 8000 që është një diskrepancë e madhe, pasi planifikimi është i dobët apo nuk është punuar dhe të hyrat janë të ulte dhe ne krahasim me vitin e kaluar dallimi është shumë i madhe dhe une e kam bërë këtë pyetje edhe ne Komitetin për Politikë dhe Financa që me ka interesua rreth lindshmërisë se si është gjendja për këtë vite në krahasim me vitin e kaluar. Pastaj tek kodi 50015 taksa për certifikata të vdekjes që gjithashtu kemi një dallim mjaft i madhe në raport me planifikimin që edhe për këtë kam bërë pyetje nëse për këtë mbledhje drejtoresha ose dikush nga drejtoria për Administratë na kishte treguar për gjendjen e vdekshmërisë në komunën tonë. Pastaj kodi 50103 largimi dhe deponimi i automjeteve, në planifikim keni pasur të hyra kurse nuk keni realizuar asnjë pra zero të hyra dhe po me intereson se arkëton diçka komuna prej këtij shërbimi apo jo. Pastaj kodi 50405 shfrytëzimi i pronës publike që kemi të hyra shumë pak ne raport me planifikimin, pra planifikimi ka qenë 13,000 ndërsa kemi të hyra afërsisht 2500 euro dhe mendoj që ne këtë drejtim duhet të keni kujdes me shumë rreth të hyrave nga prona publike që shfrytëzohet nga ana e qytetareve qofshin persona fizik apo juridik. Në faqe 8, tek shpenzimet sipas kategorive ekonomik dhe paraqitja grafike, në përqindje drejtori na prezantoi tek shpenzimet kapitale diku 67% por për këto tjera shpenzime subvencione dhe transfere i keni vetëm 41%, shpenzime komunale 49%, mallra dhe shërbime 51%, por është dashtë edhe shpenzimet kapitale me qenë se paku diku 75% për këtë 9-mujorë. Si çështje tjetër që kisha me ngritë që sigurisht u ngritë edhe nga parafolësi që bie ne sy kodi 14410 shpenzimet nga vendimi i gjykatave pasi kemi pasur vërejtje edhe ne te kaluarën se këto janë shpenzimet shtesë mbi 20,000 euro shpenzimet shtesë të paplanifikuara i kemi përmes procedurave përmbarimore dhe gjykatave dhe ne mendojmë që këto shpenzime nuk duhet që të ndodhin, që me siguri kanë ndodhur për shkak të atyre pagave jubilarë që u përmenden me herët dhe është mirë që të bëhet planifikimi për këto paga në mënyrë që komuna mos të ketë shpenzime shtesë përmes procedurave përmbarimore dhe gjykatave.

Masar Popaj – Tek kodi 13720 naftë për ngrohje qendrore me një arsyetim se e ka gjetur naftën me lirë dhe e ka ble por te kodi 13760 dru që në vitin 2019 janë 27,099 euro kurse për vitin 2020 janë 60,175 euro që është një diferencë shumë e madhe për 33,876 euro, që po kërkoj nga drejtori një arsyetim për këtë.

Afrim Limani – Faleminderit për pyetjet e bëra, do të përgjigjem me radhë ashtu siç i keni parashtrua. Se pari z. Rasim Fazliu bëri disa pyetje e nder to ishte krahasimi i realizimit të hyrave brenda kësaj periudhë me i ultë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Edhe ne fillim e thash dhe besoj që kjo përgjigje vlen edhe për doktorin pasi edhe ky e bëri të njëjtën pyetje, ku arsyeja është sepse këtë vite kemi pasur probleme të ndryshme dhe një nder to ka qenë edhe pandemia covid-19, kryesisht gjatë muajit mars, prill edhe gjysma e majit absolutisht nuk kemi pasur të hyra. Mirëpo edhe ne fillim të prezantimit të raportit thash që deri ne këtë fazë të raportimit kemi një realizim apo inkasim të kënaqshëm të të hyrave vetanake d.m.th. totali i të hyrave deri me tani ka shkuar 1,090,000 euro që i bien përafërsisht edhe 80,000 euro me arrite planifikimin dhe përqindja e të hyrave është mbi 93% dhe jam shumë i sigurt se deri ne fund të vitit fiskal jo vetëm që do të realizojmë planin por do të kemi edhe tejkalim të planit edhe me një përqindje të dukshme ne raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Po ashtu pyetje tjetër ishte tek gjambat e gjykatave, këto janë të hyra të jashtëzakonshme apo të pandikushme sepse të cilat ne nuk mundemi të i diktojmë, pasi janë të hyra që vinë nga gjykatat dhe gjambat e trafikut, bilum kjo periudhë nga gjambat e trafikut kemi pasur një inkasim jashtëzakonisht të mirë pasi as ne nuk e kemi pritur që realisht e ka tejkalua periudhën e njëjtë të vitit të kaluar deri ne këtë fazë të raportimi. Edhe ne tatimin në pronë kemi pasur ngecje të njëjtë të inkasimit si pasoj nga gjendja e krijuar nga Covid-19, mirpo në këtë periudhë nga Maji deri në shtator kemi një inkasim jashtëzakonisht të mirë dhe deri ne këtë fazë kur po raportoj, përafërsisht është i barabartë me periudhën e njëjtë të vitit kaluar dhe besoj se deri ne fund të vitit do të kemi tejkalim edhe ne kuadër të tatimit në pronë. Realizimi i buxhetit me përqindje të vogël siç e thash edhe ne fillim se deri ne atë periudhë nuk kemi pasur inkasim të mirë mirëpo në këtë fazë kur po raportojë përqindja e realizimit të buxhetit është në shumën është afër 74% dhe e dimë se si kriter për kualifikim të pasqyrave financiare për realizimin e buxhetit është 75% mirëpo këtë veç e kemi arrit këtë fazë dhe shpresoj se deri ne fund të vitit do të kemi realizim të buxhetit

përafërsisht 98-99% të buxhetit sepse trendi i realizimit është duke shkuar mirë. Te kategoritë e shpenzimeve, te shpenzimet intelektuale dhe këshilldhënëse, z. Rasim Fazliu pyeti si dhe shpenzimet për anëtarësim. Të shpenzimet intelektuale dhe këshilldhënëse, ky kodë është siç ju thash edhe ne mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa sepse ndërlidh të gjitha komunitetet të cilat paguhen nga ana e buxhetit të komunës së Rahovecit dhe janë në kuadër të kësaj kategorie si këshilli komunal për siguri në bashkësi, këshilli për komunitete pra të gjitha këshillat paguhen në kuadër të këtij kodi. Ndërsa diferencë tjetër është tek shpenzimet e anëtarësimit, pasi komuna e Rahovecit ka marrëveshje të ndryshme me organizata të ndryshme dhe unë po i përmendi dy, që është asosacioni i komunave që kemi bërë një pagesë sivjet dhe që kemi pasur një borgj të trashëguar dhe AZHR-ja që kemi një anëtarësi vjetore që e paguajmë çdo vite ka 5,000 euro që është një marrëveshje që është krijuar para 5 vite nga kryetari i komunës dhe regjionit jug si Prizreni, Malisheva, Suhareka dhe Dragashi. Doktor Fehmi Cena i parashtroj disa pyetje konkretisht tek të hyrat inkasimi i dobët me planifikimin dhe gjithashtu e ceku edhe tatimin në pronë, konsideroj që me herët e dhashë përgjigjen rreth kësaj sa i përket të hyrave. Po ashtu pyetet për disa kode të të hyrave dhe të njëjtën pyetje e keni parashtuar edhe ne komitet, edhe edhe atë ditë thash se këtë vite kemi një unifikim të kodeve ekonomike një risi që bashke me ministrinë e Financave dhe komunën dhe aty realisht janë përzier kodet. Po supozojmë që të hyrat nga certifikatat e lindjes munden me u inkasua me ndonjë të hyrë tjetër por shpresoj që këtë problem shume shpejt do ta zgjedhim dhe sa për kureshtje tuaj, ju kemi dërguar një raport në adresën tuaj, që është një raport me i detaizuar se sa ka pasur lindje, vdekje, martesë dhe për kureshtjen tende lindjet deri në këtë periudhë janë 148 lindje duke përfshijë vetëm territorin e komunës së Rahovecit që do të thotë pa informata në Prizren apo Gjakovë. Është e vërtetë se ne kemi kontratë me një kompani e cila bënë bartjen e veturave që brenda këtij vitit fiskal e kemi lidhur kontratën kështu ndonjëherë mundet me ndodh që nuk mundemi me qenë të sakt me planifikimin. Po ashtu dua të them një informatë me rëndësi tek planifikimi i të hyrave vetanake, pasi ne si komunë e Rahovecit qëndrojmë me poshtë me planifikimin real i cili duhet të ndodhë, pasi ne vazhdimisht kemi bërë kërkesë në Ministrinë e Financave dhe kemi kërkuar që të hyrat vetanake të rriten në kuadër të komunës tonë. Kështu që kërkesën tonë nuk e kanë aprovua dhe ne detyrohemi tash me dal në një planifikim real i cili faktikisht duhet të ndodhë dhe në kuadër të këtij viti kemi pasur shkurtesa buxhetore që ka ardh nga qarkorja e tretë buxhetore, kështu që ne jemi detyruar në planifikim real me shkua. Po ashtu tek shpenzimi i buxhetit në këtë periudhën 9-mujore që ndoshta nuk është i kënaqshëm shpenzimi i buxhetit mirëpo e thash edhe ne fillim se deri në këtë periudhë raportuese, në total shpenzimi i buxhetit është në masën 74% që është relativisht i kënaqshëm. Tek shpenzimet e gjykatave është vërtetë që një operator na ka paditur dhe krejt kjo vlerë ndërlidhet me atë padi, pra shuma është afërsisht 30,000 euro dhe raste tjera nuk kemi dhe nuk ndërlidhet me pagat jubilarë sepse për pagat jubilarë e kemi bërë një marrëveshje qysh ne fillim përmes avokatit të komunës dhe përmbaruesve tjerë dhe ky proces është duke shkuar jashtëzakonisht mirë dhe besoj që deri në fund të vitit do të i shlyejmë të gjitha obligimet që kemi për mësuesit që janë pension për pagat jubilarë. Pastaj Masar Popaj ka pyetur rreth dallimit të shpenzimeve me dru në krahasim me periudhën e njëjte të vitit të kaluar. Ky dallim është se brenda këtij viti fiskal kemi arrit që me kohë të kontraktojmë kontraktorin dhe operatori ka bërë furnizimin dhe ne jemi detyruar të bëjmë pagesën dhe ky është dallimi. Pasi në periudhën e njëjtë vitit të kaluar e di që është bërë pas periudhës Janar – Shtator dhe ky është dallimi.

Kryesuesi - Faleminderit shume drejtor për të gjitha sqarimet, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, kalojmë në piken e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për transfere dhe rialokim të mjeteve.

Afrim Limani – Ridestnimi i mjeteve është proces ligjor i cili është në kuadër të ligjit të financave publike dhe përgjegjësi dhe ne si komunë e kemi shfrytëzua këtë fazë pra këtë të dejtë dhe komuna jonë pra organizata jonë ka një pjesë të mjeteve të cilët për një arsye apo tjetër duhet të ridestinohen dhe kryesisht janë pjesa e mjeteve që kanë mbetje në kuadër të disa projekteve gjithashtu e kemi edhe fondin rezervë që është në

drejtorinë e shëndetësisë për shkak të rezervave nga pozicioni i pagave dhe këto mjete dhe ne disa drejtori tjera kemi paraparë që duhet të ridestinohen. Shuma e bartur për ridestitim është 192,056 euro dhe këto mjete nuk janë vetëm nga pjesa e granteve mirpo ka mjete edhe nga ana e të hyrave vetanake. Që të mos ju marr me shume kohë për secilin projekt se ku duhet të ridestinohen dhe ne cilët projekte ju lë hapësirë që të mund të bëni ndonjë pyetje, kuptohet kërkoj aprovimin e juaj.

Munib Durguti – Te vendimi kisha propozua që të plotësohet e sidomos te pika 1, pra miratohet vendimi për transfer dhe rialokim të mjeteve në vlerë, pra të shkruhet vlera sa rialokohen nga të hyrat vetanake dhe sa nga kapitale. Kjo vetëm sa të jetë vendimi pak me i plotë në aspektin e informacionit që e ka. Nuk kam ndonjë propozim tjetër për bartje të mjeteve. Faleminderit

Aferdita Thaqi – Përshëndetje për te gjithë. Kam diçka pasi jam edhe vendase me drejtorin e Financave, vetëm dua të di se a paguhet me shume pasi prej të gjithë drejtorëve është ai që punon me shume, pasi ka drejtorë që nuk janë ndegjue asnjëherë duke folur.

Fehmi Cena – Pra është fjala për një kërkesa që po kërkohet për ridestitim të mjeteve të pashfrytëzuara nga investimet kapitale në shumen dikun 177,056 euro, ridestitimi po shihet që është përsëri për investime kapitale mirëpo ne në fakt si grup e kemi analizuar këtë planë se ku do të shfrytëzohen këto mjete. Mendoj se nuk jemi të kënaqur edhe me atë që po kërkohet një ridestitim i tillë për arsye se po shihet se planifikimi ka qenë i dobët ose nuk është punuar në realizimin e këtyre projekteve. Po ashtu edhe për ridestitim i kemi disa vërejtje, po filloj nga administrata, mos ndërtimi i E-kioskut, kodi 47975 në vlerë 1500 euro, kërkohet transfer ne turizëm dhe shtigje të ecjes kodi 48159. Pyetja është pse nuk është ndërtuar një E-kiosk kryetar duke ditur se ka qenë e planifikuar buxheti ka qenë i ndarë dhe nuk është fjala vetëm për një E-kiosk që e kemi këtu te komuna por me siguri është fjala edhe për kioskë tjera që i mundësua të shërbehen qytetaret duke ditur se çfarë roli ka E-kiosku e sidomos për këtë periudhë të pandemisë. Unë mendoj dhe nuk e di ju a a e keni pas të planifikuar me herët se E-kioske të tjera ka nevojë me pas çdo kund ku është zyra e gjendjes civile si në Ratkoc, Xerxe, Ratkoc. Pastaj situata kritike në bujqësi kodi 49929, vlera 30,000 euro që po kërkohet rialokim për ndërtim dhe mirëmbajtje e rrugëve fushore kodi 40822, që unë mendoj që këto mjete kanë mundur me shfrytëzua për rastet kritike pasi kemi pasur sivjet dëme në bujqësi, nga vërshimet nga breshëri dhe keni mundur me i shfrytëzua këto dhe pse kanë mbetur këto pa u shfrytëzue, që kërkojmë shpjegime rreth tyre. Pastaj vazhdimi i ndërtimit të shtëpisë muze Ukshin Hoti në Krushe të Madhe kodi 40865 me vlerë 30,000 euro, kërkohet rialokim dhe riparim i shtëpisë se kulturës në Ratkoc me vlerë 30,000. Në buxhetin e këtij viti që ka kaluar ne këtë kuvend i kemi ndaje 20,000 për renovime në shtëpinë e kulturës në Ratkoc dhe tash me këto 30,000 po bëhen 50,000 euro dhe nëse shikojmë komizën afatmesme buxhetore janë ndarë 80,000 euro për renovim të shtëpisë se kulturës në Ratkoc për tre vitet e ardhshme dhe neve na duket se po bëhen të tepërta shpenzimet për renovimin e objektit të shtëpisë se kulturës Ratkoc që edhe për këtë duam sqarime për arsye se kemi shtëpi të kulturës edhe në Xerxe edhe në Krushe të Madhe dhe Rahovec dhe nuk po ndajmë për renovime dhe pyetja është se pse po ndahen këto mjete për çdo vite që po shpenzohen për renovimin e atij objekti duke marr parasysh se objekti është i ri por edhe nëse ka nevojë për renovim atëherë le të ndahen përnjëherë që të rinovohet ky objekt dhe le të dimë se objekti është i gatshëm për me funksionue dhe nuk ka nevojë që për çdo vjet për renovim të një objekti. Pastaj vendosja e tabelave për emërtime dhe informuese kodi 49914 me vlerë 15,000 euro, rialokim krijimi i hapësirave të gjelbëruara dhe drunjtëve dekorativ kodi 47914. Kryetar, edhe këtu mendoj se drunjet dekorativ që kemi pasur vërejtje edhe me përpara dhe kemi vërejt që nëse është fjala për drunjtë që po mbillen skaj rrugëve që shumica prej tyre po thahen edhe ju po vazhdoni me investua dhe dua të ju rikujtoj se për këtë vite janë 50,000 euro, për vitin 2021 100,000 euro për vitin 2022 edhe 100,000 euro tjera pra janë ndarë 250,000 euro për drunjtë dekorativ. Krejt ne rregull është nëse ky shpenzim bëhet për mbjellje edhe gjelbërim të sipërfaqeve të pagjelbruara që kemi mjaft si neper fusha apo pyje edhe do të ishte mirë që ti orientoni këto shpenzime pikërisht ne gjelbërimin e këtyre sipërfaqeve dhe nëse ka nevojë të bëni edhe me agjensionin e pyjeve sikurse po bëjnë disa komuna. Gjithashtu ju sugjerojmë

se pse nuk organizoni aksione të ndryshme me rini me nxënës me pensionera që me dalë me mbjell sipërfaqe me pyje me gjelbërime dhe kjo do të kushtonte shume me pak dhe mendoj se janë projekte shume të shtrenjta dhe fidanët po i bleni shtrenjte edhe për këtë duhet me na dhanë shpjegime. Pastaj restaurimi i objektit përkujtimor për 64 të masakruarit në Krushe të Madhe kodi 48201 me vlerë 20,000 euro, edhe këtu pyetja është se pse ky projekt nuk është realizua duke ditur se buxheti është ndarë edhe është vendimi i kuvendit komunal. Kërkojmë këto sqarime përndryshe ne kemi menduar që një pjesë e kësaj shume të investohet në ato projekte që i kemi kërkuar edhe me herët si në rrjetin e kanalizimit investime me shume, ne gropa septike dhe impiante kanalizimi, ujërat atmosferike për qytet të Rahovecit, ndërtimi dhe rregullimi i disa rrugëve që i keni disa kërkesa për qytetin e Rahovecit për ndërtimin dhe rregullimin e disa rrugëve që nuk i keni paraparë aspak, kështu që ne si grup nëse e votojmë këtë ridestitim të mjeteve me tepër do ta bëjmë për shkak që mjetet të mos shkojnë në suficitë.

Fehmi Hoxha – Faleminderit për mirëkuptimin tuaj kryetar, kam disa pyetje si projekti për vazhdimin i ndërtimit të shtëpisë muze Ukshin Hoti 30,000 euro që kanë qenë[të parapare, atëherë pse nuk po vazhdon ky projekt, pastaj vendosja e tabelave për emërtime dhe informuese 15,000 euro dhe konsideroj se këto mjete i duhen komunës se ka shume tabela që janë dëmtuar dhe që duhen të zëvendësohen në tere territorin e komunës se Rahovecit, kështu që për një punë është shume me rëndësi me krye dhe ju sugjeroj që ti shihni mundësitë dhe mos i largoni këto mjete se nuk keni me mundur me krye punë pasi shume tabela janë të dëmtuara në tërë territorin e komunës se Rahovecit, Gjithashtu e tha edhe kolegu Fehmi Cena, restaurimi i objektit përkujtimor për 64 masakruarit në fshatin Krushe e Madhe edhe këtu një sqarim se pse nuk po vazhdon ky projekt dhe po e shoh që duhet të rialukohen këto mjete në ndërtimin e qendrës rinore dhe kulturore në Rahovec 5000, atëherë çfarë qendre rinore dhe kulturore dëshironi me bo me kete shume, pasi i bartni 30,000 në Ratkoc kurse 5000 në Rahovec për qendrën kulturore. Pra sinqerisht do ishte mirë që hi mos me qitë këtë që po doni me ndërtua që me 5000 euro me ndërtua diçka në Rahovec. Unë kam menduar se kur kam propozuar me herët që në kuadër të kësaj kohe pa kohe të pandemisë, kam kërkuar prej kuvendareve që të ndihmohen bizneset e vogla dhe e keni në drejtorinë e zhvillimit ekonomik vetëm 20,000 mjete të ndara dhe kam menduar me këtë ridestitim që do të plotësohet kodi dhe të ndihmohen bizneset e vogla në Rahovec, gjë të cilën nuk e keni bërë. Ju keni premtuar se do të plotësoni këtë kodë edhe ne te ardhmen do e diskutojmë nëse vazhdon pandemia pasi shihet që çdo here po vjen edhe me keq për bizneset dhe kam menduar që këtu do ta plotësoni atë kodë dhe besoj se duhet të bëni diçka rreth kësaj. Po ashtu keni thënë që prej 600,000 eurove që do i merrni dhe që nuk janë askund dhe Demos që di i plotësoni shume kode edhe bizneset prape po ju kërkoj që të gjendet mundësia që të ndihmohen të paktën ka 200 euro në muaj.

Rasim Fazliu – Unë nuk do të përsëris koleget për të gjitha ato që u folën me herët por do të ndalesha konkretisht diçka që me te vërtet i bien se nuk është bërë planifikimi i mirë sepse disa kode buxhetore që kanë pasur me u realizua nuk po realizohen dhe po bëhet ridestitimi në kode tjera buxhetore. Unë dua të jem konkret për diçka, pasi kemi një shoqëri kulturore artistike e që është shume aktive në Komunën e Rahovecit e ajo është shoqëria kulturore artistike Bajram Curri në Krushe të Madhe edhe kryetari dhe ne te gjithë jemi dëshmitarë te saj se lokali që kanë ushtruar vazhdimisht është rrënuar për arsye që i dimë të gjithë dhe meqenëse jemi te transferi dhe rialukimi i mjeteve neper kode te caktuara buxhetore kisha propozua dhe kisha dhënë një mendim që nga këto mjete, me i bo një vend shoqërisë kulturore Bajram Curri që me ushtrua pasi me te vërtet që një vite gjendet në një situatë të keqe pasi një shoqëri siç është ajo shumë aktive edhe me ja bo të mundshme një vend adekuat që me pas mundësi me bo ushtrime dhe nëse ka mundësi që nga këto mjete që janë me dhanë ndonjë ide që me bo të mundshme që me ushtrua veprimtarinë e tyre.

Kryetari – Faleminderit shume për kontributin, e para po i përgjigjem të gjithë që kanë ngritë shqetësime, unë them se bizneset po ndihmohen edhe sot, pra janë duke u ndihmuar të gjitha bizneset që kanë nevojë për ndihmën tonë me kapacitetet tona buxhetore dhe përsëri do të lirohen nga taksat tash dhe janë disa kategori të bizneseve që janë trajtua edhe po ndihmohen përmes thirrjeve publike nga buxheti që e kemi për këtë vite. Për

pyetjen e parashtruar nga Fehmi Hoxha për grantin e performances, ai nuk shfrytëzohet sivjet dhe ai do të shfrytëzohet vitin e ardhshëm dhe është shumë mirë që e ka fitue komuna jon dhe besoj që do të ketë projekte të reja jashtëzakonisht të rëndësishme e të cilat i ka kalue kuvendi i komunës e ka miratua kur e ka e ka miratua buxhetin. U përmend E-kiosku, pasi u ndërtua e-kiosku dhe kanë teprue mjetet dhe vitin e ardhshëm planifikohen e-kioska tjera, pasi ne nuk lejojmë me shkua paret ne suficite prandaj duhet me i rialokue apo ridestinue, pasi ka nevojë edhe për e-kioska tjera si ne Rahovec, Krushe, Xerxe dhe një në Ratkoc ndoshta edhe dikun tjetër dhe janë të planifikuara në kodin për vitin e ardhshëm. Këto mjete ne nuk mundemi të nisemi me 1500 një procedure të re prandaj jemi detyruar me i rialokue apo me i shpërndaje këto mjete. Pastaj investimet ne turizëm dhe shtigje të ecjes, ne kemi kontratë dhe nuk mundemi assesi pa i mbyllë kontratat, pasi kemi kontratë me operatorin që e i ka krye shtigjet e ecjes edhe 1500 euro duhet me ja dhanë që me ja lehtësua barrën ose me mbyllë kontratën. Tek shërbimet e shëndetësisë primare nga fondi rezervë, të transferohen ne ne programin dhe ne kemi një pjesë 41,000 kemi vendosë teknologjike mjekësore dhe mirëmbajtja e tyre ndërsa pjesa tjetër ndërtimi i QMF-së ne Opterushë. Pastaj shtëpia e kulturës ne Ratkoc ka kontratë dhe 110,000 euro është kontrata dhe kur e kemi lidhë kontratën ishin 1000 euro dhe tash duhet me i qitë sepse operatori është duke kryer punë edhe sivjet e përfundon edhe ne natyrisht duhet me i bo pagesat për punët e kryera pra është firma Euroing dhe po ashtu po bëhet edhe biblioteka edhe zyrat e gjendjes civile dhe po ri akomodohen dhe sigurisht do të hiqen nga objekti që është në qendër të fshatit por ne vetëm po zbatojmë kontratën d.m.th. po i japim mjetet për me përmbush kontratën, pasi kontrata ka qenë me e madhe financiarisht kurse buxheti ka qenë shumë e vogël kur u lidh kontrata. Tek shtëpia muze Ukshin Hoti, e kemi pasur ne kodë ne qeverinë Haradinaj, e kemi pasur financimin nga MKRS-ja të projektit të fazës dyte të Shtëpisë muze Ukshin Hoti dhe është hequr ne qeverinë Kurti dhe ne kemi qenë ne pritje që mos po e rikthejnë në rishikim të buxhetit dhe kjo nuk ka ndodhur. Kështu që kemi marr zotime nga Ministra e re e Kulturës se ka me u rikthye projekti. Ne nuk kemi mundur me hap procedurë deri sa ka marr përsipër MKRS-ja pasi veç ka qenë e planifikuar ne kodin, por ne vetëm kemi ndaje që mos rastësisht po na kërkohet participim. Prandaj ne jemi detyruar që sivjet me heq kurse vitin e ardhshëm e vazhdue pasi projekti është i gatshëm edhe mu zhvillue procedura për lidhjen e kontratës për fazën e dyte të shtëpisë muze Ukshin Hoti dhe shpresojmë që MKRS-ja do të përgjigjet rreth kësaj dhe jam i bindur se ata kanë interes sepse këtë e kam bërë temë për heqjen e këtij kodi edhe para ish kryeministrit Kurti dhe ministres që e kemi pasur këtu dhe shpresoj se do të rikthehet kodi për shtëpinë muze kështu që ata para nuk lejojmë me shkue ne suficite por shkojnë në një pozicion tjetër dhe besoj që jemi dakord. Pastaj tek vendosja e tabelave për informim, siç e dini e kam nënshkruar urdhëresën dhe ka filluar procedura për me i vendos këto tabela informuese dhe me siguri këto mjete duhet te rialokohen dhe rishpërndahen që të rivendosen në kodin për hapësira gjelbëruese sepse kemi kontratë dhe ne duhet me i përmbushë obligimet ndaj operatorit. Tek drunjtë dekorativ, siç e dini ne vitin 2017 e kam dhënë një zotim publik për 20,000 drunjtë dekorativ dhe sigurisht se e kam vizionin tim si kryetar komune. Tek dështimet e drunjtëve dekorativ ata do të zëvendësohen dhe nuk ka nevojë komuna me pagua dy herë pasi ka dy vjet garancion dhe krejt ato që janë thae, ata janë të obliguar me i zëvendësua dhe jam i bindur që pranverën e vitit të ardhshëm do të shihni se çka po ndodhë. Pra ne përmbushim kontratën që kemi për mbjelljen e drunjtëve dekorativ por nuk paguajmë dy here për një dru, këtë duhet ta ketë të qartë secili pasi edhe qytetarët duhet ta dinë dhe sigurisht se ka me u vërtetua kjo punë por se paku asamblistët ta kenë të qarte se kush ka punua në administratë e dinë, pasi ai ka obligim me zëvendësua atë dru që thaet. Te parqet po ashtu kemi kontratë, pra kontrata për drunjtë dekorativ dhe parqet e gjelbëruara apo mjediset e gjelbëruara është e përbashkët veçse një kodë është drunjtë dekorativ dhe një kodë për parqe. Pra është një kontratë e ndarë në dy lote, që njëra është për parqe që janë bërë 9 parqe dhe tjetra është për drunjtë dekorativ. Po ashtu është e vërtet që janë të kushtueshëm por jo sa mendon sa janë të kushtueshëm pasi dikun 15 euro është një dru dekorativ mirëpo neper komuna tjetër ndoshta që kushton 50 euro dhe m varet se çfarë drunjtë janë,. Por jam i bindur se puna me drunjtë dekorativ dhe mjediset e gjelbëruara janë në funksion të frymës tonë të qartë që kemi të gjithë për

mbrojte të mjedisit dhe me krijua mjedise sa me shume të gjelbëruara që janë edhe ne të mirën e shëndetit të popullatës por edhe për me i shtue bukuritë e këtij vendi. Tek ndërtimi qendrës rinore, unë pajtohem qe me 5000 euro asgjë nuk mundet me u bo, qe realisht as projektin nuk mundesh me bo. Ne e kemi hapur këtë kodë me mundësi të ndërtimit te një qendre multifunksionale multikulturore për rini për kulture e ku do të akomodohen galeria e arteve biblioteka shkolla e muzikës e plot gjëra tjera. Dhe tash ne jemi duke e hartuar projektin dhe këtë e ka marr përgjegjësin MKRS-ja me financua. Këto 5000 euro ne nuk kemi mundur me i shfrytëzua edhe pse vitin e kaluar i kemi pasur këtë shume deri sa e kemi pritur një momentum të përshtatshëm dhe po shpresojmë se po krijohet mementumi i përshtatshëm për me u ndërtua një qendër ku do të akomodohen kërkesat dhe nevojat e shume grupeve të interesit dhe shoqërore që ka komuna jonë, pasi i mungon komunës tonë një objekt multifunksional. Pasi ajo shtëpia e kulturës që e kemi tani, ne momentin që ndërtohet këtu ndoshta duhet me mendua për me rrënuar krejt atë atje si objekt me rrënuar por jo sallën. Pra nëse e merr përsipër Ministria e Kulturës rinise dhe sporteve siç jemi d akorduar atëherë ne do të jemi komod dhe do të kemi mundësi që vërtet me pas një objekt edhe te bukur edhe multi funksional edhe që i përmbush kërkesat e shume grupeve të interesit në komunën e Rahovecit. Te ndërtimi i terreneve dhe rregullimi i qendrës kulturore ne Rahovec i kemi qitë edhe terrenet sportive pasi kemi kontratë dhe duhet me përmbushë dhe këto 5000 euro rialokohen te rregullimi i terreneve sportive. Po ashtu kemi edhe një shqetësim që e ka ngritur Rasim Fazliu për shoqërinë kulturore artistikë Bajram Curri, ne e kemi rrënuar atë objekt dhe po ashtu është e vërtet se janë keq dhe apo ashtu është e vërtet që ne do të kujdesemi që në këtë ridestitim ne do të kujdesemi dhe nuk guxojmë me hap kodë të ri por ne do të kujdesemi që të sigurojmë një mjedise me te përshtatshëm me mjedise tjera të përshtatshme për nevojat e ansamblit Bajram Curri që është me traditë mbi 45 vjeçare. Pra ne i kemi ndihmuar shoqërisë kulturore artistike dhe të gjitha grupeve kulturore artistike i kemi ndihmuar me subvencione dhe tash për mjedisin se ku me i zhvillua veprimtarinë për ushtrime atëherë ne duhet me u kujdes vitin e ardhshëm me bo diçka pasi sivjet nuk kemi. Nese mendon dikush se kemi mbet borgj, mendoj që edhe Fehmi Cenes nuk i kam mbet borgj. Po ashtu te restaurimi është mirë me ditë kuvendi i komunës se Rahovecit që kur është bërë shpronësimi i asaj sipërfaqe 1 ari e disa metra katror, ky shpronësim është bërë nga departamenti për shpronësim me vlerë 3935 euro dhe nuk është pajtuar pronari pra kryefamiljari dhe na ka bllokue. Ne jemi ne situatë që nuk dëshirojmë me heqë dorë për shkak se per pronarin ky është nënçmim total mirëpo tash sikur të ishte e imja e kisha lëshua pa asnjë çmim mirëpo duhet me kuptua se ai e ka të drejtën e vet dhe ai s'po pajtohet me shumen që e ka caktuar departamenti dhe ne kemi bërë përpjekje që te gjejmë një zgjidhje po ashtu jemi munduar që të gjejmë një zgjidhje të duhur që me pas mundësi me i ndihmua diçka tjetër pasi nuk kemi mundësi me kthye atë vendim që kanë marrë departamenti në kuadër të Ministrisë se Ekonomisë dhe ambientit pasi janë komision i certifikuar dhe janë ata që bëjnë vlerësimin e pronave dhe jo na. Tash ne duhet me rialokue këtë buxhete që mos me na shkua granti në suficite njëkohësisht ju e dini që e keni miratua përsëri nuk hequr dorë që edhe vitin e ardhshëm me bo një zgjidhje, pasi aty 64 persona janë masakrua dhe tash ne jemi të detyruar me i rialokue mjetet me i rishpërndaje që mos me na ikë dhe përsëri e keni restaurimin e shtëpisë se masakrës në Krushe të Madhe pasi ne nuk dëshirojmë me heqë dorë si komunë dhe ne besojmë se do të mbërrihet një zgjidhje pasi deri tash nuk kemi pasur zgjidhje edhe kjo ka ndodhë edhe këtë e dini edhe ju të gjithë e posaçërisht asamblastët me përvojë edhe këta që vinë nga Krusha e dinë pasi kemi një mospajtim total të pronarit pasi ndoshta ai ka menduar se do llogarisin shpronësimin me një çmim shume te madhe dhe ata nuk ja kanë vlerësua dhe unë nuk kam asnjë mundësi tjetër që me bo diçka ne këtë drejtim. U përmend edhe me herët mos planifikimi i mirë, pasi 2 apo 3 kode po i ridestinojmë por tepricat kanë teprua prej kontratave dhe nuk kemi çfar të bëjmë por vetëm shtëpia muze e Ukshin Hotit që ju dhashë sqarimin, shtëpia e masakrës, qendra multifunksionale multikulturore, të gjitha të tjerat janë në kuadër të tepricave që duhet me i rishprendae me aprovimin e anëtareve të kuvendit që mos të shkojnë ne suficite. Pra kjo është kërkesa e imja dhe unë kërkoj me votue ridestitimimin sepse është mundësi e mirë për me i operacionalizue edhe këto mjete që nuk janë edhe shume ,pra behet fjalë per mbi 170,000 euro

dhe unë ju kërkoj votën e të gjithë asamblistëve pasi është mirë me shfrytëzua momentumin e përshtatshëm si asamble që mos me ju dhanë mundësi me na ikë këto mjete që i kemi, pasi janë mjete të komunës se Rahovecit dhe i takojnë komunës se Rahovecit që me i shpenzua.

Afrim Limani – Edhe une deshta me dhanë një informatë në lidhje me pyetjet që u ngritën nga asamblistët. Konsideroj që planifikimi nuk është i dobët në këtë rast sepse ne përqindje të buxhetit ky ridestininim i cili kërkohet ne bazë të ligjit nuk e kap as 3%. Pra vetëm 70,000 euro nga granti i kemi pjesë të tepricave, d.m.th. e kemi E-kioskun 1500 euro dhe 61,000 euro i kemi nga pagat rezervë në shëndetësi që patjetër kete duhet me ridestinue. Për projekte tjera më se miri e dha arsyetimin kryetari dhe ky ridestininim po bëhet si rezultat i faktorëve të jashtëm që ne nuk kemi pasur qasje të drejtpërdrejt si p.sh. ndërtimi i shtëpisë muze Ukshin Hoti nga faktorët e jashtëm pasi konsideroj që Ministria e Kulturës mendoj se ajo ka pasur me udhëheq procedurat e tenderimit edhe buxhetin. Po ashtu ne kemi pasur ne kemi pasur një marrëveshje dhe aty e kanë hequr nga linjat buxhetore buxhetin edhe ne gjithsesi duhet me i ridestinue këto mjete të cilat ne i kemi planifikuar. Pastaj informatë tjetër me rëndësi, sipas ligjit të financave publike dhe përgjegjësi, buxheti nga një program në programin tjetër të kryhet në shumën 100% por nëse dëshirojmë prej një programi me i ridestinue mjetet me një program tjetër atëherë e drejta jonë është 15% d.m.th. ky është një akt që ndoshta na ka kushtëzuar neve që kërkojmë mjetet të i bartim në kuadër të drejtorive, se ndoshta me e arsyeshme dhe nevojshme ka qenë po supozojë prej ekonomisë me i qitë në shërbime publike mirëpo ligji në këtë rast 15% nuk e ka lejua dhe jemi detyruar që me shfrytëzua hapësirën 100% edhe ato mjete nga programi në programin konkret. Dhe shuma totale e ridestinitimit në buxhet është as 3%.

Fehmi Hoxha – E –kiosku është vendosur vitin e kaluar 2019 kurse për vitin 2020 ka qenë e planifikimi dhe unë kam pritur që të bëhet edhe një e-kioskë ndoshta jo këtë por ne Krushe Xerxe apo ne Ratkoc, pasi është e nevojshme dhe kështu e kam kuptuar dhe mendoj se është edhe kështu. Rek sqarimet që i dhatë me herët kërkojmë ne rregull është pasi thuani se qenka kontrata për drunjtë dekorativ, po ashtu është kontrata edhe për shtëpinë e kulturës në Ratkoc 110,000 por ndoshta do të ishte mirë me na u sqarue edhe me herët pasi shohim se për çdo vite shtohet shuma aty dhe jemi të interesuar me dit se ku po shkojnë dhe pse po shkojnë dhe shpeshojmë që të kryhet me qito 110,000 euro dhe të mos kemi shpenzime për të njëjtin objekt. Tek restaurimi i objektit përkujtimor në Krushe të Madhe të 64 masakruarve, mendoj që është ne rregull siç e thatë edhe ju që ky projekt mos të bie poshtë sepse është edhe vendim i kuvendit komunal dhe te gjithë jemi pajtuar edhe personalisht mendoj që është pozitive ta kemi ne atë por ju duhet të punoni që ajo pengesë që qenka me u tejkalua, pasi nëse është në pyetje parja që nuk është e madhe atëherë ne si kuvend komunal mundemi me aprovua sepse edhe ashtu po e shoh se gjithsej janë ndarë 55,000 euro dhe nëse ka nevojë me u ndaje dhe për diçka tjetër të restaurohet sepse gjurmët e një objekti të tillë çfarë ne e kërkojmë me pas rolin, ato po zhduken dhe nesër apo pasnesër pastaj nuk e ka rolin e njëjti objekti që mendohet të shërbej aty si muze sikurse sot me ndërtua apo pas ndonjë viti.

Kryetari - unë nuk dua të i mbes borgj askujt e as Fehmi Cenës, ndoshta ne kuvend mund të vimë me ndonjë propozim të ri, unë veç ju tregova se shtëpia e masakrës aq është vlerësuar mirëpo pronari nuk po pajtohet me shumën e shpronësimit dhe nuk kam të drejtë me komentua. Ndoshta do të vinë në kuvend të komunës se çka mundem me bo që me mbërri prandaj nuk kemi hequr dore edhe për vitin 2021 prapë është kodi dhe prapë janë mjetet. Tek E-kiosku ka kontrata që lidhen me 1000 euro kurse e-kiosku ndoshta kushton 12,000 euro dhe ne kur kemi bërë e-kioskën e kemi bërë ne fund të vitit por pare ska marr dhe vetëm e ka vendos e-kioskun dhe pastaj i ka marr paret pasi kanë qenë të planifikuara për këtë vit dhe tash kanë teprua këto në kuadër të këtij planifikimi. Unë ju ftoj edhe një here për votim. Faleminderit shumë

Rasim Fazliu – Mendoj që ne i dhamë diskutimet tona rreth ridestinitimit të mjeteve dhe kryetari na dha sqarimet. Unë po flas ne emër të grupit të PDK-së nuk jemi për me shkua mjetet ne suficite por jemi për me bo ridestininimin e mjeteve dhe vazhdojmë tutje. Pra grupi i PDK-se e mbështet ridestininimin e mjeteve. Faleminderit

Munib Durguti – N fillim të diskutimit e hapa diskutimin me një vërejtje për një kërkesë për plotësimin e vendimit edhe nuk mora përgjigje, pasi mendoj se kjo ishte me tepër për zyrën ligjore.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Durguti, e qesim në votim pikën e katërt të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e peste të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Celinë, P-71513083-00231-0.

Kryesuesi – Të nderuar kuvendar kam një propozim për ju nëse jeni të pajtimit, pikat 5,6,7,8,9, e kanë të njëjtin çelëm, vetëm se dallojnë parcelat dhe lokacioni. Prandaj pas prezantimit të këtyre pikave nga drejtori Oruqi kisha kërkuar nga ju që ti votojmë të gjitha në bllok.

Afrim Oruqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar para jush keni propozim vendimin për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore. Këtu kemi të bëjmë me një parcela të cilat janë në zonën kadastrale në Celinë, Nagavc dhe tre parcela janë në Krushe të Madhe, këto parcela në Krushe të Madhe janë në kufi njëra me tjetrën. Qëllimi i këtyre vendimeve është që të caktohet lokacioni për trajtim dhe deponimin e mbeturinave inerte, ftojë kuvendarët që ti përkrahin këto pesë propozim vendime.

Rasim Fazliu – Pajtohem plotësisht me këto propozime që të caktohet lokacioni për trajtimin e mbeturinave inerte, ne jemi të pajtimit dhe do ti përkrahim, me anë të kësaj do të mbrohet edhe mjedisi i komunës së Rahovecit. Por ajo që desha të potencoj është se kam një propozim sa i përket vendimit për fshatin Celinë, kishte me qenë mirë që të ceket se në lokacionin e cekur për fshatin Celinë, të drejtë për hedhje të mbeturinave inerte kanë vetëm banorët e fshatit Celinë. Arsyeja pse e them këtë janë të shumta, njëra nga to është se rrugët e fshatit i kemi shumë të ngushta dhe nëse vinë edhe i hedhin mbeturinat edhe nga fshatrat për rreth do të na shkaktojnë probleme të shumta në fshat, jam i mendimit që ky propozim të jetë edhe për pikat e tjera.

Fehmi Hoxha – Të gjitha këto propozime janë të arsyeshme, por pyetje ime për drejtorin është: a keni bërë ndonjë studim fizibiliteti sa i përket caktimit të këtyre lokacioneve, pastaj pyetje e dytë është: a keni mbajtur ndonjë debat publik së paku me atë lokalitet ku do të jenë këto deponi. Përndryshe jemi pro këtyre propozimeve, por procedurat duhet të kryhen paraprakisht.

Fehmi Cena – Shumë mirë që drejtorja ka marrë iniciativë për caktimin e lokacionit për deponi inerte sepse me të vërtet kanë nevojë banorët e këtyre zonave, pastaj me këtë veprim do të mbrohet edhe ambienti dhe nuk do të hedhen mbeturinat vend e pa vend. Ne si kuvendar kemi kërkuar në të kaluarën që të ketë më shumë lokacione të këtilla, sepse deri më tani ka qenë vetëm një në qytet, sa i përket propozimit të kolegut z. Fazliu, mendoj se rreth kësaj duhet të mendohet pak më mirë, mendoj se nëse një lokacion është shumë afër vendbanimit, kjo që r ka propozuar z. Fazliu ka arsyeshmëri, por nëse është në periferi të vendbanimit atëherë mendoj se do të ishte mirë që edhe banorët e fshatrave për rreth ti i hedhin mbeturinat inerte sepse tani për tani ato nuk kanë ku ti hedhin. Poashtu mendoj se duhet të ceket se këto lokacione duhet të kenë edhe mbikëqyrje, pra të jenë nën kontroll.

Ali Morina - Së pari e kisha falënderuar drejtorin për këtë iniciativë, poashtu e inkurajoj që ti gjejë lokacionet nëse është e mundur për secilin vendbanim, menaxhimi i mbeturinave inerte ka qenë dhe do të mbetet sfida për komunën e Rahovecit edhe pse komuna ka bërë mjaftë në këtë drejtim. Ne si grupe i AAK-së i japim mbështetje të plotë këtyre propozimeve.

Kryesuesi – Ju falënderoj për diskutimin e zhvilluar të nderuar kuvendar, fjalën ja japë z. Oruqi nëse ka ndonjë sqarim për të ju dhënë.

Afrim Oruqi – Sa i përket pyetjes së kuvendarit z. Fazliu, i nderuar kjo që e keni propozuar ju është e pamundur sepse ne kemi dalë në teren dhe i kemi kontrolluar shumicën e zonave dhe ka fshatra që nuk kanë lokacion të përshtatshëm për hedhjen e mbeturinave inerte, prandaj kemi menduar që në ato vende ku është prona e shtetit dhe ka fshatra tjera afër të shpallen zona për deponi legele. Mendoj se nuk kishte me qenë mirë

që të specifikohet se kanë të drejtë vetëm banorët e një fshati sepse do të na nxjerrin obligime të tjera ligjore. Kurse sa i përket pyetjes së kuvendarit z. Hoxha, ne para se me vendos një lokacion një herë jemi takuar me kryetarët dhe këshillat e fshatrave, shkak i pandemisë kemi menduar se nuk është e arsyeshme që të bëjmë më shumë takime. Po ashtu ne një herë i kemi studiuar lokacionet pastaj janë caktuar si lokacione të mundshme, në këto zona aktualisht hedhen mbeturinat dhe mendojmë se janë zonat e përshtatshme dhe janë prona shtetërore të Kosovës. Kurse sa i përket pyetjes së kuvendarit z. Cena, ne jemi në teren dhe jemi duke u munduar që ti afrohem çdo lokaliteti, por siç e ceka jo në çdo fshat ka prona shtetërore të Kosovës dhe që janë të përshtatshme për hedhjen e mbeturinave.

Rasim Fazliu – Jam i vetëdijshëm që prona shtetërore është pronë shtetërore dhe kur të merret vendimi atëherë është normale që kanë të drejtë të gjithë të i hedhin mbeturinat, por unë e ceka në mënyrë të veçantë fshatin Celinë sepse ne si fshat nuk kemi rrugë tjetër për të shkuar tek ky lokacion i cekur por është vetëm një rrugë. Kurse lokacionet si në Krushe të Madhe dhe në disa vendbanime tjera, këto lokacione janë shumë larg fshatit dhe nuk paraqesin kurrfarë problemi, kurse ne Celinë po ju bëj me dije largësia në mes shtëpive të banueshme dhe lokacionit të cekur nuk ka më shumë se 300 m largësi, prandaj mendoj se kishte me qenë mirë që në këtë vendim të ceket ajo që e propozova më parë.

Kryesuesi – Edhe unë jam i pajtimt që në ato vende ku ka mundësi të ceken lokacione për hedhje të mbeturinave inerte të bëhet, kurse aty ku nuk kemi mundësi duhet të gjendet një zgjidhje. Të nderuar do i qesim në votim një nga një, pra për secilën pikë do të votojmë. Tani e qes në votim pikën e 5 të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Celinë, P-71513083-00231-0.

Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Nagavc, P-71510055-00809-0;

Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Krushë të Madhe, P-71513005-00258-0;

Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Krushë të Madhe, P-71513005-00257-0;

Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte në Krushë të Madhe, P-71513005-00256-0;

Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

me propozimin e z. Rasim Fazliu: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar. Të nderuar kalojmë në pikën e radhës:

10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për shpallje me interes të përgjithshëm P – 71510057-01817-0 – Rahovec.

Afrim Oruqi – Të nderuar kuvendar para jush e keni propozim vendimin për shpallje me interes publik P-71510057-01817-0, kemi të bëjmë me 6 ari e 91 m², zona kadastrale Rahovec, pronë shtetërore e republikës së Kosovës dhe shfrytëzues i sajë është Kosova Petroli. Qëllimi i shpalljes është ruajtja dhe rritja e vlerës së

pronës shtetërore dhe do të përdoret sipas nevojës për interes të përgjithshëm, ftojë anëtarët e kuvendit që të votojnë këtë vendim për shpallje me interes të përgjithshëm.

Fehmi Hoxha – Si duket jeni duke u ngutur me këto shpallje me interes të përgjithshëm, kuvendarët që janë që disa mandate ndoshta ju kujtohet, që kemi pas këtë të drejtë para formimit të AKP-së, Malisheva e ki shpallur shumë prona në interes të përgjithshëm dhe nuk kanë mundur pastaj të privatizohen. Por tani kjo parcelë është nën menaxhimin e AKP-së edhe pse nuk e di tani se cili është qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm të kësaj parcele, kishte me qenë mirë të na jepni një shpjegim pak më në detaje të na jepet një ide se cili është qëllimi i shpalljes së kësaj parcele, arsyeja pse e them këtë është që mos të humbim kohë dhe mos të biem ndeshë me ligjin. Në legjislaturat e kaluara ne kemi marrë vendim ku i kemi shpallë me interes të përgjithshëm të gjitha pronat e pa shitura që gjenden në territorin e komunës së Rahovecit të ish NBI-së diku rreth 564 hektarë. Dhe besoni edhe pse pa fajë kryetari i komunës për këtë është përballur me ligjin, unë për vete jam por që çdo pëllëmbë e tokës të ruhet, por jo të shkelen ligjet në fuqi.

Munib Durguti – Ajo që mua më intereson është, a ka ndonjë pretendues rreth kësaj prone nga personat fizik, mos ndoshta kjo pronë është edhe nëpër gjykata sepse ka shumë nga ata që pas privatizimit kanë kërkuar të drejtën e tyre për kthimin e pronës, pra mos është në kontest kjo pronë.

Afrim Oruqi – Sa i përket pyetjes së kuvendarit z. Fehmi Hoxha se mos jemi duke u ngutur me këto vendime dhe mos jemi duke ra ndeshë me ligjin, ne një herë jemi konsultuar me zyrën ligjore, poashtu jemi në koordinim të plotë me AKP-në. Sa i përket qëllimit të shpalljes së kësaj parcele me interes të përgjithshëm ne jemi tani në fazën e fundit të projektimit të sheshit qendror të qytetit të Rahovecit. Në këtë fazë që jemi ne tani ku kërkojmë nga ju që kjo të shpallet me interes të përgjithshëm, pastaj pas kësaj mbledhje do të kërkojmë nga ju që të na jepni pëlqimin për blerje të kësaj prone. Ne jemi duke vepruar sipas ligjeve në fuqi që të mundemi me e ble këtë parcelë nga AKP-ja, një herë kjo pronë do të vlerësohet, pastaj ne si komunë jemi të obliguar vetëm 20% të shumës bazë të paguajmë AKP-së. Kjo pronë është dhënë me qira nga AKP-ja deri në momentin kur shpallet interes i përgjithshëm dhe atëherë kontrata ndërpritet njëanshëm. Kurse sa i përket pyetjes së z. Munib Durguti se a ka ndonjë pretendim, i nderuar ka mundësi që të ketë sepse shumica e këtyre pronave në fillim kanë qenë edhe prona private, ku disa janë kompensuar dhe disa jo. Por edhe nëse ka pretendime dhe janë në gjykatë, por nuk ka aktgjykim neve si komunë nuk na ndalon që këtë pjesë ta përfshimë në projektin e sheshit qendror të qytetit.

Fehmi Hoxha – Sqarimi ishte shumë në rregull edhe pse ma kishte marrë mendja që mundet të jetë pjesë e sheshit, por vitin e kaluar i kam propozuar kryetarit që të negocioj me AKP-në për ndërtesën e ish Podrimës, që sot është kafe bar Hardhia. Po ashtu edhe ka fundi i mandatit të PDK-së kemi biseduar dhe na është dhënë mundësia që rreth 30,000.00 € të i japim që të blejmë ne ndërtesën, por kaloj mandati, pastaj këtë ide ja kam propozuar kryetarit Latifi, por ai unë deri sa jam kryetar asnjë herë nuk blejë tokë nga komuna pasi ajo është toka e komunës, tash lindë pyetja çka u bo me atë premtim. Por nëse keni biseduar me AKP-në atëherë ne ju mbështesim, por nuk jemi që të shkelet ligji.

Kryesuesi – E qes në votim Propozim vendimin e kryetarit të komunës, për shpallje me interes të përgjithshëm P – 71510057-01817-0 – Rahovec: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dhjetë (10) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për shpallje me interes të përgjithshëm P- 71510037-01015-96, Xërxë.

Afrim Oruqi - Të nderuar kuvendar para jush e keni propozim vendimin për shpallje me interes publik P- 71510037-01015-9, me zonë kadastrale Xërxë, këtu bëhet fjalë për 87 m² nga sipërfaqja e përgjithshme e kësaj parcele e cila komplet është 9 ari 93m². Qëllimi shpalljes së kësaj parcelë është hapja e rrugës publike me interes të përgjithshëm, kjo parcelë është rrugës Rahovec – Prizren, në mandatin e kaluar ko rrugë është hapur dhe është e kalueshme, por arkitektët e kanë menduar për shkak të kthesës kjo rrugë është dashur edhe pak prehet edhe pjesa private. Ne në anën e majtë të kësaj parcele para disa seance e kemi rregulluar, kurse

tani pronari me të drejtë kërkon kompensim sepse rruga e ka prekur sipërfaqen nga 87 m², prandaj kërkon nga ne që të marrim vendim një herë që ta shpallim interes të përgjithshëm, pastaj të këmbejmë me pronën private me një sipërfaqe të njëjtë 1 me 1, kjo bëhet gjithmonë përmes një komisioni i cili e bënë vlerësimin e pronave. Nëse kjo nuk bëhet atëherë qytetarët kanë të drejtë që të dërgojnë lëndën në instancat e tjera gjyqësore, ne nuk jemi të pajtimit që kjo të shkojë nëpër gjykata sepse atëherë duhet të paguajmë edhe shpenzimet e tjera. Ju ftoj që pas shqyrtimit të votoni këtë propozim vendim.

Kryesuesi – E qes në votim Propozim vendimin e kryetarit të komunës, për shpallje me interes të përgjithshëm P- 71510037-01015-96, Xërxë: Konstatohet se me 1 abstenim është aprovuar pika e njëmbëdhjetë (11). Kalojmë në pikën e radhës:

12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik – Rahovec.

Artan Asllani – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, para jush e keni propozim vendimin për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale personave fizik dhe juridik dhe dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite. Prona kadastrale e cekur në pikën 1 të këtij propozimi gjendet zonën kadastrale Rahovec në qytet, e evidentuar P.SH. E Kosovës KK Rahovec, me numër të certifikatës së pronësisë P-71510057-01356-1, janë në Rr. “Xhevat Kasapi” p.n. në Palestrën Sportive Mizahir Isma në Rahovec. Gjithsej në këtë propozim janë 10 lokale dhe në propozim vendim e keni të cekur edhe hapësirat për çdo lokal me m². Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës – Lokaleve Afariste, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës – Lokaleve afariste në shfrytëzim është afatshkurtër në periudhën prej 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit, Çmimi fillestar i pronës komunale është i caktuar sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik. Të nderuar kuvendar ju ftoj që ta votoni këtë pikë të rendit të ditës.

Fehmi Hoxha – Është mirë që na ka ardhur kjo pikë sepse unë para dy mbledhjeve kam kërkuar që këto lokale të jepen në shfrytëzim sepse me dhënien në shfrytëzim hapim edhe vende të reja të punës dhe kjo është shumë pozitive. Falënderoj edhe një herë drejtorin për këtë pikë, por tani ka mbetur se për sa vite do i japim ne, ne para një mbledhje kemi marr një venim që disa lokale që janë pronë e shtetit i kemi dhënë për 10 vite. Por tani nuk e di se a kishte me qenë në rregull që në fillim të i japim për 10 vite, prandaj propozimi imë është që të jepen për 5 vite, por nuk e kundërshtoj edhe nëse dikush propozon edhe për 10 ose 15 vite.

Kryesuesi - E qes në votim Propozim vendimin e kryetarit të komunës, për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik – Rahovec për 5 (pesë) vite: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 12 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të kryetarit të komunës, për lirim nga qiraja të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme komunale.

Artan Asllani – Edhe një herë përhëndetje për të gjithë të pranishmit, para jush e keni edhe një propozim vendim për lirim nga qiraja të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të Komunës (objekteve komunale dhe lokaleve afariste) për periudhën 01.10.2020 deri më 31.12.2020 në komunën e Rahovecit. Lirimi nga qiraja mujore sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të komunës të cilët kanë kontrata për shfrytëzimin e objekteve komunale dhe lokaleve afariste që janë pronë e Komunës së Rahovecit. Obligohet shfrytëzuesit e objekteve komunale dhe lokaleve afariste të Komunës së

Rahovecit që obligimet e mbetura deri më 30.09.2020 ti kryejnë më së largu deri me datë 01.12.2020. të nderuar kuvendar ne shumë herë kemi diskutuar se si të i përkrahim bizneset në kohën e pandemisë Covid - 19, në këtë vite ne nuk kemi pasur mundësi të mëdha që ti dalim në ndihmë bizneseve, për arsye se një vite para bëhet edhe planifikimi i buxhetit. Në këtë vite edhe më parë kemi marrë vendime për lirim nga qiraja dhe lirim nga taksa për 3 muaj, prandaj ju ftoj edhe një herë që ta përkrahni edhe këtë pik të rendit të ditës.

Fehmi Hoxha – I nderuari drejtor nuk keni marrë ju vendim për lirim nga taksa por ka marrë vendim kuvendi komunale, po ashtu ju nuk e keni propozuar këtë propozim për tu liruar nga qiraja poashtu që të subvencionohen nga 200 € bizneset e vogla, por e kam propozuar unë në emër të grupit të PDK-së. Më vije mirë që jeni duke vazhduar traditën e propozimit tonë, por përsëri kam një propozim, propozimi imë është që të lirohen për 6 muaj e jo për 3 muaj, sepse pritet një dimër goxha i fortë, pastaj siç e dini pandemia është duke shkuar vetëm në rritje.

Kryesuesi – Faleminderit z. Hoxha për propozimin e dhënë, por edhe unë jam pro asaj që të jetë për 3 muaj dhe nëse është nevoja ne mundemi përsëri të marrim vendim për të vazhduar edhe për tre muaj të tjerë. Por shpresojmë se do të kalojmë këtë krizë globale që e ka përfshirë të gjithë botën.

Artan Asllani – I nderuari z. Hoxha nëse unë kam pasur ndonjë bashkëpunim me kuvendarët e komunës së Rahovecit ai je ti, këtë po e them publikisht, ne si qeverisje komunale nuk e kemi ditur se sa do të zgjasë pandemia në mënyrë që të marrim në fillim ndonjë veprim për ti ndihmuar bizneset. Por po të them sinqerisht që para se të propozosh ti në kuvend propozimin për lirim nga taksa, këtë propozimë kam pasur edhe unë dhe kam qenë shumë i pajtimt kur e keni propozuar ju, prandaj po e them se vendimet nuk i marrim ne i merrni ju por propozimet kanë qenë të përbashkëta dhe është mirë kur kemi këso bashkëpunime.

Fehmi Hoxha – I nderuari drejtor a e dini pse propozova që të jetë për 6 muaj, sepse me të vërtetë bizneset e vogla janë në një gjendje shumë të vështirë, e kuptoj që nuk kemi pasur mundësi që ti ndihmojmë me nga 200.00 € sepse nuk kemi pasur buxhet. prandaj jam duke propozuar që të shkojmë me 6 muaj pasi nuk kemi pasur mundësi që ti dalim në ndihmë me shumën prej 200.00 €.

Fehmi Cena – Ne këtë pikë e kemi shqyrtuar edhe në KPF, ku kemi kërkuar që të bëhen disa plotësime nga ana e drejtorit, ku kemi kërkuar se sa është numri i lokaleve dhe sa është shuma e përgjithshme që në këtë rast do të falen nga ana e komunës. Ne jemi pro këtij propozimi të propozuar nga ana e drejtorisë, por nëse shikojmë propozimin e z. Hoxha që të shkojmë për 6 muaj, nëse shikojmë se a kanë nevojë këto biznese mendojmë se po për arsye të situatës që jemi nga pandemia. Ajo që më intereson mua është se në këtë propozim do të lirohen të gjithë ata që i kanë objektet komunale me qira, por si qëndron puna për ata që e kanë token e komunës në shfrytëzim, a është menduar diçka edhe për ta dhe pse nuk janë futur edhe ata në këtë propozim.

Sali Sallteku – Përshëndetje edhe një herë, sa i përket pyetjes që e bërë z. Hoxha besoj se me këtë propozim janë të përfshirë të gjithë, kurse sa i përket propozimit të z. Fehmi Hoxha jam pro këtij propozimi që të shkojmë me 6 muaj sepse edhe ashtu bizneset kanë humbur shumë në këtë kohë pandemie, prandaj kishte me qenë mirë që të hedhësh në votim këtë propozim.

Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve, e di që kanë nevojë bizneset të ndihmohen në këtë kohë, por mendoj se mjaftueshëm është që një herë të shkojmë me 3 muaj, duke shpresuar se do të dalim nga kjo situatë sepse nuk janë vetëm bizneset në bllokadë totale, prandaj kishte me qenë mirë që të shkohet një herë për tre muaj dhe nëse na paraqitet nevoja pastaj do të marrim përsëri ndonjë vendim për dalje në ndihmë. Sa i përket propozimit të z. Hoxha nuk është problem unë e qesë në votim, por ndoshta z. Hoxha do të shqyrtoj edhe një herë propozimin e tij.

Artan Asllani – Të nderuar të gjithë jemi të pajtimt që të bëhet për 6 muaj falje, për vete edhe më shumë se 6 muaj i kisha liruar bizneset, ne nëse vazhdon kështu pandemi gjithsesi në fillim të vitit të ardhshëm duhet të marrim edhe ndonjë vendim për lirim, ne në këtë mbledhje do të marrim vendim për dalje në ankand publik lokalet e palestrës. Prandaj kemi propozuar që të shkohet me 3 muaj se nëse vazhdon kështu situata ne në

fillim të vitit duhet të marrim vendim për falje për komplet një vite, prandaj le të mbyllet ky vit fiskal me këto 3 muaj e pastaj do shohim se çka do të ndodhë.

Fehmi Hoxha – faleminderit drejtor për këtë arsyetim, por edhe unë tani isha duke shikuar se jemi në fazën e shpalljes së lokaleve tek palestra, nëse i japim për 6 muaj si propozova unë atëherë i bie që ata në start 3 muajt e para nuk kanë me do të paguajnë, prandaj unë e tërheqë propozimin tim.

Kryesuesi – E qes në votim i Propozim vendimin e kryetarit të komunës, për lirim nga qiraja të gjithë shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme komunale për 3 muaj: Konstatohet se në mënyrë unanime është votuar pika e 13 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

14. Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021.

Kryesuesi - Të nderuar koleg për momentin drejtorin e DKA-së nuk e kemi prezent këtu për arsye të vizitës së zëvendës kryeministrit të Republikës së Kosovës, por ne e kemi para vete materialin që na ka dërguar drejtori dhe nëse dikush ka diçka për të shtuar fjala është e juaja. Atëherë kalojmë në pikat shtesë. Siç ju thash më parë neve na është kthyer nga MAPL-ja që duhet ta shfuqizojmë Rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021, ku na është sugjeruar që të marrim vetëm vendimin për caktimin e normave tatimore për vitin 2021. Pra një herë e qesim në votim shfuqizimin e kësaj rregullore, pastaj e qes në votim vendimin.

15. Marrja e vendimit për shfuqizim të Rregullores për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2020:

Kryesuesi - E qes në votim shfuqizimin e kësaj rregullore: Konstatohet se në mënyrë unanime është votuar pika e 15. Kalojmë në pikën e radhës:

16. Shqyrtimi i Propozim vendimit për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021.

Kryesuesi - E qes në votim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 16. Kalojmë në pikën e radhës:

17. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 1988 i datës 28.06.2018 për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.

Kryesuesi - Siç ju njoftova edhe në fillim të mbledhjes komisioni e ka mbajtur një takim ku kanë bërë verifikimin e dokumentacioneve që kanë ardhur sipas konkursit publik, komisioni ka sjellë një emër për tu votuar në kuvend, për këtë ftoj kryetarin e komisionit z. Fehmi Hoxha.

Fehmi Hoxha – Të nderuar kuvendar pas shpalljes së konkursit për aplikim të kandidatëve për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, dhe pas kalimit të afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, komisioni Ad-Hoc komunal për zgjedhjen dhe zëvendësimin e anëtarit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, i emëruar me Vendim të Kuvendit të Komunës së Rahovecit Nr. 109/20, në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, dhe atë: Fehmi Hoxha (Kryesues), Bajram Morina, Ivan Shaveliq, Ivica Miciq, Marko Stashiq i cili ka munguar, është takuar me datë 26.10.2020 (të hënën) në zyrë të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit me qëllim të shqyrtimit të aplikacioneve të kandidatëve. Gjatë takimit është shqyrtuar kërkesa e vetme e kandidatit të paraqitur, dhe i cili i plotëson të gjitha kushtet, prandaj Kuvendit të Komunës së Rahovecit i propozon z. Kreshnik Haxhijaha, për emërimin e anëtarit të ri të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe. Të nderuar kuvendar kërkoj nga ju që ta përkrahni propozimin e këtij komisioni.

Kryesuesi – Ju faleminderit z. Hoxha për punën e bërë si komision, a ka dikush të shtoj diçka, nëse jo atëherë e qen në votim Propozim vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 1988 i datës 28.06.2018 për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe.: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 17. Kalojmë në pikën e radhës:

18. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në fshatin Gexhë.

Afrim Oruqi – Të nderuar kuvendar para juve keni propozimin e kryetarit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të parcelës me Nr. 00397, pronë shtetërore e Republikës së Kosovës. KK – Rahovec, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 20348 m². Kërkesa e banorëve është që të jepet në shfrytëzim afatgjatë deri 99 viteve, vetëm pjesa e parcelës prej 4 ari nga parcela e përgjithshme. Qëllimi i dhënies së kësaj parcele është dhënia në shfrytëzim për qëllime të fshatit Gexhe, pra që të ruhet dhe të rritet vlera e pronës publike dhe të shfrytëzohet nga komuniteti për zhvillimet e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e fshatit. Ftojë kuvendarët që ta votojnë propozimin e kryetarit.

Sali Sallteku – Jam në dijeni se edhe banorët e fshatit Gexhë janë duke ndërtuar një objekt për nevojat e fshatit, njëjtë sikurse në banorët e fshatit Radostë, është mirë që ti përkrahim pasi edhe nuk është parcela e madhe, prandaj jam pro këtij propozimi.

Masar Popaj – Mendoj se është bërë një gabim teknik sepse tek parcela është shkruar gabim sepse është cekur me nr. 2.03.48 m², kurse duhet të jetë 20348 m², poashtu edhe me fjalë duhet të përmirësohet sepse është shkruar gabim, besoj se këtë do të përmirësoni.

Kryesuesi – E qes në votim Propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë në fshatin Gexhë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 18.

Të nderuar kuvendar ju faleminderit për kontributin e dhënë në këtë mbledhje, mirë u takofshim në mbledhjet e radhës.

01 Nr. ____/2020
Rahovec, 30.11.2020

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

KRYESUESI

Afrim Dina



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

01 Nr. 11/20
Rahovec, 20.11.2020

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më
30 nëntor 2020 (e hënë) me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Koncept Planit për Deponinë e Mbeturinave të Ngurta;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Koncept Planit për Deponinë e Mbeturinave të Vëllimshme;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave juridik P- 02279-0, 02280-0, 02281-0;
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për Përkujdesje dhe Mbrojtje të Fëmijëve dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik;
8. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për shfuqizimin e Vendimit 01 Nr.124/20 të datës 29.10.2020, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë;
9. Shqyrtimi i Propozim Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit në fshatin Gexhë;
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim Vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër;
11. Informatë për zonën e mbrojtur "Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë"





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



DRAFT RREGULLORE NR. 02/2020
PËR
PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Nëntor 2020

RREGULLORE PËR PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Kuvendi i Komunës së Rahovecit

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12 paragrafi 2 pika c), nenit 17 pika (k) dhe nenit 40 paragrafi 2 pika a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Konventën për të Drejtat e Fëmijës, Ligjin Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, të nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.9 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005 i datës 29.03.2017, në mbledhjen e mbajtur më datë..... Kuvendi i Komunës së Rahovecit, miraton:

RREGULLOREN 00/2020 PËR PËRKUJDESJEN DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGJTHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Me këtë rregullore përcaktohen rregullat dhe procedurat për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës, në zbatim të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës dhe kompetencave vetanake të Komunës së Rahovecit, me qëllim të:

- 1.1. Mbrojtjes së fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, abuzimit, ndëshkimit trupor, keqpërdorimit, shfrytëzimit, neglizhimit apo ndonjë forme tjetër që vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës;
- 1.2. përcaktimit të detyrave dhe përgjegjësisë, të subjekteve për mbrojtjen e fëmijës, si dhe mënyrës së koordinimit, raportimit dhe bashkëpunimit të tyre me qëllim të kontributit në sistemin për mbrojtjen e fëmijës, si dhe
- 1.3. kontributit në krijimin e një komunë mike për fëmijë.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore:

- 1.1. zbatohet për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fazat, për të gjitha masat, veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, nga të gjitha subjektet për mbrojtjen e fëmijës në Komunën e Rahovecit, në përputhje me obligimet e dala nga Ligji për mbrojtjen e fëmijës, këtë rregullore si dhe legjislacionin përkatës në fuqi, dhe

- 1.2. zbatohet për fëmijën me shtetësi kosovare, pa shtetësi, të pa regjistruar, azilkërkues, refugjat ose me shtetësi të huaj, brenda territorit të Komunës së Rahovecit.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje nuk mund të merren si kufizim apo pakësim i të drejtave ekzistuese të fëmijës të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, Konventën për të Drejtat e fëmijës ose me instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë fushë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Administrata komunale-** të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal siç përkufizohet në Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 04 qershor 2008);
- 1.2. **Fëmijë** –nënkupton çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me përjashtim të rasteve kur mosha madhore arrihet më përpara, në përputhje me legjislacionin të cilit ai i nënshtrohet. Në rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë, derisa mosha e tij të jetë përcaktuar plotësisht;
- 1.3. **Komunë mike ndaj fëmijës** - nënkupton sistemin e qeverisjes së mirë lokale me fëmijën në qendër, e zotuar për zbatimin dhe realizimin e plotë të të drejtave të fëmijës në nivelin më të lartë të arritshëm, që garanton respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijës, dhe që konsideratë mbizotëruese ka interesin më të mirë të fëmijës, mos diskriminimin, mbrojtjen e dinjitetit dhe pjesëmarrjen e fëmijës, duke i dhënë vëmendjen e duhur nivelit të pjekurisë, të kuptuarit e fëmijës dhe rrethanave të rastit;
- 1.4. **Komunë** – Komuna e Rahovecit, njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin dhe me kufijtë administrativë të përcaktuar sipas Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 2 qershor 2008);
- 1.1. **Konventa mbi të drejtat e fëmijës/Konventa** - Konventa mbi të drejtat e fëmijës, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989;
- 1.2. **Kryetar-** Kryetari i Komunës së Rahovecit;
- 1.3. **Kushtetutë** - Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- 1.4. **Kuvend-** Kuvendi i Komunës së Rahovecit;
- 1.5. **Ligj** - Ligji Nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës (Gazeta Zyrtare nr. 14, 17 korrik 2019);

- 1.6. **Ligji për bashkëpunim ndërkomunal** - Ligji nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal (Gazeta Zyrtare, nr. 7, 10 gusht 2011);
 - 1.7. **Ligji për shërbime sociale dhe familjare** - Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare nr. 12, 01 maj 2007) dhe Ligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare (Gazeta Zyrtare, nr. 5, 05 prill 2012);
 - 1.8. **Mbrojtja e fëmijës** - nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë;
 - 1.9. **Ministri** - Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale;
 - 1.10. **Në të gjitha fazat** - përfshin të gjitha procedurat në të cilat fëmija është në kontakt me subjektet për mbrojtjen e fëmijës;
 - 1.11. **Organe komunale** - nënkupton kuvendin dhe kryetarin;
 - 1.12. **Përfaqësues ligjor**- nënkupton prindin/ërit ose personin, që ushtron autoritetin prindëror apo kujdestarin, i cili, brenda përgjegjësisë, që i janë dhënë nga legjislacioni në fuqi nga gjykata, ose nga Organi i Kujdestarisë, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës;
 - 1.13. **Qendra për Punë Sociale/QPS** - është institucion publik profesional, kompetent për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në kuadër të komunës;
 - 1.14. **Statut** - Statuti i Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017.
 - 1.15. **Subjekt për mbrojtjen e fëmijës** – nënkupton çdo persona të punësuar nga autoriteti komunal, administrat komunale, institucion komunal, organ komunal, institucion qendror që vepron në nivel komunal, shërbimet dhe qendrat për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve, të cilat janë nën administrimin e Komunës, apo që veprojnë në nivel komunal, profesionistë për mbrojtjen e fëmijës dhe çdo person apo subjekt tjetër që ka përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në përkujdesjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve;
 - 1.16. **Zyra për Qeverisje të Mirë/ZQM** - nënkupton Zyrën/Njësinë përkatëse për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.
2. Termat tjerë të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për mbrojtjen e fëmijës, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe Statutin.

KAPITULLI II

PARIMET E PËRKUJDESJES DHE MBROJTJES SË FËMIJËS

Neni 4

Mbrojtja e jetës dhe të drejtave të fëmijës

Mbrojtja e jetës dhe të drejtave të fëmijës është detyrimi kryesor, në masën maksimale të mundshme, për çdo përfaqësues ligjor, person, subjekt për mbrojtjen e fëmijës, institucion apo organ tjetër në territorin e Komunës së Rahovecit.

Neni 5

Parimet për mbrojtjen e fëmijës dhe interesi më i mirë i fëmijës

1. Të gjitha veprimet dhe vendimet, në të gjitha fazat, që kanë të bëjnë me fëmijën, të ndërmarra nga përfaqësuesit ligjor dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës të Komunës së Rahovecit, duhet të jenë në përputhje me parimet dhe dispozitat e Ligjit, që përfshin edhe interesin më të mirë të fëmijës.
2. Për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës, duhet të respektohen parimet e përcaktuara në Ligj dhe asnjë interpretim i supozuar i asaj se çka është në interesin më të mirë të fëmijës nuk mund të justifikojë shkeljen e çfarëdo të drejte të njohur nga Kushtetuta, Konventa, Ligji dhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare.
3. Përfaqësuesit ligjor dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës, në të gjitha fazat dhe në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, koordinojnë masat dhe veprimet e tyre për të siguruar interesin më të mirë të fëmijës.

Neni 6

Parimi i trajtimit të barabartë të fëmijës

Përfaqësuesit ligjor dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës, në të gjitha fazat dhe në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe gjatë hartimit të politikave dhe legjislacionit, duhet të veprojnë në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë të fëmijës dhe të marrin të gjitha masat e duhura, me qëllim, që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit, sipas kuptimit të cilito nga bazat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Neni 7

Fryma e edukimit të fëmijës

Të gjithë përfaqësuesit ligjor dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës në Komunën e Rahovecit, duhet të përkujdesen që fëmijët të rriten në mjedis familjar, në një atmosferë lumturie, dashurie dhe mirëkuptimi, ku nuk përdorët ndëshkimi trupor, në mënyrë që të edukohen në frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit, dhe fëmijët të përgatiten

plotësisht për të bërë një jetë individuale në shoqëri, e cila nxit zhvillimin e potencialit të plotë të fëmijës.

Neni 8

Vlerësimi i ndikimit tek fëmijët

1. Organet dhe administrata komunale, me qëllim të identifikimit të natyrës, përmasave dhe nevojës për mbrojtjen e fëmijës, e bëjnë në mënyrë të rregullt vlerësimin e ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale tek fëmijët dhe zhvillojnë procesin për vlerësimin e ndikimit të politikave, legjisllacionit, strategjive e planeve të veprimit dhe programeve për fëmijë.
2. Vlerësimi fillon në faza të hershme, gjatë analizës së situatës së fëmijëve dhe ndikimit të ndërhyrjeve tek fëmija, për të marrë vendime bazuar në interesin më të mirë të fëmijës.
3. Vlerësimi i ndikimit në fëmijë të aspekteve të qeverisjes lokale, duhet të rezultojë me rekomandime për përmirësime si dhe me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga organet komunale në mënyrë që të krijohet një komunë mike për fëmijë si dhe
4. Vlerësimi i ndikimit të aspekteve të qeverisjes lokale tek fëmijët mund të bëhet edhe nga organizata të shoqërisë civile, të cilat mund t'i referojnë të gjeturat tek organet komunale.

KAPITULLI III

PËRKUJDESJA DHE MBROJTJA E FËMIJËS

Neni 9

Përgjegjësia prindërore dhe familjare për përkujdesjen për fëmijën

1. Mbrojtja kryesore e të drejtave të fëmijës nis në familje, nga prindërit ose kujdestarët.
2. Interesi më i mirë i fëmijës përmbushet kur nevojat e zhvillimit të tij fizik dhe psikologjik, plotësohen brenda kontekstit të familjes së tij biologjike. Të gjithë subjektet duhet të bëjnë çdo përpjekje të promovojnë, mirëqenien e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike përmes ofrimit të përkujdesjes, mbrojtjes dhe këshillimit social dhe në raste të jashtëzakonshme, asistencës materiale.
3. Familja, ka përgjegjësi primare për rritjen, mirëqenien, edukimin dhe mbrojtjen e fëmijës. Përfaqësuesit ligjor dhe anëtarët e tjerë të familjes janë përgjegjës për mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha aktet dhe situatat që e vënë fëmijën në rrezik, nga të gjitha format e ndëshkimit trupor, dhunës fizike dhe mendore, neglizhimit, abuzimit, keqtrajtimit, dhe shfrytëzimit dhe përgjegjësitë tjera të përcaktuara në Ligj.
4. Përfaqësuesit ligjor janë të obliguar në radhë të parë të përkujdesen për sigurimin e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim sigurimin e mirëqenies emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur dhe mbajtur raporte vetanake me fëmijën dhe obligimin për

t'i siguruar fëmijës jetën, sigurinë, shëndetin, mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurisë së fëmijës.

5. Organet dhe administrata komunale dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën duhet të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar integrimin e fëmijës në familje dhe shoqëri dhe të bëjnë çdo përpjekje të promovojnë, mirëqenien e fëmijës në suaza të familjeve të tyre biologjike përmes ofrimit të përkujdesjes, mbrojtjes dhe këshillimit social dhe në raste të jashtëzakonshme, asistencës materiale.

6. Fëmija mund të largohet nga kujdesi i përfaqësuesit ligjor, vetëm në rastet siç përcaktohet me legjislacion në fuqi.

Neni 10

Ndihma prindërve dhe familjeve në përkujdesjen për fëmijën

1. Subjektet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës respektojnë përgjegjësinë kryesore të përfaqësuesve ligjor dhe familjes për përkujdesjen për fëmijën.

2. Subjektet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës ofrojnë mbështetjen e nevojshme për të parandaluar dhe pakësuar risqet e mundshme me të cilat mund të përballen fëmijët dhe për t'i pajisur prindërit me aftësitë përkatëse jo të dhunshme dhe proaktive për të rritur fëmijët, mbështesin përfaqësuesit ligjor në rritjen e fëmijës së tyre dhe duhet të sigurojnë ndihmat e nevojshme të familjes në nevojë, madje qysh në fazat e hershme kur një gjë e tillë del të jetë e nevojshme, si dhe t'i referojë fëmijën dhe familjen në shërbimet e mbrojtjes së fëmijës, sipas masave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

3. Subjektet përkatëse për mbrojtjen e fëmijës, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tyre, ndihmojnë dhe ndërhyjnë në familje, në bazë të referimit apo në raste kur familja nuk është në gjendje apo kur ekziston dyshimi i bazuar se familja nuk është në gjendje që të mbrojë fëmijën nga rreziku për jetë, dhuna, neglizhimi, keqtrajtimi, abuzimi dhe shfrytëzimi. Në këtë drejtim, subjektet për mbrojtjen e fëmijës, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tyre, janë të obliguara t'u dalin në ndihmë familjeve në përkujdesjen për fëmijën dhe duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë:

3.1. familjeve në nevojë, që u nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës,

3.2. fëmijës pa përkujdesje prindërore,

3.3. fëmijës së neglizhuar, abuzuar apo keqtrajtuar,

3.4. fëmijës i cili bie në konflikt me ligjin si dhe

3.5. fëmijës që i përket grupeve të ndryshme shoqërore apo komuniteteve të caktuara.

4. Mbrojtja e fëmijës realizohet nëpërmjet marrjes së masave të mbrojtjes, realizimit të ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës dhe ofrimit të shërbimeve, sipas nevojave, të cilat synojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës në mjedisin e tij familjar ose duke e vendosur atë në përkujdesje alternative, kur fëmija është i privuar në mënyrë të përkohshme apo të

përhershme nga përkujdesja dhe mbrojtja e prindërve, ose kur për shkak të interesit të tij më të mirë, ai nuk mund të lihet në përkujdesjen e prindërve.

5. Ndërhyrjet dhe shërbimet duhen bazuar mbi njohuri të shëndosha të nevojave të fëmijëve dhe familjeve, dhe duhet të jenë të përshtatura për fëmijën.

Neni 11

Obligimet e komunës ndaj fëmijës

1. Komuna e Rahovecit, përkujdeset që në territorin e saj, nga të gjitha subjektet për mbrojtjen e fëmijës dhe në të gjitha fazat, të zbatohen plotësisht, të gjitha të drejtat e fëmijës.
2. Organet dhe administrata komunale si dhe subjektet për mbrojtjen e fëmijës, janë përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve dhe masave parandaluese, mbrojtëse dhe riintegruese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e Komunës. Për këtë qëllim, sipas përgjegjësisë të përcaktuara në Ligj, duhet të:
 - 4.1. marrin hapa për të identifikuar natyrën dhe përmasat e nevojës për mbrojtjen e fëmijës brenda territorit të Komunës;
 - 4.2. zhvillojnë masa për të parandaluar rreziqet që rrezikojnë mirëqenien dhe zhvillimin e fëmijës, nevojën e fëmijës për ndihmë dhe për të zvogëluar problemet ekzistuese;
 - 4.3. marrin masa që të parandalojnë dhe të luftojnë rastet e ndëshkimit trupor të fëmijës, në përputhje me ligjet në fuqi;
 - 4.4. zhvillojnë programe dhe projekte për të garantuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës, për parandalimin dhe reduktimin e faktorëve që vënë në rrezik jetën dhe integritetin moral, fizik, psikologjik e emocional të fëmijës;
 - 4.5. organizojnë takime informuese, promovuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës, duke koordinuar dhe harmonizuar veprimet përmes shërbimeve të integruara të sektorëve të edukimit, shërbimeve sociale, shëndetësisë dhe organizatave të tjera qeveritare, joqeveritare dhe komunitetit, për vetëdijesimin e komunitetit dhe arritjen e rezultateve konkrete dhe të sigurta për fëmijët të cilët nuk kanë qasje në shërbimet ekzistuese;
 - 4.6. promovojnë artin, kulturën dhe sportin në institucionet arsimore dhe më gjerë;
 - 4.7. krijojnë një sistem që të jenë më pranë fëmijëve në nevojë dhe sipas nevojë ofrimin e financimit emergjent për fëmijë;
 - 4.8. përkrahin ekzekutimin e masave të diversitetit, masave edukative dhe dënimeve për fëmijë që kanë rënë ndesh me ligjin;
 - 4.9. zhvillojnë praktika të prindësisë së mirë dhe promovimit shëndetësor;
 - 4.10. krijojnë mundësi të barabarta për të gjithë fëmijët për t'u regjistruar në shkollë, për ta vijuar dhe për përfunduar atë;

- 4.11. inkurajojnë dhe i mbështesin organizatat e të rinjve dhe fëmijëve dhe u ofrojnë mbështetje organizatave të shoqërisë civile, për të zhvilluar kapacitetet e tyre për të ndikuar në vendimmarrjen e pavarur në fushën e të drejtave të fëmijëve;
 - 4.12. komunikojnë dhe mund të krijojnë partneritet me institucionet qendrore dhe organizatat dhe institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjve dhe mediat për t'i promovuar të drejtat e fëmijëve, në mënyrë që në komunë të sigurohet një mjedis i sigurt për fëmijët.
3. Subjektet për mbrojtjen e fëmijës, kryejnë shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të Komunës, sipas përgjegjësisë të përcaktuara në Ligjin për shërbime sociale dhe familjare, standardeve të specifikuara nga Ministria dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 12

Komuna e Rahovecit: Komunë mike ndaj fëmijës

1. Komuna e Rahovecit e përkushtuar në zbatimin e konceptit: Komunë mike për fëmijë, e cila do të mundësojë gjithë përfshirje të fëmijës në përmbushjen e të drejtave të tyre, duke ofruar mbështetje në realizimin dhe jetësimin e qëllimeve për një mirëqenie më të mirë për fëmijët dhe përkujdeset që të gjitha organet dhe administrata komunale, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre përkatëse, të marrin masa dhe veprime për të siguruar që çdo fëmijë në territorin e komunës do të:
 - 1.1. ndjehet i sigurtë në rrugë, shkollë dhe në mjedisin ku jeton;
 - 1.2. mbrohet nga shfrytëzimi, ndëshkimi trupor, dhuna, abuzimi apo çfarëdo rreziku tjetër që mund të vijë si rezultat i moshës apo gjinisë;
 - 1.3. këtë qasje në burime të ujit të pastër dhe të jetojë në një mjedis të pastër dhe me hapësira të gjelbra;
 - 1.4. pranojë shërbimet kryesore, si kujdesi shëndetësor, arsimimi dhe kujdesi alternativ;
 - 1.5. këtë të drejtë të dëgjohet, të shprehë lirisht opinionet e tij dhe të marr pjesë në proceset vendimmarrëse të rëndësishme lidhur me jetën e tij, si dhe të ndikojnë në vendimet lidhur me ta - në familje, shkollë, komunitet dhe shoqëri;
 - 1.6. këtë në disponim hapësira të mjaftueshme dhe të sigurta për lojëra dhe argëtim;
 - 1.7. marrë pjesë në ngjarjet kulturore, sportive, rekreative dhe sociale;
 - 1.8. këtë qasje të barabartë në secilin shërbim të ofruar nga Komuna, pa asnjë diskriminim në cilido nga bazat e përcaktuara në dispozitat përkatëse të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus të veçantë në kategoritë e fëmijëve në nevojë;
2. Subjektet për mbrojtjen e fëmijës kanë përgjegjësi sociale dhe ligjore për t'u angazhuar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me konceptin e Komunës mike për fëmijë.

3. Organet dhe administrata komunale në çdo plan vjetor për të drejtat e fëmijës duhet të parashohin masa dhe veprime konkrete për realizimin e konceptit të Komunës mike për fëmijë.

Neni 13

Detyrimi i raportimit për dhunën dhe ndëshkimin trupor ndaj fëmijës

1. Subjektet për mbrojtjen e fëmijës dhe çdo person që punonë me dhe për fëmijët dhe çdo pjesëtar i profesionit të mësuesisë, infermierisë, mjekësisë, stomatologjisë, psikologjisë ose i policisë apo profesionist tjetër që ka për detyrë përkujdesjen për fëmijët, i cili dyshon ose ka dëshmi se që ndaj fëmijës, qoftë nga ana e prindit ose përkujdesësit të tij apo nga cilido person, është ushtruar çdo formë e dhunës fizike ose mendore, ndëshkim trupor, keqtrajtimi, braktisja, abuzimi, neglizhimi dhe shfrytëzimi është i obliguar që të raportojë rastin, me shkrim ose gojarisht në Polici ose në Qendrën për Punë Sociale ose tek mbrojtësi i viktimave, në pajtim me legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje.
2. Subjektet e caktuara në paragrafin një të këtij neni, për rastet e ndëshkimit trupor në shkolla, raportojnë në Drejtorinë Komunale përkatëse të Arsimit dhe Inspektoratin e Arsimit rastet e ndëshkimit trupor të fëmijës, në përputhje me ligjet në fuqi, dhe këto marrin masa disiplinore ndaj personelit arsimor si dhe i raporton organeve të hetuesisë.
3. Detyra dhe mënyra e raportimit të dhunës ndaj fëmijës duhet të jenë pjesë e programeve të rregullta të trajnimeve, kur përgatiten profesionistët e ardhshëm që do të punojnë me dhe për fëmijët. Kjo duhet të bëhet edhe përmes fushatave të ndryshme promovuese duke përfshirë edhe udhëzimet përkatëse për mënyrën dhe vendin e raportimit.
4. Pamundësia e subjekteve dhe personave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, për të raportuar, sanksionohet sipas ligjit në fuqi.

Neni 14

Plani vjetor për të drejtat e fëmijës

1. Njësia apo Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës, në kuadër të komunës, udhëheq procesin e hartimit të planit të veprimit si dhe rishikon zbatimin e planit në baza vjetore, bazuar në vetëvlerësimin komunal.
2. Gjatë hartimit dhe zbatimit të planit vjetor për të drejtat e fëmijës:
 - 2.1. Njësia apo Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës bashkëpunon me institucionet qendrore apo lokale përkatëse, organizatat e shoqërisë civile, profesionistët që punojnë për dhe me fëmijët, dhe grupet e tjera relevante;
 - 2.2. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse të komunës të japin kontributin e tyre dhe të marrin pjesë aktive dhe të ofrojnë të dhënat përkatëse;
 - 2.3. Fëmijët duhet dëgjuar dhe inkurajuar që të kontribuojnë dhe që pikëvështrimet e tyre duhet të merren në konsideratë;
 - 2.4. Duhet marrë parasysh nevojat dhe specifikat e fëmijëve në Komunë; si dhe

- 2.5. duhet bazuar në të dhëna dhe njohuri shkencore për mbrojtjen e fëmijës
3. Plani i veprimtimit për të drejtat e fëmijës duhet të përcaktojë:
 - 3.1. Prioritetet;
 - 3.2. objektiva realiste;
 - 3.3. masat përkatëse;
 - 3.4. njësitë përgjegjëse dhe
 - 3.5. afatet;
4. Hartimi dhe zbatimi i Planit vjetor vjetor për të drejtat e fëmijës, duhet mbështetur me burime njerëzore dhe financiare, dhe vlerësimi i tyre duhet bërë në mënyrë sistematike.
5. Plani vjetor vjetor për të drejtat e fëmijës miratohet në Kuvend.

KAPITULLI IV

MEKANIZMAT KOMUNAL PËR MBROJTJE TË FËMIJËS

Neni 15

Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës

1. Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës, përgjegjëse për zbatimin e kësaj rregulloreje, janë:
 - 1.1. Kryetari i komunës;
 - 1.2. Drejtoritë dhe njësitë përkatëse komunale sipas fushës që mbulojnë në lidhje me të drejtat e fëmijës;
 - 1.3. Qendra për Punë Sociale;
 - 1.4. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës;
 - 1.5. Njësia/Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës;
 - 1.6. Institucionet shëndetësore;
 - 1.7. Institucionet arsimore publike dhe jopublike në nivelet arsimore parashkollore, fillore, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe të lartë;
 - 1.8. Organizatat e shoqërisë civile (organizatave joqeveritare, shoqatat, klubet dhe organizatat formale dhe joformale);
 - 1.9. Familjet strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore;
 - 1.10. Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës dhe
 - 1.11. Subjektet tjera që kanë përgjegjësitë me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 16

Roli i Qendrës për Punë Sociale

1. Qendra për Punë Sociale, ofron përkujdesje sociale dhe/ose këshillim në rrethanat kur një fëmijë është në nevojë për shërbime sociale dhe familjare dhe duhet të marrë çdo hap të nevojshëm për ruajtjen e sigurisë së fëmijës dhe siguron që shërbimet e ofruara janë në përputhje

me përgjegjësitë që përmban Ligji për shërbime sociale dhe familjare, Ligji dhe legjislacioni përkatës në fuqi.

2. Qendra për Punë Sociale identifikon rastet e fëmijëve që janë në situatë rreziku apo në nevojë dhe ndërhyr për menaxhimin e rastit, së bashku me subjektet përkatëse deri në zgjidhjen përfundimtare.

3. Qendra për Punë Sociale sipas përgjegjësiave të përcaktuara në Nenin 15 të Ligjit duhet që të:

- 3.1. koordinojë dhe organizojë sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës në kuadër të komunës;
- 3.2. zbatojë politikat nacionale dhe lokale për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna;
- 3.3. shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në kuadër të komunës, mund të informohen apo të referohen te shërbimet apo institucionet e tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;
- 3.4. përcaktojë së paku një (1) zyrtar përkatës përgjegjës dhe të specializuar për të koordinuar masat dhe ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijës;
- 3.5. Ushtron çdo kompetencë tjetër, në përmbushjen e mandatit që ka, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Qendra për Punë Sociale mobilizon të gjitha subjektet për mbrojtjen e fëmijës për funksionalizuar sistemin e integruar të mbrojtjes së fëmijës.

Neni 17

Caktimi i Njesisë/Zyrtarit për mbrojtjen e fëmijës

1. Kryetari, me qëllim të përmirësimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës si dhe të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësiave të përcaktuara me Ligj dhe këtë Rregullore, sipas vlerësimit të nevojave specifike të komunës, cakton Njësinë/Zyrtarin përkatës për mbrojtjen e fëmijës, nga radhët e punonjësve të QPS-së .

2. Kryetari, siguron që të ndahen burime të mjaftueshme nga buxheti për kryerjen e detyrave të Njesisë apo zyrtarit përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

3. Njësia apo zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës i jep llogari:

- 3.1. Kryetarit, për koordinimin dhe raportimin lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijës dhe
- 3.2. Drejtorit të QPS-së, për mbajtjen në nivel të standardeve të praktikës profesionale dhe ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësiave të përcaktuara me Ligj dhe me këtë rregullore.

4. Kryetari, në afat prej më së largu tre (3) muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, cakton njësinë apo zyrtarin/ët përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 18

Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë apo Zyrtarit përkatës për mbrojtjen e fëmijës

1. Njësia apo Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës, në kuadër të komunës, ka përgjegjësitë si në vijim:

- 1.1. bashkëpunon, koordinon, monitoron, raporton, mbron, promovon zbatimin e Ligjit;
- 1.2. ofron mbështetje në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe planeve lokale për promovimin e të drejtave të fëmijës dhe mbrojtjen e fëmijës;
- 1.3. mbështetë dhe promovon praktikën e mira dhe ndihmon në ngritjen e kapaciteteve të komunës për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve;
- 1.4. informon dhe udhëzon, në formën verbale apo të shkruar, për të drejtat e fëmijës dhe për mjetet ligjore të disponueshme për mbrojtjen e fëmijës, për të gjithë punonjësit dhe personat të komunës;
- 1.5. bashkëpunon dhe kryej detyrat dhe përgjegjësitë e veta në bashkërendim dhe koordinim me ZQM-në si dhe me institucionet tjera kompetente sipas Ligjit;
- 1.6. prezanton një raport vjetor tek ZQM-ja sipas formatit të përcaktuar nga ajo për zbatimin e Ligjit në kuadër të komunës, duke përfshirë edhe raportin për zbatimin e Konventës pranë Komitetit për të drejtat e fëmijës në Gjenevë;
- 1.7. bashkëpunon dhe mbështetë ZQM-në dhe institucionet përkatëse në hartimin e planeve relevante të veprimit lidhur me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e fëmijës;
- 1.8. bashkëpunon me Komitetin Ndërminstor për të Drejtat e Fëmijës për zhvillimin e politikave që kanë të bëjnë me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, zbaton rekomandimet e Komitetit, ofron të dhënat e kërkuara nga ZQM në emër të Komitetit, si dhe marrin pjesë në takimet e Komitetit, sipas ftesës dhe agjendës përkatëse;
- 1.9. mbledh të dhëna statistikore lidhur me rastet e diskriminimit të fëmijës, si dhe të dhëna tjera për fëmijët në territorin e komunës;
- 1.10. zhvillon aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi lidhur me promovimin e Ligjit, si dhe të kryejë hulumtime, sondazhe në çështjet e të drejtave të fëmijës;
- 1.11. publikon raporte dhe bën rekomandime për të vepruar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, në mënyrë që institucionet përkatëse t'i shfrytëzojnë raportet dhe rekomandimet për të zhvilluar politika, plane të veprimit dhe buxhetin për fëmijë;
- 1.12. shkëmben dhe siguron informata për Avokatin e Popullit, për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës dhe ato që u përkasin rekomandimeve të Avokatit të Popullit;

- 1.13. merr pjesë, sipas ftesës, në takimet e Këshillit të Drejtorëve të komunës dhe paraqet raportin, duke përshkruar në detaje punët e kryera për të cilat është përgjegjëse;
 - 1.14. përgatit vetëvlerësimet periodike, të cilat rezultojnë me veprime dhe politika që duhet të ndërmerren nga Komuna, në mënyrë që të krijohet një Komunë mike ndaj fëmijës;
 - 1.15. siguron sistem komunikimi që mundëson shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve të komunës dhe institucioneve qendrore;
 - 1.16. siguron sistem komunikimi që mundëson shprehjen e mendimeve të fëmijëve, me pjesëmarrjen e fëmijëve, të cilat përfshihen në punën e qeverisjes në nivel komunal;
 - 1.17. bashkëpunon dhe koordinon mekanizmat në territorin e komunës që merren me mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve;
 - 1.18. Përcakton treguesit dhe të dhënat për fëmijët dhe interesat e tyre, sipas prioriteteve të Komunës;
 - 1.19. bashkëpunon me tryeza multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit.
 - 1.20. bashkëpunon me Ekipin për të Drejtat e Fëmijës për zbatimin e planit për aftësimin prindëror dhe për çështjet tjera të ndërlidhura sipas legjislacionit në fuqi.
2. Administrata komunale, organet komunale dhe profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë aktivitetet e tyre me Njësinë apo Zyrtarin përkatës për mbrojtje të fëmijës, për të koordinuar dhe raportuar zbatimin e Ligjit.

Neni 19

Ekipi për të drejtat e fëmijës

1. Ekipi për të Drejtat e Fëmijës në nivel të vendimmarrjes politike në kuadër të komunës, ka përgjegjësitë e përcaktuara në Nenin 20 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës, që përcaktojnë:
 - 1.1. definimin e prioriteteve të komunës dhe masave të nevojshme që duhet ndërmarrë për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe të koordinojë aktivitetet e nevojshme për zbatimin e tyre;
 - 1.2. koordinon dhe monitoron zbatimin e politikave dhe të masave përkatëse për zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijës;
 - 1.3. kujdeset për zbatimin e rekomandimeve dhe vendimeve të nxjerra nga strukturat e parapara për mbrojtjen e fëmijës sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijës;
 - 1.4. vlerëson dhe siguron përputhshmërinë e politikave, akteve juridike dhe masave të tjera të ndërmarra nga Komuna me legjislacionin, politikat, Strategjinë për të Drejtat e Fëmijës dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

- 1.5. zhvillimi i programeve, për të parandaluar përfshirjen e fëmijës në fenomene të mundshme negative dhe ulur faktorët e rrezikut që mund të rrezikojnë fëmijët;
- 1.6. rekomandon kryetarin e komunës për ndërmarrjen e veprimeve të mëtejme, të nevojshme për të realizuar të drejtat dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në pajtim me legjislacionin në fuqi;
2. Mënyra e themelimit dhe funksionimit të Ekipit për të drejtat e fëmijës rregullohet sipas aktit nënligjor të miratuar nga Qeveria.
3. Kryetari nxjerrë vendime përkatëse dhe krijon kushtet e nevojshme Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, për kryerjen e funksionit sipas Ligjit dhe aktit nënligjor të nxjerrë nga Qeveria dhe sipas nevojës Rregullores që do të miratohet në Kuvend.

Neni 20

Asambleja Komunale e Fëmijëve

1. Asambleja Komunale e Fëmijëve përfaqëson në mënyrë të drejtpërdrejtë opinionet dhe pozitën e të gjithë fëmijëve në Komunë dhe ka përgjegjësitë si në vijim:
 - 1.1. siguron pjesëmarrjen e fëmijës për të pasqyruar në mënyrë të drejtë opinionet dhe qëndrimet e fëmijës, karshi moshës dhe pjekurisë së tyre, në zhvillimin dhe realizimin e veprimeve në fushën e arsimit, shkencës, kulturës, sportit, punës humanitare dhe aktiviteteve të tjera me interes për fëmijët dhe komunitetin;
 - 1.2. avokon tek institucionet përkatëse për të drejtat e fëmijës dhe për çështjet e ngritura nga vetë fëmijët në nivel lokal;
 - 1.3. bashkëpunon me këshillat drejtues të shkollave, këshillat e prindërve, këshillat e nxënësve dhe komunitetin lokal;
 - 1.4. zhvillon dhe bashkëpunon me mekanizmat dhe organizatat tjera;
 - 1.5. ndihmon në ngritjen e vetëdijes për të drejtat e fëmijës, përgjegjësitë dhe gjithë përfshirja e interesave të fëmijëve/nxënësve;
 - 1.6. organizon aktivitete të identifikuara nga vetë fëmijët, dhe ato që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës;
 - 1.7. inkurajon frymën e paqes, të dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit, në shoqëri dhe tek fëmijët;
 - 1.8. promovon vlerat shoqërore dhe nxitë ndjenjën për t'u marrë në të ardhmen me aktivitete institucionale dhe politike;
 - 1.9. siguron bashkëpunimin e nxënësve dhe mësuesve, edukatorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë;
 - 1.10. informon nxënësit rreth çështjeve me rëndësi të veçantë për ta;
2. Asambleja Komunale e Fëmijëve do të funksionojë sipas Rregullores që do të miratohet në Kuvend.

Neni 21

Themelimi i tryezave multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rastit

Tryezat multidisiplinare për ndihmë në menaxhimin e rasteve themelohen në nivel profesionistësh, dhe veprojnë mbi bazën e procedurave të detajuara në pajtim me aktin nënligjor që aprovohet nga Qeveria.

Neni 22

Roli i personave fizikë dhe juridikë në ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës

1. Siç është përcaktuar në Nenin 23 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës, personat fizikë dhe juridikë, mund të ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës.
2. Personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë edhe zyrtarët e punësuar në institucionet që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e fëmijës, duhet të licencohen sipas legjislacionit në fuqi dhe duhet t'i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara.
3. Administrata dhe organet komunale, në fushëveprimin e tyre, mund të lidhin kontrata vetëm me personat fizikë dhe juridikë të licencuar apo që i përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara, për ofrimin e shërbimeve të veçanta për mbrojtjen e fëmijës.
4. Kontratat sipas paragrafit 3 të këtij neni, duhet të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime të mbrojtjes së fëmijës, përmes procedurave të kontraktimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23

Familjet strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore

1. Drejtori i Drejtorisë përkatëse për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale obligohet që të sigurojë që në territorin apo për territorin e Komunës të ketë së paku tri (3) familje strehuese për fëmijët pa përkujdesje prindërore, të vlerësuara, trajnuara dhe të aprovuara sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria.
2. Ministria dhe Komuna i ofrojnë mbështetje materiale familjes strehuese për përkujdesje për fëmijën gjatë qëndrimit në strehim familjar, në pajtim me legjislacionin dhe standardet përkatëse në fuqi.
3. Familja strehuese nuk lejohet të ndaj asnjë informatë me personat e paaautorizuar, mediat dhe të tjerët lidhur me fëmijën gjatë qëndrimit dhe pas largimit nga qëndrimi në strehim familjar.

Neni 24
Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës

Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës themelohen nga Ministria pranë Qendrave për Punë Sociale ku funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë themelore sipas standardeve të përcaktuara nga ministria dhe aktit nënligjor të miratuar nga qeveria.

Neni 25
Pjesëmarrja aktive e fëmijëve

1. Organet dhe administrata komunale, institucionet edukative-arsimore, kulturore dhe sportive, mbështesin dhe inkurajojnë krijimin dhe funksionimin e organizatave të fëmijëve dhe të rinjve, klubeve të artit, kulturës dhe sportit dhe sigurojnë forma të ndryshme të pjesëmarrjes aktive të fëmijëve në jetën shoqërore.
2. Kryetari nxjerrë vendimet përkatëse dhe i krijon kushtet e nevojshme për format e ndryshme të organizimit të fëmijëve, që janë në interesin më të mirë të fëmijës.

KAPITULLI V
BASHKËPUNIMI PËR MBROJTJEN E FËMIJËS

Neni 26
Bashkëpunimi për mbrojtjen e fëmijës

1. Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës, bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën ndërmjet tyre për identifikimin e çështjeve të zbatimit të masave dhe gjetjes së mënyrave me efektive për mbrojtjen e fëmijës si dhe për zbatimin e kësaj rregulloreje, Ligjit, Ligjit për shërbime sociale dhe familjare, legjislacionit në fuqi dhe të politikave shtetërore për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.
2. Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës bashkëpunojnë me ministritë përkatëse dhe me palët e interesuara për hartimin e politikave dhe legjislacionit për ruajtjen e nivelit dhe përparimin e mbrojtjes së fëmijës si dhe zbatojnë politikat në fushën e mbrojtjes së fëmijës të përcaktuar nga ministritë përkatëse dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mekanizmat për mbrojtje të fëmijës, bashkëpunojnë me Qeverinë, institucionet e drejtësisë, policinë, prokurorinë, gjykatat, shërbimin sprovues dhe shërbimin korrektues, Avokatin e Popullit, Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave dhe insitucionet tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 27

Bashkëpunimi ndër-komunal

1. Për ushtrimin më efikas dhe më efektiv të mbrojtjes së fëmijës, komuna ka të drejtë të hyjnë në marrëdhënie bashkëpunimi me dy apo më shumë komuna të Republikës së Kosovës në pajtim me format, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin për bashkëpunim ndërkomunal.
2. Nismat për vendosjen e bashkëpunimit ndër-komunal nga paragrafi 1 i këtij neni, të ndërmarra nga palët me të drejtë nisme, Kryetari, 1/3 e anëtarëve të Kuvendit, së paku 5 % e qytetarëve të komunës me të drejtë vote apo nga Qeveria, merren me prioritet nga administrate dhe organet komunale.
3. Dispozitat e Ligjit për bashkëpunim ndërkomunal vlejnë edhe për të gjitha format e bashkëpunimit ndër-komunal për mbrojtjen e fëmijës. Këto marrëveshje nënshkruhen nga kryetarët dhe miratohen nga kuvendet komunale që janë pjesëmarrëse në bashkëpunimin ndër-komunal. Marrëveshja e bashkëpunimit ndër-komunal bëhet e plotfuqishme pas vlerësimit të ligjshmërisë së saj nga Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale dhe publikimit të marrëveshjes në Gazetën Zyrtare.

Neni 28

Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare për mbrojtjen e fëmijës

1. Organet dhe administrata komunale:
 - 1.1. bashkëpunojnë me organizatat joqeveritare për realizimin e politikave për të drejtat e fëmijës, si dhe për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e tyre, në pajtim me këtë rregullore dhe aktin nënligjor të përcaktuar nga Qeveria;
 - 1.2. sigurojnë, inkurajojnë dhe mbështesin pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare në çështjet e mbrojtjes së fëmijës dhe në aktivitetet planifikuese dhe zbatuese si dhe u ofrojnë këshilla dhe udhëzime organizatave që kërkojnë të ndërmarrin aktivitete të tilla.
 - 1.3. Mbajnë komunikime të rregullta me organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të sigurohet një situatë e qartë e fëmijëve në komunë nga një perspektivë tjetër.
2. Organizatat joqeveritare të licencuara nga Ministria, sigurojnë shërbimet përkatëse të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës, qoftë me nismën e tyre ose me kontratë.
3. Administrata dhe Organet komunale mund të hyjnë në kontrata me organizatat joqeveritare për ofrimin e shërbimeve të veçanta sociale dhe familjare brenda territorit të tyre. Kontratat e tilla duhet të jenë në pajtim me planet vjetore të komunës për shërbime sociale dhe familjare në territorin e saj.

KAPITULLI VI

PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Neni 29

Promovimi i të drejtave të fëmijës

1. QPS, Njësia apo Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës dhe administrata komunale, ndërmarrin masa konkrete, në mënyrë që të promovohen, mbrohen dhe respektohen të drejtat e fëmijëve, përmes, lansimit të fushatës së promovimit lidhur me të drejtat e fëmijës dhe hartimit të programeve të trajnimit dhe organizimin e trajnimeve për të drejtat e fëmijëve për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve që merren me të drejtat e fëmijëve dhe për persona të cilët punojnë me fëmijë ose për fëmijë në nivel komunal;
2. Kujdes i veçantë duhet kushtuar promovimit të:
 - 2.1. mbrojtjes së fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe ndëshkimit trupor;
 - 2.2. mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna e shfaqur qoftë nga personeli arsimor, bashkëmoshatarët;
 - 2.3. ndalimit të gjuhës së urrejtjes, dhunës, jo tolerancës, diskriminimit dhe formave tjera që nxisin konflikte ndër njerëzore;
 - 2.4. ndalimit të praktikave dhe zakoneve diskriminuese ndaj fëmijës;
 - 2.5. inkurajimit të mësim-nxënien gjatë gjithë jetës, të zhvillimit të respektit të fëmijës për identitetin kulturor, për gjuhën dhe vlerat kombëtare, respektin për kulturat e ndryshme si dhe respektin për ruajtjen e mjedisit;
 - 2.6. kujdesit shëndetësor parandalues që siguron zhvillim optimal të fëmijës;
 - 2.7. mbrojtjes së fëmijëve nga përdorimi i substancave narkotike, alkoolit, produkteve të duhanit, produkteve toksike, substancave psikotrope dhe substancave të tjera që janë të deklaruara të dëmshme nga autoritetet përkatëse;
 - 2.8. mbrojtjes së fëmijëve nga hyrja në klubet e natës, lokalet e lojërave të fatit, qasja në lojërat e fatit online si dhe në qendrat argëtuese për të rritur dhe të ngjashme.
 - 2.9. mbrojtjes së fëmijëve nga publikimet, filmat, video lojërat, muzika, transmetimet ose llojet e tjera mjetet e komunikimit masiv, të cilat janë të dëmshme për shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin e tyre;
 - 2.10. mbrojtjes së fëmijëve nga ndikimet e mundshme negative që ekspozimi ndaj medieve mund të ketë mbi fëmijën;
 - 2.11. eliminimit të diskriminimit dhe paragjyqimeve ndaj fëmijës me aftësi të kufizuara.
 - 2.12. Mbrojtjes së fëmijës nga rrëmbimi, trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë veprimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzimi seksual me fëmijë, sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe akteve të tjera në fuqi;
 - 2.13. Mbrojtjes së fëmijës nga shfrytëzimi ekonomik dhe Puna e ndaluar për fëmijë, dhe

- 2.14. Masave kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës.
- 2.15. Programeve përkatëse dhe atyre vetanake të rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me efektet e dëmshme të ndëshkimit trupor dhe edukimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me pasojat degraduese të ndëshkimit trupor dhe programe përkatëse dhe atyre vetanake prindërimi, që promovojnë mënyrat jo të dhunshme të disiplinimit në familje dhe institucione edukativo arsimore dhe në Institucione të Kujdesit.

Neni 30

Seanca/t vjetore për të drejtat e fëmijëve

1. Kuvendi organizon të paktën një (1) seancë vjetore, për t'i diskutuar çështjet e të drejtave të fëmijëve.
2. Në seancën/at vjetore për të drejtat e fëmijëve secili drejtor i drejtorisë komunale raporton për çështjet, veprimet dhe masat që janë në përgjegjësinë e tij dhe që kanë të bëjnë më të drejtat e fëmijëve, si dhe paraqet aktivitetet që janë ndëmrarrë për realizimin e Planit vjetor për të drejtat e fëmijës.
3. Në Seanca/t vjetore për të drejtat e fëmijëve marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile, Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, Asamblesë së Fëmijëve dhe kanë të drejtë të parashtojnë pyetje.
4. Seanca/t vjetore për të drejtat e fëmijëve organizohen në koordinim me Njësinë/zyrtarin përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 31

Ditët mike për fëmijë

1. Nën patronatin e Kryetarit të Komunës organizohen dhe mbahen "Ditët mike për fëmijë".
2. Gjatë këtyre ditëve organizohen aktivitete të ndryshme me pjesëmarrjen e subjekteve të ndryshme që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
3. Kryetari i Komunës me vendim i cakton datat e "Ditëve mike për fëmijë" në Komunë dhe përcakton përgjegjësitë e mekanizmave përkatëse për detyrat e tyre në këto ditë dhe aktivitetet konkrete që duhet ndërmarrë.

KAPITULLI VII

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 32

Përgjegjësia individuale

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit përkatës për mbrojtjen e fëmijës kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë shkeljen.

Neni 33

Buxheti për fëmijë

1. Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin përkatës që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijës, organet dhe administrata përkatëse komunale, gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijës si dhe sigurojnë burime njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme.

2. Komuna e planifikon buxhetin komunal, i cili është transparent dhe bazohet në konsultime me palët, duke i përfshirë edhe fëmijët. Ky buxhet i reflekton nevojat për ndarjen e burimeve për fëmijë në të gjitha aspektet e qeverisjes komunale.

3. Administrata dhe organet komunale zhvillojnë një proces për analizimin e nevojave të buxhetimit për fëmijët e komunës, bazuar në procesin e vlerësimit dhe raportimit. Ky proces përfshinë:

- 3.1. analizën e buxhetit të përgjithshëm komunal për të vlerësuar pjesën e shpenzuar për fëmijë dhe sa kanë përfituar fëmijët nga investimet publike të Komunës;
- 3.2. ndarjen e përqindjes së nevojshme, bazuar në Planin e veprimit për mbrojtjen e fëmijëve, nga granti i përgjithshëm, të ndarë nga Qeveria për Komunë;
- 3.3. analizon adekuate të buxhetit të përgjithshëm komunal dhe elementet brenda tij, në mënyrë që të zbulohet pjesa që është shpenzuar për fëmijë dhe të shfrytëzohen produktet e zhvilluara për të investuar në fëmijë;
- 3.4. analizën e ndarjes buxhetore për fëmijë ndër vite dhe tregon trendet e ndarjeve buxhetore për fëmijë.

4. Kryetari bashkëpunon me Ministrinë dhe me donator të ndryshëm për prioritetet për mbrojtjen e fëmijës, dhe marrjen e fondeve për mbrojtjen e fëmijëve.

Neni 34

Ngritja e kapaciteteve për mbrojtjen e fëmijës

1. Për të siguruar ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, të gjithë punonjësit e komunës, vecanarishtë punonjësitë që kanë përgjegjësi direkte në mbrojtjen e fëmijës, janë të obliguar të ndjekin trajnime dhe aktivitete që synojnë të zhvillojnë kapacitetet e tyre në fushën e mbrojtjes së fëmijës si dhe të venë në shfrytëzim, në punën e tyre të përditshme, njohurinë dhe dijen e përftuar.

2. Organet komunale duhet të luajnë rol të vazhdueshëm dhe proaktiv që të jenë në hap me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës dhe në këtë drejtim organizojnë apo inkurajon zyrtarët komunal për pjesëmarrje në trajnime për aspekte të të drejtave të fëmijës dhe buxhetimit për fëmijë.
3. Punonjësit që kanë përgjegjësi në mbrojtjen e fëmijës, trajnohen në nivel teorik dhe praktik, duke përdorur metodologjinë “mësimi nëpërmjet punës”.

Neni 35

Informimi në interes të fëmijës

1. Zyra përkatëse për informim në Komunën e Rahovecit, në bashkëveprim me QPS-në dhe Njësinë apo Zyrtarin përkatës për mbrojtjen e fëmijës, përmes fushatave, ligjeratave publike si dhe materialeve të ndryshme promovuese për ngritjen e vetëdijes për të rriturit e fëmijët, krijojnë një sistem të informimit për tërësinë e shërbimeve që ofrohen për fëmijë dhe informata të tjera të cilat janë në interes të fëmijës.
2. Organizatat e shoqërisë civile inkurajohen dhe përkrahen që të monitorojnë, promovojnë dhe informojnë për të drejtat e fëmijës.

Neni 36

Raporti për zbatimin e rregullores

1. Njësia/Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës monitoron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe nxjerrë raporte vjetore.
2. Obligohen të gjitha njësitë përkatëse të komunës për ofrimin e të dhënave të kërkuara nga Njësia/Zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës.

Neni 37

Zbatimi

1. Përgjegjësia në radhë të parë për zbatimin e kësaj rregulloreje është për organet dhe administrata komunale e Komunës së Rahovecit.
2. Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryetari, me mbështetjen e Zëvendës kryetarit.
3. Kryetari mund të nxjerrë Vendime për zbatimin e kësaj Rregulloreje.
4. Administrata dhe Organet komunale janë të obliguara që pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për krijimin e mekanizmave për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësi të përkatëse.
5. Subjektet për mbrojtjen e fëmijës janë të obliguara që pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësi të përkatëse.

Neni 38
Interpretimi i Rregullores

1. Kjo rregullore duhet interpretuar dhe zbatuar brenda kuadrit të Kushtetutës, Konventës dhe Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.
2. Në të gjitha rastet kur ka kundërthënie të kësaj Rregulloreje me Ligjet dhe dispozitat e Statutit të Komunës do të zbatohen dispozitat e ligjeve dhe statutit.

Neni 39
Publikimi

1. Kjo rregullore publikohet në gjuhët zyrtare dhe gjuhët në përdorim zyrtare.
2. Kjo rregullore dhe ndryshimet e mëpasshme të saj publikohen ueb faqen e komunës dhe në “Gazetën Zyrtare”.

Neni 41
Përgatija e Planit vjetor për të drejtat e fëmijës

1. Organet e përcaktuara në këtë rregullore janë të obliguara që të përgatisin Planin vjetor për të drejtat e fëmijës, duke marrë parasysh nevojat dhe specifikat e fëmijëve në Komunën e Rahovecit si dhe duke marrë parasysh mundësitë buxhetore dhe kohën në dispozicion, duke toleruar shmangien nga standardet e përcaktuara në këtë Rregullore.
2. Përgatitja e Planit të parë vjetor për të drejtat e fëmijës, duhet të shërbejë për analiza përkatëse në mënyrë që në vitet pasuese të respektohen kërkesat e përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 42
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, publikohet në ueb faqen e komunës.
2. Në ditën në të cilën kjo rregullore publikohet në ueb faqe të komunës do të përcaktohet si dita e shpalljes.
3. Kjo Rregullore hyn në fuqi nga data 1 janar 2021.

Smajl Latifi


Kryetari i Komunës



Skica e terrenit

Z.K. Gegje

P/1:200



Nr	Y	X
1	7462388.00	4691799.22
2	7462365.41	4691807.43
3	7462377.90	4691824.76
4	7462391.63	4691820.35

Rahovec me 24.11.2020



Miftar Krasniqi gjeom.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12.2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (f) dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe 46 paragrafi 1 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2020, merr këtë:

V E N D I M

Për vënien në debat publik të Rregullores për Përkujdesje dhe Mbrojtje të Fëmijëve

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit merr vendim për vënien në debat publik të Rregullores për Përkujdesje dhe Mbrojtje të Fëmijëve .
2. Të drejtë pjesëmarrje në debat publik kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe subjektet të tjera të interesuara.
3. Për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së debatit publik qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara do të njoftohen përmes web - faqes zyrtare të Komunës dhe shpalljes publike në tabelën e shpalljeve .
4. Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet, komentet etj. (verbale dhe me shkrim), mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e debatit publik drejtpërdrejtë ose përmes zyrës së Kuvendit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Administratë dhe zyra e Kryetarit të Komunës së Rahovecit.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Shërbime Publike,*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/20
Me datë:30.11.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.11.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01-Nr. 124/20, i datës: 29.10.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë

1. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi 01-Nr. 124/20, i datës 29.10.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë.
2. Anulohet procedura për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në zonën kadastrale në Gexhë.
3. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01-Nr. ____/20
Me Datë: 30.11.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, 39, 40, 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.11.2020, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevojat e komunitetit në fshatin Gexhë

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Gexhë.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510013-00397-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 20347m² (njëzet mijë e treqind e dyzet e shtatë metra katror), zona kadastrale Gexhë, e evidentuar në emër të P.S.H.E Kosovës KK Rahovec.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen 400m² (katërqind metra katror) për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Gexhë.
4. Objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit do të financohet nga donatorët.
5. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në terren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit ,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe
- Arkivi

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/20
Me datë: 30.11.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odaljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 4068 Më 08.10.2020
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

P- 397-0 Gexhe

**Republika e Kosovës
Komuna e Rahovecit
Këshilli i Fshatit Gexhë**

KP.nr. 012/20

Lënda:

Kërkesë

Drejtuar: Komunës së Rahovec- Drejtorisë së Kadastrit

Nga: Këshilli i Fshatit Gexhë,

Datw: 08.10.2020

Fillimisht dëshirojë të ju falenderoj për kontributin e vazhdueshëm që ka dhënë Komuna e Rahovecit, në ofrimin e shërbimeve sociale, karshi qytetarëve të komunës sonë në përgjithësi, dhe në veçanti të Fshatit Gexhë.

Si një fshat i vogël i Komunës së Rahovecit, ndihemi të anashkaluar duke mos pasur qasje të plotë në shërbime sociale dhe kulturore.

Mungesa e një objekti të mirëfillt, ku do të mundësonte kryerjen e shërbimeve socio- kulturore të fshatit tonë si ceremonitë e varrmit, mbledhjet e ndryshme që mbahen në fshatin tonë.

Prandaj duke parë se kemi mungesë të një qendre kulturore, mendojmë se një objekt i tillë do të mbulojë shumë mirë këtë mungesë të theksuar në jetën tonë socio-kulturore.

Andaj me anë të kësaj kërkesë, kërkojmë nga Komuna e Rahovecit përkatësisht Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, të ndajë një parcelme numër 397-0, në sipërfaqe prej 4 ari.

Kjo parcel mund të ndahet përball shkollës fillore që gjendet në fshatin Gexhe.

Me nderime dhe respekte.

**Këshilli Drejtues i
Fshatit Gexhë**

Leutrim

Himaj

Nexhmedin

Krasniqi

Adresa:

Fshati Gexhë, Rruga "Mali", pn.

Telefoni: +383 44 932 100

+383 44 218 629

Email: leo.himaj@live.com



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510013-00397-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 08-942/03-0048720/20
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 26.10.2020 - 10:31
Komuna / Opština / Municipality: Rahovec / Orahovac / Rahovec
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: GEXHË / GEDE / GAGHË
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Rahovec / Orahovac / Rahovec

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zana U/R GIS U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510013-00397-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		20348			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Podjednosti adrese Address Details	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
FERA-ULICA / FERA-ULIC / FERA-ULICA		FERA-ULICA		

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri i Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Bujqesore/Poljoprivredno/Agriculture	Kulllosat/Pashnjat/pasture	Kulllosë E Klases 2/Pasnjak 2 Klase/2nd Class Pasture	20348

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri i Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor	P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC	KCID1502383	RAHOVEC/ ORAHOVAC/ RAHOVEC/		RAHOVEC 30	1/1		

Nenshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina në Republikën e Kosovës, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH – Nr. 07/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave nga Ndërtimi dhe Demolimi i Objekteve Ndërtimore, nenit 10, 39, 40, 46, 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.11.2020 merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr.02/1514/20, i datës: 19.11.2020 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, janë në zonën kadastrale Rahovec në vendin e quajtur Gavne Shume, e evidentuar P.SH. E Kosovës KK Rahovec me sipërfaqe të përgjithshme prej 116186 m² (njëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë metra katror) me numër te certifikatës së pronësisë si më poshtë:
 - 2.1. Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02279-0, kullosë e klasës 5 me sipërfaqe prej 42737 m².
 - 2.1 . Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02280-0, kullosë e klasës 5 me sipërfaqe prej 62661 m².
 - 2.2 Parcela kadastrale sipas Certifikatës së pronësisë Nr. P-71510057-02281-0, jo pjellore me sipërfaqe prej 10788 m²
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor me qëllim të ruajtjes së mjedisit duke pasur në konsideratë kontrollin dhe menaxhimin sa më të mirë të mbeturinave të ngurta si dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme komunale, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi është afatshkurtër në periudhën deri 5 (pesë) vite.
5. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të ndryshoj kontratën me përfituesin e pronës së dhënë në shfrytëzim.

6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Pronat e paluajtshme komunale të cekura në pikën 2 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim pa kompensim, për qëllimin e cekur në pikën 3 të këtij vendimi.
8. Obligohen Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ____/20
Me datë: 30.11.2020

Afrim Dina
Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Oraovac / Municipality Rahovec
Drejtoria për Shërbime Publike



Të nderuar kuvendarë!

Kuvendi Komunal në Rahovec me datë 30.05.2018 ka marrë vendim për caktimin e lokacionit për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.

Më pas, me propozim të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës me datë 30.04.2020 ka marrë vendim me Nr. Prot 01/66 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër në afat prej 5 (pesë) viteve të parcelave kadastrale, me qëllim të ruajtjen së mjedisit dhe kontrollin dhe menaxhimin sa më të mirë të mbeturinave të ngurta si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen dhe ushtrimin e aktivitetit biznesor. Po me këtë vendim është obliguar Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që në bashkëpunim me komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të zhvilloj procedurat e ankandit publik duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Gjithashtu po me datë 30.04.2020 Kuvendi i Komunës me Vendim Nr. 01/67 ka caktuar tarifën për deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore

Pas konfirmimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, ne si drejtori kemi kërkuar nga komisioni përkatës që të shpall ankand publik për dhënien e pronës së paluatshme në shfrytëzim konform ligjit.

Komisioni në fjalë në takimin e mbajtur me datë 15.10.2020 ka marrë vendim që të caktojë çmimin fillestar të dhënies në shfrytëzim të pronave të caktuara për demolimin e objekteve, kriteret dhe dokumentet e nevojshme për aplikim.

Me datë 11.09.2020 është shpallur njoftimi për Ankand Publik për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, në të cilin njoftim janë caktuar kushtet dhe kriteret për aplikim për persona fizik dhe juridik për të qenë përfitues potencial të ngastrave kadastrale për qllimit për të cilin është cekur edhe në Ankandin Publik.

Andaj, duke marrë parasysh se pas mbylljes së afatit të njohimit për ankand publik, nuk kemi pranuar asnjë aplikacion nga të interesuarit për ti marrur në shfrytëzim këto parcela kadastrale. Kjo, ka ndodhur pasi që bizneset e interesuar kanë nguruar të aplikojnë pasi që sipas informatave të marra çmimi i caktuar nga komisioni është tepër i lartë, që do të thotë se shuma totale sipas tyre është e papërballueshme duke e ditur se sipërfaqja e përgjithshme për dhënie në shfrytëzim është 116186m².

Pas kësaj, ne propozojmë që Kuvendi i Komunës të merr vendim që këto parcela kadastrale ti jepen në shfrytëzim **pa pagesë** për qëllimin e destinuar të cekur më lartë, do të thotë për trajtimin dhe depozimin e mbeturinave inerte nga ndërtimi dhe demolimi.

Andaj, kërkojmë nga ju që propozimin tonë ta shqyrtoni dhe ky kuvend të merr vendim për dhënien në shfrytëzim pa pagesë, pasi që siç e dimë të gjithë është një çështje e ndërlikuar dhe se dita ditës në atë vend po kemi grumbullimin e mbeturinave, hudhjen e mbeturinave nga persona të ndryshëm pa kurrfarë pagese dhe pa kurrfarë kriteri.

Ju faleminderit!



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMIENTIT / MINISTRATVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA/IZVOD IZ CERTIFIKATA/EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : P.SHE KOSOV.K.K.RAHOVEC

Numeri i referencës / Broj Referent Number: 08-942/03-0013827/20
Data dhe koha e kështimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 10.04.2020 - 13:52
Komuna / Opština / Municipality: Rahovec / Orahovac / Rahovec
Zyrja Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: Rahovec / Orahovac / Rahovec

A. TË DHËNAJ PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Shënimet/Komente i adresantit (shënime) Prezime/Načelo poslovanja (biznis) Last Name / Business Name	Emri i parë First Name	Emri i tatë Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personat/biznesit Identifikues/Identifikacija ID. No.	Shteti i shërbimit apo regjistrimit Država / državljanstva ili učešćem Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendani/Dan osnivanja Date of birth/Establishment	Krijuar me datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Uradjeno Updated
P.SHE KOSOV.K.K.RAHOVEC				KC/ID1502327	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi Postajal Poštanski Kod Postal Code	Detaje të adresës Podrobnosti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC			RAHOVEC	

Printuar nga / Viskungam od / Printed by: Agjencia Kadastrale e Kosovës / Agencija Katastarska KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

B. NJESJA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale katastarska zona	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property type	Katë Kater m/ Sprat Floor number	Vendi i quajtur Zyrtar meoto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shtyryezimi aktual/Kultura- klasa Aktualna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510MS7-422M-0	Rahovec / Orahovac / Rahovec	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC	PARCELA E / PARCELA A / parcel	Pronë shogëitore Društvena Imovina Socially owned Land / R		GAVNI SHUMI - / GAVNI SHUMI - / GAVNI SHUMI -	42737	Bugësore - Kullorë - Kullorë E Klases 5 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashjak 5 Klase / / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dzavina / single possessor	
P-71510MS7-422M-0	Rahovec / Orahovac / Rahovec	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC	PARCELA E / PARCELA A / parcel	Pronë shogëitore Društvena Imovina Socially owned Land / R		GAVNI SHUMI - / GAVNI SHUMI - / GAVNI SHUMI -	62661	Bugësore - Kullorë - Kullorë E Klases 5 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pashjak 5 Klase / / Agriculture - pasture - 5th Class Pasture / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dzavina / single possessor	
P-71510MS7-422M-0	Rahovec / Orahovac / Rahovec	RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC	PARCELA E / PARCELA A / parcel	Pronë shogëitore Društvena Imovina Socially owned Land / R		GAVNI SHUMI - / GAVNI SHUMI - / GAVNI SHUMI -	10788	Tokë Tjetër - Jo Pjellorë - / / Ostalo Zemljište - Neplodno - / / Other Land - Unproductive - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Dzavina / single possessor	





Republika e Kosovës

Republika Kosova / Republic of Kosovo

Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambienit / Ministrastvo Infrastrukture i Sredine / Ministry of Infrastructure and Environment


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Rahovec

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71510057-02281-0	Parcelë / Parcela / Parcel	10788
P-71510057-02280-2		
P-71510057-02279-0	Parcelë / Parcela / Parcel	42737



Shkalla/Razmera/Scale: 1:5101

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 10.04.2020

Koha/ Vreme/ Time: 02:00:00

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

[Handwritten signature]



Approv/ Usvajio/ Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature

[Handwritten signature]

Në bazë të nenit 3, 16 pika 1, 21 alinea 1 dhe 31 të Ligjit mbi mbrojtjen e natyrës së KSAK ("Gazeta zyrtare e KSAK", nr. 44/76) dhe propozimit të Entit Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës në Prishtinë, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në bazë të nenit 230 të Statutit të Komunës së Rahovecit "Gazeta zyrtare e KSAK", nr. 21/76, 31/81 dhe 20/84) në seancën e përbashkët të Dhomës së Punës së Bashkuar dhe Dhomës së Bashkësive Lokale të mbajtur më 9 prill 1986, mori

V E N D I M

MBI VËNJEN NËN MBROJTJE TË KANIONIT TË DRINIT TË BARDHË TE URA E FSHENJTË SI MONUMENT NATYROR

Neni 1

Vihet nën mbrojtje Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshenjtë si MONUMENT NATYROR.

Neni 2

Kanioni i mbrojtur është krijuar në mënyrë epigjenike duke prerë shkëmbin gëlqeror të Gradishës në pikën më të lartë të lartësisë mbidetare (l.m. 408 m.) lumi i Drinit të Bardhë në gjatësi 5,6 km., duke krijuar një fenomen të rrallë natyror i cili bashkë me rrethin e ngushtë përfaqson një vlerë posaçërisht të lartë natyrore në Krahinë.

Neni 3

Sipërfaqja e përgjithshme e mbrojtur në territorin e KK Rahovec është 124.96.09 ha, prej saj në pronësi shoqërore 84.27.70 ha e në pronësi private 40.68.39 ha.

Sipas regjimit të mbrojtjes territori ndahet në dy zona edhe ato në: a) Zona e ngushtë (rigoroze) dhe b) zona e gjërë (mbrojtëse).

a) Zona e ngushtë (rigoroze) në territorin e komunës së Rahovecit përfshin sipërfaqen prej 54.86.86 ha nga e cila në pronësi shoqërore 49.82.67 ha e në pronësi private 5.04.19 ha. Në kuadër të kësaj zone hyjnë këto ngastra kadastrale:

Në komunën kadastrale Gexhe këto parcela: pjesa e parcelës nr. 631, 632, 633, pjesa e parcelës nr. 772 dhe parcelat e tëra:

773, 775/1, 775/2, 776/1, 776/2, 777, 778, 780, 833, 834, 835/1, 835/2, 836, 837, 848, 849, 852, 853, 855, 856, 857, 858, 859, 860, 861, 862, 863, 864, 865 dhe 866.

Në zonën e ngushtë (rigoroze), e cila për shkak të vlerës posaçërisht të lartë natyrore dhe njëkohësisht përfaqëson fenomenin themelor të Monumentit natyror, do të ketë trajtim rigoroz të mbrojtjes. Në këtë qëllim në kuadër të kësaj zone ndalohen të gjitha llojet e veprimtarisë të cilat e lëndojnë, apo çrregullojnë, prishin pamjen e objektit, ose pengojnë zhvillimin spontan të bashkësisë jetësore dhe populacioneve që jetojnë në të. Në këtë qëllim ndalohet shfrytëzimi i pyjeve, ose cilit do burim natyror. Ndalohet prerja e trungjeve, shkurreve dhe shkëlja e ekzemplarëve të bimëve përdhese, nxjerrja e gurëve ose bartja e tokës. Ndalohet kullotja e kafshëve, mbledhja e gjetheve, barit dhe ngjashëm. Ndalohet çdo lloj i gjuetisë, vrasja apo zhdukja e cilës do shtazë të egër, apo shpeze ose insekti, si dhe kalimi i poterës së gjuetisë, ose përzënja e egërsirave në qëllim të gjuajtjes jashtë zonës së mbrojtur. Ndalohet peshkimi i peshqeve, ose prurja e ndonjë lloji peshku. Ndalohet mbjellja e llojeve të huaja (egzotëve), ose prurja e shtazëve që nuk i takojnë këtij lokaliteti, me ç'rast mund të shkaktojnë çrregullimin e ekuilibrit biologjik. Ndalohet zbatimi i çfarë do veprimtarie ndërtimore, apo tokësor, ose tjetër goftë, e cila do të shkaktojë dëmtimin e specifiteteve dhe fenomenit natyror të relëfit. Ndalohet ndotja e ujit të lumit, dëmtimi i birqjeve të lumit, formacioneve shkëmbore, shfrytëzimi i gurit, si dhe veprimtaritë e tjera të cilat do të rezikojnë objektin në vlerën e tij natyrore.

b) Zona e gjërë (mbrojtëse), në territorin e komunës së Rahovecit përfshin sipërfaqen prej 70.09.23 ha. nga e cila në pronësi shoqërore 34.45.03 ha e në pronësi private 35.64.20 ha. Në kuadër të kësaj zone hyjnë këto ngastra kadastrale:

Në komunën kadastrale Gexhe: pjesa e parcelës nr. 631, 632 dhe 633 si dhe parcelat e tëra: 623, 624, 625, 626, 627, 628, 629 dhe 630.

Në komunën kadastrale Xërxe: pjesa e parcelës nr. 772 si dhe parcelat e tëra: 774, 779, 781, 782, 783, 784, 785, 786, 787, 788, 815/1, 815/2, 816/1, 816/2, 816/3, 816/4, 817, 818, 819, 820, 821, 822, 823, 824, 825, 826, 827, 828/1, 828/2, 829/1, 829/2, 830, 831, 832/1, 832/2, 838, 839, 840, 841, 842, 843, 844, 845, 846, 847, 850, 851, 854, 867, 868, 869, 870, 871, 872, 873, 874, 875, 876, 877/1, 877/2, 878/1, 878/2, 906, 907, 908, 909, 910, 911, 912, 913, 914, 915, 916, 917/1, 917/2, 918.

Organizimi i mbrojtjes, rregullimit, përparimit, ruajtjes mirëmbajtjes dhe shfrytëzimit të ambientit natyror në këtë zonë do të përcaktohet me Planin hapsiror dhe projektet destinuese, në të cilët do të japë pëlqim Enti Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës e i aprovon Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Neni 4

Monumenti natyror ndodhet në kufirin administrativ ndërmjet territorit të KK të Gjakovës dhe KK të Rahovecit, prandaj kuvendet e këtyre dy komunave janë marë vesh që njëkohësisht të marrin vendim mbi shpalljen e territoreve të tyre veç e veç si monument natyror, e që objekti si tërësi mer trajtimin e merituar mbrojtës.

Neni 5

Punët të cilat, eventualisht do të jenë të nevojshme në qëllim të ruajtjes së gjendjes së tanishme, ose sigurimit (konzer-vimit) të objekteve të veçantë natyror ose sipërfaqeve të veçanta: punët në qëllim të studimeve shkencore, kulturore-arsimore, edukative, turistiko-rekreative dhe sportive mund të bëhen në pëlqimin me Entin Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës.

Neni 6

Punët konservatoreske, restaurike dhepunët përkatëse arqitektoniko-urbanistike dhe dhënja e formës së sipërfaqeve të lira, mund të kryhen vetëm në pajtim me karakteristikat e peisazhit dhe ambientit natyror të tërë territorit, me të cilat do të përfaqësojë një tërësi organike.

Neni 7

Planet dhe projektet ekonomike, pyjore, komunale, urban stike etj, nëse kanë ndikese në ndryshimin e gjendjes së territorit të mbrojtur, pa tjetër duhet të harmonizohen me regjimin e rapare me këtë vendim të mbrojtjes.

Neni 8

Kryesit e punëve, në kundërshtim me këtë vendim, të kryera në objektin e mbrojtur do të dënohen sipas dispozitave përkatëse të Ligjit mbi mbrojtjen e natyrës së KSA të Kosovës, respektivisht sipas dispozitave të Ligjit penal.

Neni 9

Me vënjen e territorit të Kanionit të Drinit të Bardhë nën mbrojtje, njëkohësisht me këtë vendim, në kuptimin e dispozitave të Ligjit mbi mbrojtjen e natyrës së KSAK përcaktohet interesi i përgjithshëm i objektit.

Neni 10

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Sekretariati për ekonomi, punët komunale dhe urbanizëm i komunës së Rahovecit.

Neni 11

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të KSAK".

01 nr. 352-13

Rahovec, më 9 prill 1986

Kuvendi i Komunës së Rahovecit

- Dhoma e Punës së Bashkuar -
- Dhoma e Bashkësive Lokale -

Kryetari i Kuvendit

Bejhan Jaha

Kryetari i DHPB

Trajko Milosavljević

Kryetari i DHBL

Misin Palushi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008), nenit 10 paragrafi 10.2 dhe 10.5 shkronja (b) të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokat Bujqësore, nenit 6 paragrafi 6.3 dhe nenit 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, 39, 40 dhe 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. merr këtë:

V E N D I M

Për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/1515/19.11.2020 i datës 19.11.2020 dhe merret vendimi për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës P-71510056-00062-3.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, toka me destinim bujqësor, parcela kadastrale Nr. P-71510056-00062-3 kullosë e klasës 6, në sipërfaqe të përgjithshme prej 560m² (pesëqind e gjashtëdhjetë metra katror), e evidentuar në certifikatën e pronësisë P-71510056-00062-3, zonë kadastrale Opuerushë, pronë private në pronësi të Melit (Axhi) Bytyqi, destinohet tokë ndërtimore.
3. Kompensimi për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi do të paguhet në procedurë administrative të marrjes së lejes së ndërtimit sipas dispozitave të nenit 14 paragrafi 14.2 shkronja b të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore.
4. Obligohet pronari që paluajtshmërinë për ndërrim destinim ta shfrytëzojë sipas kërkesës së parashtruar.
5. Për zbatimin e këtij propozimi do të kujdeset Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Urbanizëm , Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në web-faqen e Komunës së Rahovecit.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

K U V E N D I I K O M U N Ě S Ě R A H O V E C

01-Nr. ____/20
Me datë: 30.11.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
Uprava za Urbanizam, planiranje i zashtitu okoline
Department for Urbanism, planning and environment protection

Sektori për Urbanizëm
Odeljenje za Urbanizam
Sector for Urbanism

12Nr. 07

Rahovec, 24.01.2020

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, duke vendosur sipas kërkesës për lëshimin e Kushteve Ndërtimore të MELIT BYTYQI nga fshati Oterushë komuna e Rahovecit, 12Nr.07, Nr. i protokollit 12-351/02-0001741/20, të dt. 10.01.2020, duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04 / L - 174 të datës 31.07.2013, neneve 17, 18, 19 dhe nenit, 20 të Ligjit për ndërtim Nr. 04 / L - 110 të datës 31.05.2012, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2017 për Kategorizimin e ndërtimeve, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgaditjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushtet ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, si dhe nenit 14, 31 dhe 33 të Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive me 01 nr. 109 të datës 14.07.2006, neni 84 dhe 85 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr.1005 të datës 29.03.2017 dhe neneve 3, 21, 22 dhe 44 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative Nr.05/L-031 të datës 25.05.2016 kjo drejtori lëshon këto:

K U S H T E T N D Ë R T I M O R E

1. APROVOHET Kërkesa e Melit Bytyqi nga fshati Oterushë komuna e Rahovecit për ndërtimin e Objektivit të Banimit - Shtëpi e veçant me garazhë, me Etazhitetë P+1, Objekt i kategorisë së I-rë. Kushtet Ndërtimore i lejohen në Zonën Kadastrale Oterushë, në rrugën fushore nr. p.n. , në ngastrën kadastrale nr. 62-3, të evidentuarë në certifikatën nr. 08-942/03-0000907/20 të datës 06.01.2020, Vendbanimi - adresa VINISHTE-SADE, Lloji i pronës Pronë private, Shfrytëzimi aktual i parcelës Tokë Bujqësore-Kullosë-Kullosë e Klasës 6, Zona kadastrale Rahovec.

2. Lokacioni për të cilin caktohen kushtet ndërtimore sipas këtyre kushteve ndërtimore gjendet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal (PZH) 01nr. 2566 të datës 30.05.2013 dhe kanë destinim të përhershëm.

3. Ngastra ndërtimore e ka formën sipas kopjes së planit me sipërfaqe të parcelës prej 5 ari 60 m² (S=560 m²), e drejta pronësore-juridike në bazë të certifikatës dhe kopjes së planit, tokë e ndërtuar dhe me infrastrukturë të ujësjellësit , kanalizimi fekalë , rrjetit elektrikë dhe rrugë urbane.


4. Sipas gjendjes së planifikuar për realizimin e objektit , kushtet e lokacionit janë:

- Destinimi i shfrytëzimit: Ndërtimi i Objektivit të Banimit - Shtëpi e veçant me garazhë,
- Karakteri: Objekt i Përhershëm, Gabariti i përdhësës (11.75x8.20)+(5.75x6.55)m', ose sipërfaqe prej (S=134.01 m²), sipas Lejes së Lokacionit,
- Përshkrimi i prezantimit grafik në dispozicionin urbanistik që është pjesë përbërëse e këtyre Kushteve Ndërtimore në përpjesë P = 1: 300
- Prezantimi i situacionit të terrenit,që është pjesë përbërëse e këtyre Kushteve Ndërtimore në përpjesë P=1:500
- Vija ndërtimore e larguar prej skajit të Rrugës Fushore për 10.36m'.
- Vija e rregulluese e larguar prej skajit të Rrugës Fushore për 1.00m'.
- Standardet dhe normativat teknike-urbanistike, respektimi i lokacionit të prezantuar në planin e situacionit.
- Rregullimi horizontal i objektit respektimi i vijës ndërtimore dhe vijës rregullative.
- Rregullimi vertikal i objektit respektimi i etazhitetit të objektit P+1
- Pozita Sipas kushteve të lokacionit të terrenit ,

LOKACIONI HAPËSINOR

Legjenda:

-  Parcela Kadastrale
-  Objekt i Ri
-  Rrugë Ekzistuese
-  Hyrja kryesore
-  Hyrja për garazhë



- **LEJOHET** Lokacioni Hapësinor për **Ndërtimin e Objektit të Banimit me garazhë (Objekt i Kategorisë së I-rë)**, investitorit (Pronarit) **MELIT BYTYQI** nga fshati **Opterushë** Komuna e **Rahovecit**, Kushtet **Ndërtimore** i lejohen në ngastrën kadastrale nr. **62-3**, të evidentuarë në çertifikatën nr. **08-942/03-0000907/20** të datës **06.01.2020**, në Zonën Kadastrale **Opterushë**.

Objekti të ndërtohet sipas **KUSHTEVE NDËRTIMORE** - si më poshtë:

- **Gabariti:** Gabariti i përdhësës $(11.75 \times 8.20) + (5.75 \times 6.55) \text{ m}^2$, ose sipërfaqe prej $(S = 134.01 \text{ m}^2)$, gjithsej sipas skicës së Lokacionit Hapësinor.

- **Etazhiteti P+1**

- **Hyrjet në Objekt:** Hyrja **Kryesore** kah ana jug-perendimore, kurse ne garazhë kah ana veri-perendimore.

- **Vija E NDËRTIMIT** e larguar prej skajit të Rrugës **Fushore** për **10.36 m'**.

- **Vija e RREGULLUESE** e larguar prej skajit të Rrugës **Fushore** për **1.00 m'**.

Të respektohen kushtet Ndërtimore sipas skicës.

Rahovec. 24.01.2020

Hartoi:
Shpejtim MUSTAFA

Drejtori:
Rumir ZHUNIQI

[Signature]



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government


Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Oterushë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m2
P-71510056-00062-3	Parcelë / Parcela / Parcel	560,0



Shkalla/Razmera/Scale: 1:310

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.01.2020

Koha/ Vreme/ Time: 11:03:07

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E MËDITIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR / MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA / MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510056-00062-3

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 08-942/03-0000907/20
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 06.01.2020 - 15:49
Komuna / Opština / Municipality: Rahovec / Orahovac / Rahovec
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: OPTERUSHË / OPTERUŠA / OPTERUSHË
Zyra kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office: Rahovec / Orahovac / Rahovec

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71510056-00062-3	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë private / Privatna imovina / Privately owned Land	Rural	560	rip-mr 1-2018	13.06.2018	13.06.2018

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostilne adrese Address Details	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
VINISHTE-SADE/VINISHTE-SADE/VINISHTE-SADE		VINISHTE-SADE	13.06.2018	13.06.2018

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenumto koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësori/Polljoptivredno/Agriculture	Kulllosat/Pashnjat/pasture	Kulllosë E Klases 6/Pashnjat 6 Klase/6th Class Pasture	560

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personat Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi posttal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Drzavina / single possessor	Bytyqi Mehit (Axhi)	1030203719	OPTERUSHE / OPTERUSHA / OPTERUSHE /		Opterushe	1/1	Nr.Pro. 264-2018	19.06.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12.2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (f) dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe 46 paragrafi 1 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.11.2020, merr këtë:

V E N D I M

Për vënien në debat publik të Koncept Planit për Deponin e Mbeturinave të Ngurta

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit merr vendim për vënien në debat publik të Koncept Planit për Deponin e Mbeturinave të ngurta në Komunën e Rahovecit.
2. Të drejtë pjesëmarrje në debat publik kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe subjektet të tjera të interesuara.
3. Për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së debatit publik qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara do të njoftohen përmes web - faqes zyrtare të Komunës dhe shpalljes publike në tabelën e shpalljeve .
4. Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet, komentet etj. (verbale dhe me shkrim), mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e debatit publik drejtpërdrejtë ose përmes zyrës së Kuvendit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe zyra e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Shërbime Publike,***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ___/20
Me datë:30.11.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12.2 shkronja (d), nenit 17 shkronja (f) dhe nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe 46 paragrafi 1 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.6 i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt.30.11.2020, merr këtë:

V E N D I M

Për vënien në debat publik të Koncept Planit për Deponin e Mbeturinave të Vëllimshme

1. Kuvendi i Komunës së Rahovecit merr vendim për vënien në debat publik të Koncept Planit për Deponin e Mbeturinave të Vëllimshme në Komunën e Rahovecit.
2. Të drejtë pjesëmarrje në debat publik kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe subjektet të tjera të interesuara.
3. Për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së debatit publik qytetarët dhe subjektet tjera të interesuara do të njoftohen përmes web - faqes zyrtare të Komunës dhe shpalljes publike në tabelën e shpalljeve .
4. Pyetjet, vërejtjet, sugjerimet, komentet etj. (verbale dhe me shkrim), mund ti drejtohen ekipit për përcjelljen e debatit publik drejtpërdrejtë ose përmes zyrës së Kuvendit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Publike dhe zyra e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Shërbime Publike,***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr. ___/20
Me datë: 30.11.2020

Afrim Dina

Kryesues i Kuvendit